



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

**RAPORT PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË AGJENCINË KOMBËTARE
TË UJËSJELLËS-KANALIZIMEVE DHE INFRASTRUKTURËS SË
MBETJEVE**

RAPORT AUDITIMI

MBI PËRPUTHSHMËRINË

NË

**AGJENCINË KOMBËTARE TË UJËSJELLËS KANALIZIMEVE DHE
INFRASTRUKTURËS SË MBETJEVE**

PRILL 2022

Nr.	Përmbajtja	Faqe
I.	PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	
1.	Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit.....	3
2.	Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve.....	3
3.	Konkluzion i përgjithshëm dhe opinion i auditimit.....	10
II.	HYRJA	
1	Objekti i auditimit.....	11
2	Qëllimi i auditimit.....	11
3	Identifikimi i çështjes.....	11
4	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese.....	12
5	Përgjegjësitë e audituesve.....	12
6	Kriteret e vlerësimit.....	12
7	Standardet e auditimit.....	13
8	Metoda e auditimit.....	13
9	Dokumentimi i auditimit	13
III.	PËRSHRIMI I AUDITIMIT.....	14
1.	Informacion i përgjithshëm mbi subjektin	14
2.	Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit.....	14
III.1	Pika 1. Mbi hartimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit.....	14-22
III.2	Pika 2. Zbatimi i dispozitave ligjore për administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare.....	22-28
III.3	Pika 3. Zbatimi i procesit të shpronësimit për interes publik. Marrëdhëniet e Agjencia Kombëtare e Ujësjellës Kanalizimeve, me ministrinë e linjave, me njësitë e qeverisjes vendore dhe me komunitetin në lidhje me shpronësimet publike.....	28-47
III.4	Pika 4. Vlerësimi i detyrave të projektimit, të projekteve të zbatimit, preventivave të zbatimit dhe studimeve të ndryshme. Auditimi i burimeve të financimit, të pagesave apo sponsorizimeve (dhurimeve) të bëra për këto shërbime.....	47-48
III.5	Pika 5. Mbi zbatimin e procedurave të prokurimit publik për punime, mallra dhe shërbime. a. Vlerësimi i hartimit të nevojave për ndërtime, mallra dhe shërbime në infrastrukturën e Ujësjellës Kanalizime. b. Argumentimi dhe përlogaritja e fondit limit. c. Hartimi i dokumenteve të tenderit. d. Zbatimi dhe vlerësimi i procedurave të prokurimit nga momenti i nxjerrjes së urdhrat të prokurimit deri në lidhjen e kontratës.....	48-74
III.6	Pika 6. Mbi zbatimin e kontratave për punime, mallra dhe shërbime. a. Lidhja e kontratave, ndryshimet dhe shtesat përkatëse, si dhe realizimi në sasi e cilësi. b. Zbatimi i afateve të përfundimit të kontratave.....	74-102
III.7	Pika 7. Mbi zbatimin e procedurave të prokurimit për blerjet me vlera të vogël.....	102-115
III.8	Pika 8. Zbatimi i rekomandimeve të lëna nga auditimet e mëparshme.	115-123
IV.	GJETJET DHE REKOMANDIMET.....	123-144
V.	ANEKSE.....	144-156

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit.

Agjencia Kombëtare e Ujësjetës-Kanalizime dhe Infrastrukturës së Mbetjeve është i vetmi organ shtetëror i specializuar në fushën e furnizimit me ujë të pijshëm, kanalizimeve të ujërave të zëza dhe të bardha si dhe trajtimit të tyre (infrastrukturës ujore). Ajo mbështet teknikisht politikat e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, në përputhje me legjislacionin dhe politikat e Qeverisë të përcaktuara në strategjitë sektoriale.

Roli i AKUM në fushën e veprimtarisë së saj është që të realizojë nëpërmjet autoritetit të saj ligjor dhe teknik, koordinimin dhe monitorimin e aktivitetit për sigurimin e furnizimit me ujë, kanalizimeve të ujërave të përdorura dhe trajtimit të tyre për të gjithë popullsinë e vendit, në bashkëpunim me pushtetin vendor dhe subjektet e menaxhimit të infrastrukturës ujore.

Objekti, qëllimi dhe fushë veprimi i auditimit është përputhshmëria aktivitetit të subjektit për periudhën nga 31.07.2019 deri më datë 30.06.2021.

Është audituar aktiviteti i Institucionit për periudhën e auditimit, fokusuar kryesisht në operacione financiare, por jo vetëm. Konkretisht janë audituar realizimi i buxhetit, shpenzime për investime, shpenzimet operative, realizimi i prokurimeve dhe kontratave përkatëse, etj.

2. Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve.

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Referenca me Raportin Përfundimtar të auditimit.	Rëndësia	Rekomandimi
1	Nga auditimi i dokumentacionit në lidhje me zbatimin e kontratës me objekt <i>‘Përmirësimi i Infrastrukturës së Ujërave të Zeza në zonën Bregdetare, Vlorë’</i> , rezultoi se punimet e konsideruara si të përfunduara nga palët (sipërmarrës, mbikëqyrës) nuk janë kolauduar nga ana e Grupit të Punës të ngritur me Urdhrin nr. 1136 prot., datë 31.05.2021 gjithashtu nga ana e Autoritetit Kontraktor nuk është miratuar situacioni përfundimtar i punimeve dhe as ai i përdorimit të fondit rezervë. Grupi i punës më datën 22.04.2021 ka miratuar situacionin nr. 5 i cili nga ana e sipërmarrësit është dorëzuar me datë 02.03.2021 dhe nga ana e mbikëqyrësit të punimeve më datën 02.03.2021, kur si datë e përfundimit të punimeve ishte parashikuar data 15.02.2021. Autoriteti Kontraktor gjatë periudhës në auditim nuk ka paraqitur dokumentacion për marrjen në dorëzim dhe miratim të situacionin përfundimtar nr. 6, por për ta konfirmuar atë nëse është apo jo i vërtetë dhe nëse punimet janë kryer konform kontratës së sipërmarrjes. Nga ish Titullarit z. C.K., me Urdhrin nr. 69, datë 07.10.2021, administruar në AKUK me nr. 1926, prot., datë 07.10.2021, për monitorimin e situacionit përfundimtar nr. 6 dhe fondit rezervë është ngritur Grupi i Punës. Ky Grup Pune ka hartuar një	Pika 6	E Lartë	Nga AKUM të merren masat e nevojshmet për nxjerrjen e përgjegjësisë dhe shmangien e praktikave të cilat ndikojnë në përdorimin pa efektivitet, eficiencë dhe ekonomikitet të fondeve si pasojë e mos përmblotjes se qëllimeve kryesore të investimeve në vlerën prej 25,715,880 lekë pa TVSH e shkaktuar në kontratën e lidhur mes sipërmarrësit BOE óV.H.&B.I&E.” si penalitet i aplikuar për vonesa në realizimin e kontratës së sipërmarrjes të lidhur sipas aktit me nr. 2446 prot., datë 26.08.2019 me objekt <i>‘Përmirësimi i Infrastrukturës së Ujërave të Zeza në zonën Bregdetare, Vlorë’</i> .

	shkresë drejtuar Drejtorisë Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse duke vënë në dijeni edhe Titullarin mbi faktin se në stacionin 102/1 ku mblidhen prurjet e të gjitha stacioneve të tjera, pompat e reja të vendosura me investimin e realizuar nga sipërmarrësi BOE V.H.&B.I&E., ishin nxjerrë jashtë stacionit të pompimit dhe ishin çmontuar nga vetë UK Vlorë me argumentin se në reshjet e fundit në qytetin e Vlorës këto pompa nuk arrinin të përçonin prurjen maksimale duke shkaktuar përmytje. Për këtë arsye nga ana e Grupit të Punës u la si detyrë që kontraktori të bënte dhe një herë kontrollin mbi konfigurimin e pompave nëse defekti fillon aty apo nga projektuesi në kriteret e projektimit për pompat që ka vendosur në projekt, pasi kontraktori thekson se çdo pompë është marrë sipër specifikimeve teknike përkatëse të projektit. Në fakt sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se nuk disponohen testimet e kryera në zbatim të pikës 4.16 TESTIMI DHE INSPEKTIMI I PAJISJEVE të dokumentit me titull Rehabilitimi i Sistemit të Stacioneve të Pompimit të K.U.Z Vlorë, Specifikimet Teknike. Në përfundim, rezulton se edhe pas datës në të cilën punimet duhet të kishin përfunduar, ky grup pune ka lenë rekomandime sikur kontrata të ishte ende në proces apo si të ishte grup kolaudimi dhe nga asnjë prej palëve përgjegjës nuk janë marrë masa për aplikimin e penaliteteve duke favorizuar padrejtësisht sipërmarrësin e punimeve. Situacionet dhe likuidimet përkatëse paraqiten sipas tabelës së paraqitur në Aneksin nr. 2.6.1.2. Duke patur parasysh se vlera e kontratës pas ndryshimeve dhe miratimeve të marra nga ana e Projektuesit dhe Autoritetit Kontraktor është në masën 441,699,656 lekë me TVSH rezulton se <u>punimet e pa miratuara dhe të pa marra aktualisht në dorëzim nga ana e Autoritetit Kontraktor janë në vlerën 163,931,250 lekë me TVSH, ose 37 % e vlerës së kontratës.</u> Nga ana e ish në Titullarit të Autoritetit Kontraktor z. C.K., ish në zv. Drejtorit të Përgjithshëm z. F.Sh. si dhe mbikëqyrësi i punimeve BOE D.&H.S. nuk janë marrë masa për aplikimin e penaliteteve për vonesa në përfundimin në afat të zbatimit të kontratës dhe realizimin e punimeve, kjo në zbatim të nenit 38 të lidhur sipas aktit nr. 2446 prot., datë 26.08.2019, e ndryshuar. Konkretisht rezulton se ndaj sipërmarrësit të punimeve nuk janë aplikuar penalitetet për dorëzimin me vonesë të situacionit nr. 5 dhe mos dorëzimit deri aktualisht të situacionit nr. 6 i përlogaritur sipas tabelës së paraqitur në aneksin nr. 2.6.1.3. Vlera e pa aplikuar e penaliteteve prej 25,715,880 lekë			
--	---	--	--	--

	përbën përdorim pa efektivitet, eficiencë dhe ekonomikitet të fondeve të AKUM për shkak të mos arritjes së funksionit kryesor të këtij investimi dhe si e tillë ka rënduar situatën financiare të AKUM dhe atë funksionale të investimit në Ujësjellës Kanalizime Vlorë. Sa më sipër është në kundërshtim me Ligjin nr. 10 296 <i>“Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”</i>, neni 8, pika 1, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 <i>“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”</i>, i ndryshuar, neni 77 <i>Mbikëqyrja e kontratës</i>, Kontrata e sipërmarrjes së punimeve të lidhur sipas aktit nr. 2446 prot., datë 26.08.2019, e ndryshuar, neni 38 si dhe me kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes me objekt <i>‘Përmirësimi i Infrastrukturës së Ujërave të Zeza në zonën Bregdetare, Vlorë’</i>.			
2	Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me zbatimin e kontratës nr. 3889 prot., datë 31.12.2019 me objekt <i>‘Përmirësimi i furnizimit me ujë për lagjen Krastë e Vogël, Harmës dhe qytetin e Elbasanit’</i>, me vlerë 320,833,499.7 lekë me TVSh, me afat të zbatimit të punimeve 12 muaj, lidhur midis BOE óL.&B.&A.K.&B.ó, SHPK të përfaqësuar nga OE óL.ó SHPK dhe Autoritetin Kontraktor i përfaqësuar nga z. A.B. rezultoi se: Nga auditimi i dosjes teknike të kontratës, krahasimi i librezës së masave, situacionit progresiv, projektit të miratuar me ndryshime, etj. rezultoi se i janë likuiduar 4 zëra punimesh të situacionuara por të pakryera në fakt në vlerën 10,880,258 lekë pa TVSh, (<i>Aneksi 2.6.2.1</i>). Sa më sipër është në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 <i>“Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi”</i>, i ndryshuar, Kreu III, Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 <i>“Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”</i>, i ndryshuar me Udhëzimin nr. 1, datë 16.6.2011, Kreu I, pika 3, nënpikat 3.2 dhe 3.3 si dhe me kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes me objekt <i>“Përmirësimi i furnizimit me ujë për lagjen Krastë e Vogël, Harmës dhe qytetin e Elbasanit”</i> lidhur sipas aktit nr. 3166 prot., datë 23.10.2019.	Pika 6	E lartë	Nga ana e AKUM të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit arkëtimi i vlerës 10,880,258 lekë pa TVSH nga sipërmarrësit BOE óL.&B.&A.K.&B.ó SHPK sa përfituar padrejtësisht punime të pakryera por të likuiduara.
3	Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me zbatimin e kontratës nr. 2446 prot., datë 26.08.2019 me objekt <i>‘Përmirësimi i Infrastrukturës së Ujërave të Zeza në zonën Bregdetare, Vlorë’</i>, me vlerë 462,629,496 lekë me TVSh, me afat të zbatimit të punimeve 12 muaj, lidhur midis BOE óV.H.&B.I&E.ó, SHPK të përfaqësuar nga OE óV. H.ó SHPK dhe Autoritetin Kontraktor i përfaqësuar nga z. A.B. rezultoi se: Nga auditimi i dosjes teknike të kontratës, krahasimi i	Pika 6	E lartë	Nga ana e AKUM të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit arkëtimi i vlerës 8,364,636 lekë pa TVSH nga sipërmarrësit BOE óV.H.&B.I&E.ó SHPK sa përfituar

	librezës së masave, situacionit progresiv, projektit të miratuar me ndryshime, etj. rezultoi se i janë likuiduar 17 zëra punimesh të situacionuara por të pakryera në fakt në vlerën 8,364,636 lekë pa TVSh, (<i>Aneksi 2.6.1.1</i>). Sa më sipër është në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar me Udhëzimin nr. 1, datë 16.6.2011, Kreu I, pika 3, nënpikat 3.2 dhe 3.3 si dhe me kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes me objekt “Përmirësimi i furnizimit me ujë për lagjen Krastë e Vogël, Harmes dhe qytetin e Elbasanit” lidhur sipas aktit nr. 1226 prot., datë 26.04.2019.			padrejtësisht punime të pakryera por të likuiduara.
4.	Gjatë zbatimit të kontratës óNdërtim i kolektorit kryesor të ujërave të zeza dhe I.T.U.P në Gjirin e L.zitô, janë bërë ndryshime të cilat kanë rezultuar edhe me zëra të rinj punimesh. Nga verifikimi i analizës së kostos së tyre, konstatohen mangësi si më poshtë: - Sipas zërit 2.2.5 (2.116 + an.23) óRrethim me mur me blloqe betoni, kanxhella dhe derë hyrëseô, por edhe për rrethimet e stacioneve të pompave, është përfshirë zë i ri i punimeve óTrarë themeli beton monolit C 20/25ô. Çmimi i aplikuar për këtë zë është 15,145 lekë/m³. Nga analiza e çmimit konstatohet se ka rritje të sasisë për zërin kallëpe konkretisht, kallëp muri nga përcaktimi në manual në sasinë 3.5 m², është aplikuar sasia 10 m² dhe kallëp trari nga 3.5 m² në 4 m². Çmimi i betonit C 20/25 në manual është 5,388 lekë/m³, ndërsa në analizën e re është paraqitur 6,629 lekë/m³. Çmimi i betonit është rritur me pretendimin se duhet përdorur betopompa, por në këtë rast nuk kemi hedhje të betonit në lartësi. Nga ribërja e llogaritjeve rezulton se çmimi që duhet të aplikohet të ishte 12,376 lekë/m³. Sipas këtij zëri është likuiduar sasia 148.8 m³. Vlera 412,027 lekë [148.8 m³ x (15,145 ñ 12,376)], është përfituar padrejtësisht nga Kontraktori óS.Aô SHPK dhe përbën dëm ekonomik. - Sipas zërit 2.2.5 (2.116 + an.23) óRrethim me mur me blloqe betoni, kanxhella dhe derë hyrëseô, për kolonat metalike profil katror me dimensione (5 x 5 cm x 1.5 mm), me lartësi 1.75 m, është aplikuar çmimi 4,660 lekë për copë. Nga verifikimi i këtij çmimi në sitin e Subjektit óM.ô, rezulton se për profil me gjatësi 6 m, çmimi është 3,140 lekë, ose 1050 lekë për kolonë (890 lekë + 18 % struktura). Nga verifikimi i manualit të çmimeve të ndërtimit viti 2015, rezulton se çmimi i hekurit profil dhe shirit është 94 lekë për kg, ose 827.2 lekë për kolonë. Duke marrë në konsideratë çmimin e tregut (1050 lekë për kolonë) si dhe numrin 277 copë	Pika 6	E lartë	AKUM të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykit, arkëtimin e vlerës 3,720,837 lekë , nga Kontraktori BOE “S.A” SHPK, përfituar padrejtësisht si pasojë e mangësive në hartimin e analizës së kostos së punimeve të ndërtimit.

	impianti dhe 53 copë stacionet e pompimit), vlera 1,191,300 lekë [(4,660 lekë në 1,050 lekë) x 330 copë], është përfituar padrejtësisht nga kontraktori óS.Aó dhe përbën dëm ekonomik. - Nga shqyrtimi i zërit 1.1.B.3 óMbikallim i linjës me presionó rezulton se janë përfshirë konstruksione metalike për mbështjen e tubit në sasinë 16.43 ton, me çmim 216,364 lekë/ton. Nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se në konstruksione metalike është përfshirë tubacioni me diametër Ø 711 mm dhe spesor 11 mm, me gjatësi 82 m. Nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se në kontratën bazë, për ndërtimin e kalimit ishte parashikuar çmimi për tubacion çeliku është 187,111 lekë për ton dhe i konstruksionit metalik 216,364 lekë/ton. Sa më sipër, çmimi i tubit të çelikut duhet të ndahej nga çmimi i konstruksioneve metalike. Pesha e tubit e përcaktuar konstruksion është 15.3 ton. Vlera 447,571 lekë (216,364 -187,111) x 15.3 ton, është përfituar padrejtësisht nga kontraktori óS.Aó dhe përbën dëm ekonomik. - Nga shqyrtimi i zërit óPropozime shtesa V.Oó, nënzhëri óRezervuar betoni me volum 36.9 m³ó, janë përfshirë punime elektrike, kablllo, kablllo tokëzimi, ndriçues infrastrukture, për mbrojtjen nga zjarri dhe pompat, është parashikuar vlera 1,593,879 lekë. Nga verifikimi i analizës së çmimeve të detajuar rezulton se është përfshirë transport me vlerë 1,870 lekë, materiale ndërtimi me vlerë 1,364,169.5 lekë pa përfshirë 18 % të fitimit dhe shpenzime të përgjithshme (63,771 lekë transport, 76,525 lekë ngjeshje tabani dhe 1,223,873 lekë shtresë çakulli). Vendosja e vlerës së mësipërme pa asnjë argumentim, për zëra që nuk kanë të bëjnë me punime elektrike, si dhe duke marrë në konsideratë se sistemi zjarrfikës parashikohet më vete, vlera e likuiduar në shumën 1,539,879 lekë, është përfituar padrejtësisht nga Kontraktori óS.Aó SHPK dhe përbën dëm ekonomik. -Sipas zërit óNdërtim linje elektrike kablllore nëntokësore me kablllo 24 kV, ALXLPE. 3 x 1 x 240/25 mm², sipas rregullores së OSHEE, sipas tipologjisë së zonës ku kalon linja, mufta dhe terminale për kabllot, tuba çeliku Ø 160 mm për intersektimet me rrugë të linjës, shtresë mbrojtëse me tulla të plota dhe shirit sinjalizuesó,rezulton se analiza e çmimit është rishikuar për të gjithë elementët dhe jo vetëm për elementët e shtuar. Në këtë analizë çmimi, sa i përket shtresës mbrojtëse me tulla të plota, krahas materialit dhe punëtorisë, është përfshirë edhe zëri makineri, zë i cili mund të përfshihet në rast të ndërtimit të murit dhe jo shtresë me tulla. Vlera 130,060 lekë (20,150 x 18%			
--	---	--	--	--

	x 5.47 km), është përfituar padrejtësisht nga Kontraktori óS.Aó SHPK dhe përbën dëm ekonomik. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me VKM nr. 514, datë 15.08.2007 óPër informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të ndërtimitó ndryshuar, pika 2 dhe 11, Udhëzimi i Këshillit Të Ministrave nr. 2, datë 08.05.2003 óPër klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimitó si dhe VKM nr. 629, datë 15.7.2015 óPër miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyreó, pika 4			
5	Në lidhje me proceset gjyqësore në të cilat shoqëria është palë, nga dokumentacioni i vënë në dispozicion konstatohet se për periudhën objekt auditimi janë humbur 10 çështje gjyqësore, duke e detyruar institucionin të paguajë vlerën 126,031,384 lekë e cila përbën efekt financiar negative për buxhetin e shtetit ; si dëmshtëpërblim për ndërprerje të paligjshme të marrëdhënieve të punës n vlerën 8,740,707 lek, si dëmshtëpërblim për shpronësime n mas t pa drejt n vlerën 19,850,459 lek dhe si dëmshtëpërblim për kontratat e investimit n vlerën 97,440,218 lek, shpenzime përmbartimore për kto venime kapin vlerën e 6,443,953 lek dhe shpenzimet gjyqësore n vlerën 851,287 lek (Më hollësisht trajtuar në Pikën 2, faqe 19 deri 24 të Projektraportit të Auditimit).	Pika 2	E lartë	Nga Drejtori i Përgjithshëm, Departamenti Ligjor dhe Departamenti i Ekonomik i AKUM të merren masa për ndjekjen me përgjegjësi të gjitha proceseve gjyqësore t iniciuara ndaj Institucionit, për menaxhimin sa m t mir t fondeve publike. Drejtuesit e institucionit duhet t shmangin n maksimum detyrimin e tarifave përmbartimore dhe likuidimin e detyrimeve t rrjedhura nga vendimmarrjet e gabuara n mnyr vullnetare për t shmangur tarifat përmbartimore q kan kapin vlerën e 6,443,953 lek. N do rast t nxirren përgjegjësit dhe t merren masat e duhura.

3. Konkluzion i përgjithshëm dhe opinioni i auditimit.

Nga auditimi i kryer pranë AKUM, për periudhën 31.07.2019 deri datë 30.06.2021, lidhur me përputhshmërinë, rezultoi se:

Bazuar në punën e kryer të auditimit, evidencat e marra për veprimtarinë ekonomike dhe financiare të AKUM, të periudhës 31.07.2019 deri më 30.06.2021, rezultoi se:

Është konstatuar dëm ekonomik në vlerë **22,965,731 lekë pa TVSH**, kryesisht në zbatimin e kontratave të punimeve civile, për punime të pa kryera, mos aplikim penaltetesh, përcaktim të çmimeve të zërave të punimeve në kundërshtim me manualet e çmimeve teknike.

Janë konstatuar shpenzime pa ekonomikitet, efikasitet dhe efektivitet, me vlerë **155,149,641 lekë**, në lidhje me proceset gjyqësore në të cilat shoqëria është palë.

OPINIONI I AUDITIMIT

-Nga opinionit i auditimit mbi përputhshmërinë e veprimtarisë së AKUM, sa i takon shkallës së zbatueshmërisë së rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura, termave dhe kushteve, mbi të cilat ky institucion realizon misionin e tij, (kriteret e auditimit të përputhshmërisë), janë konstatuar disa mangësi dhe parregullsi. Gjatë auditimit në terren janë marrë të dhëna të mjaftueshme të cilat mundësojnë dhënien e opinionit.

Opinion i kualifikuar mbi përputhshmërinë¹

Sipas opinionit të KLSH-së, nga auditimi i përputhshmërisë, i mbështetur në lidhin nr. 154/2014, miratuar në datën 27.11.2014 óPër Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, standardet INTOSAI dhe në Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë së KLSH-së, i kryer në subjektin AKUM, rezultuan devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi të cilat në gjykimin profesional të audituesit shtetëror të pavarur janë të përhapura, por jo materiale efektet e të cilave justifikojnë ***dhënien e një opinionit të kualifikuar të përputhshmërisë²***.

Baza për opinionin e kualifikuar (ISSAI 4000³)

Ne e kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik (ISSAIs), ISSAI-n 4000 óStandardi i Auditimit të Përputhshmërisë. Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, mbështetur në ISSAI-n 10ñDeklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 30- Kodi Etik. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura, përfshirë këtu dhe Kodin e Etikës së KLSH-së. Auditimi i ynë përfshin kryerjen e procedurave me qëllim marrjen e evidencave të auditimit, mbi ligjshmërinë dhe rregullshmërinë e veprimtarisë të ushtruar nga subjekti i audituar. Procedurat janë përzgjedhur mbështetur mbi gjykimin profesional të audituesit, duke marrë në konsideratë vlerësimin e riskut dhe materialitetit për subjektin e audituar.

Bazuar në punën e kryer të auditimit, evidencat e marra për veprimtarinë ekonomike dhe financiare të AKUM, të periudhës 31.07.2019 deri më 30.06.2021, rezultoi se:

Është konstatuar dëm ekonomik në vlerë 22,965,731 **lekë pa TVSH**, kryesisht në zbatimin e kontratave të punimeve civile, për punime të pa kryera, mos aplikim penalitetesh, përcaktim të çmimeve të zërave të punimeve në kundërshtim me manualin e çmimeve teknike

Janë konstatuar shpenzime pa ekonomikitet, efikasitet dhe efektivitet, me vlerë **155,059,641 lekë**, në lidhje me proceset gjyqësore në të cilat shoqëria është palë, si dhe në realizimin e procedurave të auditimit.

Përgjegjësitë e strukturave drejtuese.

Strukturat drejtuese kanë për detyrë që të përgjigjen për garantimin e sistemeve të përshtatshme dhe efektive të menaxhimit financiar dhe kontrollit, në përputhje me kërkesat e kuadrit ligjor dhe rregullator përkatës.

Strukturat drejtuese janë përgjegjëse për realizimin e objektivave dhe zbatimin e përgjegjësiave të caktuara në kuadrin ligjor dhe rregullator, për të menaxhuar fondet publike në mënyrë të ligjshme, me ekonomi, efektivitet dhe efikasitet.

Përgjegjësitë e audituesve.

Audituesit e KLSH kanë përgjegjësi në dhënien e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacioni përputhen, në të gjitha aspektet materiale, me kriteret e aplikuar si: rregullat, ligjet, politikat, kodet e vendosura apo termat dhe kushtet, mbi të cilat është rënë dakord, ku mund të përmendim si burim të këtyre kriterëve: standarde, ligje, vendime të Këshillit të Ministrave, rregullore, buxhete, kontrata, marrëveshje, instrumente të tjerë që përmbajnë rregulla se si duhet të menaxhohen transaksionet dhe zbatohen buxhetet etj;

- njëherësh aspektet e rregullshmërisë (respektimi i kriterëve formale siç janë ligjet përkatëse, rregulloret dhe marrëveshjet) dhe ligjshmërisë (respektimi i parimeve të përgjithshme që rregullojnë menaxhimin e shëndoshë financiar dhe sjelljen e zyrtarëve publik);

- promovimin e një qeverisje të mirë, duke identifikuar dhe raportuar devijimet nga kriteret, në mënyrë që të merren veprime korigjuese si dhe të identifikojë personat përgjegjës për veprimet e tyre.

¹Mbështetur në ligjin nr.154/2014 ôPër organizimin dhe funksionimin e KLSH-sëô

²Një opinion i kualifikuar shprehet kur efekti i një çështje nuk është aq material sa të justifikojë dhënien e një opinionit të kundërt.

³ISSAI 4000-Udhërrëfyeni i Auditimit të Përputhshmërisë.

II. HYRJA

Mbështetur në Ligjin nr.154/2014, datë 27.11.2014 ôPër organizimin dhe funksionimin e KLSHô, në zbatim të projektit dhe programit të auditimit të miratuar nga Kryetari i KLSH nr.888/2 prot., datë 07.09.2021, i ndryshuar, nga data 07.09.2021 deri më datë 10.12.2021, në subjektin Agjencia Kombëtare e Ujësjetllës-Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve (AKUM),për periudhën nga data 31.07.2019 deri më datë 30.06.2021, u krye auditimi ôPërputhshmërisëô nga Grupi i Auditimit me përbërje:

- 1.A. T., Përgjegjës Grupi
2. J. H.,Kryeauditues
3. S. H., Auditues
- 4.A. S., Auditues
- 5.Xh. Xh., Auditues

1. Objekti i auditimit:Raport mbi auditimin e ôPërputhshmërisëô në Agjencinë Kombëtare të Ujësjetllës-Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve, për periudhën e aktivitetit nga data 30.07.2019 deri më 30.06.2021.

2. Qëllimi i auditimit: Në objektivat dhe qëllimet e auditimit përfshihet vlerësimi objektiv i evidencave, dokumentacionit të kërkuar dhe të vënë në dispozicion, për të përcaktuar nëse të dhënat e raportuara për periudhën objekt auditimi përputhen me kriteret përkatëse të kuadrit rregullator. Objektivi i Auditimit është dhënia e opinionit nëse AKUM, në të gjithë aspektet materiale, aktiviteti ekonomik dhe financiar, transaksionet dhe informacioni janë në përputhje ose jo me dispozitat ligjore dhe rregulloret përkatëse.

Qëllimi i këtij auditimi përputhshmërie është evidentimi i devijimit nga standardet e pranuar i shkeljes së parimeve të ligjshmërisë, të menaxhimit financiar me synim ndërmarrjen e masave dhe veprimeve korigjuese nga ana e subjektit të audituar.

Auditimi i përputhshmërisëi ndërmarrë nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, ka për qëllim promovimin e qeverisjes së mirë në sektorin publik duke marrë parasysh rrezikun e mashtrimit në lidhje me përputhshmërinë (*sipas ISSAI 400, p 18*).

Me auditimin e përputhshmërisë, duhet të përcaktohet niveli i zbatimit të kuadrit ligjor në fuqi lidhur me realizimin e procedurave të prokurimit të realizuara në periudhën nën auditim.

3. Identifikimi i çështjes: Projekt Raporti mbi përputhshmërinë e veprimtarisë ekonomike dhe financiare të AKUM për periudhën 31.07.2019- 30.06.2021, ka identifikuar sipas kritereve specifike të vlerësimit, shqyrtimin dhe vlerësimin e F.ve në vijim:

- Mbi hartimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit.
- Zbatimi i dispozitave ligjore për administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare.
- Zbatimi i procesit të shpronësimit për interes publik. Marrëdhëniet e Agjencia Kombëtarë e Ujësjiellës Kanalizimeve, me ministritë e linjave, me njësitë e qeverisjes vendore dhe me komunitetin në lidhje me shpronësimet publike.
- Vlerësimi i detyrave të projektimit, të projekteve të zbatimit, preventivave të zbatimit dhe studimeve të ndryshme. Auditimi i burimeve të financimit, të pagesave apo sponsorizimeve (dhurimeve) të bëra për këto shërbime.
- Mbi zbatimin e procedurave të prokurimit publik për punime, mallra dhe shërbime.
 - a. Vlerësimi i hartimit të nevojave për ndërtime, mallra dhe shërbime në infrastrukturën e Ujësjiellës Kanalizime.
 - b. Argumentimi dhe përlllogaritja e fondit limit.
 - c. Hartimi i dokumenteve të tenderit.
 - d. Zbatimi dhe vlerësimi i procedurave të prokurimit nga momenti i nxjerrjes së urdhrat të prokurimit deri në lidhjen e kontratës.
- Mbi zbatimin e kontratave për punime, mallra dhe shërbime.
 - a. Lidhja e kontratave, ndryshimet dhe shtesat përkatëse, si dhe realizimi në sasi e cilësi.
 - b. Zbatimi i afateve të përfundimit të kontratave.
- Mbi zbatimin e procedurave të prokurimit për blerjet me vlera të vogël.
- Zbatimi i rekomandimeve të lëna nga auditimet e mëparshme.

4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese: Strukturat drejtuese kanë për detyrë që të përgjigjen për garantimin e sistemeve të përshtatshme dhe efektive të menaxhimit financiar dhe kontrollit, në përputhje me kërkesat e kuadrit ligjor dhe rregullator përkatës.

Strukturat drejtuese janë përgjegjëse për realizimin e objektivave dhe zbatimin e përgjegjësiave të caktuara në kuadrin ligjor dhe rregullator, për të menaxhuar fondet publike në mënyrë të ligjshme, me ekonomi, efektivitet dhe efikasitet.

Strukturat drejtuese duhet të orientojnë strukturat e institucionit, për përmirësimin e furnizimit me ujë dhe kanalizimet.

5. Përgjegjësitë e audituesve: Audituesit e KLSH janë përgjegjës për dhënien e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacioni përputhen apo jo, në të gjitha aspektet materiale, me kriteret e aplikuar si: rregullat, ligjet, politikat, kodet e vendosura apo termat dhe kushtet, mbi të cilat është rënë dakord, ku mund të përmendim si burim të këtyre kritereve: standarde, ligje, vendime të Këshillit të Ministrave, rregullore, buxhete, kontrata, marrëveshje, instrumente të tjerë që përmbajnë rregulla se si duhet të menaxhohen transaksionet dhe zbatohen buxhetet, etj; shpreh nëpërmjet opinionit të auditimit, duke respektuar Standardet Ndërkombëtare të Auditimit sipas INTOSAI, si dhe kodin e etikës me qëllim që të arrihet niveli i arsyeshëm i sigurisë për dhënien e opinionit, në mënyrë që të merren veprime korrigjuese si dhe të identifikojë personat përgjegjës për veprimet e tyre.

6. Kriteret e vlerësimit: Kriteret e vlerësimit të përdorura në këtë auditim e kanë burimin në legjislacionin bazë e dytësor, në dispozita të tjera si dhe kuadrin rregullator përkatës sipas çështjeve të auditimit:

- Ligji nr. 154/2014, datë 27.11.2014 për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit; Ligji nr.8102, datë 28.3.1996 për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura; Ligji Nr. 10296, datë 08.07.2010 për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin e ndryshuar; Ligji nr. 8438, datë 28.12.1998 për tatimin mbi të ardhurat e ndryshuar; Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë e ndryshuar; Ligji nr. 7703, datë 11.05.1993 për sigurimet shoqërore në RSH, të ndryshuar me ligjin nr. 104/2014, datë 31.07.2014; Ligji nr. 7870, datë 13.10.1994 për Sigurimet Shëndetësore në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar; Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 për prokurimin publik, i ndryshuar; Ligji nr. 8402, datë 10.09.1998 për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit, i ndryshuar, si dhe akte të tjera të fushës së ndërtimit dhe urbanistikës; VKM nr. 431, datë 11.07.2018 për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Ujësjellës-Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve; VKM nr. 63, datë 27.1.2016 për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura; VKM nr. 870 Date 14.12.2011 për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit; VKM nr. 997, datë 10.12.2010 për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit e ndryshuar; VKM nr 864, date 23.07.2010 për pajisjen me numër telefoni celular të personave juridikë, publikë; VKM nr. 914, datë 29.12.2014 për miratimin e rregullave të prokurimit publik, VKM nr. 918 datë 29.12.2014 për kryerjen e procedurave të prokurimit publik në mënyrë elektronike; VKM nr. 1304, datë 11.12.2009 për miratimin e modelit të rregullores për furnizimin me ujë dhe kanalizimet në zonën e shërbimit të ujësjellës kanalizimeve SHA; Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorin publik; Rregullorja e brendshme dhe rregullore të tjera të funksionimit të institucionit, etj.

7. Standardet e auditimit: Auditimi është kryer në përputhje me procedurat e përgjithshme të pranura të kuadrit ligjor, rregullator dhe Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit. Projekt Raporti i auditimit është hartuar në përputhje me kërkesat e Rregullores së Procedurave të Auditimit në KLSH, mbështetur në:

- Ligjin nr. 154/2014 për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit;
- Kodi etik i KLSH dhe Rregullorja e Brendshme.
- ISSAI 100- Parimet themelore të auditimit të sektorit publik;
- ISSAI 400-Standardet e Auditimit të Përputhshmërisë;
- ISSAI 4000-Prezantim i përgjithshëm i udhëzimeve për auditimin e përputhshmërisë;
- ISSAI 1500 (ISA 500)- Objektivi i audituesit është të hartojë dhe të kryejë procedurat e auditimit në mënyrë të tillë që të mundësojë marrjen e evidencës së mjaftueshme për të nxjerrë konkluzione të arsyeshme në të cilin do të bazojë opinionin e tij;
- Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë të Gjykatës Evropiane të Audituesve;
- Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t, INTOSAI për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi Auditimin e përputhshmërisë; si dhe në praktikat më të mira të fushës.

8. Metodat e auditimit: Audituesit e KLSH, mbi bazën e evidencave të kërkuara dhe të vëna në dispozicion, intervistave, takimeve dhe konsultave me nëpunësit e AKUM, kanë përgatitur dokumentacionin e mjaftueshëm të auditimit, si rezultat i kuptimit të qartë të kriterëve të përdorura, të fushë-veprimit të auditimit, të gjykimeve, të përfundimeve të arritura, programin e auditimit dhe natyrën, kohën, shtrirjen dhe rezultatet e procedurave të kryera; si dhe

konkluzioneve lidhur me to. Në këtë mënyrë, dokumentimi i auditimit është kryer nëpërmjet letrave të punës, shënimeve, pyetësorëve, të finalizuar me aktkonstatimet dhe observacionet e subjektit, të cilat kanë shërbyer si bazë për hartimin e këtij Projekt-Raporti.

9.Dokumentimi i auditimit: Është kryer bazuar në kërkesat e manualit të auditimit të përputhshmërisë, në standardet ndërkombëtare të auditimit (ISAI), për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet dhe kërkesat ligjore dhe rregullatorë.

III.PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim.

Agjencia Kombëtare e Ujësjetllës Kanalizime dhe Infrastrukturës së Mbetjeve është i vetmi organ shtetëror i specializuar në fushën e furnizimit me ujë të pijshëm, kanalizimeve të ujërave të zëza dhe të bardha si dhe trajtimit të tyre (infrastrukturës ujore). Ajo mbështet teknikisht politikat e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, në përputhje me legjislacionin dhe politikat e Qeverisë të përcaktuara në strategjitë sektoriale.

Roli i AKUM në fushën e veprimtarisë së saj është që të realizojë nëpërmjet autoritetit të saj ligjor dhe teknik, koordinimin dhe monitorimin e aktivitetit për sigurimin e furnizimit me ujë, kanalizimeve të ujërave të përdorura dhe trajtimit të tyre për të gjithë popullsinë e vendit, në bashkëpunim me pushtetin vendor dhe subjektet e menaxhimit të infrastrukturës ujore. Veprimtaria e institucionit bazohet në VKM nr. 431, datë 11.07.2018 óPër krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Ujësjetllës-Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve.

Objekti, qëllimi dhe fushëveprimi i auditimit është përputhshmëria e aktivitetit të subjektit për periudhën nga 31.07.2019 deri më datë 30.06.2021.

Është audituar aktiviteti i Institucionit për periudhën e auditimit, fokusuar kryesisht në operacione financiare, por jo vetëm. Konkretisht janë audituar realizimi i buxhetit, shpenzime për investime, shpenzimet operative, realizimi i prokurimeve dhe kontratave përkatëse, etj.

2. Përshkrimi i auditimit, sipas drejtimeve të auditimit.

Në mënyrë të detajuar, gjatë këtij auditimi rezulton si më poshtë:

III.1 Mbi hartimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit.

Në zbatim të pikës (1) të programit të auditimit óNr.888/2 datë 07/09/2021ó, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

-Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 óPër menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë, ndryshuar me Ligjin nr. 57/2016, datë 02.06.2016.

-Ligji nr.10296, datë 08.07.2010 óPër menaxhimin financiar dhe kontrollinó i ndryshuar;

-Ligji nr.99/2018, datë 03.12.2018óPër buxhetin e vitit 2019ó.

-Ligji nr. 88/2019, datë 18.12.2019 óPër buxhetin e vitit 2020ó.

-Ligji nr. 137/2020, datë 16.12.2020 óPër buxhetin e vitit 2021ó.

-Akti Normativ nr. 2, datë 02.10.2019 óPër disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr.99/2018 óPër buxhetin e vitit 2019ó, të ndryshuar.

-Akti Normativ nr.11, datë 24.12.2019 Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.99/2018 óPër buxhetin e vitit 2019ó, të ndryshuar;

-Akti Normativ nr. 6, datë 21.03.2020 óPër disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr.88/2019ó.

-Akti Normativ nr.15, datë 15.04.2020 óPër disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr.88/2019ó.

-Akti Normativ nr.28, datë 02.07.2020 óPër disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr.88/2019ó.

-Akti Normativ nr.34, datë 02.07.2020 óPër disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr.88/2019ó.

-Akti Normativ nr.4, datë 05.02.2021 óPër disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr.137/2020ó.

-Akti Normativ nr.8, datë 22.03.2021 óPër disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr.137/2020ó.

-Akti Normativ nr.18, datë 12.04.2021.

-Udhëzimi i Ministrisë Financave nr. 1, datë 17.01.2019 óPër zbatimin e buxhetit të vitit 2019ó.

-Udhëzimi i Ministrisë Financave nr. 2, datë 20.01.2020 óPër zbatimin e buxhetit të vitit 2020ó.

-Udhëzimi i Ministrisë Financave nr. 4, datë 25.01.2021 óPër zbatimin e buxhetit të vitit 2021ó.

-Udhëzimi nr.7, datë 28.02.2018 óPër procedurat standarde të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëmó.

-Udhëzimi nr.9, datë 20.07.2018 óPër procedurat standarde të zbatimit të buxhetitó.

-Udhëzimi nr.22, datë 17.11.2016 óPër procedurat standarde të monitorimit të buxhetit nëNjësi të qeverisjes qendroreó.

Mbi programimin buxhetor afatmesëm 2019-2021 dhe planifikimin fillestar për buxhetin e vitit 2019.

Programi Buxhetor Afatmesëm (PBA) është instrument operacional për menaxhimin e shpenzimeve publike dhe një komponent i Sistemit të Planifikimit të Integruar. Ky dokument përdoret për të informuar Kuvendin e Shqipërisë dhe publikun e gjerë lidhur me planet e shpenzimeve të Qeverisë për tre vitet e ardhshme, të cilat do të çojnë në arritjen e objektivave politike të Qeverisë. Ai përcakton kontekstin afatmesëm të Buxhetit Vjetor.

Në mënyrë të përmbledhur, shpenzimet buxhetore të programit 06370 óFumizimi me ujë dhe kanalizimeó, janë progrA.ar si më poshtë:

Tabela nr. 1

	Emërtimi	Buxheti I rishikuar 2018	Faza e I PBA 2019	Faza e II PBA 2019	Faza III
600	Paga	40,500	52,000	52,000	
601	Sigurime Shoqërore	8,500	8,100	8,500	
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	13,780	21,400	14,000	
603	Subvencionet	1,000,000	1,218,500	1,000,000	
605	TransfertaKorente të Huaja				
606	Trans perBuxh. Fam. & Individ	210			
I	Shpenzime Korrente	1,062,990	1,300,000	1,074,500	0
230	Kapitale të Patrupëzuara	27,231	52,118	54,455	54,455
231	Kapitale të Trupëzuara	3,935,769	3,947,882	3,945,545	4,345,045
	Shp. Kapitale me financim te brendshem	3,963,000	4,000,000	4,000,000	4,399,500
230	Kapitale të Patrupëzuara				
	Shpenzime Kapitale me financim te huaj	5,251,219	6,500,000	6,500,000	6,500,000
II	Shpenzime Kapitale				
III	Shpenzime nga Të ardhurat jashte limiti				
I+II +III Totali I Shpenzimeve		10,277,209	11,800,000	11,574,500	10,899,500

Burimi: AKUM

Në fazë e parë të PBA 2019-2021 totali i shpenzimet të planifikuara për programin 06370 ôFurnizimi me ujë dhe kanalizimeô është në vlerën 11,800,000 mijë lekë nga të cilat shpenzimet korrente janë planifikuar në vlerën 1,300,000 mijë lekë dhe shpenzimet kapitale në vlerën 10,500,000 mijë lekë. Shpenzimet kapitale me financimi të brendshëm janë planifikuar në vlerën 4,000,000 mijë lekë ndërsa shpenzimet kapitale me financim të huaj janë planifikuar në vlerën 6,500,000 mijë lekë. Totali i shpenzimeve të planifikuar në fazën e parë të PBA-së 2019-2021 është kryer brenda nivelit të tavanit buxhetor për programin.

Në fazë e dytë të PBA 2019-2021 totali i shpenzimet të planifikuara për programin 06370 ôFurnizimi me ujë dhe kanalizimeô është në vlerën 11,574,500 mijë lekë nga të cilat shpenzimet korrente janë planifikuar në vlerën 1,074,500 mijë lekë dhe shpenzimet kapitale në vlerën 10,500,000 mijë lekë. Shpenzimet kapitale me financimi të brendshëm janë planifikuar në vlerën 4,000,000 mijë lekë ndërsa shpenzimet kapitale me financim të huaj janë planifikuar në vlerën 6,500,000 mijë lekë. Rezulton se në fazën e dytë totali i shpenzimeve të planifikuara është ulur për vlerën 225,500 mijë lekë, konkretisht në zërin e shpenzimeve korrente, ndërsa shpenzimet kapitale nuk kanë pësuar ndryshime.

Në fazën e tretë të PBA-së totali i shpenzimeve të planifikuar për këtë program është në vlerën 10,899,500 mijë lekë, duke u ulur më tej për vlerën 675,000 mijë lekë. Ndryshimi ka ndodhur në zërin e shpenzimeve kapitale me financim të brendshëm.

B. Zbatimi i kriterëve në çeljen e buxhetit, detajimi i planit fillestar dhe nivelet e realizimit të planit përfundimtar

a. Çelja e buxhetit dhe detajimi i tij për vitin 2019. Detajimi i planit të buxhetit për shpenzimet korrente është bërë me shkresën e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 15503/4, datë 17.01.2019 me subjekt ôDërgohet detajimi i buxhetit të vitit 2019-2021, për shpenzime korrenteô. Në total shpenzimet korrente janë miratuar në vlerën 463,000,000 lekë, të ndara me artikuj:

Llogaria 600, në vlerën 40,500,000 lekë;

Llogaria 601, në vlerën 8,500,000 lekë;

Llogaria 602, në vlerën 14,000,000 lekë;

Llogaria 603, në vlerën 400,000,000 lekë.

Detajimi i Shpenzimet për investime, është miratuar me shkresën e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 761/8 datë, 01.03.2019.

b. Mbi ndryshimet e planit të buxhetit të vitit 2019 me Akte Normative.

Me Akti Normativ, nr. 02, datë 02.10.2019, ôPër disa ndryshime ne ligjin 99/2018 ôbuxhetin e vitit 2019ô, i ndryshuar, fondet buxhetore për Shpenzimet Korrente janë shtuar në vlerën 16,200 mijë lekë, konkretisht llogaria 600 është shtuar për vlerën 10,500 mijë lekë, ndërsa llogaria 602 është shtuar për vlerën 5,700 mijë lekë. Sipas shkresës së Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 17343/66, datë 23.10.2019, shpenzimet kapitale për këtë program janë ulur në vlerën 467,500 mijë lekë, ku shpenzimet kapitale me financim të huaj janë ulur në vlerën 300,000 mijë lekë ndërsa shpenzimet kapitale me financim të brendshëm janë ulur në vlerën 167,500 mijë lekë. Me Aktin Normativ nr.2, datë 02.10.2020 në total shpenzimet e programit 06370 ôFurnizimi me ujë dhe kanalizimeô janë ulur në vlerën 451,300 mijë lekë.

Me Akti Normativ, nr. 11, datë 24.12.2019, ôPër disa ndryshime ne ligjin 99/2018 ôbuxhetin e vitit 2019ô, në total shpenzimet buxhetore për programin 06370 janë shtuar për vlerën 191,600 mijë lekë. Fondet buxhetore për shpenzime korrente në llogarinë 600, janë ulur në vlerën 8,400

mijë lekë. Sipas shkresës të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 10877/4, datë 30.12.2020 me lëndë ôDërgohet për zbatim Akti Normativ nr.11, datë 24.12.2020, shpenzimet buxhetore kapitale janë shtuar në vlerën 200,000 mijë lekë, konkretisht shpenzimet kapitale me financim të brendshëm.

Tabela në vijim paraqet planifikimin fillestar, ndryshimet e pësuar si dhe buxhetin e rishikuar.

Tabela nr. 2

Mijë lekë

	Shpenzime Korente	Buxheti rishikuar 2018	Buxheti Fillestar 2019	A.Normativ Nr. 02	A. Normativ Nr. 11	Buxheti I Rishikuar 2019	Diferenca
		1	2	3	4	5	6=5-4
600	Paga	40,500	40,500	10,500	-8400	42,600	-2,100
601	Sigurime Shoqërore	8,500	8,500			8,500	0
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	13,780	14,000	5700		19,700	-5,700
603	Subvencionet	1,000,000	400,000			400,000	0
605	Transferta Korente të Huaja						
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ	210				7,985	
I	Totali i Shpenzimeve Korente		463,000	16,200	-8,400	478,785	-7,800
230	Kapitale të Patrupëzuara F. B	27,231	54,455	-45,105	0	80,058	25,603
231	Kapiale të Trupëzuara F.B	3,935,769	4,345,045	-122,395	200,000	4,351,942	6,897
230-231	Kapitale me Financim të Huaj	5,251,219	5,520,000	-300,000		5,220,000	-300,000
II	Totali i Shpenzimeve Kapitale	9,214,219	9,919,500	-467,500	200,000	9,652,000	-267,500
III	Shp. të ardhurat jashte limiti						
	Totali i Përgjithshëm	9,214,219	10,382,500	-451,300	191,600	10,130,785	-275,300

Burimii: AKUM

Me shkresën nr. 286, datë 30.01.2020 është dërguar raport-monitorimi i investimeve buxhetore për vitin 2019 në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë. Në lidhje me realizimin faktit sipas zërave rezulton si më poshtë:

-Artikulli 230 (studime, projektim dhe oponencë teknike) për vitin 2019 është planifikuar në vlerën 80,058 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 77,149 mijë lekë ose 96% e planit të akorduar.

-Artikulli 231 (investime me financim të brendshëm), për vitin 2019 është planifikuar në vlerën 4,351,942 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 4,062,665 mijë lekë ose 93% e planit të akorduar.

-Artikulli 230 (konsulencë/investim i huaj) për vitin 2019 është planifikuar në vlerën 400,000 mijë lekë dhe është realizuar në 400,000 mijë lekë ose 100% e planit të akord

-Artikulli 231 (investime me financim të huaj) për vitin 2019 është planifikuar në vlerën 5,120,000 mijë lekë dhe është financuar në vlerën 4,097,756 mijë lekë ose 80% e planit të akorduar.

- Për artikullin 600 ôPagaô, plani vjetor i rishikuar në vlerën 42,600 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 41,971 mijë lekë ose 99% e planit të akorduar.

- Për artikullin 601 ôSigurime shoqëroreô plani në vlerën 8,500 mijë lekë është realizuar në vlerën 6,795 mijë lekë ose 80% e planit të akorduar.

- Për artikullin 602 ôMallra dhe shërbime të tjeraô, plani vjetor i rishikuar në vlerën 19,700 mijë leke është realizuar në vlerën 19,700 mijë lekë ose 100% e planit të akorduar.

- Për artikullin 603 ôSubvencione për ndërmarrje/sh.a ujësjellës kanalizimeô plani në vlerën 400,000 mijë lekë është realizuara në vlerën 399,648 mijë lekë ose 100% e planit të akorduar.

- Për artikullin 606 ôTransport për Buxhet, Familjar dhe Individëô, plani i rishikuar në vlerën 7,985 mijë lekë është realizuar në vlerën 7,845 mijë lekë, ose 98% e planit të akorduar.

Mbi programimin buxhetor afatmesëm 2020-2022 dhe planifikimin fillestar për buxhetin e vitit 2020

Në mënyrë të përmblëdhur, shpenzimet buxhetore të programit 06370 òFurnizimi me ujë dhe kanalizimeò, në PBA 2020-2022 Faza I dhe Faza II si dhe projekt buxhetin e vitit janë progrA.ar si në tabelën më poshtë:

Tabela nr. 3

Mijë lekë

	Emërtimi	Buxheti Faktik 2019	Faza e I PBA 2020	Faza e II PBA 2020	ProjektBuxhet 2020
600	Paga	42,600	50,000	50,000	
601	SigurimeShoqërore	8,500	8,500	8,500	
602	MallradheShërbimetëTjera	19,700	33,800	41,500	
603	Subvencionet	400,000	400,000	400,000	
605	TransfertaKorentetëHuaja				
606	Trans per Buxh. Fam. &Individ	7,985			
I	Shpenzime Korrente	478,785	492,300	500,000	0
230	KapitaletëPatrupëzuara	80,058	185,582	173,374	209,903
231	KapitaletëTrupëzuara	4,351,942	4,516,258	4,228,466	3,759,897
	Shp. Kapitale financimtebrendshem me	4,432,000	4,701,840	4,401,840	3,969,800
230	KapitaletëPatrupëzuara				
	ShpenzimeKapitale financimtehuaj me	5,220,000	5,530,220	5,530,220	4,411,411
II	ShpenzimeKapitale	9,652,000	10,232,060	9,932,060	8,381,211
III	ShpenzimengaTëardhuratjashtelimiti				
I+II +III Totali I Shpenzimeve		10,130,785	10,724,360	10,432,060	8,381,211

Burimi: AKUM

Në fazë e parë të PBA 2020-2022 totali i shpenzimet të planifikuara për programin 06370 òFurnizimi me ujë dhe kanalizimeò është në vlerën 10,724,360 mijë lekë nga të cilat shpenzimet korrente janë planifikuar në vlerën 492,300 mijë lekë dhe shpenzimet kapitale janë planifikuar në vlerën 10,232,060 mijë lekë. Shpenzimet kapitale me financimi të brendshëm janë planifikuar në vlerën 4,701,840 mijë lekë ndërsa shpenzimet kapitale me financim të huaj janë planifikuar në vlerën 5,530,220 mijë lekë. Totali i shpenzimeve të planifikuar në fazën e parë të PBA-së 2020-2022 është kryer brenda nivelit të tavanit buxhetor për programin.

Në fazë e dytë të PBA 2020-2022 totali i shpenzimet të planifikuara për programin 06370 òFurnizimi me ujë dhe kanalizimeò është në vlerën 10,432,060 mijë lekë, ku në krahasim me Fazën e I të PBA 2020-2022 totali i shpenzimeve të planifikuara për këtë program është ulur për vlerën 292,300 mijë lekë. Shpenzimet korrente janë planifikuar në vlerën 500,000 mijë lekë dhe krahasuar me fazën e I-rë të PBA-së janë rritur në vlerën 7,700 mijë lekë, ndërsa shpenzimet kapitale janë planifikuar në vlerën 9,932,060 mijë lekë, të cilat në krahasim me fazën e parë janë ulur për vlerën 300,000 mijë lekë. Shpenzimet kapitale me financimi të brendshëm janë planifikuar në vlerën 4,401,840 mijë lekë të cilat në krahasim me fazën e parë janë ulur për vlerën 300,000 mijë lekë, ndërsa shpenzimet kapitale me financim të huaj janë planifikuar në vlerën 5,530,220 mijë lekë, të cilat në krahasim me fazën e parë nuk kanë pësuar ndryshime.

Ndërsa në fazën e tretë të PBA-së totali i shpenzimeve të planifikuar për këtë program është në vlerën 8,381,211 mijë lekë, duke u ulur më tej në krahasim me fazën e dytë për vlerën

2,050,849 mijë lekë. Ndryshimi ka ndodhur në zërin e shpenzimeve kapitale, ku shpenzimet kapitale me financim të brendshëm janë ulur për vlerën 432,400 mijë lekë, ndërsa shpenzimet kapitale me financim të huaj janë ulur për vlerën 1,118,809 mijë lekë.

Çelja e buxhetit dhe detajimi i tij për vitin 2020. Detajimi i planit të buxhetit për shpenzimet korrente është bërë me shkresën e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 49, datë 09.01.2020 me subjekt ÓDërgimi i detajimit të buxhetit të vitit 2020 për shpenzime korrenteó. Në total shpenzimet korrente janë miratuar në vlerën 373,500 mijë lekë, të ndara me artikuj:

Llogaria 600, në vlerën 50,000 mijë lekë;

Llogaria 601, në vlerën 8,500 mijë lekë;

Llogaria 602, në vlerën 15,000 mijë lekë;

Llogaria 603, në vlerën 300,000 mijë lekë.

Detajimi i Shpenzimet për investime është miratuar me shkresën e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 1669, datë 12.02.2020.

b. Mbi ndryshimet e planit të buxhetit të vitit 2020 me Akte Normative.

Me Akti Normativ nr. 28, datë 02.07.2020, óPër disa ndryshime ne ligjin 88/2019 óPër buxhetin e vitit 2020ó, referuar shkresës nr. 5098/20, datë 23.07.2020, shpenzimet kapitale me financim të huaj janë ulur për vlerën 595,000 mijë lekë ndërsa shpenzimet kapitale me financim të brendshëm janë shtuar për vlerën 1,500,000 mijë lekë.

Me shkresën nr. 6651/5, datë 06.10.2020, në zbatim të VKM nr. 766, datë 06.10.2020 óPër shpërndarje fondesh ndërmjet programeve buxhetore, për buxhetin e vitit 2020, miratuar për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisëó, shpenzimet kapitale me financim të brendshëm dhe konkretisht artikulli 231 óShpenzime kapitale të trupëzuaraó janë ulur për vlerën 179,000 mijë lekë.

Me Akti Normativ, nr. 34, datë 16.12.2020, óPër disa ndryshime ne ligjin 88/2019 óPër buxhetin e vitit 2019ó, referuar shkresës së Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 8844/12, datë 24.12.2020, shpenzime korrente në llogarinë 603 óSubvencioneó, janë shtuar për vlerën 420,000 mijë lekë. Shpenzimet kapitale me financim të brendshëm në artikullin 230 janë shtuar për vlerën 46,233 mijë lekë ndërsa për artikullin 231 janë shtuar për vlerën 3,053,767 mijë lekë. Ndërsa shpenzimet kapitale me financim të huaj janë ulur për vlerën 380,863 mijë lekë. Tabela në vijim paraqet planifikimin fillestar, ndryshimet e pësuar si dhe buxhetin e rishikuar.

Tabela nr. 4

	ShpenzimeKorente	Fakti 2019	BuxhetiFill estar 2020	A.Normati v Nr. 28	VKM .765,date 30.09.2020	A.Normati v Nr. 34	Buxheti Rishikuar 2020	I Diferenc a
		1	2	3	4	5	6	
600	Paga	41,971	50,000				50,000	0
601	SigurimeShoqërore	6,795	8,500				8,500	0
602	MallradheShërbimetëTjera	19,700	15,000				15,000	0
603	Subvencionet	399,648	300,000			420,000	720,000	420,000
605	TransfertaKorentetëHuaja							
606	Trans per Buxh. Fam. &Individ	7,845					305	

I	Totali i Shpenzimeve Korente	468,114	373,500	0	0	420,000	793,805	420,000
230	Kapitalet e Grupit F. B	80,058	209,903	110,910		46,233	159,011	-50,892
231	Kapitalet e Grupit F. B	4,351,942	3,759,897	1,389,090	-179,000	3,053,767	8,231,789	4,471,892
230-231	Kapitale me Financim të Huaj	5,220,000	4,411,411	-595,000		-380,863	3,435,548	-975,863
II	Totali i Shpenzimeve Kapital	9,652,000	8,381,211	905,000	-179,000	2,719,137	11,826,348	3,445,137
III	Shp. Tëardhurat jashtë limiti	0						
	Totali i Përgjithshëm	10,120,114	8,754,711	905,000	-179,000	3,139,137	12,620,153	3,865,137

Burimi: AKUM

Me shkresën nr. 581, datë 05.03.2021 është dërguar raport-monitorimi i investimeve buxhetore për vitin 2020 në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë. Në lidhje me realizimin faktit sipas zërave rezulton si më poshtë:

-Artikulli 230 (studime, projektim dhe oponencë teknike) për vitin 2020 është planifikuar në vlerën 159,010 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 157,223 mijë lekë ose 99% e planit të akorduar.

-Artikulli 231 (investime me financim të brendshëm), për vitin 2020 është planifikuar në vlerën 8,231,790 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 7,848,415 mijë lekë ose 95% e planit të akorduar.

-Artikulli 230 (konsulencë/investim i huaj) për vitin 2020 është planifikuar në vlerën 673,630 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 345,853 mijë lekë ose 51% e planit të akorduar.

- Artikulli 231 (investime me financim të huaj) për vitin 2020 është planifikuar në vlerën 2,761,918 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 1,915,418 mijë lekë ose 69% e planit të akorduar.

- Artikulli 600 òPagaò i planifikuar në vlerën 50,000 mijë lekë është realizimi në vlerën 44,546 mijë lekë ose 89% e planit të akorduar.

-Artikulli 601 òSigurime shoqëroreò i planifikuar në vlerën 8,500 mijë lekë është realizuar në vlerën 7,258 mijë lekë ose 85% e planit të akorduar.

-Artikulli 602 òMallra dhe shërbime të tjeraò i planifikuar në vlerën 15,000 mijë lekë është realizuar në vlerën 11,345 mijë lekë ose 76% e planit të akorduar.

-Artikulli 603 òSubvencione për ndërmarrje/sh.a ujësjetllës kanalizimeò, i planifikuar në vlerën 720,000 mijë lekë është realizuar në vlerën 720,000 mijë lekë ose 100% e planit të akorduar.

-Artikulli 606 òTransport për Buxhet, Familjar dhe Individëò, i planifikuar në vlerën 305 mijë lekë është realizuar në vlerën 91 mijë lekë, ose 30% e planit të akorduar.

Mbi programimin buxhetor afatmesëm 2021-2023 dhe planifikimin fillestar për buxhetin e vitit 2021

Në mënyrë të përmblodhur, shpenzimet buxhetore të programit 06370 òFurnizimi me ujë dhe kanalizimeò, në PBA 2021-2023 Faza I dhe Faza II janë progrA.ar si në tabelën më poshtë:

Tabela nr. 5

Mijë lekë

	Emërtimi	Buxheti I Rishikuar 2020	Faza e I PBA 2021	Faza e II PBA 2021
600	Paga	50,000	50,000	
601	Sigurime Shoqërore	8,500	8,500	
602	Mallra dhe Shërbimet e Tjera	15,000	31,500	
603	Subvencionet	720,000	380,000	
605	Transferat Korente të Huaja			

606	Trans per Buxh. Fam. &Individ	305	0	
I	Shpenzime Korrente	793,805	470,000	470,000
230	Kapitalet e Patrupëzuara	159,011	118,180	41,134
231	Kapitalet e Trupëzuara	8,231,789	4,325,836	4,402,882
	Shp. Kapitale me financime brendshëm	8,390,800	4,444,016	4,444,016
230	Kapitalet e Patrupëzuara			
	Shpenzime Kapitale me financime huaj	3,816,411	5,820,498	772,647
II	Shpenzime Kapitale	12,207,211	10,264,514	5,216,663
III	Shpenzime nga Të ardhurat jashtë limiti			
I+II +III Totali i Shpenzimeve		13,001,016	10,734,514	5,216,663

Burimi: AKUM

Në fazën e parë të PBA 2021-2023 totali i shpenzimeve të planifikuara për programin 06370 "Furnizimi me ujë dhe kanalizime" është në vlerën 10,734,514 mijë lekë, ku shpenzimet korrente janë planifikuar në vlerën 470,000 mijë lekë dhe shpenzimet kapitale janë planifikuar në vlerën 10,264,514 mijë lekë. Shpenzimet kapitale me financime të brendshme janë planifikuar në vlerën 4,444,016 mijë lekë ndërsa shpenzimet kapitale me financime të huaja janë planifikuar në vlerën 5,820,498 mijë lekë. Totali i shpenzimeve të planifikuara në fazën e parë të PBA-së 2021-2023 është kryer brenda nivelit të tavanit buxhetor për programin.

Në fazën e dytë të PBA 2021-2023 totali i shpenzimeve të planifikuara për programin 06370 "Furnizimi me ujë dhe kanalizime" është në vlerën 5,216,663 mijë lekë, ku në krahasim me Fazën e I të PBA 2021-2023 totali i shpenzimeve të planifikuara për këtë program është ulur për vlerën 5,517,851 mijë lekë ose 52% më pak në krahasim me fazën e parë. Shpenzimet kapitale me financime të brendshme nuk kanë pësuar ndryshim në vlerën e planifikuar në fazën e parë të PBA-së. Shpenzimet kapitale me financime të huaja janë planifikuar në vlerën 772,647 mijë lekë, të cilat në krahasim me fazën e parë kanë pësuar një ulje të konsiderueshme për vlerën 5,047,851 mijë lekë ose 87% më pak se faza e parë e PBA-së 2021-2023.

Çelja e buxhetit dhe detajimi i tij për vitin 2021. Detajimi i planit të buxhetit për shpenzimet korrente është bërë me shkresën e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 590/1, datë 18.01.2021 me subjekt "Dërgohet miratimi i buxhetit të shpenzimeve korrente për vitet 2021-2023". Në total shpenzimet korrente janë miratuar në vlerën 373,500 mijë lekë, të ndara me artikuj:

Llogaria 600, në vlerën 50,000 mijë lekë;
Llogaria 601, në vlerën 8,500 mijë lekë;
Llogaria 602, në vlerën 31,500 mijë lekë;
Llogaria 603, në vlerën 380,000 mijë lekë.

Detajimi i Shpenzimeve për investime është miratuar me shkresën e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 383/3, datë 28.01.2021.

b. Mbi ndryshimet e planit të buxhetit të vitit 2021 me Akte Normative.

Pas miratimit të Aktit Normativ nr. 4, datë 05.02.2021, Aktit Normativ nr. 8, datë 22.03.2021 dhe Aktit Normativ nr. 18, datë 12.04.2021, planifikimi për programin buxhetor 06370 ôFurnizimi me ujë dhe kanalizimeô nuk ka pësuar ndryshime.

Ndërsa nëpërmjet miratimit të shkresa për rishpërndarje buxhetore shpenzimet kapitale me financim të brendshëm janë shtuar për vlerën 2,500,000 mijë lekë nga të cilat llogaria 230 ôShpenzimet kapitale të pa trupëzuaraô janë shtuar në vlerën 59,400 mijë lekë ndërsa llogaria 231 ôShpenzimet kapitale të trupëzuaraô janë shtuar në vlerën 2,440,600 mijë lekë.

Tabela në vijim paraqet planifikimin fillestar, ndryshimet e pësuar si dhe buxhetin e rishikuar.

Tabela nr. 6

	ShpenzimeKorente	Fakti 2020	BuxhetiFillestar 2021	Ndryshime	Buxheti I Rishikuar 2021
		1	2	3	5
600	Paga	44,546	50,000		
601	SigurimeShoqërore	7,258	8,500		
602	MallradheShërbimetëTjera	11,346	31,500		
603	Subvencionet	712,736	380,000		
605	TransfertaKorentetëHuaja				
606	Trans per Buxh. Fam. &Individ	92	214		
I	TotaliShpenzimeveKorente	775,886	470,000	0	0
230	KapitaletëPatrupëzuara F. B	159,011	91,134	59,400	150,534
231	KppiatetëTrupëzuar F.B	8,231,789	6,416,882	2,440,600	8,857,482
230-231	Kapitale me FinancimtëHuaj	5,220,000	5,731,495		5,731,495
II	TotaliShpenzimeveKapitale	13,610,800	12,239,511	2,500,000	14,739,511
III	Shp. tëardhuratjashtelimiti	0			
	TotaliPërgjithshëm	14,386,686	12,709,511	2,500,000	14,739,511

Burimi: AKUM

Me shkresën nr. 1319, datë 16.06.2021 është dërguar raport-monitorimi i investimeve buxhetore për 4 mujorin e parë të vitit 2021, në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë. Realizimi i llogarive buxhetore për 4 mujorin e parë të vitit 2021 rezulton si më poshtë:

-Artikulli 230 (studime, projektim dhe oponencë teknike) i planifikuar në vlerën 91,134 mijë lekë është realizuar 14,607 mijë lekë ose 16% e planit të akorduar.

-Artikulli 231 (investime me financim të brendshëm) i planifikuar në vlerën 6,416,882 mijë lekë është realizuar në vlerën 1,521,245 mijë lekë ose 24% e planit të akorduar.

-Artikulli 230 (konsulencë/investim i huaj) i planifikuar në vlerën 100,000 mijë lekë është realizuar 0 mijë lekë ose 0% e planit të akorduar.

-Artikulli 231 (investime me financim të huaj) i planifikuar në vlerën 5,631,495 mijë lekë është realizuar në vlerën 830,351 mijë lekë ose 15% e planit të akorduar.

-Artikulli 600 ôPagaô i planifikuar në vlerën 50,000 mijë lekë është realizuar në vlerën 15,233 mijë leke ose 30% e planit të akorduar.

-Artikulli 601 ôSigurime shoqëroreô i planifikuar në vlerën 8,500 mijë lekë është realizuar në vlerën 2,485 mijë lekë ose 29% e planit të akorduar.

-Artikulli 602 ôMallra dhe shërbime të tjeraô, i planifikuar në vlerën 31,500 mijë lekë është realizuar në vlerën 1,170 mijë lekë ose 4% e planit të akorduar.

-Artikulli 603 ôSubvencione për ndërmarrje/sha ujësjellës kanalizimeô i planifikuar në vlerën 380,000 mijë lekë është realizuar në vlerën 0 mijë lekë ose 0% e planit të akorduar.

-Artikulli 606 ôTransport për Buxhet, Familjar dhe Individëô i planifikuar në vlerën 214 mijë lekë është realizuar në vlerën 146 mijë lekë, ose 68% e planit të akorduar.

III.2. Zbatimi i dispozitave ligjore për administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare.

Në zbatim të pikës nr. 2 të programit të auditimit ó nr. 888/2, datë 07.09.2021 i ndryshuaró, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- Dokumentet bazë të kontabilitetit si: fletëhyrje, fletëdalje, faturë, urdhër-shpenzim.
- Transaksionet e llogarive bankare.
- Pagesa për shërbime e mallra/shërbime, të ndara në disa kontrata me disa grup mallrash apo shërbimesh të ngjashme:

- Ligjshmëria dhe saktësia e veprimeve të kryera përmes bankës

- Nga auditimi me zgjedhje mbi ligjshmërinë dhe saktësinë e plotësimit të dokumentacionit bazë të kontabilitetit (fletëhyrje, fletëdalje, faturë, urdhër shpenzim, etj.) të realizuara në Sektorin e Financës të AKUM-së, rezultoi se, veprimet janë kryer konform kërkesave të ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 óPër kontabilitetin dhe pasqyrat financiareó, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 248, datë 10.04.1998 óPër miratimin e planit kontabël publik të organeve të Pushtetit Lokal, Institucioneve shtetërore qendrore si dhe njësive që varen prej tyreó, i ndryshuar me VKM nr. 25, datë 20.01.2001.

Transaksionet janë kontabilizuar në mënyrë kronologjike dhe gjendja e llogarive bankare rakordon me ekstraktet e bankës në fund të çdo muaji, kjo për sa i përket veprimeve të kryera gjatë periudhës 01.08.2019 deri me datë 30.06.2021.

Dokumentacioni i bankës është mbajtur dhe kontabilizuar konformë rregullave të kontabilitetit si dhe udhëzimit për menaxhimin financiar dhe kontrollin. Urdhër-shpenzimet janë bazuar në dokumentacionin justifikues (si faturat, kontratat e lidhura për blerjet e shërbimet, proces verbalet dhe aktet e marrjes në dorëzim të mallrave apo shërbimeve.) dhe në çdo rast kanë nënshkrimin e personit të autorizuar në Degën e Thesarit.

Nga këto grupi i auditimit, me përzgjedhje auditoi transaksionet sipas urdhër shpenzimeve paraqitur në Aneksin nr. 1, bashkëngjitur këtij projekt-raporti për shpenzimet buxhetore.

Urdhër Shpenzimet e përzgjedhura u audituan në funksion të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 óPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorin publikó veçanërisht sa i takon regjistrimit të veprimeve ekonomike në librat e kontabilitetit bazuar në dokumente origjinale që përdoren për këtë qëllim si; *Dokumentet autorizues, Dokumente vërtetues, Dokumente të kontabilitetit, etj.*

Nga auditimi rezultoi:

- Regjistrimi i veprimeve ekonomike në librat e kontabilitetit është bazuar në dokumente origjinale që përdoren për këtë qëllim *Dokumentet autorizues, Dokumente vërtetues, Dokumente të kontabilitetit, etj.*

- Marrja në dorëzim e shërbimeve sipas kontratave të lidhura për mallra/shërbime përgjithësisht janë të konfirmuara dhe dokumentuara rregullisht nga një komision i ngritur nga Titullari i AKUM-së, në përputhje me përcaktimet e dispozitave dhe kuadrit nënligjor mbi menaxhimin financiar, kontrollin e brendshëm dhe kontabilitetit.

Nga auditimi u konstatua se faturat e lëshuara për situacionet e punimeve në lidhje me investimet në përgjithësi nuk janë reregjistruar dhe paguar brenda afatit ligjorë prej 30 ditësh në sistemin e thesarit, nga data e marrjes prej debitorit të faturës, veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 48/2014 óPër pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtareó neni 7, por si detyrime janë konstatuar në pasqyrat financiare të institucionit. Kjo ka sjellë krijimin e detyrimeve të prapambetura të institucioni ndaj subjekteve.

Analiza e detyrimeve të AKUKIM-së

Nga analiza e likuidimit të faturave që nga momenti i regjistrimit në kontabilitet deri në regjistrimin dhe likuidimin e tyre nga thesari konstatohet se AKUM ka detyrime në shumën prej 485,043,745 lekë deri me datën 30.06.2021, nga të cilat 194,250,573lekë janë likuiduar në tetor 2021 me Aktit Normativ Nr.26 date 22.06.2021 óPër disa ndryshime ne Ligjin Nr.137/2020 óPër buxhetin e vitit 2021, i ndryshuarô të qeverisë dhe borxhi i mbetur paraqitet 290,793,172 lekë.

- 80,592,807lekë janë detyrime të krijuara rishtas deri me datën 31.12.2020.

-290,793,172 lekë janë detyrime aktuale të mbetura në AKUM

Ecuria e detyrimeve ndër vite paraqitet e detajuar në tabelat si më poshtë:

Tabela nr. 7

Në lekë

Viti	Detyrimi i akumuluar 31.12.2019	Likuiduar 2020	Detyrimi 31.12.2020	Likuiduar	Detyrimi 30.06.2021	Likuiduar në tetor 2021 A.normativ	Detyrimi Aktual
2019	261,657,034	245,726,177					
2020			80,592,807				
2021					485,043,745	194,250,573	
Totali							290,793,172

Burimi i të dhënave: Sektori i financës në AKUM

Siç vërehet sa me sipër, detyrimet deri me datën 31.12.2019 të pasqyruara në bilancin e vitit 2019 dhe të çelura në 01.01.2020 janë në shumën 261,657,034 lekë, nga të cilat 245,726,177 lekë janë likuiduar në vitin 2020.

Në vitin 2020 janë krijuar rishtazi 80,592,807 lekë detyrime ndaj furnitorëve e kontraktorëve të ndryshëm.

-Ne vitin 2020 është bërë sistemimi i detyrimit të prapambetura në shumën 245,726,177 lekë, e cila ka të bëjë me fatura për punë të kryera si dhe shpenzime gjyqësore e shpenzime përmbarimore.

Deri me datën 30.06.2021 AKUM ka detyrime në shumën 485,043,745 lekë nga të cilat 194,250,573 lekë janë likuiduar në tetor 2021 me Aktit Normativ Nr.26 date 22.06.2021 óPër disa ndryshime ne Ligjin Nr.137/2020 óPër buxhetin e vitit 2021, i ndryshuarô dhe pjesa e mbetur **290,793,172 lek paraqet gjendjen aktuale të detyrimeve në këtë institucion.**

Nga auditimi konstatohet se, detyrimet e prapambetura vijnë të jenë problem për financat publike. Një pjesë e konsiderueshme e buxhetit vjetor të AKUM-së shkon për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura të viteve të kaluara për kontratë / marrëveshje / vendim gjykate i formës së prerë që mbeten të papaguara 30 ditë pas datës së specifikuar në kontratë apo me ligj,, duke mos prodhuar pasqyrim real të realizimit të buxhetit vjetor, pasi përfshihen pagesa për shërbime dhe të mira që janë realizuar në vitet e mëparshme buxhetore.

Gjithashtu u konstatua se një pjesë e faturave për situacione punimesh janë paguar të copëzuara në disa urdhër shpenzime, në muaj dhe vite të ndryshme, Kjo ka ardhur si rezultat i mungesës së fondeve, çka tregon se në momentin e lëshimit të faturës nuk ka pasur fonde buxhetore. Kjo vjen për shkak se nga institucioni AKUM nuk është realizuar monitorimi i kontratave se deri në ç ôfazë janë realizuar dhe kush janë faktorët korrigjues që duhet të marrë institucioni për të ardhmen me qëllim mirë menaxhimit të pagesave dhe mos krijimin e detyrime te prapambetura për institucionin.

Por mospagimi në kohë i detyrimeve ka efekt zinxhir duke sjellë që

- Bizneset të mos kenë mundësi financiare për shlyerjen e detyrimeve ndaj punonjësve, firmave nënkontraktore me të cilat kanë bashkëpunuar gjatë kryerjes së punimeve /ofrimit të shërbimeve, furnitorëve të ndryshëm si dhe krijimin e detyrimeve fiskale ndaj administratës tatimore dhe/ose doganore.

Nga auditimi u konstatua se një pjesë e likuidimeve realizohen në muajin Dhjetor të vitit ushtrimor, kjo vjen si rezultat i alokimit të fondeve me aktet normative që qeveria nxjerr. Kjo ka bërë që rreth 30-40 % të shumës totale të pagesave të realizuar gjatë vitit ushtrimor realizohen në fund vit.

*Inicimi i procedurave të prokurimit për investime publike në mungesë të fondeve ka sjellë dhe rritjen apo krijimin e detyrimeve të reja për buxhetin e institucionit dhe buxhetin e shtetit duke krijuar dhe shpenzime përmbartimore shtesë të cilat **përbëjnë efekte negative** për buxhetin e shtetit dhe ngarkon me përgjegjësi të gjitha strukturat drejtuese dhe vendimmarrëse të institucionit për mënyrën e përzgjedhjes së faturave për likuidim duke krijuar shpenzime përmbartimore shtesë për buxhetin e shtetit.*

Proceset gjyqësore

Nga shqyrtimi me zgjedhje i dokumentacionit të urdhër-shpenzimeve për vitin 2019, 2020 dhe deri me 30.06.2021 u konstatua se, janë paguar gjyq fituesit dhe subjektet përmbartuese gjyqësore private për tarifën e shërbimit përmbartimor. Shuma e detyrimeve për vendimet gjyqësore të paguara nga buxheti i shtetit për vitin 2019 në shumën 14,429,230 lek■, për vitin 2020 në shumën 90,492,335 lekë, për vitin 6 mujorin e para viti 2021 në shumën 4,548,627 lek■. Për të gjitha këto vendime edhe pse kanë qenë të formës së prerë, të gjitha pagesat nuk janë kryer vullnetarisht nga AKUM, por janë kryer në bazë të urdhër ekzekutimeve të lëshuara nga përmbartuesit privat, ku është paguar nga buxheti i shtetit kosto shtesë në shumën prej **6,443,953 lekë** për tarifa përmbartimore dhe shpenzime gjyqësore 851,287 lek■. Kjo tregon dhe një here për menaxhim jo të mirë të fondeve publike nga drejtuesit e institucionit.

Nga auditimi u konstatua se nga institucioni ndër vite nuk ka një fond të planifikuar për proceset gjyqësore të cilat janë në shkallën e dytë të apelimit. Në PBA-në e institucionit nuk është planifikuar një fond për këto detyrime, veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008 për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, si dhe Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 8, datë 9.3.2018 për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme.

Spektori i financës ka bërë kontabilizimin dhe konstatimin e detyrimeve gjyqësore vetëm në momentin e likuidimit të personave me urdhër shpenzim kaluar nëpërmjet degës së thesarit, ndërsa detyrimet e lindura për tu paguar nuk janë të kontabilizuara në pasqyrën financiare, për faktin se nga Spektori Ligjor dhe i Prokurimeve nuk janë dërguar informacione në lidhje me proceset gjyqësore, por informojnë spektorin e financës vetëm kur duhet të bëhet pagesa në b.a.ë në favor të gjyqe fituesit.

Titulli i gjetjes : Rritje e kostove nga proceset gjyqësore.

Situata: Nga shqyrtimi me zgjedhje i dokumentacionit të urdhër-shpenzimeve për vitin 2019, 2020 dhe deri me 30.06.2021 u konstatua se, janë paguar gjyq fituesit dhe subjektet përmbartuese gjyqësore private për tarifën e shërbimit përmbartimor. Shuma e detyrimeve për vendimet gjyqësore të paguara nga buxheti i shtetit për vitin 2019 në shumën 14,429,230 lek■, për vitin

2020 në shumën 90,492,335 lekë, për vitin 6 mujorin e para viti 2021 në shumën 4,548,627 lekë. Për të gjitha këto vendime edhe pse kanë qenë të formës së prerë, të gjitha pagesat nuk janë kryer vullnetarisht nga AKUM, por janë kryer në bazë të urdhër ekzekutimeve të lëshuara nga përmbaruesit privat, ku është paguar nga buxheti shtetit kosto shtesë në shumën prej **6,443,953 lekë** për tarifa përmbarimore dhe shpenzime gjyqësore 851,287 lekë.

Kriteri: Ligji nr.7961, datë 12.07.1995 óKodi i punës i Republikës të Shqipërisë, i ndryshuar me ligj nr.136/2015, datë 05.12.2015. Ligjit nr. 9643 óPër prokurimin publik, i ndryshuar.

Ndikimi/Efekti: Efekt financiar negativ në shumën prej **126,031,384 lekë**.

Shkaku: Mos zbatimi i kushteve afateve dhe legjislacionit, në shpronësimin publik, largimet nga puna dhe kontratat e punimeve.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: Nga Drejtori i Përgjithshëm, Departamenti Ligjor dhe Departamenti i Ekonomik të shoqërisë të merren masa për ndjekjen me përgjegjësi të gjitha proceseve gjyqësore të iniciuara ndaj Institucionit, për menaxhimin sa më mirë të fondeve publike. Drejtuesit e institucionit duhet të shmangin në maksimum detyrimin e tarifave përmbarimore dhe likuidimin e detyrimeve të rrjedhura nga vendimmarrjet e gabuara në mënyrë vullnetare për të shmangur tarifat përmbarimore që kanë kapin vlerën e 6,443,953 lekë. Në do rast të nxirren përgjegjësit dhe të merren masat e duhura.

b. Saktësia dhe rregullshmëria e veprimeve të kryera në magazinë

Ditari i magazinës është mbajtur dhe veprimet hidheshin periodikisht.

- U audituan me të zgjedhur dokumentacioni i magazinës për vitin 2019 deri me 30.06.2021. Fletë daljet dhe fletë hyrjet e mallrave janë të hartuara sipas rendit kronologjik dhe pa korrigjime të plotësuar me adresën nga vjen malli dhe kujt i dërgohet malli.

Hyrja e mallrave në magazinë dokumentohet në çdo rast me fletë-hyrjen përkatëse, të hartuar sipas gjendjes fizike të tyre. Fletë-hyrjet lëshohen nga magazinieri, pasi është bërë më parë verifikimi fizik i sasisë, i cilësisë dhe i çmimit, në përputhje me përcaktimet e paragrafit 37, kreu III, të udhëzimit të ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 óPër menaxhimin e aktiveve në sektorin publik, i ndryshuar. Kontabilizimet e fletë-daljeve dhe fletë hyrjeve janë bërë në mbështetje të planit unik kontabël dhe në mënyrë kronologjike e sistematike në ditarët e magazinës. Dokumentacioni i magazinës përpilohet nga administratori i vlerave materiale, ndërsa kontabilizimi i veprimeve kryhet nga një specialiste e sektorit të financës.

Fletë-hyrja e plotësuar nga magazina për hyrjen e mallrave që qarkullojnë pa pagesë në njësi, ka të bashkëlidhur dokumentacionin përkatës si: fletëdaljen e nënshkruar nga përfaqësuesit e njësisë shpenzuese që ka bërë daljen e mallit; Shkresën e Njesisë për transferimin e aktiveve;

- Për hyrjet e mallrave që qarkullojnë pa pagesë në njësite e sektorit publik fletë-hyrja e plotësuar nga magazina kishte të bashkëlidhur dokumentacionin përkatës si: fletëdaljen e nënshkruar nga përfaqësuesit e njësisë shpenzuese që ka bërë dalje mallin; Shkresën e Njesisë për transferimin e aktiveve. Autorizimin për tërheqje malli të firmosur nga nëpunësi zbatues dhe Nëpunësi Autorizues.

c. Inventarizimi i pronës shtetërore, nxjerrja e rezultateve të inventarizimit dhe sistemimi i diferencave në përputhje me rregullat kontabël

Nga auditimi u konstatua se Agjencia Kombëtare e Ujësjetës Kanalizimeve ka të dhëna mbi gjendjen fizike dhe vlerën kontabël të pronave në përputhje me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 óPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik, nëneni 26 ku citohet: óÇdo

njësi publike duhet të krijojë dhe të përditësoj një regjistër kontabël të të gjitha aktiveve që zotëron apo ka në administrim, përfshi dhe pronat publike që siguron të ardhur ...” dhe neni 31, citohet “ ...për objektet e dhëna me qira – sipërfaqja e objektit në m², numri dhe data e kontratës së qirasë, afati i vlefshmërisë së kontratës...

-Komisioni i ngritur me urdhër të titullarit të AKUM nr. 112, datë 13.09.2019 óPër kryerjen e inventarizimit të përgjithshëm ka bërë verifikimin fizik të gjendjes së aktiveve në përdorim të personelit.

-Komisioni i ngritur me urdhër të titullarit të AKUM nr. 100, datë 22.10.2020 óPër kryerjen e inventarizimit të përgjithshëm ka bërë verifikimin fizik të gjendjes së aktiveve në përdorim të personelit.

Nga auditimi u konstatua se, nga komisioni para fillimit të inventarit nuk ishte fiksuar numri rendor i fletë hyrjes dhe fletë daljeve nëpërmjet një procesverbali të mbajtur midis përgjegjësit material dhe komisionit të inventarizimit, në kundërshtim me pikën 83 të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 óPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik.

Në fund të procesit të inventarizimit, komisioni nuk kishte përpiluar një raport në lidhje me inventarizimin fizik të aktiveve, ku të japë komentet në lidhje me gjendjen fizike aktuale të aktiveve (nëse janë apo jo në përdorim), si dhe për kushtet e ruajtjes së tyre dhe së bashku me gjithë dokumentacionin e inventarizimit, t'ia dorëzonte për veprime të mëtejshme titullarit të institucionit, veprime në kundërshtim me pikën 85/c të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011.

Për vitet objekt auditimi u konstatua se komisioni i inventarizimit nuk ka bërë një vlerë totale me listë të bashkëngjitur, se sa ka gjendje fizike institucioni, për pajisje informatike, për pajisje zyre të ndarë në artikuj, si dhe mjete transporti në dispozicion etj sipas formatit të regjistrit të aktiveve, i cili hartohet në vartësi të llojit të tyre, si dhe grupit përkatës brenda llojit dhe më pas të bëhej krahasimin gjendjes konkrete të aktiveve me të dhënat përkatëse të librave që mbahen nga punonjësit me përgjegjësi materiale e që janë të regjistruara në kontabilitet, për të vërtetuar nëse eksitojnë apo jo diferenca, veprime në kundërshtim me pikat 30, 73, 74 , pika 81 të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 óPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik,

Me urdhrin e titullarit të AKUM nr. 23, datë 28.02.2019 është ngritur komisioni i vlerësimit të aseteve dhe komisioni i nxjerrjes së aktiveve nga përdorimi në njësi.

Nga komisioni i vlerësimit të aktiveve ka bërë propozim për daljen jashtë përdorimi të aktiveve, bashkëngjitur dhe procesverbalet përkatëse për secilin aset, me vlerë totale prej 1,248,384 lekë, për të cilat citojnë se: këto pajisje nuk janë në gjendje pune dhe nuk realizojnë asnjë funksion, pasi janë teje e të konsumuara, ku riparimi është i pA.ndur si pasojë e konsumit dhe kur nuk mund të përshtaten për përdorim tjetër. Për këto aktivet pas vlerësimit nga komisioni janë nxjerrë jashtë përdorimit dhe është në proces çregjistrimi i tyre nga zëri 213- 218 dhe kalimi i tyre në óAktive afatgjata të dëmtuara deri në momentin e tjetërsimit të tyre.

Me urdhrin e titullarit të AKUM nr.63, datë 30.06.2020 është ngritur komisioni i vlerësimit të aseteve dhe komisioni i nxjerrjes së aktiveve nga përdorimi në njësi.

Me urdhrin e titullarit të AKUM nr.50, datë 17.06.2021 është ngritur komisioni i vlerësimit të aseteve dhe komisioni i nxjerrjes së aktiveve nga përdorimi në njësi.

Amortizimi vjetor është llogaritur udhëzimit nr. 8, datë 09.03.2018 óPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësinë e qeverisjes së përgjithshme.

Nga auditimi i regjistrimit të aktiveve të regjistruar në kontabilitet u konstatua se një pjesë e këtyre aktiveve pasi i është zbritur amortizimi i akumuluar ndër vite vlera e tyre është e 0. Këto aktive vazhdojnë të jepen në përdorim dhe gjendje pune. Nga institucioni nuk është marrë asnjë masë për të ngritur grupin e punës me ekspertë të F.ve, për artikujt, për të shqyrtuar jetën e dobishme dhe vlerën e mbetur të këtyre aktiveve, ku pas këtij shqyrtimi të bëhet rivlerësimi i vlerës së tyre nëse këto aktive vazhdojnë të jepen në gjendje pune dhe nuk kanë nevojë për tu riparuar. Ndryshimet në jetën e pritshme të dobishme dhe të vlerës së tyre të kontabilizohen duke ndryshuar periudhën e amortizimit apo metodën, sipas rastit, dhe të trajtohen si ndryshime në vlerësimet kontabël.

Respektimi i rregullave kontabël për nxjerrjen jashtë përdorimi të vlerave materiale, kryerja e veprimeve kontabël për shkarkimin nga magazina

Komisioni i ngritur me urdhrë të titullarit të institucionit nr. 23, datë 28.02.2019 óPër ngritjen e komisionit për nxjerrjen jashtë përdorimi të aseteve të vlerësuara për jashtë përdorimi, nuk ka marrë asnjë masë për të vazhduar procedurën e tjetërsimit/, e cila duhet të ishte realizuar brenda datës 30.04.2019, sipas urdhrit të titullarit. Nga komisioni nuk është dhënë asnjë koment se kush janë shkaqet e mos fillimit dhe realizimit të kësaj faze. Deri në momentin që grupi i auditimit ishte në terren kjo procedurë nuk kishte filluar.

-Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresën nr. 71/1 datë 18.02.2022 óDërgim shpjegimesh dhe komentesh mbi Projektraportin e Auditimit, ku janë shprehur objeksionet lidhje me gjetjen nr. 14 subjekti i audituar ka nxjerr urdhrin e brendshëm nr. 305 prot., datë 17.02.2022 në zbatim të rekomandimeve të lëna dhe paraqitur observacion me pretendimet si më poshtë.

Pretendimi i subjektit: Referuar rekomandimit tuaj lidhur me shmangien e detyrimeve të tarifave përmbartimore, ju bëjmë me dije, të gjitha vendimet gjyqësore të ekzekutuara e kanë patur të përcaktuar në dispozitiv të vendimit modalitetin e pageses. Në këtë rast nuk kemi të bëjmë me kosto shtesë, por me procedurë të realizuar në zbatim të vendimeve gjyqësore të formës së prerë.

Përsa më sipër përveç se në raste urgjente kur nuk ka patur informacion të saktë dhe të plotë në sektorin ligjor dhe të prokurimeve ka ndodhur që likuidimi të bëhet jashtë planit të shlyerjes së detyrimeve, përsa i përket rasteve të tjera, të gjitha likuidimet e bëra nga viti 2019 deri në vitin 2021 janë rrjedhojë e planit të shlyerjes të vitit 2019. të cilin sektori i financës e disponon, qënë para këtij fakti sektori ligjor dhe i prokurimeve e ka kryer funksionin e tij në dhënien e informacionit në lidhje me proceset gjyqësore.

Qëndrimi i Grupit të auditimit: Në lidhje me pretendimet paraqitura sqarojmë se, pas cdo vendimi gjykatë I formës së përpjetë dhe si E e cilësoni dhe Ju fare mirë titull ekzekutiv Juve nëse nuk bëni recurs në kohë Ju lind detyrimi për ekzekutimin vullnetarë të këtij detyrimi. Nëse për një periudhë prej 5 ditësh Ju nuk e ekzekutoni atëherë kreditori i drejtohet përmbartuesit privat për ekzekutim të detyrueshëm ku shkon deri në bllokimin e llogarive. JU në asnjë rast nuk e keni respektuar Njoftimin për ekzekutim vullnetar por keni pritur ekzekutimin me përmbartues duke shtuar kostot. Sa më sipër observacioni nuk merret në konsiderat.

III.3. Zbatimi i procesit të shpronësimit për interes publik. Marrëdhëniet e Agjencisë Kombëtare e Ujësjellës Kanalizimeve, me ministritë e linjave, me njësitë e qeverisjes vendore dhe me komunitetin në lidhje me shpronësimet publike.

Në zbatim të pikës pikës 3, óZbatimi i procesit të shpronësimit për interes publikó,marrëdhëniet e Agjencisë Kombëtare të Ujësjetllës Kanalizimeve me ministrinë e linjave, me njësitë e qeverisjes vendore dhe me komunitetin në lidhje me shpronësimet publikeó, të Programit të Auditimit, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

1. Praktika e shpronësimeve për zbatimin e projektit óPërmirësimi i Sistemit të Kanalizimeve të Tiranës së Madheó;

2. Praktika e shpronësimeve për zbatimin e projektit óRehabilitimi i Rrjetit Hidrik të Tiranësó;

3. Dosjet e proceseve gjyqësore aktive gjatë periudhës të auditimit të të shpronësuarve nga implementimi i projektit óPërmirësimi i Sistemit të Kanalizimeve të Tiranës së Madheó.

Procesi i shpronësimit në zbatimin e projekteve të ndjekura dhe të realizuara nga AKUM prek nga afër vëtëm pesë prej tyre, të cilët janë:

1. óNdërtimi i kolektorit kryesor të ujërave të zeza dhe I.T.U.P. në zonën turistike, Gjiri i Lalëzitó; Përfitues Bashkia Durrës, (njësia administrative Ishëm); Autoriteti kontraktor AKUM; Projekt i financuar me Buxhet Shteti;

2. óNdërtimi i Rrjetit të Ujësjetllës të Gjirit të Lalëzitó; Përfitues Bashkia Durrës; Autoriteti kontraktor AKUM; Projekt i financuar me Buxhet Shteti;

3. óPërmirësimi i Sistemit të Kanalizimeve të Tiranës së Madheó; Përfitues UKT; Autoriteti kontraktor AKUM; Burimi i financimit JICA;

4. óRehabilitimi i Rrjetit Hidrik të Tiranësó; Përfitues UKT; Autoriteti kontraktor AKUM;

5. "Furnizimi me ujë i zonës së Vlorës (Orikum, Dukat, Tragjas, Radhimë)"; Përfitues Bashkia Vlorë; Autoriteti kontraktor AKUM; Burimi i financimit IPA.

Afatet e nevojshme për fillim dhe përmbylljen e procesit të shpronësimit, janë relativisht të gjatë, nëse procesi i shpronësimit konsiderohet jo vëtëm i lidhur me tjetërsimin e pronës për interes publik, por edhe i lidhur me përmbylljen e detyrimit për dhënie e shpërblimeve për efekt të shpronësimit, ish-pronarëve të pasurive të zhveshur nga tituli i pronësisë.

Prandaj për këto projekte që u listuan pak më lart, proceset e shpronësimit ka rast që kanë filluar dhe nuk janë përmbyllur, sikurse ka dhe raste ku pavarësisht zhvillimit të projektit, akoma nuk janë miratuar aktet nënligjore (VKM) me të cilët ekzekutohet një shpronësim.

Me zgjedhje u audituan proceset e shpronësimit në zbatim të projekteve: óPërmirësimi i Sistemit të Kanalizimeve të Tiranës së Madheó dhe óRehabilitimi i Rrjetit Hidrik të Tiranësó, të cilët përfaqësojnë këto raste.

Projekti: “Përmirësimi i Sistemit të Kanalizimeve të Tiranës së Madhe”.

Informacioni i mëposhtëm, jep një panoramë të përgjithshme, edhe mbi situata e veprime të cilat nuk u audituan, meqë jashtë periudhës kohore në fokus auditimi, por që zgjatimi i pasojave të tyre, prek objektin dhe fokusin kohor të auditimit të kryer.

Ky projekt është financuar përmes marrëveshjes së financimit ABA-P3 lidhur midis Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë Japoneze (JICA, Japanese International Cooperation Agency) dhe ratifikuar në Kuvend përmes ligjit nr. 9964, datë 24.7.2008.

Mbas përfundimit të procedurave të prokurimit të finalizuar në vitin 2013, në datën 30.01.2014, është nënshkruar kontrata për zbatimin e punimeve ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Ujësjetllës Kanalizime (DPUK), sot AKUM dhe shoqërisë së përbashkët BO óD., I.&K., J.ó. Kontrata e sipërmarrjes është nënshkruar në datën 30.01. 2014 dhe punimet kanë filluar në datën 16.06.2014 me afat 30 muaj.

Më pas afati i punimeve është shtyrë deri në 30.10.2018. Projektues dhe Supervizor është bashkimi i shoqërisë óT., J.& E., Shqipërió.

Me shkresën nr. 2004, datë 04.07.2018 AKUM, ka njoftuar Kontraktorin për ndërprerjen e kësaj kontrate. Këtë vendim AKUM e ka marrë në zbatim të Urdhrit të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, komunikuar me shkresën nr. 1225/11 prot., datë 31/05/2019, ku përcaktohej, që AKUM brenda muajit qershor 2018, të fillojnë procedurat për ndërprerjen e kontratës me Kontraktorin.

Ndodhur në këtë situatë, shoqëria kontraktuese BO óD.& K.ó, ka depozituar kërkesën për arbitrazh pranë Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë (ICC) Londër. Kjo gjykatë me njoftimin zyrtar të datës 19.12.2018 ka njoftuar zyrtarisht palët, MIE dhe Kontraktorin, për hapjen e kësaj çështje.

Shtyrja e afatit të disbursimit të fondeve për Marrëveshjen e Huasë është miratuar me VKM nr. 877, datë 11.11.2020 duke e shtyrë afatin e disbursimit të kredisë deri në 24.04.2022.

Procesi i shpronësimit për projektin ka filluar në vitin 2010 me dorëzimin e planvendosjes së impiantit të paraqitur në hartë kadastrale dixhitale. Kjo është pasuar me një kërkesë Komunës Kashar për të dhëna lidhur me pasuritë që preken nga ndërtimi i ITUZ, kërkesë AKKP-së për të dhëna mbi çmimin e tokës për zonën ku do të ndërtohet impianti, konfirmimin e çmimit të tokës nga AKKP dhe në vitin 2013 DPUK (sot AKUM) miraton akt-marrëveshjen me MPPT óPër Shpronësimin për interes publik të pasurive pronë private që preken në kuadër të zbatimit të projektit.

Në 12 qershor 2013 është shpallur në gazetën óS.ó dhe óK. J.ó, óKërkesa për Shpronësim Publik" me një listë të përbërë prej 156 pasurish.

Me VKM nr. 61, datë 12.03.2014 óPër shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i projektit óPërmirësimi i sistemit të kanalizimeve të Tiranës së Madheó janë miratuar për t'u shpronësuar 52 pronarë dhe sipas pikes 5, përcaktohet: óVlera totale e shpronësimit, prej 66 739 008 (gjashtëdhjetë e gjashtë milionë e shtatëqind e tridhjetë e nëntë mijë e tetë) lekësh, të përballohet nga buxheti i vitit 2014 për Drejtorinë e Përgjithshme të Ujësjiellës Kanalizimeve.ó

Me VKM nr. 772, datë 16.09.2015 janë miratuar për t'u shpronësuar 9 pronarë dhe sipas pikes 4 përcaktohet: óVlera e përgjithshme e shpronësimit, 7 288 512 (shtatë milionë e dyqind e tetëdhjetë e tetë mijë e pesëqind e dymbëdhjetë) lekë, të përballohet nga buxheti i vitit 2015, miratuar për Drejtorinë e Përgjithshme të Ujësjiellës- Kanalizimeve, zëri óKosto lokale, për projektin e kanalizimeve të Tiranës së Madheó, me kod projekti M061489ó.

Me VKM Nr. 252, datë 24.04.2019 janë miratuar për t'u shpronësuar 12 pronarë.

Procesi i shpronësimit më 31.07.2019, paraqitej si më poshtë:

Nga 52 pronarë të shpronësuar me VKM nr. 61, datë 12.03.2014, shtetasit e prekur nga ky proces, të cilët janë rimbursuar pa ngritur pretendime, lidhur me vlerësimin e pasurive të shpronësuar, apo ata të cilët kanë ngritur pretendime në gjykatë janë paraqitur në tabelat 1 dhe 2, si më poshtë:

Pronarë të rimbursuar në zbatim të VKM Nr.61, datë 12.03.2014, të cilët nuk kanë ngritur pretendime.

Tabela 8.

Nr.	Emri/Atesia/Mbiemri	ZK	Pasuria	Lloji	Sip.	Cmimi (L/m2)	Vlera e Kompensimit (në Lekë)	VKM/Datë
1	S.Xh. V.	3866	123/18	Arë	7500	448	3,360,000	61 dt.12.02.2014

2	Sh. Xh. V.	3866	123/17	Arë	6000	448	2,688,000	61 dt.12.02.2014
3	Q. Xh. V.	3866	123/16	Arë	6000	448	2,688,000	61 dt.12.02.2014
4	N. Z. T.	3866	202/3/2	Arë	1000	448	448,000	61 dt.12.02.2014
5	Y. I. G.	3866	204/13	Arë	3400	448	1,523,200	61 dt.12.02.2014
6	Shoqeria "Vë " Sh.p.k	3866	204/14	Arë	5000	448	2,240,000	61 dt.12.02.2014
7	M. S. H.	3866	181/8	Arë	4000	448	1,792,000	61 dt.12.02.2014
8	A. Q. Q.	3866	181/9	Arë	3200	448	1,433,600	61 dt.12.02.2014
9	R. S. H.	3866	181/10/1	Arë	3200	448	1,433,600	61 dt.12.02.2014
10	Q. Q. B.	3866	181/11	Arë	4000	448	1,792,000	61 dt.12.02.2014
11	R. A. B.	3866	181/15	Arë	3200	448	1,433,600	61 dt.12.02.2014
12	H. S. E.	3866	181/25	Arë	5600	448	2,508,800	61 dt.12.02.2014
13	M. L.	3866	181/26	Arë	2500	448	1,120,000	61 dt.12.02.2014
14	M. N. D.	3866	193/3	Arë	1950	448	873,600	61 dt.12.02.2014
15	N. H. D.	3866	193/14	Arë	5000	448	2,240,000	61 dt.12.02.2014
16	A. S. D.	3866	195/1	Arë	2138	448	957,824	61 dt.12.02.2014
17	A. F. C.	3866	181/12	Arë	2400	448	1,075,200	61 dt.12.02.2014

Burimi: Të dhëna vënë në dispozicion nga AKUM

Pronarë të rimbursuar në zbatim të VKM Nr.61, datë 12.03.2014, të cilët kanë ngritur pretendime në gjykatë.

Tabela 9.

Nr.	Emri/Atesia/Mbiemri	ZK	Pasuria	Lloji	Sip.	Cmimi (L/m2)	Vlera e Kompensimit (në Lekë)	VKM/Datë
1	Z. Xh. K.	3866	202/3/1	Arë	4800	448	2,150,400	61 dt.12.02.2014
2	S. A. Sh.	3866	181/4	Arë	2400	448	1,075,200	61 dt.12.02.2014
3	G. Q. P.	3866	195/9	Arë	1557	448	697,536	61 dt.12.02.2014

Burimi: Të dhëna vënë në dispozicion nga AKUM

Ndërkohë që 32 shtetas të shpronësuar nga 52, nuk rezultonin të kishin marrë përsipër as ndjekjen e rrugëve ligjore, për ndonjë pretendim lidhur me vlerësimin e pasurive të shpronësuar dhe nuk ishin paraqitur pranë AKUM të dorëzonin dokumentacionin, i cili është parakusht për ekzekutimin e shpërblimit ish - pronarit, për efekt shpronësimi të pasurisë, në zbatim të parashikimeve të VKM nr. 61, datë 12.03.2014, Pika 7: óPronarët e pasurive për të cilat është bërë shënimi óKonfirmuar nga ZVRPP-jaô, të likuidohen, për efekt shpronësimi, në bazë të dokumentacionit të plotë të pronësisë (çertifikatë, hartë kadastrale dhe kartelë të rifreskuar), që do të dorëzojnë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Ujësjiellës-Kanalizimeveô.

Nga 9 pronarë të shpronësuar me VKM nr. 772, datë 16.09.2015, shtetasit e prekur nga ky proces, të cilët janë rimbursuar, por edhe që paralelisht kanë ngritur pretendime në gjykatë lidhur me masën e shpërblimit dhe ata të parimbursuar, të cilët kanë ngritur pretendime në gjykatë janë paraqitur në tabelat 3 dhe 4.

Pronarë të rimbursuar me VKM Nr.772, datë 16.09.2015, por edhe që kanë ngritur pretendime në gjykatë lidhur me masën e shpërblimit sipas VKM.

Tabela 10

Nr.	Emri/Atesia/Mbiemri	ZK	Pasuria	Lloji	Sip.	Cmimi (L/m2)	Vlera e Kompensimit (në Lekë)	VKM/Datë
1	N. H. S.	3866	203/5	Arë	3000	448	1,344,000	772 dt.16.09.2015

Burimi: Të dhëna vënë në dispozicion nga AKUM

Pronarë të parimbursuar me VKM Nr. 772, datë 16.09.2015, të cilët kanë ngritur pretendime në gjykatë lidhur me masën e shpërblimit sipas VKM.

Tabela 11

Nr.	Emri/Atesia/Mbiemri	ZK	Pasuria	Lloji	Sip.	Cmimi (L/m2)	Vlera e Kompensimit (në Lekë)	VKM/Datë
1	A. A. B.	3866	123/22	Arë	1322	448	592,256	772 dt.16.09.2015
2	I. H. B.	3866	123/5/1	Arë	3895	448	1,744,960	772 dt.16.09.2015
3	I. Xh. M.	3866	123/20	Arë	1700	448	761,600	772 dt.16.09.2015
	I. Xh. M.	3866	123/21/1	Arë	1366	448	611,968	772 dt.16.09.2015

Burimi: Të dhëna vënë në dispozicion nga AKUM

Ndërkohë që 5 shtetas të shpronësuar nga 9, nuk kishin marrë përsipër as ndjekjen e rrugëve ligjore për ndonjë pretendim lidhur me vlerësimin e pasurive të shpronësuar dhe as nuk ishin paraqitur pranë AKUM, të dorëzonin dokumentacionin (çertifikatë, hartë kadastrale dhe kartelë të rifreskuar), i cili është parakusht për ekzekutimin e likuidimit ish - pronarit, për efekt shpronësimi të pasurisë.

Nga 12 pronarë të shpronësuar me VKM nr. 252, datë 24.04.2019, shtetasit e prekur nga ky proces, të cilët janë rimbursuar, por edhe që paralelisht kanë ngritur pretendime në gjykatë lidhur me masën e shpërblimit dhe ata të parimbursuar, të cilët kanë ngritur pretendime në gjykatë, janë paraqitur në tabelat 5 dhe 6.

Pronarë të rimbursuar me VKM Nr. 252, datë 24.04.2019, por edhe që kanë ngritur pretendime në gjykatë lidhur me masën e shpërblimit sipas VKM.

Tabela 12

Nr.	Emri/Atesia/Mbiemri	ZK	Pasuria	Lloji	Sip.	Cmimi (L/m2)	Vlera e Kompensimit (në Lekë)	VKM/Datë
1	Bashkëpronarët B.	3866	193/29	Arë	11000	448	4,928,000	252 dt.24.04.2019
2	H. B. K.	3866	193/27	Arë	4630	448	2,074,240	252 dt.24.04.2019
3	K. O. H.	3866	181/20	Arë	4800	448	2,150,400	252 dt.24.04.2019

Burimi: Të dhëna vënë në dispozicion nga AKUM

Pronarë të parimbursuar me VKM Nr.252, datë 24.04.2019, të cilët kanë ngritur pretendime në gjykatë lidhur me masën e shpërblimit sipas VKM.

Tabela 13

Nr.	Emri/Atesia/Mbiemri	ZK	Pasuria	Lloji	Sip.	Cmimi (L/m2)	Vlera e Kompensimit (në Lekë)	VKM/Datë
1	B. L. H.	3866	202/2	Arë	4300	448	1,926,400	252 dt.24.04.2019
2	A. J. Sh.	3866	181/16	Arë	3000	448	1,344,000	252 dt.24.04.2019
3	G. H. Sh.	3866	181/15	Arë	2300	448	1,030,400	252 dt.24.04.2019
4	Bashkëpronarët G. A. K.	3866	193/26	Arë	10000	448	4,480,000	252 dt.24.04.2019
5	R. Xh. H.	3866	202/2/1	Arë	4400	448	1,971,200	252 dt.24.04.2019
6	H. S. H.	3866	181/19	Arë	3200	448	1,433,600	252 dt.24.04.2019

Burimi: Të dhëna vënë në dispozicion nga AKUM

Tre pronarë të rimbursuar për tokën e marrë, kanë ngritur pretendime lidhur me masën e shpërblimit të përcaktuar në VKM. Nëntë pronarë nuk janë paraqitur me dokumentet përkatëse pranë zyrës së AKUM për të tërhequr rimbursimin dhe gjashtë prej tyre kanë ngritur pretendime gjyqësore lidhur me masën e shpërblimit të përcaktuar në VKM. Ndërkaq tre të shpronësuar, nuk

janë as rimbursuar nga AKUM dhe as nuk kanë ndërmarrë nisma ligjore, lidhur me ndonjë pakënaqësi mbi masën e shpërblimit për efekt të shpronësimit.

Procesi shpronësimit gjatë periudhës 31.07.2019 në 30.06.2021 ka vijuar me ndjekjen e proceseve gjyqësore për pretendimet e subjekteve të prekur nga shpronësimi, si dhe me likuidimin e kompensimeve për efekt shpronësimi.

Ecuria e proceseve gjyqësore për proceset me objekt rishikimin e vlerës së kompensimit për efekt shpronësimi paraqitet si më poshtë.

Referuar ish pronarëve të shpronësuar në zbatim të VKM Nr. 61, datë 12.03.2014, janë zhvilluar në gjykatë, në nivele të ndryshme gjykimi, këto procese të cilat kanë përvijuar edhe në periudhën objekt auditimi:

1. Çështja administrative me palë S. Sh.;
2. Çështja administrative me palë S. A. L.;
3. Çështja administrative me palë G. Q. P.;

Referuar ish pronarëve të shpronësuar në zbatim të VKM Nr. 772, datë 16.09.2015, janë zhvilluar në gjykatë, në nivele të ndryshme gjykimi, këto procese të cilat kanë përvijuar edhe në periudhën objekt auditimi:

1. Çështja administrative me palë N. H. S.;
2. Çështja administrative me palë A. A. B.;
3. Çështja administrative me palë I. H. B.;
4. Çështja administrative me palë I.Xh. M.;
5. Çështja administrative me palë Z. Xh. K..

Referuar ish pronarëve të shpronësuar në zbatim të VKM Nr. 252, datë 24.04.2019, janë zhvilluar në gjykatë, në nivele të ndryshme gjykimi, këto procese të cilat kanë përvijuar edhe në periudhën objekt auditimi:

1. Çështja administrative me palë Bashkëpronarët B.;
2. Çështja administrative me palë K. H.;
3. Çështja administrative me palë H. H.;
4. Çështja administrative me palë B. L. H.;
5. Çështja administrative me palë G.A. K. dhe Z. A. K.;
6. Çështja administrative me palë R. H.;
7. Çështja administrative me palë A. J. Sh. dhe G. H. Sh.;
8. Çështja administrative me palë B. M..

Sikurse konstatohet nga auditimi i materialeve procesuale të çështjeve me objekt padie, vlera e dëmshpërblimit për efekt shpronësimi publik për rastet sa më sipër, në shumë raste gjykatat kanë vendosur pranimin e plotë ose të pjesshëm të kërkesëpadisë, ku qytetarët e shpronësuar kanë kërkuar që shpronësimet të bëhen jo duke iu referuar çmimit të referencës të pasurive, për llojin e pasurisë óArêô, sikurse pasuritë e shpronësuar rezultojnë në regjistrat hipotekorë të ZVRPP, por duke iu referuar një kriteri dhe shtate tjetër.

Në kohën e shpronësimit si de facto ashtu edhe de jure, pronat objekt gjykimi kanë qenë "Tokë Truall" pasi ky është lloji i tokës, mbi të cilën studimet e kryera të miratuara dhe instrumenti vendor i miratuar lejojnë dhënien e lejeve dhe ngritjen e ndërtimeve, gjithashtu është ky lloji i tokës "Tokë Truall" kur mbi të ka një leje ndërtimi të miratuar dhe në zbatim e sipër, miratuar me vendimin nr. 3 datë 07.04.2012, Këshilli Kombëtar i Territorit për miratimin e Lejes së Infrastrukturës për Impiantin e Trajtimin të Ujërave të Ndotura".

Mospërkimi i llojit të pasurisë, me të dhënat pranë ish ZRPP sot A. Sh. Kadastrës, kur kjo e fundit vetëm sa pasqyron llojin e pasurisë dhe nuk e përcakton atë, në regjimin e saktë juridik, nuk do të thotë se zëri kadastral tokë "arë" nuk ka ndryshuar.

Këto vendime të gjykatave të niveleve të ndryshme hedhin dritë mbi faktin se në fazat fillestare të përgatitjes së procesit të shpronësimit, ndërveprimi ndërmjet subjektit të audituar, pushtetit vendor, ZVRPP-së (sot ASHK), nuk ka qenë shterues.

Gjatë periudhës në fokus auditimi, lidhur me procesin e shpronësimit, janë ekzekutuar likuidimet, si në përgjigje të kërkesave të ish - pronarëve për dhënien e shpërblimit për efekt shpronësimi, ashtu edhe në zbatimin e vendimeve gjyqësore me objekt shpronësimet, sikurse më poshtë paraqitur.

Procedurat e likuidimeve të kompensimeve për efekt shpronësimi

Tabela 14

Nr.	Emri/Atësia/Mbiemri	Data e kërkesës	Data e ekzekutimit të pagesës	Vlera e Kompensimit (në Lekë)	Komente
1	M. B.	11.07.2019	07.10.2019	821,333	
2	I. B.	11.07.2019	07.10.2019	821,333	
3	I. B.	11.07.2019	07.10.2019	821,333	
4	S. B.	11.07.2019	07.10.2019	821,333	
5	H. B.	11.07.2019	23.10.2019	821,333	
6	Z. A. (B.)	11.07.2019	06.12.2019	821,333	
7	B. K. (H. B. K.)	30.09.2019	14.11.2019	2,074,240	
8	A. D.	16.12.2019	14.05.2020	957,824	Mungesë fondesh
9	A. Ç.	21.08.2020	18.09.2020	1,075,200	
10	M. D.	10.11.2020	15.12.2020	873,600	Dokumentacion jo i plotë
11	K. H.	19.11.2020	28.12.2020	2,150,400	
12	A. B. <i>Vendimin Nr. 657 Regj., datë 11.12.2018, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë</i>	Nga Gjykata	10.12.2019	574,320	Tarifë përmbarimore
			12.12.2019	3,600,000	Kosto lokale - kompensimi
			17.09.2020	3,019,144	Kosto lokale – kompensimi
			24.09.2020	218,000	Shpenzime gjyqësore
13	I. B.	Nga Gjykata	24/12/2020	9,800,000	4,548,627 lekë për t'u paguar
14	H. Y. B.	21.06.2021	Jo	1,106,560	
15	B. L. H.	11.10.2019	Jo	1,926,400	Problem me prokurën
16	L. U. P.	16.06.2021	Jo	1,075,200	Problem me gjeneralitetet

Burimi: Të dhëna vënë në dispozicion nga AKUM

Likuidimet e vendimeve gjyqësore

Tabela 15

					Likuidimet Vendimet Gjyqësore				Mbetet për likuidim
					Urdhër Shpenzimi				
					Nr.	Datë	602	231.3	Totali
Vendime Gjyqësore TOTALI	Shpenz. gjyqësore	Tarifa Përmbari more	Pagese nga kosto lokale, Projekti 0Tirana e Madhe- 231.3 (Shpërblimi)						
	602	602	Kosto lokale 231.3						
7,411,464	218,000	574,320	6,619,144	568	10.12.2019	574,320		7,411,444	
				593	12.12.2019		3,600,000		

				334	17.09.2020		3,019,144		
				349	24.09.2020	217,980			
14,348,627	153,600	963,712	13,231,315	474	24.12.2020		9,800,000	9,800,000	4,548,627
21,760,091	371,600	1,538,032	19,850,459			792,300	16,419,144	17,211,444	4,548,627

Burimi: Të dhëna vënë në dispozicion nga AKUM

1. Titulli i gjetjes:	Vonesa në likuidimin e dëmshpërblimit të ish-pronarëve të shpronësuar, për interes publik, në zbatimin e projektit óPërmirësimi i Sistemit të Kanalizimeve të Tiranës së Madheó.
Situata:	Nga auditimi, lidhur me ecurinë e pagesave nga AKUM për shpërblimet për efekt shpronësimi, u konstatua se në rastin e të shpronësuarit A. B.: Pavarësisht se Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë (shkresa nr. 3534 prot., datë 17.12.2018) me Vendimin Nr. 657 Regj., datë 11.12.2018 ka vendosur mospranimin e kërkesës së AKUM, për pezullimin e ekzekutimit të Vendimit Nr. 3401 datë 28.09.2018 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, e cila linte në fuqi të Vendimin Nr. 6577, datë 28.12.2015, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, e cila vendosi: 1. Pranimin e pjesshëm të padisë (të shtetasit A. A. B.); 2. Shfuqizimin e pikës 4 të listës së pronarëve të VKM Nr.772, datë 16.09.2015; 3. Detyrimin e palëve të paditura (AKUM...) për të shpërblyer paditësit diferencën e krijuar në shumën 6.619.144 lekë, Pavarësisht lajmërimit nga ana e përmbauesit A. K. drejtuar AKUM për të ekzekutuar vullnetarisht detyrimet; Pavarësisht vënieve nën sekuestro të llogarive të AKUM (AKUM) që në një kohë para periudhës në fokus auditim, sikurse dhe vendosjes të sekuestros mbi llogaritë e AKUM me 07.08.2020, shlyerja e detyrimit është bërë me vonesë në katër këste, në datat: 10.12.2019, 12.12.2019, 17.09.2020, 24.09.2020 me Urdhër shpenzimet: nr. 568, nr. 593, nr. 334, nr. 349, në vlerën prej 7,411,444 lekë, ku vlera prej 6,619,144 lekësh futet në kosto lokale, 574,320 lekë janë Tarifë Përmbarimore dhe 218,000 lekë janë Shpenzime Gjyqësore. Për këtë situatë, sikurse informuar formalisht nëpërmjet postës elektronike (datë 27 tetor 2021) nga znj. N. A. Përgjegjëse e Sektorit të Financës, Drejtoria Ekonomike, A. B. është likuiduar me këste, për shkak të mungesës së fondeve, duke filluar pagesat pas një viti dhe duke përfunduar pas afro dy vitesh, pavarësisht se duhej progrA.ar dhe parashikuar në fondet buxhetore për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore, të akorduara në ligjin vjetor të buxhetit pasardhës.
Kriteri:	Udhëzim i Këshillit të Ministrave Nr. 1, datë 04.06.2014 óPër mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të njësive të qeverisjes së përgjithshme në llogari të thesaritó: Pika 3. Ekzekutimi i vendimeve gjyqësore realizohet nga njësia shpenzuese përgjegjëse: Germa a. me fondet buxhetore për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore, të akorduara në ligjin vjetor të buxhetit pasardhës për njësinë shpenzuese për shlyerjen e detyrimeve të vitit paraardhës, duke respektuar rradhën e paraqitjes në njësinë shpenzuese;

	Germa b. nga të ardhura të tjera, të siguruara nga njësitë e qeverisjes së përgjithshme, në bazë të legjislacionit përkatës, dhe të cilat shërbejnë si burime financimi për vetë njësinë; Pika 4. Njësitë e qeverisjes së përgjithshme, gjatë vitit buxhetor, mbajnë database për vendimet gjyqësore të formës së prerë që parashikojnë detyrime monetare, si dhe për shumat e detyrimeve. Shuma totale e detyrimeve për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, bëhet pjesë e procesit të programimit buxhetor të vitit të ardhshëm, sipas përcaktimeve të akteve ligjore e nënligjore përkatës. Këto parashikime i bëhen të njohura edhe njësisë së qeverisjes së përgjithshme nga e cila varet.
Ndikimi:	AKUM ka patur nën sekuestro llogarinë e vet, sikurse dhe rrezikon që qytetari i shpronësuar të kërkojë kamatëvonesë për efekt ekzekutimi të vonuar të pagesës së dëmshpërblimit.
Shkaku	Mos vënie në dispozicion fondesh për ekzekutim pagese dëmshpërblimi.
Rëndësia:	E lartë.
1.1 Rekomandimi:	AKUM të sigurojë shlyerjen pa vonesë të pagesave të dëmshpërblimeve për efekt shpronësimi, objekt vendimesh gjyqësore.

Për mangësitë e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi: A. B., në cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm i AKUM.

Për sa më sipër është mbajtur Aktkonstatimi nr. 4, datë 10.12.2021

Lista e ish pronarëve të shpronësuar për efekt të zbatimit të projektit është mjaft e madhe, ndërkaq konstatohet se AKUM mbart një masë detyrimesh që deri me 30.06.2021 arrijnë vlerën prej 54,251,904 lekësh, që përfaqësojnë afro 54% të vlerës totale prej 100,616,320 lekësh, sakurse janë përcaktuar dëmshpërblimet me tre VKM e shpronësimit, duke e lënë në procesin e shpronësimit të papërmbyshur detyrimin e shpërblimit të të shpronësuarve. Të dhënat e ofruara nga AKUM, mbi të shpronësuarit e parimbursuar paraqiten më poshtë.

Lista emërore e ish – pronarëve të pakompensuar për efekt shpronësimi për interes publik

Tabela 16

Nr.	Emri/Atesia/Mbiemri	Pasuria	Lloji	Sip. e pergj. (m2)	Sip. e shpron.	Vlera (Lekë)	VKM/Data
1	A. S. Sh.	123/11/1	Arë	6250	6250	2,800,000.00	252 dt.24.04.2019
2	H. Y. B.	193/1	Arë	3200	2470	1,106,560.00	252 dt.24.04.2019
3	B. L. H.	202/2	Arë	5000	4300	1,926,400.00	252 dt.24.04.2019
4	A. J. S.	181/16	Arë	3600	3000	1,344,000.00	252 dt.24.04.2019
5	G. H. Sh.	181/15	Arë	3600	2300	1,030,400.00	252 dt.24.04.2019
6	Bp. G. A. K.	193/26	Arë	10000	10000	4,480,000.00	252 dt.24.04.2019
	Z. A. K.						
7	R. Xh. H.	202/2/1	Arë	5000	4400	1,971,200.00	252 dt.24.04.2019
8	L. T.	181/27	Arë	3700	3000	1,344,000.00	252 dt.24.04.2019
9	H. S. H.	181/19	Arë	3200	3200	1,433,600.00	252 dt.24.04.2019
10	I. Xh. M.	123/20	Arë	1700	1700	761,600.00	772 dt.16.09.2015
11	I. Xh. M.	123/21/1	Arë	1700	1366	611,968.00	772 dt.16.09.2015
12	F. H. B.	123/23	Arë	1700	1048	469,504.00	772 dt.16.09.2015
13	R./I./A./N. I. N.	123/26	Arë	2600	2600	1,164,800.00	772 dt.16.09.2015
14	I. H.	123/27	Arë	5000	72	32,256.00	772 dt.16.09.2015

15	D. B. B.	123/28	Arë	3400	1266	567,168.00	772 dt.16.09.2015
16	Sh. Q. S.	121/1	Arë	8400	7583	3,397,184.00	61 dt.12.02.2014
17	K. M.	122/3	Arë	5900	1924	861,952.00	61 dt.12.02.2014
18	G. M. Sh.	137/3	Arë	4800	1876	840,448.00	61 dt.12.02.2014
19	R./I./A./N. I. N.	138/1/1	Arë	3500	623	279,104.00	61 dt.12.02.2014
20	I. H. B.	138/1/2	Arë	3125	513	229,824.00	61 dt.12.02.2014
21	I. H. B.	138/1	Arë	3000	356	159,488.00	61 dt.12.02.2014
	Xh. H. B.						
	D. A. (B.)						
	Z. L. (B.)						
	Sh. M. B.						
	V. Sh. B.						
	E. I. B.						
	E. I. B.						
	A. I. B.						
22	I. Xh. R.	138/7	Arë	5000	379	169,792.00	61 dt.12.02.2014
23	S. R. B.	116/7/3	Arë	6000	342	153,216.00	61 dt.12.02.2014
24	A. H. Sh.	123/12	Arë	9470	9470	4,242,560.00	61 dt.12.02.2014
25	B. A. H.	203/12	Arë	500	500	224,000.00	61 dt.12.02.2014
26	H. T.	203/13	Arë	4500	3074	1,377,152.00	61 dt.12.02.2014
	J. T.						
	M. T.						
	A. K.						
	E. T.						
27	I. M. B.	181/5	Arë	1600	1600	716,800.00	61 dt.12.02.2014
28	L. U. P.	181/7	Arë	2400	2400	1,075,200.00	61 dt.12.02.2014
29	H. I. A.	181/10	Arë	5600	5600	2,508,800.00	61 dt.12.02.2014
30	T. A. M.	181/16	Arë	6400	6400	2,867,200.00	61 dt.12.02.2014
31	H. B. K.	181/24	Arë	4000	2883	1,291,584.00	61 dt.12.02.2014
32	F. L.	181/10	Arë	1800	1612	722,176.00	61 dt.12.02.2014
33	B. B.	191/9	Arë	2500	1323	592,704.00	61 dt.12.02.2014
34	F. Q. K.	193/17	Arë	6700	80	35,840.00	61 dt.12.02.2014
35	H. H. Zh.	193/20	Arë	1000	1000	448,000.00	61 dt.12.02.2014
36	F. H. K.	193/24	Arë	3000	3000	1,344,000.00	61 dt.12.02.2014
37	I. F. C.	195/3	Arë	3200	1574	705,152.00	61 dt.12.02.2014
38	T. M. L.	195/4	Arë	3200	1655	741,440.00	61 dt.12.02.2014
39	S. M. P.	195/5	Arë	7200	3938	1,764,224.00	61 dt.12.02.2014
40	T. C. P.	195/6	Arë	800	480	215,040.00	61 dt.12.02.2014
41	G. Q. H.	195/15	Arë	1000	650	291,200.00	61 dt.12.02.2014
42	Sh. B.	195/8	Arë	2400	1300	582,400.00	61 dt.12.02.2014
43	Sh. D. B.	195/10	Arë	4800	3320	1,487,360.00	61 dt.12.02.2014
44	Xh. H. G.	195/11	Arë	6400	3750	1,680,000.00	61 dt.12.02.2014
45	A. T. M.	195/12	Arë	4000	3081	1,380,288.00	61 dt.12.02.2014
46	A./T. B. Ll.	195/13	Arë	1500	1200	537,600.00	61 dt.12.02.2014
47	A. D.	193/15	Arë	7000	640	286,720.00	61 dt.12.02.2014
					TOTALI	54,251,904 lekë	

Burimi: Të dhëna vënë në dispozicion nga AKUM

Rrjedhimisht, masa e madhe e detyrimeve që AKUM ka ndaj të shpronësuarve do duhej të ishte bërë objekt interesimi të veçantë nga ana e AKUM dhe e Njesisë së Zbatimit të Projektit: òPërmirësimi i Sistemit të Kanalizimeve të Tiranës së Madheò me synim uljen e numrit të të shpronësuarve të parimbursuar. Kjo problematikë, sigurisht do duhej të ishte bërë objekt

raportimi nga ana e Njesisë së Zbatimit tek Drejtori i Përgjithshëm i AKUM, duke kërkuar fokusimin e një strategjie që e mundëson uljen e numrit të të shpronësuarve akoma të padëmshpërblyer për humbjen e pronës, për interes publik.

2. Titulli i gjetjes:	Nuk ka raportime të dokumentuara nga Koordinatorit i Njesisë të Zbatimit të Projektit, lidhur me procesin e shpronësimit.
Situata:	Lidhur me detyrimin e Koordinatorit të Njesisë së Zbatimit të projektit óPërmirësimi i Sistemit të Kanalizimeve të Tiranës së Madheó për të raportuar pranë Drejtorit të Përgjithshëm të AKUM, lidhur me shpronësimet sikurse konfirmuar nga e - maili i datës 21 tetor 2021, marrë nga znj. Rudina Karoli, shkruhet: óNjesia e zbatimit ka raportuar ne vazhdimësi me Drejtorin e Përgjithshëm ne mbledhje periodike ne lidhje me shpronësimet por jo te dokumentuaraó. <u>Nga sa pohohet, konstatohet se raportimi lidhur me shpronësimet mbetet një detyrim i cili nuk dokumentohet, nëpërmjet asnjë akti shkresor, ndaj përmbushja e këtij detyrimi konsiderohet e parealizuar nga Koordinatorja e Njesisë së Zbatimit të Projektit.</u>
Kriteri:	Urdhri i Ministrit të MIE, Nr. 88, datë 24.02.2020, me të cilin është miratuar óRregullorja e brendshme për organizimin dhe funksionimin e AKUMó, Neni 17, Njesia e projekteve me financim të huaj, Pika 4, óDrejtuesi i Projektit/Koordinatori raporton tek Drejtori i Përgjithshëm, si eprori direkt, për ecurinë dhe çështje të ndryshme të projektitó.
Ndikimi:	Mungesa e raportimeve nga Koordinatorit i Njesisë të Zbatimit të Projektit, lidhur me procesin e shpronësimit, krijon kushte për mostrajtim me seriozitet të këtij procesi nga AKUM.
Shkaku	Neglizhencë
Rëndësia:	E lartë.
2.1 Rekomandimi:	Të sigurohet në AKUM një raportim i vazhdueshëm dhe i dokumentuar mbi proceset e shpronësimit dhe detyrimeve që rrjedhin prej tij, tek Drejtori i Përgjithshëm.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit të Auditimit, nga subjekti i audituar AKUM është paraqitur observacioni me shkresë nr. 888/11 prot., të datës 24.02.2022, në të cilin AKUM bën me dije se në vijim do të zbatojë detyrat e lëna nga KLSH, lidhur me këtë pikë.

Menaxhimi i marrëdhënieve me kategorinë e të shpronësuarve, të cilët janë të shumtë në numër dhe bile të shpronësuar edhe prej disa vitesh, në kushtet kur një pjesë të madhe të tyre nuk u disponohet një numër kontakti, apo edhe një adresë e saktë nga AKUM, për të nxitur procesin e shpërblyerit pas shpronësimit, e bën të nevojshëm informimin, si e drejtë themelore e tyre, edhe nëpërmjet informacionit elektronik. Kjo formë informimi mbetet një mundësi dhe detyrim të paanashkalueshëm nga ana e AKUM.

3. Titulli i gjetjes:	Nënfaqja e Njoftimeve, óShpronësimeó e faqes zyrtare të AKUM, është e pazhvilluar dhe pa asnjë përmbajtje apo informacionë
Situata:	Një formë komunikim dhe informimi për grupe të përfshira në procese kolektive është edhe ai nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të

	institucioneve që janë referent të këtyre proceseve. Por ajo që konstatohet është se nënfaqja e Njoftimeve óShpronësimeó e faqes zyrtare të AKUM, është e pazhvilluar dhe pa asnjë përmbajtje apo informacion. Mungojnë aktet ligjore dhe nënligjore që udhëheqin procesin e shpronësimit, si dhe kriteret e dhënies së shpërblimeve për efekt të shpronësimeve.
Kriteri:	Ligjin Nr. 119/2014 óPër të drejtën e informimitó, Neni 7, Kategoritë e informacionit që bëhet publik pa kërkesë Pika 1. Në përputhje me programin e transparencës së miratuar për çdo autoritet publik, këto të fundit përgatitin paraprakisht, në formate lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme, si dhe vënë në dispozicion të publikut në faqen e tyre në internet kategoritë e mëposhtme të informacionit: Germat k) informacione dhe dokumente që kërkohen shpesh; l) çdo informacion tjetër që gjykohet i dobishëm nga autoriteti publik. iii) të akteve nënligjore;
Ndikimi:	Moszhvillimi i nënfaqes së Njoftimeve óShpronësimeó e faqes zyrtare të AKUM, pengon ish - pronarët e shpronësuar të kenë informacion mbi procesin, i cili ngadalësohet rrjedhimisht.
Shkaku	Neglizhencë
Rëndësia:	E mesme
3.1 Rekomandimi:	Të sigurohet nga AKUM zhvillimi i nënfaqes së Njoftimeve, óShpronësimeó tek faqja zyrtare e agjencisë.

Për mangësitë e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi: z. I. Sh., ish - Koordinator i Njesisë së Zbatimit të Projektit “Përmirësimi i Sistemit të Kanalizimeve të Tiranës së Madhe”; Znj. R. K., Koordinaore e Njesisë së Zbatimit të Projektit “Përmirësimi i Sistemit të Kanalizimeve të Tiranës së Madhe”.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit të Auditimit, nga subjekti i audituar AKUM është paraqitur observacioni me shkresë nr. 888/11 prot., të datës 24.02.2022, në të cilin AKUM bën me dije se në vijim do të zbatojë detyrat e lëna nga KLSH, lidhur me këtë pikë.

Projekti: “Rehabilitimi i Rrjetit Hidrik të Tiranës”.

Informacioni i mëposhtëm, jep një panoramë të përgjithshme, edhe mbi situata e veprime të cilat nuk u audituan, meqë jashtë periudhës kohore në fokus auditimi, por që zgjatimi i pasojave të tyre, prek objektin dhe fokusin kohor të auditimit të kryer.

Në kuadër të Marrëveshjes Financiare ndërmjet Qeverisë Shqiptare dhe Bankës Artigiancassa, Itali, óPër financimin e Përbërësve të Asistencës Teknike për Ndërmarrjen e Ujrave dhe të Ndërhjryjeve Infrastrukturore të Rrjetit Hidrik, nr. FROT. / AID 99/004, është marrë përsipër financiarisht realizimi i Projektit me objekt: óRehabilitimi i Rrjetit Hidrik të Tiranësó i miratuar me Vendimin e Këshillit Teknik Nr. 17, datë 28.12.2018.

Punimet kanë filluar më 25.02.2019 dhe kanë përfunduar më 11.08.2020, ashtu siç ishte parashikuar në kontratë.

Me shkresën nr. 347 prot., datë 31.01.2019 AKUM i është drejtuar Drejtorisë së Bujqësisë Tiranë, duke i kërkuar vënien në dispozicion të çmimeve të referencës për dëmshpërblim, me synim marrjen e të gjitha masave për nisjen e procedurave për shpronësime të mundshme.

Me shkresën nr. 369 prot., datë 01.02.2019, AKUM i është drejtuar Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Tiranë, duke i kërkuar dhënien e statusit juridik të pronave që preken në kuadër të zbatimit të projektit óRehabilitimi i Rrjetit Hidrik të Tiranësó, me qëllim plotësimin e gjithë dokumentacionit tekniko-ligjor për të pajisur objektin me leje ndërtimi, si detyrim i palës shqiptare në përputhje me marrëveshjen e programit.

Me shkresën nr. 558 prot., datë 18.02.2019, AKUM i është drejtuar Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Tiranë, duke i kërkuar dhënien e statusit juridik të pronave që preken në kuadër të zbatimit të projektit óRehabilitimi i Rrjetit Hidrik të Tiranësó, óSegmenti 1ó, të cilës ZVRPP Tiranë i është përgjigjur me shkresën nr. 6124/1 prot., datë 26.02.2019 (nr.558/1 prot., datë 01.03.2019 i AKUM).

Me shkresën nr. 559 prot., datë 18.02.2019, AKUM i është drejtuar Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Tiranë, duke i kërkuar dhënien e statusit juridik të pronave që preken në kuadër të zbatimit të projektit óRehabilitimi i Rrjetit Hidrik të Tiranësó, óSegmenti 5ó.

Me shkresën nr. 560 prot., dhe nr. 561 prot., datë 18.02.2019, AKUM i është drejtuar Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Tiranë, duke i kërkuar dhënien e statusit juridik të pronave që preken në kuadër të zbatimit të projektit óRehabilitimi i Rrjetit Hidrik të Tiranësó, “Segmenti 4” dhe “Segmenti 3”, të cilave ZVRPP Tiranë u është përgjigjur me shkresën nr. 6126/1 prot., datë 27.02.2019 (nr.560/1 prot., datë 28.02.2019 i AKUM).

Me shkresën nr. 562 prot., datë 18.02.2019, AKUM i është drejtuar Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Tiranë, duke i kërkuar dhënien e statusit juridik të pronave që preken në kuadër të zbatimit të projektit óRehabilitimi i Rrjetit Hidrik të Tiranësó, “Segmenti 2” të cilës ZVRPP Tiranë i është përgjigjur me shkresën nr. 6128/1 prot., datë 26.02.2019 (nr.562/1 prot., datë 01.03.2019 i AKUM).

Me shkresën nr. 647 prot., datë 25.02.2019, AKUM i është drejtuar Agjencisë Rajonale të Ekstensionit Bujqësor (AREB), Tiranë, duke i kërkuar vënien në dispozicion të çmimeve të referencës për dëmshpërblim për projektin óRehabilitimi i Rrjetit Hidrik të Tiranësó të cilës AREB Tiranë i është përgjigjur me shkresën nr. 194 prot., datë 28.02.2019 (nr.647/1 prot., datë 01.03.2019 i AKUM).

Me Urdhrin e Brendshëm Nr. 29, datë 11.03.2019, nr. 813 prot., është ngritur Komisioni i Vlerësimit të Kulturave Bujqësore që do të dëmtoheshin në kuadër të projektit, i cili do përbëhej nga përfaqësues të AKUM, AREB, UKT dhe Njesisë Administrative Zall Herr (A. M., A. Duva, H. G., B. K.).

Në zbatim të këtij urdhri nga ana e Komisionit janë mbajtur proces-verbalet të cilat i janë dërguar për bërjen e vlerësimit ekonomik të kulturave bujqësore që dëmtohen nga procesi i shpronësimit të përkohshëm, Agjencisë Rajonale të Ekstensionit Bujqësor, Tiranë.

Me shkresën nr.805 prot., datë 11.03.2019 AKUM ka njoftuar Njësine Administrative Zall Herr që të vërë në dijeni pronarët që preken nga gjurma e projektit, me qëllim realizimin e procesit të shpronësimeve me transparencë dhe sipas legjislacionit në fuqi.

Procesi i shpronësimit pas 31.07.2019, paraqitej si më poshtë:

Pas vendimit të Grupit të Punës të AKUM (sikurse nga procesi verbal i datës 02.09.2019, i nënshkruar nga: F. M., V. B., A. Y., J. Gj., S. Z., A. M., A. Ç., L. V. dhe S. P.), i ngarkuar me

Urdhërin nr. 47, datë 07.05.2019 për koordinimin, organizimin dhe zbatimin e procesit të shpronësimeve të pasurive prone private në interes publik për realizimin e projektit óRehabilitimi i Rrjetit Hidrik të Tiranës, për të paraqitur kërkesën për shpronësim MIE, duke bashkëlidhur dokumentacionin shoqëruar, me shkresën nr. 2667 prot., datë 13.09.2019 AKUM i është drejtuar MIE-së duke i paraqitur kërkesën për shpronësim të pasurive të lartpërmendura.

Sqarojmë se me Urdhërim nr. 47, datë 07.05.2019, është ngritur Grupi i Punës të AKUM për koordinimin, organizimin dhe zbatimin e procesit të shpronësimeve të pasurive prone private për projektet e financuara nga buxheti i shtetit, porse është fakt, se ky grup pune i konstituuar me Urdhërim nr. 47, ka koordinuar, ndjekur dhe zbatuar procesin e shpronësimeve të pasurive prone private në interes publik për realizimin e projektit óRehabilitimi i Rrjetit Hidrik të Tiranës, sikurse jo vetëm nga pohimet e anëtarëve, por edhe nga përmbajtja e procesverbalit më lart cituar, pa u përgënjeshtuar në aktivitetin e zhvilluar prej tij nga titullari i subjektit.

Me shkresën nr. 8086/1 prot., datë 21.10.2019 (apo nr. 2667/1 prot., datë 22.11.2019, prototokoll i AKUM) **Spektori i Shpronësimeve të MIE i bën me dije AKUM - it se:**

Komisioni i Posaçëm i Shpronësimeve në MIE, ngritur me Urdhërin e Ministrit nr. 352, datë 02.10.2019, pasi shqyrtoi dokumentacionin bashkëlidhur kërkesës për shpronësim të dërguar nga ana juaj, **konstatoi semungon dokumentacioni si më poshtë:**

1. Projekti i miratuar dhe argumentet përkatëse ligjore për interesin publik lidhur me realizimin e tij (gërma b, pika 1, neni 10, Ligji nr. 8561, datë 22.12.1999 óPër shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë prone private për interes publik, i ndryshuar);
2. Lejet dhe miratimet përkatëse nga organet kompetente sipas ligjit, në përputhje me natyrën dhe llojin e projektit që kërkohet të realizohet (gërma d, neni 10, Ligji nr. 8561, datë 22.12.1999);
3. Projekti i hedhur në Hartën Kadastrale ku të evidentohet vija e shpronësimit, mungesa e të cilës bën të pA.ndur evidentimin e pronave që preken nga realizimi i projektit;
4. Aktet që vërtetojnë mënyrën e realizimit të projektit, nga vetë kërkuarësi i shpronësimit ose me të tretët, si dhe afatet përkatëse (gërma dh, neni 10, Ligji nr. 8561, datë 22.12.1999);
5. Relacion ku të jepet informacion përmbledhës për procedurën e shpronësimit;
6. Tabela përmbledhëse e pronarëve që shpronësohen, e cila duhet të jetë e formatuar sipas ndarjeve me emërtimet e nevojshme që kanë të bëjnë me të dhënat e pronave;
7. Kartelat e pasurive që preken nga projekti, të shoqëruara me Hartën Treguese të Regjistrat, të nënshkruara e të vulosura nga ASHK, si dhe të konfirmuara me vulën e AKUM;
8. Të gjitha dokumentet e vlerësimit të kulturave bujqësore e drufrutore, duhet të konfirmohen me vulë nga AKUM;
9. Subjekti kërkuar duhet të shprehet lidhur me burimin e fondeve të nevojshme për shpronësim;
10. Lista e pronarëve të pasurive prone private për të cilat kërkohet shpronësimi, në të cilën pasqyrohen sipërfaqet që do të shpronësohen dhe vlera për secilën pronë që shpronësohet;
11. Adresat dhe vendbanimi më i fundit i njohur i pronarëve dhe personave të tretë përkatës;
12. dokumentacioni duhet të jetë i firmosur me vulë nga subjekti kërkuar.

Në fund vihet në dukje se Komisioni i Posaçëm i Shpronësimit në MIE, me plotësimin dhe dërgimin e dokumentacionit nga AKUM, do të vazhdojë procedurat e mëtejshme të shpronësimit.

4. Titulli i gjetjes:	AKUM nuk ka përgatitur kërkesën për shpronësim dhe dosjen përkatëse të dokumentacionit shoqëruar konform parashikimeve ligjore mbi shpronësimin, lidhur me zhvillim e Projektit óRehabilitimi i Rrjetit Hidrik
------------------------------	--

	të Tiranës.
Situata:	Sikurse vënë në dukje në shkresën nr. 8086/1 prot., datë 21.10.2019 (apo nr. 2667/1 prot., datë 22.11.2019, prototokoll i AKUM) Sektori i Shpronësimeve të MIE, konstatohet se AKUM nuk ka përgatitur kërkesën për shpronësim dhe dosjen përkatëse të dokumentacionit shoqërues konform parashikimeve ligjore mbi shpronësimin, duke bërë që të mungojë: Projekti i miratuar dhe argumentet përkatëse ligjore për interesin publik lidhur me realizimin e tij; Lejet dhe miratimet përkatëse nga organet kompetente sipas ligjit, në përputhje me natyrën dhe llojin e projektit që kërkohet të realizohet; Aktet që vërtetojnë mënyrën e realizimit të projektit, nga vetë kërkuksi i shpronësimit ose me të tretët, si dhe afatet përkatëse; si dhe shumë dokumente të tjerë të nevojshëm për ecurinë e kërkesës për shpronësim.
Kriteri:	Ligji nr. 8561, datë 22.12.1999 óPër shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publikó, i ndryshuar, Neni 10 óKërkesa dhe dokumentet shoqëruese të kërkesës për shpronësimó pika 1, gërmat b), d), dh), óSubjekti, në favor të të cilit bëhet shpronësimi, duhet të paraqesë ne ministrinë kompetente sipas ligjit, kërkesën për shpronësim. Kjo kërkesë duhet të shoqërohet me këtë dokumentacion: b) Projektet e nevojshme dhe të miratuara sipas ligjit, si dhe argumentet përkatëse ligjore për interesin publik, lidhur me realizimin e këtyre projekteve. d) Lejet dhe miratimet përkatëse nga organet kompetente sipas ligjit, në përputhje me natyrën dhe llojin e projektit që kërkohet të realizohet. dh) Aktet që vërtetojnë mënyrën e realizimit të projektit, nga vetë kërkuksi i shpronësimit ose me të tretët, si dhe afatet përkatëse.
Ndikimi:	Pengohet procesi i shpronësimit.
Shkaku	Neglizhencë
Rëndësia:	E lartë
4.1 Rekomandimi:	AKUM të angazhohet seriozisht në përgatitjen e kërkesave për shpronësim dhe dosjeve të cilat shoqërojnë procesin e shpronësimit, duke shmangur shkeljet e konstatuara.

Për mangësitë e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi: Grupit i Punës i përbërë: F. M., Kryetar; V. B., Anëtare; A. Y., Anëtare; J. Gj., Anëtar; S. Z., Anëtare; A. M., Anëtare; A. Ç., Anëtare; L. V., Anëtare; S. P., Anëtar.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit të Auditimit, nga subjekti i audituar AKUM është paraqitur observacioni me shkresë nr. 888/11 prot., të datës 24.02.2022, në të cilin AKUM bën me dije se në vijim do të zbatojë detyrat e lëna nga KLSH, lidhur me këtë pikë.

Grupit i Punës të AKUM (sikurse nga procesi verbal i datës 05.12.2019, i nënshkruar nga: F. M., V. B., A. Y., J. Gj., S. Z., G. Ll., A. Ç., L. V. dhe S. P.), i ngarkuar me Urdhrin nr. 47, datë 07.05.2019, ndryshuar me Urdhrin 175, datë 05.12.2019, për koordinimin, organizimin dhe zbatimin e procesit të shpronësimeve të pasurive prone private në interes publik për realizimin e

projektit óRehabilitimi i Rrjetit Hidrik të Tiranësó (Ky grup pune ka funksionuar edhe për projektet me financim të huaj, duke mbuluar të gjitha procedurat e shpronësimit të AKUM), vendosi të paraqesë kërkesë pranë ASHK Tiranë për konfirmimin e statusit juridik të pronave që preken nga ky projekt, si dhe të dokumentacionit shtesë dhe pas marrjes së kësaj përgjigjeje, tã ridërgojë dosjen në MIE për të vijuar më tej.

Me shkresën me lëndë: óKujtesë mbi plotësimin e dokumentacionit të kërkesës për shpronësimó nr. 1994 prot., datë 21.02.2020 (nr. 605 prot., datë 24.02.2020, protokoll i AKUM), MIE tërheq vëmendjen dhe sqaron se, óMeqenëse kanë kaluar mbi 4 muaj dhe nga ana juaj nuk është dërguar dokumentacioni i kërkuar, Ju bëjmë me dije se vonesat e tejzgjatura në plotësimin e dokumentacionit, përbëjnë shkak për kthimin e dosjes së shpronësimit dhe refuzimin e kërkesës për shpronësim, referuar përcaktimeve të nenit 12, të Ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 óPër shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publikó, i ndryshuar.

Në fund të shkresës thuhet: óSa më sipër, lutemi plotësimin e dokumentacionit të kërkuar brenda 30 ditëve, në të kundërt do të procedohet me kthimin e kërkesës për shpronësimó.

Me shkresën nr. 1183 prot., datë 15.05.2020 AKUM i është drejtuar ASHK-së duke i kërkuar rifreskimin dhe konfirmimin e statusit juridik të pronave që preken nga zbatimi i projektit.

ASHK-ja me shkresën nr. 1407 prot., datë 11.06.2020 (protokoll i AKUM) ka kthyer përgjigje duke njoftuar AKUM ñ in, se në zbatim të nenit 63 të Ligjit Nr.111/2018 óPër Kadastrënó Këshilli i Ministrave ka miratuar VKM Nr. 389, datë 13.05.2020 óPër miratimin e listës dhe të tarifave të shërbimeve kadastraleó ndërkohë që kërkesa mbi statusin juridik të pronave që preken nga ky projekt duhet të kryhet nëpërmjet paraqitjes së kërkesës në portalin qeveritar e-albania.

Me Urdhrin e Brendshëm nr. 78, datë 08.09.2020 shkresa nr. 583/1, ngrihet Grupi i përhershëm i Punës për koordinimin, organizimin dhe zbatimin e procesit të shpronësimit të pasurive óPronë private për interes publikó për realizimin e projekteve me financim të huaj i përbërë nga: Koordinator i Njësisë (Kryetar), Njësia e Projektit (Anëtar), znj. F. B. (Anëtare), i cili organizon dhe koordinon punën mes drejtorive brenda institucionit të AKUM për grumbullimin, shqyrtimin dhe verifikimin e dokumentacioneve përkatëse të shpronësimit, si dhe udhëheq dhe organizon procesin e koordinimit me institucione të tjera përgjegjëse për grumbullimin, shqyrtimin dhe verifikimin e dokumentacioneve përkatëse, për të realizuar procedurën e shpronësimit.

5. Titulli i gjetjes:	ASHK ka vënë me vonesë në dispozicion të AKUM zyrtarisht informacionin e kërkuar mbi pasuritë pronë private, që preken nga zbatimi i Projektit óRehabilitimi i Rrjetit Hidrikó.
Situata:	Nga AKUM më datë 14.09.2020 është kryer procedura e aplikimit online për verifikimin e statusit juridik të pronave që preken në zbatim të projektit óRehabilitimi i Rrjetit Hidrikó. Me shkresën nr. 2327/1 datë 28.09.2020 ASHK ka dërguar faturën për shërbimin kadastral për të cilin AKUM do aplikonte në portal, në përgjigje të kërkesës së AKUM për këtë informacion, përcjellë me shkresën nr. 2327 prot., datë 14.09.2020. Me shkresën nr. 3326 prot., datë 24.12.2020 (protokoll i AKUM) ASHK ka vënë në dispozicion zyrtarisht informacionin e kërkuar mbi pasuritë pronë private që preken nga zbatimi i Projektit óRehabilitimi i Rrjetit Hidrikó, në kuadër të aplikimit të kryer online nga AKUM. Referuar vonesës në dhënien e shërbimit për të cilin ka aplikuar AKUM,

	konstatohet shkelja e afateve procedurale nga ASHK në dhënien e shërbimit kadastral. Ndërkohë AKUM duhej të kishte insistuar pranë ASHK për respektimin e afateve.
Kriteri:	Ligji Nr. 111/2018 óPër kadastrënó, Neni 29 óKërkesa dhe afatetó, pika 3. óÇdo kërkesë për shërbim kadastral, që paraqitet rregullisht, trajtohet brenda 15 ditëve nga data e depozitimit, por në çdo rast jo më vonë se 21 ditë kalendarikeó.
Ndikimi:	Vonesat e ASHK në dhënien e informacionit mbi statuset e pasurive pengojnë procesin e shpronësimit.
Shkaku:	Neglizhencë e ASHK.
Rëndësia:	E lartë
5.1 Rekomandimi:	AKUM të insistojë me vëmendje të shtuar në marrjen e informacionit nga ASHK, lidhur me statuset juridike të pasurive të cilat preken nga proceset e shpronësimit, duke synuar një ndërveprim më efikas me ASHK.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Projekt Raportit të Auditimit, nga subjekti i audituar AKUM nuk është paraqitur observacion.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit të Auditimit, nga subjekti i audituar AKUM është paraqitur observacioni me shkresë nr. 888/11 prot., të datës 24.02.2022, në të cilin AKUM bën me dije se në vijim do të zbatojë detyrat e lëna nga KLSH, lidhur me këtë pikë.

6. Titulli i gjetjes:	AKUM nuk ka përgatitur kërkesën e shpronësimit dhe dosjen përkatëse të dokumentacionit shoqërues, brenda afateve kohore përcaktuara nga parashikimet ligjore mbi shpronësimin, referuar Projektit óRehabilitimi i Rrjetit Hidrik të Tiranësó.
Situata:	Me shkresën nr.469 Prot., datë 24.02.2021 AKUM ka dërguar dosjen e plotë për kërkesën për shpronësim në MIE. Në këtë pikë procesi i shpronësimit nuk është e sigurtë se mund të përmbyllet pozitivisht, meqë referuar shkresës me lëndë: óKujtesë mbi plotësimin e dokumentacionit të kërkesës për shpronësimó nr. 1994 prot., datë 21.02.2020 (nr. 605 prot., datë 24.02.2020, protokoll i AKUM), ku MIE tërhoqte vëmendjen dhe sqaronte se, óMeqënëse kanë kaluar mbi 4 muaj dhe nga ana juaj nuk është dërguar dokumentacioni i kërkuar, Ju bëjmë me dije se vonesat e tejzgjatura në plotësimin e dokumentacionit, përbëjnë shkak për kthimin e dosjes së shpronësimit dhe refuzimin e kërkesës për shpronësim, referuar përcaktimeve të nenit 12, të Ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 óPër shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publikó, i ndryshuar, duke shtuar në fund se: óSa më sipër, lutemi plotësimin e dokumentacionit të kërkuar brenda 30 ditëve, në të kundërt do të procedohet me kthimin e kërkesës për shpronësimó. Nga data 21.02.2020 kanë kaluar rreth 13 muaj, pra 12 muaj përtej afatit 30 ditor, të lënë si afat nga Komisioni i Posaçëm i Shpronësimeve të MIE. Kësaj vonese i ka paraprirë edhe vonesa tjetër prej katër muajsh, e cila u bë shkas për dërgimin e shkresënr. 1994 prot., datë 21.02.2020 (nr. 605 prot.,

	datë 24.02.2020, protokoll i AKUM), nga MIE. Duke përjashtuar AKUM në in nga përgjegjësia për vonesën ASHK, sigurisht, konstatohet se vonesa në dërgimin e kërkesës për shpronësim lidhet me administrimin jo në përputhje me ligjin, nga ana e AKUM. Vërtetë nga MIE nuk është refuzuar kërkesa për shpronësim e AKUM, por konsideruar edhe koha që MIE ka tashmë dosjen në dispozicion, dhe nuk ka dhënë përgjigje lidhur me praktikën, shtyn të mendohet se kërkesa, për shkak të kalimit të afateve, mund të jetë e destinuar për refuzim për kapërcim të afateve.
Kriteri:	Ligji nr. 8561, datë 22.12.1999 óPër shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publikó, i ndryshuar, neni 12, pikat 2 dhe 3: ó2. Në rastet kur dokumentacioni i paraqitur nga kërkuesi nuk është i plotë ose i saktë, ministria kompetente i kthen menjëherë pa veprim kërkuesit të shpronësimit kërkesën e shpronësimit dhe dokumentacionin shoqërues të tij sipas këtij neni, duke caktuar edhe afat të posaçëm për plotësimet përkatëse. 3. Kur kërkesa dhe dokumentacioni shoqërues nuk paraqiten të plotësuar në afatin e caktuar ose gjenden të pambështetur, për mungesë të shkakut ose të kushteve të shpronësimit sipas këtij ligji, kërkesa refuzohet nga ministria dhe i njoftohet menjëherë kërkuesit të shpronësimitó.
Ndikimi:	Kapërcimi i afateve të përgatitjes së kërkesës për shpronësim duke provokuar refuzimin e saj, kompromenton në mënyrë të pariparueshme gjithë procesin e shpronësimit.
Shkak:	Neglizhencë
Rëndësia:	E lartë
6.1 Rekomandimi:	AKUM të angazhohet seriozisht në përgatiten e kërkesave për shpronësim brenda afateve kohore.

Për mangësitë e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi: Grupet e Punës të përbërë: F. M., Kryetar; V. B., Anëtare; A.Y., Anëtare; J. Gj., Anëtar; S. Z., Anëtare; A. M., Anëtare; A. Ç., Anëtare; L. V., Anëtare; S. P., Anëtar, G. Ll., Anëtar, A. M., Koordinator i Njesisë (Kryetar); F. B. (Anëtare).

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit të Auditimit, nga subjekti i audituar AKUM është paraqitur observacioni me shkresë nr. 888/11 prot., të datës 24.02.2022, në të cilin AKUM bën me dije se në vijim do të zbatojë detyrat e lëna nga KLSH, lidhur me këtë pikë.

Procedura e shpronësimit është e ndarë në dy F.: shpronësim për marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë dhe shpronësim në kuadër të marrjes së përhershme të pasurisë në funksion të zbatimit të projektit.

Sipas konfirmimit të ASHK rezultojnë:

46 pronarë për shpronësim të përkohshëm, referuar marrjes në përdorim të përkohshëm të pasurisë;

1 pronar për shpronësim të përhershëm, në kuadër të marrjes së përhershme të pasurisë për interes publik.

Lista e pronarëve sipas konfirmimit nga ASHK, referuar shpronësimit të përkohshëm:

Tabela 17

<i>Emri/Atesia/Mbiemri</i>	<i>Zona Kadastrale</i>	<i>Pasuria</i>	<i>Sip. e pergj. (m2)</i>	<i>Sip. e shpron.</i>	<i>Lloji</i>
B. R. M.	1929	67/4	3000	810	Arë
N. I. L.	1929	67/6	450	195	Arë
Xh. B. L.	1929	73/4	1035	260	Arë
I. B. L.	1929	73/3	1035	360	Arë
A. B. H.	1929	73/8	2074	300	Arë
Xh. B. M.	3052	67/3	2000	1300	Arë
Xh. L.	1929	66/16	1700	-	Arë
J. H.	1929	65/7	5100	750	Arë
Shtet	1929	65/9	1000	0	Arë
Sh. L.	1929	67/8	150	200	Arë
Shtet	1929	4/1	48000	0	Ullishte
Shtet	1929	1/1	1000	0	Arë
Shtet	1929	1/2	624	0	Arë
Shtet	1929	46/9	5500	0	Truall
Shtet	1929	65/2	1200	855	Pemëtore
Shtet	1929	65/1	300	0	Truall
H. O. Sh.	1929	73/1	2450	1400	Arë
Shtet	1929	71/2	19375	0	Pyll
SHtet	1929	67/9	42050	800	Pyll
Xh. L.	1929	67/7	330	240	Arë
Shtet	1929	67/5	625	165	Arë
Shtet	1929	67/2	1520	1050	Arë
Shtet	1929	67/1	2375	180	Pyll
F. & B. F.	1929	65/19	800	600	Arë
F. & B. F.	1929	65/18	180	600	Arë
Shtet	1929	65/15	650	30	Arë
Shtet	1929	65/13	1750	375	Arë
Bashkëpronësi H., M. etj	1929	65/33	1550	570	Arë
Shtet	1929	65/34	1750	450	Arë
F. C.	1929	65/35	1100	735	Arë
Shtet	1929	65/36	675	0	Arë
S. Sh.	3052	130/4	2500	815	Arë
S. Sh.	3052	130/6/1	250	500	Truall
Shtet	3052	130/1	1260	0	Pemëtore
Shtet	3052	130/1/1	300	0	Truall
Shtet	3052	130/2	690	0	Pemëtore
Shtet	3052	130/2/1	300	0	Truall
Shtet	3052	130/5	1640	1130	Arë
Shtet	3052	130/6	1920	0	Arë
Shtet	3878	124/1	2200	450	Arë
S. Sh.	3878	124/2	2200	1125	Arë
Sh. L.	3878	86/6	4000	0	Arë
Q. L.	3878	86/8	3200	200	Arë
Shtet	3878	173/17	5100	0	Arë
Sh. Xh.	3878	173/3	2950	0	Arë
Shtet	3878	184/3	1960	270	Arë
Shtet	3878	184/4	1960	9100	Arë
Shtet	3878	184/6	1400	380	Arë
Shtet	3878	124/3	2500	338	Arë
Q. C.	3878	124/4	1220	0	Arë
Shtet	3878	124/6	1720	0	Arë
Shtet	3878	124/33	2700	0	Arë
Shtet	3878	116/1	3420	9750	Arë
Bashkëpronësi Sh. & A.	3878	116/38	700	0	Arë
Shtet	3878	116/39	-	0	Arë
Bashkëpronësi Sh. & A.	3878	116/2	2700	1425	Arë

S. Sh.	3887	116/31	3100	975	Arë
M. Sh.	3887	116/32	1700	225	Arë
Shtet	3887	116/33	1700	0	Arë
Shtet	3878	116/5	3600	525	Arë
S. B.	3878	86/23	4000	450	Arë
I. H.	3878	24/7	2040.00	330	Arë
Xh. A.	3878	24/8	3360.00	555	Arë
H. M.	3878	116/36	3500	345	Arë
R. H.	3878	124/24	1800	0	Arë
Shtet	3878	5	21937	0	Arë
I. Z.	3878	244/4	22500	0	Arë
F. K.	3878	224/10	7960	0	Arë
B. Q.	3878	239/1	1000	0	Arë
Sh. K.	3878	244/13	2700	-	Arë
R. G.	3878	24/9	500.00	405	Arë
H. E	3878	261/5	7654	1100	Arë
I. M.	3878	24/11	600.00	960	Arë
Bashkëpronësi B.	3878	86/25	4300	750	Arë
M. M.	3878	116/28	1950	525	Arë
Q. M.	3878	261/10	1500	0	Arë
M. K.	3878	239/6	6000	350	Arë
Sh. K.	3878	239/7	3700	2400	Arë
Bashkëpronësi D.	3878	1/3	2200.00	2500	Arë
B. D.	3878	1/1	2200.00	750	Arë
Q. R. B.	3878	24/29	1000	160	Arë

Burimi: Të dhëna vënë në dispozicion nga AKUM

Lista e pronarëve sipas konfirmimit nga ASHK, referuar shpronësimit të përhershëm:

Tabela 18

<i>Emri/Atesia/Mbiemri</i>	<i>Zona Kadastrale</i>	<i>Pasuria</i>	<i>Sip. e pergj. (m2)</i>	<i>Sip. e shpron.</i>	<i>Kilomentri</i>	<i>Lloji</i>
Shtet	3052	130/6	1920	28.5	3+560	arë
S. Sh.	3878	124/2	2200	23.5	7+230	arë

Burimi: Të dhëna vënë në dispozicion nga AKUM

III.4. Vlerësimi i detyrave të projektimit, të projekteve të zbatimit, preventivave të zbatimit dhe studimeve të ndryshme. Auditimi i burimeve të financimit, të pagesave apo sponsorizimeve (dhurimeve) të bëra për këto shërbime.

Referuar periudhës së auditimit nuk janë miratuar pojqekte zbatimi të reja, por për projektet e miratuara më parë dhe që janë në fazë zbatimi, të cilat janë audituar, janë konstatuar disa mangësi.

Gjatë zbatimit të kontratës ôNdërtim i kolektorit kryesor të ujërave të zeza dhe I.T.U.P në Gjirin e Lalezitô,kanë rezultuar diferenca të volumeve të parashikuara krahasuar me ato faktike, por edhe nevoja për ndryshime. Ndryshimet nuk kanë rezultuar vetëm për faktin e diferencave të volumeve por edhe ndryshime të cilat kanë ardhur si pasojë e përshtatjes së elementëve të kontratës si psh. i linjave elektrike. Linjat elektrike të projektuara nuk janë të njëjta me rrjetin elektrik i cili do të lidhej me linjat ekzistuese të rrjetit të OSHEE, për këtë arsye dimensionimi i kabllit nga 624 kV, ALXLPE. 3 x 1 x 185 mm²ô është përshtatur në 624 kV, ALXLPE. 3 x 1 x 240/25 mm², si dhe është shtuar shtresë me tulla dhe shirit sinjalizues. Ndryshimi si më sipër rezulton me zë të ri punimi, për të cilin nuk ka referencë në preventiv dhe në këto kushte është nevojitur hartimi i analizës teknike.

- Sipas zërit 1.5.1, është parashikuar ôLinjë nëntokësore fibër optike e armuar me 12 deje SM të futur në tub HDPE Ø 40 mm, përfshirë specifikimet dhe lidhjet e nevojshme.

Ky zë është zëvendësuar me:ôLinjë nëntokësore fibër optike e armuar me 24 deje SM të futur në tub HDPE Ø 40 mm, përfshirë specifikimet dhe lidhjet e nevojshme. Ky ndryshim është bërë për rritjen e kapacitetit të fibrës optike është bërë për mundësimin e instalimit të kamerave të vëzhgimit si dhe shtimit të stacioneve të pompimit në të ardhmen. Ndryshimet të cilat janë shoqëruar me zëra të rinj punimesh, kryesisht janë bazuar në studimin e tregut si dhe manualët e çmimeve të punimeve të ndërtimit.

Ndryshime të volumeve të punimeve ka dhe në kontrata të tjera, por duke qenë se kemi të bëjmë me kontrata me matje, volumet janë përshtatur sipas faktit dhe në rastet e rritjes së vlerës së preventivit është shfrytëzuar fondi rezervë.

III.5 Mbi zbatimin e procedurave të prokurimit publik për punime, mallra dhe shërbime.

- Vlerësimi i hartimit të nevojave për ndërtime, mallra dhe shërbime në infrastrukturën e Ujësjetës Kanalizime.
- Argumentimi dhe përlogaritja e fondit limit.
- Hartimi i dokumenteve të tenderit.
- Zbatimi dhe vlerësimi i procedurave të prokurimit nga momenti i nxjerrjes së urdhrit të prokurimit deri në lidhjen e kontratës.

Në zbatim të pikës (5) të programit të auditimit ôNr.888/2 datë 07/09/2021ô, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- Regjistri realizimeve dhe parashikimit të prokurimeve publike për periudhën 31.07.2019-30.06.2021.
- Dosjet e procedurave të prokurimeve.
- Aksesi në sistemin e prokurimeve publike në faqen e APP (<http://www.app.gov.al/>).

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet:

I.Procedura prokurimit publik me objekt “Përmirësimi i furnizimit me ujë për lagjen Krastë e Vogël, Harmes dhe qytetin Elbasan”,rezultoi si më poshtë:

Urdhër prokurimi me nr. 1912 prot datë 02.07.2019	NJHDT L.V.(person përgjegjës)	KVO me urdhrin nr. 1912/1, datë 02.07.2019
Fondi limit 357,799,354 lekë. I shtrirë në 3 vite financim: 2019 në vlerën 85,871,845 lekë me tvsh; 2020 në vlerën	A.C. A.B. (E.S.person përgjegjës sipas shkresës nr. 2540 prot., datë	F.M.ñ kryetar J.Gj.ñ anëtar A.M.- anëtar

75,000,000 lekë me tvsh; 2021 në vlerën 268,487,380 lekë me tvsh	02.09.2019)	
Procedura e prokurimit në hapur		
Burimi i Financimit: buxheti i shtetit. Për vitin 2019 financimi 85,871,845 lekë	Fitues: BOE óL.ó Shpk & óB.ó & óA.K.ó shpk & óB.ó shpk	Vlera fituese 267,811,250 lekë pa tvsh
Datë e hapjes së tenderit 13.08.2019	Diferenca nga fondi limit 89,988,104 lekë.	Kontrata nr. 3889 prot., datë 31.12.2019
Marrin pjesë 9 OE S`kualifikuar 2 OE	Miratimi i procedurës: Me shkresën nr. 3781/1 prot., datë 17.12.2019	Vlera e kontratës 267,811,250 lekë pa tvsh dhe 320,833,450lekë me tvsh.
A.imime në AK - po A.imime në KPP - po	Afati kontratës 12 muaj nga nënshkrimi.	Titullar i AK në A.B.

Dosja e Tenderit.

Dosja e procedurës së prokurimit nuk është arkivuar, inventarizuar dhe numerizuar me numër fletësh sipas përcaktimeve të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 óPër Arkivató, nenin 4/26 dhe óNormat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisëó, Neni 19, **çka ngarkon me përgjegjësi anëtarin e njësisë së prokurimit E. S. në cilësinë e personit përgjegjës për prokurim (sipas shkresës nr. 2540 prot., datë 02.09.2019 ka zëvendësuar L. V.).**

Projekt preventivi

Në lidhje me hartimin e Projektit dhe Preventivit rezulton se është kryer si procedurë prokurimi nga Bashkia Elbasan dhe kaluar AKUM me shkresën nr. 166 prot., datë 18.01.2019. Këshilli Teknik, në bazë të urdhrin nr. 75, datë 21.06.2019 shqyrtoi projekt-preventivin dhe me vendimin Nr. 20, datë 26.06.2019 me nr. 1881 prot., datë 26.06.2019 u konfirmua projekt preventivi i mësipërm.

Dokumentet e tenderit.

Me shkresën nr. 2224 prot., datë 29.07.2020, urdhër për pezullim procedure prokurimi, është urdhëruar pezullimi procedurës prokurimit si rezultat i rekomandimeve të APP për DST me afat deri në hedhjen Shtojcës nr.1. Për zbatimin e këtij urdhri është ngarkuar njësia prokurimit. Me shkresën nr. 2224/1 prot., datë 29.07.2019, pas hedhjes së shtojcës nr.1 është hequr pezullimi dhe është vazhduar me hapat e mëtejshëm të procedurës.

Nga Njësia e Prokurimit me shkresën datë 02.07.2019 është hartuar procesverbali për miratimin e dokumenteve standarde të tenderit dhe formularët përkatës. Sipas këtij akti përlllogaritja e Fondit Limit dhe hartimi i Specifikimeve Teknike është kryer nga ana e Drejtorisë së Planifikimit të Investimeve të cilat më pas janë paraqitur në sektorin Juridik dhe Prokurimeve me anë të shkresës datë 01.07.2019.

Në përcaktimet e kriterëve të veçanta të kualifikimit nga Njësia Hartimit Dokumenteve të Tenderit, u konstatuan mangësi, pasi kriteret e përdorura për identifikimin e ofertës ekonomikisht më të favorshme, nuk janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe nuk janë të argumentuara me hollësi mbi domosdoshmërinë e tyre, konkretisht si më poshtë:

1- Në dokumentet e tenderit, Në pikën 2.3.7, pika 3 është kërkuar *óTë paraqiten mjete dhe pajisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit si më poshtë:*

- Kokore minimumi 100 (njëqind) copë
- Jelekë minimumi 100 (njëqind) copë
- Prozhektorë ndriçimi natën minimumi 5 (pesë) copë
- Komplet i ndihmës së shpejtë minimumi 5 (pesë) copë
- Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt minimumi 20 (Njëzetë) copë
- Kontenier për mbajtje malli 1 (një) copë

Të cilat në bazë të Udhëzimit nr.2, datë 08.05.2003, *óPër klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimitó*, dalë në zbatim të neneve 12 e 18 të ligjit nr.8402, datë 10.9.1998 *óPër kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimitó*, kreu II, pika B. *óStruktura e kostos së punimeve të ndërtimitó*, nënpika B, *óShpenzimet e përgjithshme dhe fitimió* pika 3, **janë të përcaktuara në shpenzime të përgjithshme** në të cilat përfshihen veç të tjerash shpenzimet për masat e sigurimit teknik, rrethimet e përkohshme gjatë ndërtimit në lartësi, skelat, makineritë, tabelat sinjalizuese etj., për mbrojtjen në punë si trajtimi me veshmbathje, ushqime, antidote, ndihmë e shpejtë etj. Në bazë të neneve nr. 8, 9, 10 e 18 të ligjit nr.8402, datë 10.9.1998 *óPër kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimitó*, të ndryshuar, drejtuesit ligjorë dhe teknikë të sipërmarrësit janë përgjegjës përpara investitorit për ndërtimin e veprës, sipas projektit, për kryerjen e punimeve të ndërtimit, në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, specifikimet teknike, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë, brenda kushteve të kontratës e dispozitave ligjore në fuqi.

2 - Në dokumentet e tenderit është kërkuar që: *óPër fabrikën e betonit, nëse është në pronësi, duhet të paraqitet vendndodhja (ne distance teknike si të pranueshme nga objekti jo me shume se 50 km, për të garantuar hedhjen në vepër brenda kushteve teknike), kontrata e blerjes apo çdoganimit, fotot dhe fatura tatimore përkatëse, leja mjedisore lëshuar nga QKLó.*

I cili është një kriter kufizues për pjesëmarrjen e gjerë të operatorëve ekonomik që ndodhen më larg se 50 km, të cilët mund të kenë largësi më të madhe se 50 km por mund të garantojnë furnizimin apo hedhjen në vepër brenda kushteve teknike.

Sa më sipër, për përcaktimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit, është vepruar në pajtueshmëri me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, *óPër prokurimin publikó*, të ndryshuar, Neni 46 *óKualifikimi i ofertuesveó*, pika 1, dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014, *óPër miratimin e rregullave të prokurimit publikó*, Neni 26 *óKontratat për punë publikeó*, pika 5, Neni 61 *óHartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderitó*, pika 2, për arsye se në procesverbalet e hartimit dhe miratimit të dokumenteve të tenderit nuk ka argumentim dhe nuk justifikohen me volumet e punës kërkesat teknike të përcaktuara nga Njësia Prokurimit, **çka ngarkon me përgjegjësi Njësinë e Prokurimit e përbërë nga L. V., A.C., A.B. dhe E. S.**

Zhvillimi i procedurës:

Nga auditimi në elektronik dhe dokumenteve faktik të procedurës së prokurimit me objekt *“Përmirësimi i furnizimit me ujë për lagjen Krastë e Vogël, Harmes dhe qytetin Elbasan”*, rezultoi se në tender kanë marrë pjesë 9 operator ekonomik, për të cilat KVO ka kryer vlerësimet si më poshtë:

Nr.	Operatori ekonomik pjesëmarrës	Oferta ekonomike (pa tvsh)	Vlerësimi i KVO-së
1	BOE óN.ó shpk & óJ.ó shpk	246,953,231	Kualifikuar
2	BOE óS.ó shpk me Nipt & óB.N.ó Shpk	257,249,099	Kualifikuar

3	BOE óL.ô Shpk & óB.ô shpk & A.K. shpk & óB.ô shpk	267,811,249	Kualifikuar
4	óC.ô shpk	286,182,560	Kualifikuar
5	óA.ô shpk	296,945,229	Kualifikuar
6	óF.ô Shpk	299,790,005	Kualifikuar
7	BOE óA.ô shpk & óA.ô Shpk & óS.N.P.ô shpk,	322,431,886	Kualifikuar
8	BOE óA.I.G.C.ô Shpk & óS.2.ô shpk & óN.ô Shpk	335,012,583	Kualifikuar
9	óA.ô shpk	354,036,967	Kualifikuar

Sa më sipër rezultoi se KVO me procesverbalin nr. 2, datë 02.09.2019 ka kualifikuar të gjithë operatorët ekonomik pjesëmarrës në procedurë duke bërë njoftimin e këtij vendimi në SPE. Si rezultat, operatorë ekonomik kanë paraqitur Ankesat si më poshtë:

A.esa për vlerësimin e ofertave, konkretisht në mënyrë kronologjike:

1. BOE “B.N.” shpk & “S.” shpk

- Ka paraqitur Ankesën më datë 06.09.2019 dhe protokolluar pranë AKUM nr. 2584 prot., datë 06.09.2019 me objekt skualifikimin e OE të renditur në vend të parë.
- me shkresën nr. 2587 prot., datë 06.09.2019 është pezulluar procedura e prokurimit deri në marrjen e një vendimi përfundimtar.
- me shkresën nr. 2587 /1 prot., datë 06.09.2019 është ngritur Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave (KSHA) i përbërë nga Z.I., J.O.dhe G.Ll..
- me shkresën nr. 2584/1 prot., datë 10.09.2019 informacion drejtuar titullarit në lidhje me shqyrtimin e Ankesës së paraqitur nga ky BOE, duke refuzuar Ankesën e tij.
- me shkresën nr. 2584/2 prot., datë 10.09.2019 kthim përgjigje BOE Ankimes, i është komunikuar refuzimi Ankesës.

2. BOE “L.” shpk & “B.” shpk & “A.K.” shpk & “B.X.” shpk.

- Ka paraqitur Ankesën nr. 107 prot., datë 07.09.2019 dhe protokolluar pranë AKUM nr. 2590 prot., datë 09.09.2019 me objekt skualifikimin e dy ofertuesve të renditur në vend 1 dhe 2 pasi sipas tyre asnjë prej tyre nuk plotësojnë kriteret e DST.
- me shkresën nr. 2587 prot., datë 06.09.2019 është pezulluar procedura e prokurimit deri në marrjen e një vendimi përfundimtar.
- me shkresën nr. 2587/1 prot., datë 06.09.2019 është ngritur Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave (KSHA) i përbërë nga Z.I., J.O.dhe G.Ll..
- me shkresën nr. 2590/2 prot., datë 13.09.2019 informacion drejtuar titullarit në lidhje me shqyrtimin e Ankesës së paraqitur nga ky BOE, duke refuzuar Ankesën e tij.
- me shkresën nr. 2590/1 prot., datë 13.09.2019 kthim përgjigje BOE Ankimes, i është komunikuar refuzimi Ankesës.

Në vijim janë paraqitur Ankesat pranë KPP:

- Në datën 20.09.2019 BOE óL.ô shpk & óB.ô shpk & óA.K.ô shpk & óB.X.ô shpk ka paraqitur A.esë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtën objekt si në AK.
- Me vendimin nr. 1512/1 prot., datë 24.09.2019 Komisioni Prokurimit Publik (KPP) ka vendosur pezullimin e procedurës së prokurimit dhe shqyrtimin në themel.
- Më shkresën nr. 2843/1 prot., datë 26.09.2019 të Autoritetit Kontraktor i është dërguar informacioni KPP në lidhje me vlerësimin e ofertave.

- Me shkresën nr. 1512/4 prot., datë 15.10.2019 KPP njofton AK se për shkak të fluksit të madh të çështjeve në shqyrtim nuk mund të dalë me vendim brenda 15 ditëve.

Sa më sipër, KVO ka kualifikuar dhe shpallur fitues BOE ôV.H.ô shpk & ôE.ô shpk & ôB.ô shpk, *i renditur i katërti*, me vlerë 389,375,085 lekë, pasi nuk ka plotësuar kriteret e kërkuara në DST, veprime në mospërputhje nenin 46 ô*Kualifikimi i ofertuesve* e nenit 53 ô*Shqyrtimi i ofertave*ô, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, ô*Për prokurimin publik*ô i ndryshuar, ku thuhet se ô*Autoriteti kontraktor, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit*”, **çkangarkojnë me përgjegjësi KVO e përbërë nga F.M., J.Gj., A.M..**

Lidhja e Kontratës

Në përfundim të procedurës së prokurimit është lidhur kontrata me nr. 2446 prot., datë 26.08.2019 me BOE ôB.Iô shpk. & ôV.H.ô shpk & ôE.ô shpk në vlerën 389,375,085 lekë pa tvsh dhe 462,629,496 lekë me tvsh. Gjithashtu, referuar urdhrit të prokurimit dhe kushteve të veçanta të kontratës rezulton se vlera e financimit për vitin 2019 është 97,768,406 lekë me tvsh.

Sa më sipër konstatohet se, për këtë procedurë prokurimi nga AK nuk kanë qenë në dispozicion fondet e plota të nevojshme për të marrë angazhimet buxhetore për realizimin e punimeve, duke qenë përpara një kontrate prokurimi me kohëzgjatje brenda 12 muajve referuar DST dhe kontratës së lidhur.

Veprime në kundërshtim me VKM nr.914 datë 29.12.2014 ôPër miratimin e Rregullave të Prokurimit Publikô i ndryshuar, nenin 70 ôLidhja e Kontratësô në të cilën thuhet se: ô*Zhvillimi i procedurës së prokurimit do të bëhet deri në momentin e shpalljes së njoftimit të fituesit, ndërsa lidhja e kontratës do të bëhet në përputhje me afatet e përcaktuara në pikën 3, të nenit 21, të këtyre rregullave, dhe vetëm pasi fondi do të jetë në dispozicion (në llogarinë përkatëse) të autoritetit kontraktor*ô, neni 76 ôKohëzgjatja e kontratësô pika 1, në të cilën thuhet se: ô*Autoriteti kontraktor, për fondet buxhetore, prokuron kontratat për një periudhë deri në mbylljen e vitit buxhetor, përveç rasteve kur lidhen kontrata shumëvjeçare, në përputhje me shkronjën “b”, të pikave 3 e 5, të nenit 33 të LPP. Në çdo rast, financimi i kontratave të prokurimit bëhet në përputhje me parashikimet e legjislacionit përkatës për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*ô, ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008 ôPër menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisëô të ndryshuar neni 40 ôE drejta për të kryer shpenzimeô, neni 50 ôAngazhimet buxhetoreô dhe neni 51 ôMenaxhimi i angazhimeveô.

V. Procedura prokurimit publik objekt “F.V Matësa prodhimi/konsumi dhe pajisje për ndërmarrjet Durrës, Elbasan, Lushnjë, Vlorë, Fier, Kavajë”, rezultoi si më poshtë:

Urdhër prokurimi me nr. 1781 prot datë 17.06.2019	NJHDT M.M. (person përgjegjës)	KVO me urdhrin nr. 1781/1 prot datë 17.06.2019
Fondi limit 365,599,130 lekë. I shtrirë në 3 vite financim: 2019 në vlerën 88,007,000 lekë me tvsh; 2020 në vlerën 267,847,816 lekë me tvsh; 2021 në vlerën 82,864,140 lekë me tvsh	J.Gj. A.M. Z.I. A.B.	F.M.ñ kryetar I.Sh.ñ anëtar S.Z.ñ anëtar A.C.ñ anëtar G.Ll.- anëtar
Procedura e prokurimit në e		

hapur		
Burimi i Financimit: buxheti i shtetit.	Fitues:BOE óG.E.S.T.ó & óA.ó shpk	Vlera fituese 300,631,377 lekë pa tvsh
Datë e hapjes së tenderit 23.09.2019 ora 12:00	Diferenca nga fondi limit 64,967,753 lekë.	Kontrata nr. 3643 prot., datë 03.12.2019
Marrin pjesë 5 OE S`kualifikuar 4 OE	Miratimi i procedurës: Me shkresën nr. 3614 prot., datë 27.11.2019	Vlera e kontratës 300,631,377 lekë pa tvsh dhe 360,757,652lekë me tvsh.
A.imime në AK - po A.imime në KPP - po	Afati kontratës 12 muaj nga nënshkrimi. Shtyre afati deri më 03.02.2021 sipas shtesës nr.2997 prot., datë 24.11.2020. Amendament nr. 155 prot., datë 21.01.2021 shtyrë afati deri më 03.03.2021	Titullar i AK ñ A.B.

Dosja e Tenderit.

Dosja e procedurës së prokurimit nuk është arkivuar, inventarizuar dhe numerizuar me numër fletësh sipas përcaktimeve të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 óPër Arkivatô, nenin 4/26 dhe óNormat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisëô, Neni 19, **çka ngarkon me përgjegjësi personin përgjegjës për këtë procedurë prokurimi M.M..**

Projekt preventivi

Me urdhrin e titullarit nr. 63, datë 24.05.2019, nr.1550 prot., datë 24.05.2019, është ngritur grupi i punës mbi përgatitjen e dokumentacionit të plotë teknik për tenderin me objekt *óMbështetje teknike në zbatim të reformës në sektorin e furnizimit me ujë dhe kanalizimeve (sipas performancës, për uljen e humbjeve deri në nivelin teknik 20% dhe matjen e prodhimit të ujit): F.V Matës prodhimi/konsumi dhe pajisje për ndërmarrjet Durrës, Elbasan, Lushnjë, Vlorë Fier, Kavajëô me kod projekti **18BQ361**, i përbërë nga F.M.drejtore i planifikimit të investimeve, V.B. përgjegjëse sektorit të planifikimit të investimeve, L.H. specialiste sektorit të planifikimit të investimeve, Th.M.specialist sektorit të planifikimit të investimeve, G.A. specialist sektori projektimit dhe oponencës, Ligor Toslluku specialist sektori projektimit dhe oponencës, me afat realizimi deri më 29.05.2019.*

Grupi i punës ka hartuar në treg dhe mori 4 oferta pasi këto mallra nuk janë përfshirë në manualin e miratuar, konkretisht nga kompanitë sa vijon: óGj.ô shpk, óI.T.S.ô shpk, óF.ô shpk dhe óA.G.ô shpk nga të cilat sipas informacionit të vënë në dispozicion rezultoi se u morë parasysh vlera minimale e paraqitur nga shoqëria óI.T.S.ô shpk.

Sipas preventivit konstatohet fondi limit në vlerën totale **438,718,956 lekë me tvsh**. Konkretisht sipas ndërmarrjeve: UK Vlorë 22,173,517 lekë me tvsh, UK Kavajë 19,579,390 lekë me tvsh, UK Durrësi 53,192,513 lekë me tvsh, UK Fieri 114,776,623 lekë me tvsh, UK Lushnjë 130,860,689 lekë me tvsh, UK Elbasan 98,136,224 lekë me tvsh. Me Memon e datës 14.06.2019 hartuar nga grupi i punës drejtuar titullarit dhe konfirmuar prej. tij.

Dokumentet e tenderit.

- Me shkresën nr. 2488 prot., datë 29.08.2019, urdhër për pezullim procedure prokurimi, është urdhëruar pezullimi procedurës prokurimit si rezultat i rekomandimeve të APP për DST me afat deri në hedhjen Shtojcës nr.1. Për zbatimin e këtij urdhri është ngarkuar njësia prokurimit. Me

shkresën nr. 2488 /1 prot., datë 29.08.2019, pas hedhjes së shtojcës nr.1 është hequr pezullimi dhe është vazhduar me hapat e mëtejshëm të procedurës.

- Me shkresën nr. 2509 prot., datë 30.08.2019, urdhër për pezullim procedure prokurimi, është urdhëruar pezullimi procedurës prokurimit si rezultat i i modifikimit të DST, me afat deri në hedhjen Shtojcës nr.2. Për zbatimin e këtij urdhri është ngarkuar njësia prokurimit.

Me shkresën nr. 2509/1 prot., datë 30.09.2019, pas hedhjes së shtojcës nr.2 është hequr pezullimi dhe është vazhduar me hapat e mëtejshëm të procedurës.

Në përcaktimet e kriterëve të veçanta të kualifikimit nga Njësia Hartimit Dokumenteve të Tenderit, u konstatuan mangësi, pasi kriteret e përdorura për identifikimin e ofertës ekonomikisht më të favorshme, nuk kanë lidhje me objektin e kontratës pasi referuar specifikimeve teknike kemi të bëjmë vetëm me furnizimin e mallrave, konkretisht si më poshtë:

1- Për të provuar përvojën e duhur autoriteti kontraktor ka kërkuar një punësim mesatar i të paktën 20 personave, për periudhën Janar 2018-Qershor 2019, duke mosargumentuar hollësisht mbi nevojën për numrin e punonjësve me grafikun dhe volumet e punimeve të parashikuara në preventivin e publikuar në SPE. Veprime në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014, óPër miratimin e rregullave të prokurimit publikó, nenin 27 óKontratat e mallraveó, pika 3, në të cilën është përcaktuar se: *óKërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëveó.*

2- Në Dokumentet e Tenderit, kriteret e veçanta të kualifikimit pika 2.3.4 është kërkuar që: *óOperatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar si staf teknik për kryerjen e të gjitha punimeve në këtë objekt, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, diplomë, CV, si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë stafi inxhinierik si më poshtë: 1 Inxhinier Mekatronik dhe 6 Inxhinier Elektronik (nga 1 për çdo ndërmarrje UK). Ne lidhje me inxhinierin Mekatronik , do të pranohen edhe profilet me diplomat ekuivalenteó.*

Kërkesa për Inxhinier Mekatronik është kërkuar në mënyrë të paargumentuar me volume pune të parashikuara nga autoriteti kontraktor referuar objektit të prokurimit, pasi Termi Mekatronik përkufizohet si *ósi shkencë që kryen procese ku krijohen makineri dhe pajisje komplekse”.*

Gjithashtu edhe kërkesa që do të pranohen edhe profilet me diplomat ekuivalente pa përcaktuar se kush diploma do të pranohen është një kërkesë evazive çka mund të përbejë shkak për ngatërresa dhe konfuzione të operatorëve ekonomik, në kundërshtim me VKM 914 neni 27 pika 3.

3- Në DT është kërkuar dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që kanë dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës, konkretisht Kamion 2.5 ton- 7.5 ton, dhe Autovinç 2 copë (pronësi ose qira), ku rezultoi se këto kërkesë nuk janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe nuk janë të argumentuara dhe justifikuar hollësisht mbi nevojën duke marrë në konsideratë edhe faktin se afati për realizimin e kontratës është 12 muaj.

Sa më sipër, për përcaktimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit, është vepruar në papajtueshmëri me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, óPër prokurimin publikó, të ndryshuar, Neni 1, óObjekti dhe qëllimió, pika 2, germa c, ç dhe d, dhe Neni 2 óParimet e përzgjedhjesó, germa

a, b dhe c, Neni 46 óKualifikimi i ofertuesveó, pika 1, dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014, óPër miratimin e rregullave të prokurimit publikó, Neni 27 óKontratat e mallraveó pika 3, Neni 61 óHartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderitó, pika 2, për arsye se në procesverbalet e hartimit dhe miratimit të dokumenteve të tenderit nuk kanë lidhje me objektin e kontratës objekt prokurimi si edhe nuk kanë argumentim dhe nuk justifikohen me volumet e punës kërkesat teknike të përcaktuara nga NJHDT (njësia hartimit dokumenteve të tenderit), **çka ngarkon me përgjegjësi Njësinë e Prokurimit e përbërë nga M.M., J.Gj., Th.M., A.M., Z.I., A.B..**

Zhvillimi i procedurës:

Nga auditimi në elektronik dhe dokumenteve faktik të procedurës së prokurimit me objekt “*F.V Matësa prodhimi/konsumi dhe pajisje për ndërmarrjet Durrës, Elbasan, Lushnjë, Vlore, Fier, Kavajë*”, rezultoi se në tender kanë marrë pjesë 5 operator ekonomik, për të cilat KVO ka kryer vlerësimet si më poshtë:

Nr.	Operatori ekonomik pjesëmarrës	Oferta ekonomike (pa tvsh)	Vlerësimi i KVO-së
1	BOE óN.ó shpk& ól. d.o.oó dhe ól. A. d.o.oó	298,348,300	Skualifikuar për arsyet e mëposhtme: 1- Në marrëveshjen për bashkimin e operatorëve ekonomikë óN.ó sh.p.k & ól. d.o.oó dhe ól.A. d.o.oó nuk shprehet ndarja e shërbimeve/punëve/furnizimeve në mënyrë konkrete që merren përsipër nga secili operator ekonomik pjesëmarrës në bashkim por vetëm në përqindjen përkatëse. 2- Nga verifikimi dhe shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga ky BOE, vërehet se nuk ka asnjë dokument / deklaratë, të lëshuar nga autoriteti përkatës për operatorin ól.ó d.o.o, mbi xhiron vjetore të 3 (tri) viteve të fundit ushtrimore (2016, 2017, 2018). 3- Nuk përmbush kriterin óVërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2018. Nga verifikimi dhe shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga ky BOE, vërehet se nuk ka asnjë dokument / vërtetim të lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar operatori ól.ó d.o.o. 4- Ky BOE nuk plotëson kriterin për punë të ngjashme. Dokumentacioni i paraqitur nga ky BOE ka mangësi dhe nuk përmbush përcaktimet sipas pikës 2.3/1 të Shtojcës 9. ól.ó d.o.o si anëtar me përqindjen më të madhe në bashkimin e shoqërive, BOE ka paraqitur / dorëzuar vetëm dokumente óCertifikatë Pranimi dhe Marrje në Dorëzimó dhe Fatura. Në lidhje me përmbushjen e këtij kriteri nga ana e operatorit óN.ó sh.p.k si anëtar në bashkimin e shoqërive, BOE ka paraqitur / dorëzuar dokumente Fatura Tatimore dhe Deklarata Doganore. 5- Nga shqyrtimi konstatojmë se OE nuk ka paraqitur dokumentacion për stafin e kërkuar dhe nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion për stafin mekatronik dhe elektronik. 6- BOE nuk ka dorëzuar asnjë mostër duke mos plotësuar kriterin e përcaktuar në DST si me sipër, si dhe asnjë dokument siç është kërkuar tek kriteri me lart. 7- Nuk plotëson pikën 2/1/c të Shtojcës 9, ku është përcaktuar kriteri: óSigurimin e ofertësó (nëse është zbatueshme) sipas Shtojcës 4;ó

2	BOE óL.ô shpk & óSh. I.ô shpk	299,671,625	Skualifikuar për arsyet e mëposhtme: 1- BOE nuk ka paraqitur asnjë kontratë të ngjashme në natyrë me objektin e procedurës aktuale. Kontratat e paraqitura nga BOE janë të natyrës punime civile. Asnjëra prej kontratave nuk është furnizim mallrash të ngjashme me mallrat e kërkuara në këtë procedurë prokurimi. 2- BOE nuk ka paraqitur dokumentacion për stafin e kërkuar dhe nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion për stafin elektronik dhe mekatronik. 3- Nga shqyrtimi i mëtejshëm i dokumenteve të paraqitura nga BOE nuk ka asnjë dokument që provon lidhjen midis distributorit të autorizuar shoqërisë "H.M." Sh.p.k, i vetëdeklaruar në dokumentin óAutorizimó cituar më sipër, dhe prodhuesve óE.ô dhe óB. M.ô. BOE ka paraqitur vetëm dy dokumente nëpërmjet të cilave i jepet e drejta Shoqërisë "H.M." Sh.p.k të paraqesë ofertë, të negociojë dhe të nënshkruajë kontratën për tenderin në fjale. 4- BOE nuk ka dorëzuar asnjë mostër duke mos plotësuar kriterin e përcaktuar në DST si me sipër, si dhe asnjë dokument siç është kërkuar tek kriteri me lart. Ky operator ka dorëzuar një dokument ku kundërshton kriterin për mostrat duke e pranuar edhe vete si dhe duke deklaruar që nuk e ka plotësuar këtë kriter sepse ky është hartuar në kundërshtim me legjislacionin për prokurimin publik. 5- Nuk plotëson pikën 2/1/c të Shtojcës 9, ku është përcaktuar kriteri: óSigurimin e ofertësó (nëse është zbatueshme) sipas Shtojcës 4;ô
3	BOE óG.E.S.T.ó & óA.ó shpk	300,631,377	Kualifikuar dhe shpallur fitues
4	óI.T.S.ó shpk	364,098,085	Skualifikuar për arsyet e mëposhtme: 1- OE ka paraqitur kontratën e ngjashme në natyrë me objektin e procedurës aktuale, por vlera e kësaj kontrate të paraqitur është më e vogël se 40% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet. Në këtë rast OE nuk ka plotësuar këtë kriter dhe nuk ka përmbyllur kriteret dhe kërkesat e përcaktuara në DST. 2- Nga shqyrtimi konstatohet se OE nuk ka paraqitur dokumentacion për stafin e kërkuar dhe nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion për stafin mekatronik dhe elektronik. 3- OE nuk ka paraqitur / dorëzuar dokumentacion Autorizim prodhuesi ose Autorizim Distributori. 4- OE nuk ka dorëzuar dokumentacion e katalogut/ve apo fragmenteve të katalogut. 5- Operatori ekonomik nuk ka dorëzuar asnjë mostër duke mos plotësuar kriterin e përcaktuar në DST si me sipër, si dhe asnjë dokument siç është kërkuar tek kriteri me lart. 6- Nuk plotëson pikën 2/1/c të Shtojcës 9, ku është përcaktuar kriteri: óSigurimin e ofertësó (nëse është zbatueshme) sipas Shtojcës 4;ô
5	óA.C.ô shpk	0	Skualifikuar për arsyet e mëposhtme: - Nuk ka paraqitur ofertë ekonomike

Nga auditimi i pretendimeve të KVO-së, rezultoi si më poshtë:

1. Nga auditimi i ofertës së paraqitur nga BOE óN.ô shpk & óI. d.o.o dhe óI. A. d.o.o, me vlerë 298,348,300 lekë, me vlerë më të ulët, rezultoi se KVO e ka s̈kualifikuar me të drejtë ofertën e paraqitur nga ky BOE pasi nuk kanë plotësuar kriteret e kërkuara sipas dokumenteve standarde të tenderit (DST). Konkretisht në kontratën e bashkëpunimit nuk shprehet për ndarjen e elementeve konkrete që merren përsipër nga secili operator ekonomik, veprim në kundërshtim me VKM 914 neni 74 pika 2.
2. Nga auditimi i ofertës së paraqitur nga BOE óL.ô shpk & óSh.I.ô shpk, me vlerë 299,671,625 lekë, *i renditur i dyti*, rezultoi se KVO e ka s̈kualifikuar me të drejtë ofertën e paraqitur nga ky BOE pasi nuk kanë plotësuar kriteret e kërkuara sipas dokumenteve standarde të tenderit (DST). Konfirmuar me vendimin 746/2019 datë 25.11.2019 të Komisioni i Prokurimit Publik duke skualifikuar këtë BOE.
3. Nga auditimi i ofertës fituese të BOE óG.E.S.T.ó & óA.ó shpk, *i renditur i treti* me vlerë 300,631,377 lekë, rezultoi se KVO e ka kualifikuar dhe shpallur padrejtësisht fitues këtë ofertë pasi nuk ka plotësuar kriteret e kërkuara sipas DST, konkretisht si më poshtë:
 - a- Shoqëria óA.ô shpk nuk përmbush kriterin 2.3 Për kapacitetin teknik, pika 1.a për përvojën e suksesshme në realizimin e të paktën: *óKontrate e ngjashme për furnizim me vlerë jo më të vogël se 40% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet të realizuar gjatë tri viteve të fundit, datë e përllogaritur nga data e hapjes së ofertaveô*.
Referuar kontratës së bashkëpunimit kjo shoqëri ka marrë përsipër të kryejë 30% të të punimeve, konkretisht fondi limit 365,599,130 lekë * 30%=**109,679,739 lekë** pa tvsh.
Nga auditimi dokumenteve të paraqitur nga ky OE në SPE rezulton se shumica e punëve të ngjashme të kryera në asnjë rast nuk e kalojnë shumën 50,000,000 lekë ose **13.6%** e fondit limit.
 - b- shoqëria A. nuk plotëson kërkesat për stafin teknik pasi nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion për inxhinierët e kërkuar në DST si: 1(një) Inxhinier Mekanik dhe 6 (gjashtë) Inxhinier Elektronik.

Sa më sipër, KVO ka kualifikuar dhe shpallur fitues BOE óG.E.S.T.ó & óA.ó shpk, me vlerë 300,631,377 lekë, pasi nuk ka plotësuar saktësisht kriteret e kërkuara në DST si kriterin për punë të ngjashme dhe stafin teknik, duke vepruar në mospërputhje me nenin 46 *óKualifikimi i ofertuesveô* e nenit 53 *óShqyrtimi i ofertaveô*, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, *óPër prokurimin publikô* i ndryshuar, ku thuhet se *óAutoriteti kontraktor, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit”,* çka ngarkojnë me përgjegjësi KVO e përbërë nga F.M., I.Sh., S.Z., A.C., G.Ll., pasi me veprimet e tyre kanë shkaktuar mos përdorim me efektivitet, efikasitet dhe ekonomikitet të fondeve në vlerën 2,283,077 lekë, të llogaritur si diferencë nga oferta e shpallur fituese të BOE óG.E.S.T.ó & óA.ó shpk minus (-) ofertën e s̈kualifikuar të BOE óN.ô shpk & óI. d.o.o dhe óI.A. d.o.o, *me vlerë më të ulët*, $(300,631,377 - 298,348,300) = 2,283,077 \text{ lekë}$. Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, *óPër prokurimin publikô*, i ndryshuar, Neni 1, *óObjekti dhe qëllimiô*, pika 2, germa a, b, d dhe dh, dhe Neni 2 *óParimet e përzgjedhjesô*, germa a, b dhe c dhe me Nenet 46, 53 pika 4, dhe 55.

A.esa për vlerësimin e ofertave:

1. BOE“N.” shpk& “I. d.o.o” dhe “I.A. d.o.o”,

- Ka paraqitur Ankesën më datë 14.10.2019 dhe protokolluar pranë AKUM nr. 3030 prot., datë 14.10.2019.

- me shkresën nr. 3020 prot., datë 14.10.2019 është pezulluar procedura e prokurimit deri në shqyrtimin e Ankesave
- me shkresën nr. 3020/1 prot., datë 14.10.2019 është ngritur Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave (KSHA) i përbërë nga V.B., L.V.dhe Th.M..
- me shkresën nr. 3030/1 prot., datë 18.10.2019 informacion drejtuar titullarit në lidhje me shqyrtimin e Ankesës së paraqitur nga ky BOE, duke refuzuar Ankesën e tij.
- me shkresën nr. 3030/2 prot., datë 18.10.2019 kthim përgjigje BOE Ankimues, është refuzuar A.esa e këtij BOE.

2. BOE “L.” shpk & “Sh.I.” shpk

- Ka paraqitur Ankesën më datë 14.10.2019 dhe protokolluar pranë AKUM nr. 3018 prot., datë 14.10.2019.
- me shkresën nr. 3020 prot., datë 14.10.2019 është pezulluar procedura e prokurimit deri në shqyrtimin e Ankesave
- me shkresën nr. 3020/1 prot., datë 14.10.2019 është ngritur Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave (KSHA) i përbërë nga V.B., L.V.dhe Th.M..
- me shkresën nr. 3018/1 prot., datë 18.10.2019 informacion drejtuar titullarit në lidhje me shqyrtimin e Ankesës së paraqitur nga ky BOE, duke refuzuar Ankesën e tij.
- me shkresën nr. 3018/2 prot., datë 18.10.2019 kthim përgjigje BOE Ankimues, është refuzuar A.esa e këtij BOE.
- në datën 25.10.2019 ky BOE ka paraqitur A.esë pranë Komisionit të prokurimit publik me të njëjtën objekt si në AK.
- me vendimin 746/2019 datë 25.11.2019, KPP vendos të mos pranojë Ankesën e paraqitur nga ky BOE.

Lidhja e Kontratës

Në përfundim të procedurës së prokurimit është lidhur kontrata me nr. 3643 prot., datë 03.12.2019 me BOE óG.E.S.T.ô & óA.ô shpknë vlerën 300,631,377 lekë pa tvsh dhe 360,757,652 lekë me tvsh. Gjithashtu, referuar urdhrin të prokurimit dhe kushteve të veçanta të kontratës rezulton se vlera e financimit për vitin 2019 është 88,007,000 lekë me tvsh.

Sa më sipër konstatohet se, për këtë procedurë prokurimi nga AK nuk kanë qenë në dispozicion fondet e plota të nevojshme për të marrë angazhimet buxhetore për realizimin e punimeve, duke qenë përpara një kontrate prokurimi me kohëzgjatje brenda 12 muajve referuar DST dhe kontratës së lidhur.

Veprime në kundërshtim me VKM nr. 914 datë 29.12.2014 óPër miratimin e Rregullave të Prokurimit Publikô i ndryshuar, nenin 70 óLidhja e Kontratësô në të cilën thuhet se: *óZhvillimi i procedurës së prokurimit do të bëhet deri në momentin e shpalljes së njoftimit të fituesit, ndërsa lidhja e kontratës do të bëhet në përputhje me afatet e përcaktuara në pikën 3, të nenit 21, të këtyre rregullave, dhe vetëm pasi fondi do të jetë në dispozicion (në llogarinë përkatëse) të autoritetit kontraktorô*, neni 76 óKohëzgjatja e kontratësô pika 1, në të cilën thuhet se: *óAutoriteti kontraktor, për fondet buxhetore, prokuron kontratat për një periudhë deri në mbylljen e vitit buxhetor, përveç rasteve kur lidhen kontrata shumëvjeçare, në përputhje me shkronjën “b”, të pikave 3 e 5, të nenit 33 të LPP. Në çdo rast, financimi i kontratave të prokurimit bëhet në përputhje me parashikimet e legjislacionit përkatës për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisëô*, ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008 óPër menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisëô të ndryshuar neni 40 óE drejta për të kryer shpenzimeô, neni 50 óAngazhimet buxhetoreô dhe neni 51 óMenaxhimi i angazhimeveô.

III.6. Mbi zbatimin e kontratave për punime, mallra dhe shërbime.

- Lidhja e kontratave, ndryshimet dhe shtesat përkatëse, si dhe realizimi në sasi e cilësi.
- Zbatimi i afateve të përfundimit të kontratave.

Nga auditimi konstatohet se, për periudhën objekt auditimi janë përfunduar dhe janë në proces, kontrata si më poshtë:

Tabela nr. 19

Nr.	Emërtimi	Vlera e kontratës	Data e nënshkrimit	Data e përfundimit	kolauduar
1	Ndërtim i kolektorit kryesor të ujërave të zeza dhe I.T.U.P në Gjirin e Lalzit.	1,319,216,065	10.10.2016	23.05.2019	Po
2	F.V matës prodhimi/konsumi dhe pajisje për ndërmarrjet Durrës, Elbasan, Lushnje, Vlorë, Fier, Kavajë.	360,757,652	03.12.2019	03.03.2021	Janë marrë në dorëzim
3	Përmirësim i infrastrukturës së ujërave të zeza në zonën bregdetare Vlorë.	462,629,469	26.08.2019	15.02.2021	Në proces kolaudimi
4	Përmirësim i furnizimit me ujë për lagjen Krastë e Vogël, Harmes, dhe Qytetin Elbasan.	320,833,499	31.12.2019	31.11.2021	Në proces ndërtimi
5	Impianti i trajtimit të ujërave të ndotura dhe sistemit KUZ, Drimadhe, Dhërmi.	400,304,510	17.08.2020	proces	jo
6	Furnizim me ujë i zonave turistike Drimadhes, Dhërmi dhe përmirësimi i rrjetit të ujësjellësit të Fshatit Dhërmi.	271,191,129	20.08.2020	03.11.2021	Në proces ndërtimi
7	Impianti i trajtimit të ujërave të ndotura në zonën bregdetare Dhralë, Palasë, Lot i parë.	138,305,992	31.08.2017	27.11.2020	Po
8	Mbyllja e venddepozitimit ekzistues të mbetjeve të ngurta ECO Park, Durrës.	1,948,445,742,	27.12.2019	14.10.2021	Në proces ndërtimi

Burimi: AKUM

Vlera e kontratave të nënshkruara, në proces zbatimi dhe të përfunduara është në shumën 3,273,238,316 lekë. Janë audituar katër kontratat të punimeve civile, me vlerë 2,240,985,025 lekë, ose 68.5 % e vlerës, si më poshtë:

- Ndërtim i kolektorit kryesor të ujërave të zeza dhe I.T.U.P në Gjirin e Lalzit.
- Impianti i trajtimit të ujërave të ndotura në zonën bregdetare Dhralë, Palasë, Lot i parë.
- Përmirësim i furnizimit me ujë për lagjen Krastë e Vogël, Harmes, dhe Qytetin Elbasan.
- Përmirësim i infrastrukturës së ujërave të zeza në zonën bregdetare Vlorë.

Sa i përket kontratës 6.F.V matës prodhimi/konsumi dhe pajisje për ndërmarrjet Durrës, Elbasan, Lushnje, Vlorë, Fier, Kavajë, është auditur dokumentacioni shoqërues i materialeve, aktet e marrjes në dorëzim sipas shoqërive të ujësjellës kanalizimeve përkatëse, nga ku rezulton se furnizimi është bërë në sasinë e përcaktuar në preventivin e kontratës, sipas shoqërive. Materialet janë bërë hyrje në shoqëritë përkatëse dhe nuk është konstatuar mangësi në procesin e marrjes në dorëzim të tyre. Bazuar në dokumentacionin e dosjes së furnizimit, nga ana e shoqërive nuk janë paraqitur pretendime në lidhje me sasinë, apo cilësinë e tyre.

Në lidhje me zbatimin e kontratave të audituara, konstatohet si më poshtë:

III.6.1. Mbi zbatimin e kontratës ‘Përmirësimi i Infrastrukturës së Ujërave të Zeza në zonën Bregdetare, Vlorë’.

Të dhëna të përgjithshme

1. Në lidhje me Projektin

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se projekti është hartuar nga ana e studios E.B.S dhe si investim ka parashikuar:

- a. Rehabilitimin dhe zgjerimin e sistemit të Kanalizimeve në zonën e Fabrikës së Çimentos;
- b. Rehabilitimin dhe zgjerimin e sistemit të Kanalizimeve në zonën e Lungomares;

2. Historiku i zbatimit të punimeve

Me datë 16.10.2019 është miratuar Leja Infrastrukture nga ana e Kryetarit të Bashkisë Vlorë, z. Dritan Leli me nr. 637, datë 16.10.2019. Në përfundim të procedurës së prokurimit, është shpallur fitues BOE *V.H.&B.I&E.*, të përfaqësuar këta sipas prokurës së posaçme me nr. 8315 rep. 4040 kol. Datë 13.07.2019 nga OE *V.H.* me nr. licence për zbatim punimesh NZ.3930/18 datë 06.12.2018 dhe me përfaqësues ligjor z. Besnik Hysa me të cilin është lidhur kontrata me Autoritetin Kontraktor e përfaqësuar nga z. A.B. me nr. 2446 prot., datë 26.08.2019 me vlerë **462,629,496 lekë me TVSh** dhe me afat të zbatimit të punimeve 12 muaj. Drejtuesi teknik i sipërmarrësit është caktuar ing. P. G. me nr. Licence për zbatim punimesh Z. 1045/2. Për mbikëqyrjen e punimeve është lidhur kontrata përkatëse e këtij shërbimi me Autoritetin Kontraktor, e përfaqësuar nga Titullarit z. A.B. dhe BOE *D.& H.&S.*, të përfaqësuar këta sipas prokurës së posaçme me nr. 623 rep. 304 kol. datë 12.07.2019 nga OE nga D. me nr. licence MK3019 datë 26.06.2020, me përfaqësues ligjor znj. S.G. sipas aktit me nr. 1226 prot., datë 26.04.2019 me vlerë të kontratës 3,490,192 lekë me TVSH. Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se objekti nuk është kolauduar.

Në mënyrë të detajuar gjetjet në lidhje me këtë investim paraqiten si më poshtë:

1. Titulli i gjetjes: Emërimi i grupit të kolaudimit në kundërshtim me kuadrin përkatës ligjor e rregullator.

Situata: Sipas shkresës së administruar në subjekt me nr. 703 prot., datë 26.03.2021, është bërë një kërkesë nga ana e zv. Drejtorit të Përgjithshëm z. F.Sh. drejtuar Ujësjiellës Kanalizime SHA Vlorë, për caktimin e një inxhinieri me licencën përkatëse për të qenë pjesë e grupit të kolaudimit të punimeve të përfunduara. Kësaj kërkesë, Ujësjiellës Kanalizime SHA Vlorë, i ka kthyer përgjigje me shkresën nr. 830/1 prot., datë 11.05.2021, administruar në AKUM me nr. 703/1 prot., datë 14.05.2021 sipas të cilës është caktuar si inxhinier znj. E. V. me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh ndërtimi MK.0456/3, datë 12.05.2018. Grupi i kolaudimit është caktuar sipas Urdhrit nr. 1136 prot., datë 31.05.2021 të Zv. drejtorit të Përgjithshëm z. F.Sh. me përbërje të këtij grupi si më poshtë:

1. Z.I., inxhinier Hidroteknik, përfaqësues i AKUK në Tiranë;
2. A.Ç., inxhinier Hidrogeologe, përfaqësues e AKUK në Tiranë;
3. V.B., inxhinier Ndërtimi, përfaqësues e AKUK në Tiranë;
4. F. B., inxhinier Hidroteknike, përfaqësues e AKUK në Tiranë;
5. E. V., inxhinier Ndërtimi, përfaqësues e Ujësjiellës Kanalizime SHA Vlorë;

Në fakt ky urdhër është hartuar në kundërshtim me kuadrin ligjor si më poshtë pasi është nxjerrë pas 3.5 muajsh dhe jo pas 30 ditësh nga përfundimi i punimeve dhe përveç kësaj, ky urdhër as nuk ka përcaktuar afatin e zgjatjes së procesit të kolaudimit.

Kriteri: - Ligji nr. 8402, datë 10.9.1998 *“Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”*, i ndryshuar, neni 12, ku përcaktohet se:

“Emërimi i kolaudatorit apo i grupit të kolaudimit është detyrë e investitorit, i cili duhet që këtë t’ia komunikojë personit, institucionit që do të merret me kolaudimin dhe seksionit ose zyrës së urbanistikës të rretheve apo bashkive, brenda 30 ditëve nga përfundimi i punimeve të ndërtimit. Investitori do të përcaktojë afatet e zgjatjes së procesit të kolaudimit”;

- Udhëzimi nr. 3, datë 15.2.2001 të Këshillit të Ministrave *“Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”*, të ndryshuar, Kreu II, pika 2 ku përcaktohet se:

“Kolaudatori ose grupi i kolaudimit caktohet nga investitori, i cili duhet t’ia komunikojë, me shkrim, këtë person apo grup personash, Sekretariatit Teknik të KRRT-së, pranë zyrës dhe seksionit urbanistik përkatës në rreth, brenda 30 ditëve nga data e përfundimit

të punimeve. Punëdhënësi duhet të përcaktojë, gjithashtu, në marrëveshje me mbikëqyrësin dhe kolaudatorin (ose grupin e kolaudimit), mënyrën dhe afatet e procesit të kolaudimit”;

- Udhëzimi nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu II, pika 10.1, paragrafi i dytë ku përcaktohet se:

“Kolaudimi i objektit fillon jo më vonë se një muaj nga data e përfundimit të punimeve”.

Ndikimi: Mungesa e ngritjes në mënyrën e duhur të Grupit të Kolaudimit/Kolaudatorit të punimeve të përfunduara ndikon në procesin e marrjes në dorëzim të punimeve, duke u bërë shkak për mos evidentimin në kohë të mangësive të zbatimit dhe më pas në ndarjen e përgjegjësive në rast të identifikimit të tyre.

Shkaku Mungesa e veprimeve në kohë e zv. Drejtorit të Përgjithshëm (në cilësinë e Titullarit të Autoritetit Kontraktor).

Rëndësia: E mesme.

1.1 Rekomandimi: Nga AKUM në të ardhmen të merren masat për caktimin e kolaudatorit ose grupit të kolaudimit në afatet e duhura ligjore me qëllim realizimin e objektit të investimit, në përputhje me projektin, lejen e ndërtimit, standartet dhe rregullat teknike.

Lidhur me mangësitë e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi zv. Drejtori i Përgjithshëm z. F.Sh., në atë kohë në cilësinë e Titullarit të Autoritetit Kontraktor, i emëruar sipas Urdhrit nr. 141 datë 11.03.2021 të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, administruar në AKUM me nr. 621 prot., datë 11.03.2021.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit në lidhje me kontratën me objekt ‘Përmirësimi i Infrastrukturës së Ujërave të Zeza në zonën Bregdetare, Vlorë’, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresën nr. 888/11 prot., datë 24.02.2022 nga ana e z. F.Sh., administruar në subjekt me nr. 71/1 prot., datë 18.02.2022 ku janë shprehur objeksionet si më poshtë.

Pretendimi i subjektit:

“Ngritja e grupit të kolaudimit tej afatit 30 ditor të përfundimit të punimeve nuk ka sjellë e nuk mund të sjellë ndikimin e përcaktuar nga audituesit.. ...”

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Pretendimet tuaja mbi këtë pikë nuk merren në konsideratë nga Grupi i Auditimit pasi ato nuk sjellin fakte shtesë.

2. Titulli i gjetjes: Mungesë e ushtrimit të detyrave nga ana e personave përgjegjës për investimin.

Situata: Sipas Urdhrit nr. 240 datë 16.06.2021 të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, është bërë emërimi në detyrë i z. C.K. në pozicionin e Drejtorit të Përgjithshëm të AKUM nga ana e të cilit është ngritur Urdhri nr. 69, datë 07.10.2021, administruar në AKUK me nr. 1926, prot., datë 07.10.2021, për monitorimin e situacionit përfundimtar nr. 6 dhe fondit rezervë me përbërje të grupit:

1. z. F.Sh., Kryetar;
2. z. A.K., Anëtar;
3. znj. V.B., Anëtare;
4. znj. A.Y., Anëtare;
5. znj. E.B., Anëtare;

Në zbatim të këtij Urdhri, Grupi i Punës si më sipër ka hartuar dhe mbajtur një shkresë drejtuar Drejtorisë Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse duke vënë në dijeni edhe Titullarin z. C.K. mbi faktin se në stacionin 102/1 i cili ishte stacioni ku mblidhen prurjet e të gjitha stacioneve të tjera, pompat e R.a të vendosura me investimin e realizuar nga

sipërmarrësi BOE *V.H.&B.I&E.*, ishin nxjerrë jashtë stacionit të pompimit dhe ishin çmontuar nga vetë UK Vlorë me argumentin se në reshjet e fundit në qytetin e Vlorës këto pompa nuk arrinin të përçonin prurjen maksimale duke shkaktuar përmbytje. Për këtë arsye nga ana e Grupit të Punës u la si detyrë që kontraktori të bënte dhe një herë kontrollin mbi konfigurimin e pompave nëse defekti fillon aty apo nga projektuesi në kriteret e projektimit për pompat që ka vendosur në projekt, pasi kontraktori thekson se çdo pompë është marrë sipër specifikimeve teknike përkatëse të projektit. Këtë ndërhyrje të Ujësjetllës Kanalizime SHA Vlorë e ka vënë në dukje edhe sipërmarrësi i punimeve pasi sipas një shkrese të dërguar nga ana e tij dhe administruar në AKUK me nr. 2044, prot., datë 20.10.2021, është njoftuar mbikëqyrësi i punimeve, BOE D.& H., Autoriteti Kontraktor Agjencia Kombëtare e Ujësjetllës Kanalizime dhe Infrastrukturës së Mbetjeve si dhe është vënë në dijeni Ujësjetllës Kanalizime SHA Vlorë, mbi faktin se, në stacionin e pompimit nr. 102/1, përfituesi final i investimit me objekt *‘Përmirësimi i Infrastrukturës së Ujërave të Zeza në zonën Bregdetare, Vlorë’* Ujësjetllës Kanalizime SHA Vlorë ka kryer ndërhyrje në STP pa praninë e tyre dhe pa vënë në dijeni me shkresë apo verbalisht sipërmarrësin e punimeve. Konkretisht kjo ndërhyrje ka konsistuar në zëvendësimin e pompave të R.a me kapacitet $Q=225 \text{ l/s}$, $H=9.83 \text{ m}$, 26.8 kE me pompat e vjetra, pra me pompat ekzistuese përpara kryerjes së investimit. Gjithashtu, sipas pretendimeve të sipërmarrësit, rezulton se gjatë heqjes së pompave, ato nuk janë ngritur me zinxhirët e A.orimit që janë lënë në çdo pompë në rast avarie dhe nuk janë hequr tubat udhëzues dhe për pasojë janë dëmtuar dhe shkëputur nga pjesa e murit të stacionit tubat udhëzuar për secilën pompë.

Në fakt në lidhje me sa më sipër konstatohet se nga personat kryesorë përgjegjës për ndërtimin e objektit, konkretisht investitori Agjencia Kombëtare e Ujësjetllës Kanalizime dhe Infrastrukturës së Mbetjeve, e përfaqësuar nga ish në Drejtori i Përgjithshëm z. C.K., sipërmarrësi i punimeve BOE *V.H.&B.I&E.* si dhe mbikëqyrësi i punimeve BOE *D.& H.* nuk janë marrë masat e duhura për evidentimin e saktë dhe në kohë të mangësive dhe shkaqeve prej të cilave ka ardhur mungesa e funksionimit të pompave e duke lejuar përmes veprimeve dhe mosveprimeve (sipas pretendimeve të vetë palëve të sipërpërmendura) marrjen në dorëzim nga ana e Ujësjetllës Kanalizime Vlorë SHA, kur në fakt ky institucion (UKV SHA) nuk është në rolin e Investitorit dhe kjo aq më tepër për një punë e cila nuk i është nënshtruar procesit të kolaudimit. Aktualisht objekti ende nuk është kolauduar nga ana e Grupit të Punës.

Kriteri:

- Udhëzimi nr. 2, datë 13.05.2005 *“Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”*, Kreu II, pika 10.2 përcaktohet se:

*“Sipërmarrësi është përgjegjës për drejtimin, mbajtjen në gatishmëri, riparimin, mirëmbajtjen, ruajtjen e punimeve të ndërtim-montimit të objektit e të kantierit, deri në nënshkrimin e procesverbalit të kolaudimit. **Objekti merret në dorëzim në datën e nënshkrimit të procesverbalit të kolaudimit**’.*

- Urdhri nr. 1136 prot., datë 31.05.2021, ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998 *“Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”*, i ndryshuar, neni 12, ku përcaktohet se:

“Të gjitha objektet e përkufizuara në nenin 3 duhet t’i nënshtrohen kolaudimit tekniko ekonomik, i cili ka për qëllim të verifikojë nëse:

1. objekti është realizuar në kushtet teknike;
2. objekti është realizuar në përputhje me kontratën dhe anekset e saj;
3. çmimet e aplikuar janë sipas përcaktimeve të kontratës;
4. në këtë akt verifikohen edhe kërkesat e zbatuesit të paraqitura gjatë zbatimit të punimeve.

- Udhëzimi nr. 3, datë 15.2.2001 *“Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”*, Kreu II, ku përcaktohet se:

“3. Kolaudatori ose grupi i kolaudimit duhet të verifikojë me përgjegjësi:

- a. Realizimin e objektit, në përputhje me projektin, lejen e ndërtimit, standardet dhe rregullat teknike.
- b. Realizimin e objektit, në përputhje me kontratën e nënshkruar.
- c. Përputhjen e dokumenteve me të dhënat nga matjet në dimension, formë, sasi dhe cilësi.

ç. Përputhjen e vlerës së preventivuar dhe të kontraktuar me atë të paraqitur në situacionin përfundimtar, si dhe sqarimet përkatëse, në rastet e mospërputhjes.

4. Kur vërehen defekte në verifikimet që përcaktohen në pikën 3, kolaudatori ose grupi i kolaudimit lë detyra me shkrim për punimet që duhet të kryhen, duke përcaktuar afatet e përfundimit të tyre, në mënyrë që të plotësohen të gjitha kushtet e pikës 3. Në varësi nga natyra e këtyre defekteve përcaktohen detyrimet e secilës palë”.

Ndikimi:

Marrja në dorëzim e punimeve të pakolauduara nuk konfirmon nëse ato janë kryer në përputhje me kushtet teknike, me kontratën dhe anekset e saj, me çmimet e aplikuara nëse janë apo jo sipas përcaktimeve të kontratës si dhe kërkesat e zbatuesit gjatë zbatimit të punimeve. Gjithashtu, mungesa e kolaudimit nuk konfirmon nëse objekti është realizuar në përputhje me projektin, lejen e ndërtimit, standardet dhe rregullat teknike, përputhjen e dokumenteve me të dhënat nga matjet në dimension, formë sasi dhe cilësi.

Mungesa e vendimmarrjes nga ana e Titullarit në lidhje me ndryshimin e gjendjes, ndikon në procesin e marrjes në dorëzim të punimeve, duke u bërë shkak për mos evidentimin në kohë të mangësive të zbatimit dhe më pas në ndarjen e përgjegjësive në rast të identifikimit të tyre.

Shkaku

Mungesa e veprimeve nga ana e ish - Drejtorit të Përgjithshëm.

Rëndësia:

E lartë.

2.1 Rekomandimi:

Nga ana e AKUM të merren masa që nga personat kryesorë përgjegjës për ndërtimin e objektit, konkretisht investitori Agjencia Kombëtare e Ujësjellës Kanalizime dhe Infrastrukturës së Mbetjeve, sipërmarrësit si dhe mbikëqyrësit e punimeve të evidentohen saktë dhe në kohë mangësitë dhe shkaqet për nga rezultojnë këto mangësi.

2.2 Rekomandimi:

Nga ana e AKUM të merren masa që nga personat kryesorë përgjegjës për ndërtimin e objektit, konkretisht investitori Agjencia Kombëtare e Ujësjellës Kanalizime dhe Infrastrukturës së Mbetjeve, sipërmarrësit si dhe mbikëqyrësit e punimeve të ndiqen procedurat e marrjes pjesore në dorëzim të punimeve vetëm pas nënshkrimit të procesverbalit të kolaudimit.

Lidhur me mangësitë e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi ish – Drejtori i Përgjithshëm z. C.K..

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit në lidhje me kontratën me objekt ‘Përmirësimi i Infrastrukturës së Ujërave të Zeza në zonën Bregdetare, Vlorë’, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresën nr. 888/11 prot., datë 24.02.2022 nga ana e z. F.Sh., administruar në subjekt me nr. 71/1 prot., datë 18.02.2022 ku janë shprehur objeksionet si më poshtë.

Pretendimi i subjektit:

“Besojmë që këtë rekomandim (2.2) ka një lapsus dhe duhet të korrigjohet në raportin final. Kjo sepse baza ligjore e aplikueshme në fuqi nuk përmend asnjë marrje në dorëzim pjesor dhe besojmë që audituesit kanë dashur të thonë për marrje të përkohëshme në dorëzim ...”.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Në lidhje me citimin e mësipërm sqarojmë se nuk kemi të bëjmë me lapsus pasi referuar Udhëzimit nr. 2, datë 13.05.2005, Kreu II, Zbatimi i Punimeve të Ndërtimit, pika 4 citohet se:

“Punimet e ndërtimit, që kanë të bëjnë me sigurinë e jetës e të shëndetit të njerëzve dhe mbrojtjen e mjedisit, merren në dorëzim me kontroll të dokumentuar në faza të ndërmjetme, sipas rregullave që përcaktohen në kushtet teknike të zbatimit. Në planin e veprimit përcaktohen punimet, kontrolli i të cilave bëhet në prani të përfaqësuesve të investitorit dhe të subjektit projektues.

Gjithashtu, në pikën 8 citohet se:

“Punimet e përfunduara dhe të marra në dorëzim në kantier paraqiten nga sipërmarrësi në situacione pjesore, sipas periudhave progresive të zhvillimit të punimeve, dhe në atë përfundimtar”. Gjithashtu, në Kreun III Dokumentacioni Teknik i Punimeve të Ndërtimit, pika 1, germa b citohet se:

“Gjatë zbatimit të punimeve të ndërtimit, në kantier hartohet e grumbullohet dokumentacioni teknik, që vërteton kontrollin e vazhduar, saktësinë dhe cilësinë e punimeve, i cili përmban:

b) Dokumentacionin teknik për kontrollin dhe marrjen në dorëzim të strukturave, proceseve të ndërmjetme e rrjeteve, përpara se ato të bëhen të fshehta, të punimeve të montimit të strukturave, makinerive e pajisjeve teknologjike, provave pa ngarkesë, rezultateve dhe ndreqjes së të metave”.

3. Titulli i gjetjes: Volume punimesh të situacionuara por të pakryera në fakt.

Situata:

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion, konkretisht nga auditimi i dosjes teknike të kontratës, nga krahasimi i librezës së masave, situacionit përfundimtar, projektit të miratuar me ndryshime, etj. rezultoi se i janë likuiduar tepër sipërmarrësit të punimeve shuma prej **8,364,636 lekë pa TVSh**, kjo si rrjedhojë e punimeve të situacionuara por të pakryera në fakt për 17 zëra punimesh. (Shiko Aneksin 2.6.1.1)

Kriteri:

- Kontrata e shërbimit të mbikëqyrjes me objekt ‘Përmirësimi i Infrastrukturës së Ujërave të Zeza në zonën Bregdetare, Vlorë’ lidhur sipas asaj me ‘Përmirësimi i Infrastrukturës së Ujërave të Zeza në zonën Bregdetare, Vlorë’;
- Ligji nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, ku përcaktohet se:

neni 7: “Mbikëqyrësi i punimeve është i detyruar të kontrollojë periodikisht dhe në fazat më kryesore, librin e kantierit dhe është përgjegjës për saktësinë vërtetësinë e dokumenteve dhe cilësinë e punimeve të ndërtimit”

- Udhëzimi nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar me Udhëzimin nr. 1, datë 16.6.2011, Kreu I, pika 3, nën pikat 3.2 dhe 3.3 ku përcaktohet se:

3.2 Libreza e masave për punimet e ndërtimit është dokumentacioni bazë për verifikimin e

saktësisë së vëllimeve të punimeve të ndërtimit, të vendosura në situacion. Kjo librezë hartohet nga drejtuesi teknik i objektit dhe firmoset nga ai, nga mbikëqyrësi i punimeve dhe nga përfaqësuesi ligjor i sipërmarrësit, për të cilin është miratuar leja e ndërtimit.

3.3 Situacionet mujore pjesore, progresive dhe përfundimtare hartohen mbi bazën e volumeve të llogaritura në librezën e masave dhe çmimeve faktike, mbështetur në analizat teknike të çmimeve, që përfshihen në manualin teknik të çmimeve të ndërtimit, të miratuara çdo vit me vendim të Këshillit të Ministrave. Ato firmosen nga dejtuesi teknik i objektit, mbikëqyrësi i punimeve dhe përfaqësuesi ligjor i sipërmarrësit për të cilin është miratuar leja e ndërtimit. Në rastet kur në manualin teknik të çmimeve të ndërtimit mungojnë analizat teknike të çmimeve të zërave të punimeve të kryera në

objekt, veprohet në përputhje me procedurën e përcaktuar në pikën 8 të vendimit nr. 514, datë 15.8.2007 të Këshillit të Ministrave “Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit”.

Ndikimi: Dëm ekonomik prej **8,364,636 lekë pa TVSh.**

Shkaku Mungesa e ushtrimit të detyrave ligjore dhe kontraktuale nga ana e mbikëqyrësit të punimeve.

Rëndësia: E lartë.

3.1 Rekomandimi: Nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të AKUM të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e vlerës **8,364,636 lekë pa TVSH** ndaj sipërmarrësit BOE V.H.&B.I&E. si punime të pakryera por të likuiduara në kontratën e sipërmarrjes të lidhur sipas aktit me nr. 2446 prot., datë 26.08.2019 me objekt “Përmirësimi i Infrastrukturës së Ujërave të Zeza në zonën Bregdetare, Vlorë”.

Lidhur me mangësitë e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi mbikëqyrësi i punimeve BOE D.& HE & SK.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit në lidhje me kontratën me objekt ‘Përmirësimi i Infrastrukturës së Ujërave të Zeza në zonën Bregdetare, Vlorë’, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresën nr. 888/11 prot., datë 24.02.2022 nga ana e mbikëqyrësit të punimeve D. ShPK me përfaqësues ligjor znj. S.G., administruar në subjekt me nr. 68 prot., datë 16.02.2022 ku janë shprehur objeksionet si më poshtë.

Pretendimi i subjektit:

“Sa i përket llogaritjes së volumit të punimeve të cilat janë konstatuar si të shtuara nga grupi i auditimit sqarojmë sa me poshtë: Diametri i pusetës është si në vizatimin e paraqitur figurë ... ”

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Pretendimet tuaja mbi këtë pikë nuk merren në konsideratë nga Grupi i Auditimit pasi sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion ato janë përsëritje e argumenteve të dhëna me observacionet e dërguara për aktin e konstatimit. Për sa më sipër pretendimet tuaja nuk qëndrojnë dhe si të tilla ato nuk merren në konsideratë nga Grupi i Auditimit.

4. Titulli i gjetjes: Mungesë e aplikimit të penalteteve për vonesa në realizimin e punimeve sipas afateve të kontratës.

Situata: Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se punimet e konsideruara si të përfunduara nga palët (sipërmarrës, mbikëqyrës) nuk janë kolauduar nga ana e Grupit të Punës të ngritur me Urdhrin nr. 1136 prot., datë 31.05.2021 dhe nga ana e Autoritetit Kontraktor ende nuk ka marrë miratim situacioni përfundimtar i punimeve dhe as ai i përdorimit të fondit rezervë. Gjithashtu, situacioni nr. 5 është dorëzuar me datë 02.03.2021 nga ana e sipërmarrësit dhe me datë 02.03.2021 nga ana e mbikëqyrësit të punimeve, pra përtej datës 15.02.2021 të parashikuar si datë të përfundimit të punimeve dhe është miratuar nga ana e Grupit të Punës z. A.K., znj. V.B., znj. A.Y. dhe znj. E.B. dhe Titullari z. F.Sh. me datë 22.04.2021. Nga sa më sipër rezulton dokumentet e dorëzuara në Autoritetin Kontraktor, konkretisht ato si më poshtë:

- Dokumenti me datë 15.02.2021 mbi njoftimin nga ana e mbikëqyrësit për përfundimin e punimeve;
- Dokumenti me datë 15.02.2021 mbi njoftimin nga ana e sipërmarrësit për përfundimin e punimeve, sipas shkresës së administruar në AKUM me nr. 286 prot., datë 15.02.2021;
- Dokumenti me datë 19.02.2021 mbi mbajtjen e procesverbalit të përfundimit të

punimeve;
janë dokumente fiktive të hartuar mes palëve pasi nuk paraqesin realitetin e asaj kohe. Kjo konfirmohet me faktin se Autoriteti Kontraktor deri në ditën ku mbahet ky akt konstatimi jo vetëm që nuk ka marrë në dorëzim dhe nuk ka miratuar situacionin përfundimtar nr. 6, por për ta konfirmuar atë nëse është apo jo i vërtetë dhe nëse punimet janë kryer konform kontratës së sipërmarrjes, nga ana e vet ish Titullarit z. C.K., është ngritur Urdhri nr. 69, datë 07.10.2021, administruar në AKUK me nr. 1926, prot., datë 07.10.2021¹, “Për monitorimin e situacionit përfundimtar nr. 6 dhe fondit rezervë” me përbërje të grupit:

1. z. F.Sh., Kryetar;
2. z. A.K., Anëtar;
3. znj. V.B., Anëtare;
4. znj. A.Y., Anëtare;
5. znj. E.B., Anëtare;

Në zbatim të këtij Urdhri, ky Grup Pune si më sipër ka hartuar dhe mbajtur një shkresë drejtuar Drejtorisë Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse duke vënë në dijeni edhe Titullarin z. C.K. mbi faktin se në stacionin 102/1 i cili ishte stacioni ku mblidhen prurjet e të gjitha stacioneve të tjera, pompat e R.a të vendosura me investimin e realizuar nga sipërmarrësi BOE V.H.&B.I&E., ishin nxjerrë jashtë stacionit të pompimit dhe ishin çmontuar nga vetë UK Vlorë me argumentin se në reshjet e fundit në qytetin e Vlorës këto pompa nuk arrinin të përçonin prurjen maksimale duke shkaktuar përmbytje. Për këtë arsye nga ana e Grupit të Punës u la si detyrë që kontraktori të bënte dhe një herë kontrollin mbi konfigurimin e pompave nëse defekti fillon aty apo nga projektuesi në kriteret e projektimit për pompat që ka vendosur në projekt, pasi kontraktori thekson se çdo pompë është marrë sipër specifikimeve teknike përkatëse të projektit.

Në fakt sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se **nuk disponohen testimet e kryera** në zbatim të pikës 4.16 TESTIMI DHE INSPEKTIMI I PAJISJEVE të dokumentit me titull Rehabilitimi i Sistemit të Stacioneve të Pompimit të K.U.Z Vlorë, Specifikimet Teknike, ku përcaktohet se:

Pas përfundimit të ngritjes, Kontraktori do të vendosë të punojë dhe të operojë pjesë të tilla të pajisjeve sa të jetë në gjendje, duke pasur parasysh kushtet në vendin në atë kohë dhe duhet të bindë veten se pajisja funksionon siç duhet. Sipërmarrësi ose Përfaqësuesi i tij do të kryejnë një test inspektimi dhe dëshmie të të gjithë pajisjeve për të siguruar që secila pjesë është furnizuar dhe instaluar në përputhje me Specifikimin dhe se performanca hidraulike dhe mekanike dhe elektrike janë në përputhje me garancitë dhe Specifikimin. Nëse ndonjë pjesë e instalimit nuk është në përputhje me këtë Specifikim ose puna e kryer nuk është e kënaqshme, Sipërmarrësi duhet të ndërmarrë hapa të menjëhershëm për të korrigjuar këtë mangësi, deri sa të marrë aprovimin e Supervizorit. Kontraktori do të sigurojë të gjitha pajisjet e nevojshme, mjetet, materialet, artikujt dhe veglat e konsumit, instrumentet, matësit dhe kimikatet e nevojshme për kryerjen e duhur të të gjitha procedurave të testimit. ... Jo më pak se tre javë para kryerjes së ndonjë testimi, Supervizori duhet të paraqesë për miratimin e Supervizorit një përshkrim të detajuar të testeve që do të kryhen.

Përveç çdo testimi specifik të kërkuar në artikujt e pajisjes, siç është detajuar diku tjetër në këtë Specifikim, duhet të kryhen testet e mëposhtme:

- a) Të gjitha impiantet duhet të testohen mekanikisht dhe elektrikisht për të demonstruar se çdo artikull funksionon siç është projektuar;
- b) Do të testohet sekuenca e funksionimit të të gjitha sistemeve të impianteve dhe të kontrollit;
- c) Të gjitha tubacionet, valvulat, etj., do të testohen me presion;
- d) Kontrollimi i rezistencës së rrotullimit dhe izolimit të të gjithë motorëve;
- e) Testet e ngarkesës duhet të kryhen në të gjitha pajisjet e ngritjes;
- f) Të gjitha instalimet elektrike duhet të testohen;
- g) Testimet e kalibrimit duhet të kryhen në të gjitha instrumentet;

¹Një urdhër i ngritur për monitorimin e situacionit përfundimtar dhe fondit rezervë, 7.5 muaj pas datës në të cilën punimet duhet të kishin përfunduar!!!

- h) Të gjitha sistemet e alarmit, overloads dhe pajisjet e sigurisë duhet të testohen;
 i) Sistemet e vajosjes dhe lubrifikimit duhet të testohen;
 j) Të gjithë komutatorët, qendrat e kontrollit motorik, panelet e kontrollit dhe panelet e paneleve duhet të testohen;
 k) Performanca e pompave duhet të testohet;
 l) Çdo test tjetër që kërkohet nga Supervizori.

Në përfundim, rezulton se edhe pas datës në të cilën punimet duhet të kishin përfunduar, ky grup pune ka lenë rekomandime sikur kontrata të ishte ende në proces apo si të ishte grup kolaudimi dhe nga asnjë prej palëve përgjegjëse nuk janë marrë masa për aplikimin e penaltiteve duke favorizuar padrejtësisht sipërmarrësin e punimeve. Situacionet dhe likuidimet përkatëse paraqiten sipas tabelës së paraqitur në Aneksin nr. 2.6.1.2.

Nga sa më sipër rezulton se duke patur parasysh se vlera e kontratës pas ndryshimeve dhe miratimeve të marra nga ana e Projektuesit dhe Autoritetit Kontraktor është në masën **441,699,656 lekë me TVSH** rezulton se punimet e pa miratuara dhe të pa marra në dorëzim nga ana e Autoritetit Kontraktor aktualisht janë në vlerën **163,931,250 lekë me TVSH**, ose 37 % e vlerës së kontratës.

Në vijim, nga ana e ish në Titullarit të Autoritetit Kontraktor z. C.K., ish në zv. Drejtorit të Përgjithshëm z. F.Sh. si dhe mbikëqyrësi i punimeve BOE D.&H.S. nuk janë marrë masa për aplikimin e penaltiteve për vonesa në përfundimin në afat të zbatimit të kontratës dhe realizimin e punimeve, kjo në zbatim të nenit 38 të lidhur sipas aktit nr. 2446 prot., datë 26.08.2019, e ndryshuar. Konkretisht rezulton se ndaj sipërmarrësit të punimeve nuk janë aplikuar penaltitetet për dorëzimin me vonesë të situacionit nr. 5 dhe mos dorëzimit deri në fund të afatit të auditimit të situacionit nr. 6 i përlogaritur sipas tabelës së më poshtme:

Vlera e punimeve të kryera jashtë afatit të kontratës	1/1000 e vlerës (për kontrata me afat mbi 12 muaj)	Data e situacionit	Ditë e vonese vonesë ²	Vlera e pa aplikuar e penaltitetit
99,840,0001	0.001	02.03.2021	15	1,497,600
84,091,249	0.001	-	288	24,218,280
SHUMA				25,715,880

Vlera e mësipërme prej **25,715,880 lekë përbën përdorim pa efektivitet, eficiencë dhe ekonomikitet të fondeve të AKUM** për shkak të mos arritjes së funksionit kryesor të këtij investimi dhe si e tillë ka rënduar situatën financiare të AKUM dhe atë funksionale të investimit në Ujësjellës Kanalizime Vlorë.

Kriteri:

- Ligji nr. 10 296 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, neni 8, pika 1 ku përcaktohet se:

“Titullarët e njësive publike, të përmendura në nenin 3 të këtij ligji, përgjigjen për vendosjen e përmbushjen e qëllimeve dhe të objektivave të njësive publike, nëpërmjet krijimit të një sistemi të përshtatshëm dhe efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit, si dhe përdorimit të fondeve publike, në mënyrë të ligjshme, me ekonomi, efektivitet dhe eficiencë.”;

- VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 77 Mbikëqyrja e kontratës, ku përcaktohet se:

- Gjatë zbatimit të kontratës, autoriteti kontraktor dhe organe të tjera shtetërore, të autorizuar me ligj, (nëse është rasti) mbikëqyrin veprimtarinë e kontraktorit, sipas kërkesave të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe legjislacionin në fuqi;
- Për t’u siguruar nëse cilësia e punëve, shërbimeve ose e mallrave është e njëjtë me cilësinë për të cilën është shpallur fitues kontraktori, autoriteti kontraktor duhet të monitorojë zbatimin e kontratës dhe në rast të shkëlqes së kushteve të kërkuara zbaton

² Penaltitet janë përlogaritur duke marrë për bazë datën e dorëzimit të akteve të konstatimit nga Audituesit Shtetëror të KLSH, afat ky i cili duhet të përlogaritet saktësisht deri në datën e lëshimit të Urdhër pagesës nga ana e Autoritetit Kontraktor.

penalitetet e parashikuara në kontratë. Autoriteti kontraktor, gjatë kryerjes së kontrolleve mban procesverbal me shkrim në prani të kontraktorit, sipas përcaktimeve në legjislacionin në fuqi.

- Kontrata e sipërmarrjes së punimeve të lidhur sipas aktit nr. 2446 prot., datë 26.08.2019, e ndryshuar, neni 38.
- Kontrata e shërbimit të mbikëqyrjes me objekt 'Përmirësimi i Infrastrukturës së Ujërave të Zeza në zonën Bregdetare, Vlorë'.

Ndikimi: Përdorim pa efektivitet, eficiencë dhe ekonomikitet prej **25,715,880 lekë pa TVSh**, mos arritje e funksionit kryesor të investimit duke rënduar situatën financiare të AKUM dhe atë funksionale të investimit në Ujësjiellës Kanalizime Vlorë.

Shkaku Mungesa e ushtrimit të detyrave ligjore dhe/apo kontraktuale nga ana e ish në Titullarit të Autoritetit Kontraktor z. C.K., ish në zv. Drejtorit të Përgjithshëm z. F.Sh. (në cilësinë e Titullarit të Autoritetit Kontraktor) si dhe mbikëqyrësi i punimeve BOE D.&H.S. mbikëqyrësit të punimeve, i përfaqësuar nga znj. S.G..

Rëndësia: E lartë.

4.1 Rekomandimi: Nga AKUM të merren masat e nevojshmet për nxjerrjen e përgjegjësisë dhe shmangien e praktikave të cilat ndikojnë në përdorimin pa efektivitet, eficiencë dhe ekonomikitet të fondeve si pasojë e mos përmbushjes së qëllimeve kryesore të investimeve në vlerën prej **25,715,880 lekë pa TVSH** e shkaktuar në kontratën e lidhur me sipërmarrësit BOE óV.H.&B.I&E.” si penalitet i aplikuar për vonesa në realizimin e kontratës së sipërmarrjes të lidhur sipas aktit me nr. 2446 prot., datë 26.08.2019 me objekt “Përmirësimi i Infrastrukturës së Ujërave të Zeza në zonën Bregdetare, Vlorë’.

Lidhur me mangësitë e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi ish – Drejtori i Përgjithshëm z. C.K., ish – zv. Drejtorit i Përgjithshëm z. F.Sh. si mbikëqyrësi i punimeve BOE D. & HE & SK, i përfaqësuar nga znj. S.G..

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit në lidhje me kontratën me objekt 'Përmirësimi i Infrastrukturës së Ujërave të Zeza në zonën Bregdetare, Vlorë', nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresën nr. 888/11 prot., datë 24.02.2022 nga ana e mbikëqyrësit të punimeve D. ShPK me përfaqësues ligjor znj. S.G., administruar në subjekt me nr. 68 prot., datë 16.02.2022 ku janë shprehur objeksionet si më poshtë.

Pretendimi i subjektit:

“Në lidhje me furnizimin dhe instalimin e pompave në stacionet përkatëse ju bëjmë me dije se ne, në pozicionin e mbikëqyrësit të punimeve kemi ndjekur instalimin e pompave sipas metodologjisë së përcaktuar nga prodhuesi dhe nga projektuesi ... ”.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Pretendimet tuaja mbi këtë pikë merren pjesërisht në konsideratë nga Grupi i Auditimit duke kryer edhe korrigjimet përkatëse përgjatë materialit.

III.6.2. Mbi zbatimin e kontratës ‘Përmirësimi i furnizimit me ujë për lagjen Krastë e Vogël, Harmës dhe qytetin e Elbasanit’.

Të dhëna të përgjithshme

1. Në lidhje me Projektin

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se projekti është hartuar nga ana e studios PALMA CONTRUCTION dhe si investim ka parashikuar:

- Ndërtimin e rrjetit shpërndarës të ujësjellësit për zonën Krastë e Vogël, Elbasan;
- Ndërtim Linje transmetim nga Stacioni i Pompimit Krastë e Vogël deri në Depo Krastë e vogël;
- Ndërtim linje DN400 nga Depo Krastë e Vogël – Unazë e qytetit dhe përgjatë Unazës Elbasan (zëvendësimin e linjës D400 çeliku të amortizuar);
- Ndërtim depo 1000 m³ Harmës, Elbasan;
- Ndërtim Linje transmetimi nga Depot Krastë e Madhe - Stacion Pompimi ndërmjetës Harmës deri në Depon e Re dhe linjën e kthimit;
- Ndërtimi i linje të ri PE për zëvendësimin e linjës DN-200 çelik të zonës së varrezave;
- Ndërtim linje DN-400 nga STP Mengel deri tek rrethimi i STP frigoriferi.

Projekt në preventivi i punimeve i hartuar nga ana e Projektuesit ka parashikuar një vlerë prej **357,799,354 lekë pa TVSH**, vlerë kjo e cila është përdorur edhe për vlerën limit të këtij investimi. Diferenca mes vlerës së fondit limit dhe vlerës së kontratës është në vlerën 89,988,104 lekë pa TVSH, ose 25 %.

2. Historiku i zbatimit të punimeve

Në përfundim të procedurës së prokurimit, është shpallur fitues BOE L.&B.&A.K.&B., të përfaqësuar këta sipas prokurës së posaçme me nr. 454 rep. 1344 kol. datë 13.08.2019 nga OE L.me nr. licence për zbatim punimesh NZ. 3386/7 dhe me përfaqësues ligjor z. J.L. me të cilin është lidhur kontrata me Autoritetin Kontraktor e përfaqësuar nga z. A.B.me nr. 2446 prot., datë 26.08.2019 me vlerë **320,833,499.7 lekë me TVSH** dhe me afat të zbatimit të punimeve 12 muaj. Sipas Vendimit të Kryetarit të Bashkisë Elbasan z. G.Ll. me nr. 985/7, datë 17.03.2020 është miratuar leja e ndërtimit e cila mban nr. 985/10 prot., datë 04.06.2020. Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit është lidhur kontrata përkatëse e këtij shërbimi mes Autoritetit Kontraktor, e përfaqësuar nga Titullarit z. A.B.dhe OE A. MK me nr. licence MK.3019 datë 26.06.2020, me përfaqësues ligjor z. E.M. sipas aktit me nr. 3166 prot., datë 23.10.2019 me vlerë të kontratës 3,375,386 lekë me TVSH. Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezultojnë se:

- Me datë 19.06.2020 është bërë dorëzimi i sheshit të ndërtimit, njoftimi nga ana e mbikëqyrësit për fillimin e punimeve, akti i piketimit të sheshit të ndërtimit si dhe procesverbali i fillimit të punimeve;
- Sipas aktit nr. 831 prot., datë 20.04.2021 është bërë amendamenti i kontratës së sipërmarrjes së punimeve sipas të cilës afati i përfundimit të punimeve është caktuar data 30.11.2021;
- Sipas shkresës së administruar në A.K.U.M me nr. 1963 prot., datë 18.10.2021 i është kërkuar Autoritetit Rrugor Shqiptar (ARRSH) leje për kryerje punimesh në rrugën nacionale Elbasan në Librazhd, shkresë për të cilën ende nuk është marrë përgjigje;

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezultojnë se në total janë paraqitur nga ana e sipërmarrësit 3 situacione pjesore me të dhëna sipas tabelës së mëposhtme:

Tabela nr. 1

Situacioni	Data e Faturës tatimore	Vlera e situacionit	Vlera e faturës tatimore	USH nr. Datë
Nr. 1	16.09.2020	21,350,644	10,000,000	nr. 371 datë 06.10.2020
	16.09.2020		10,000,000	nr. 372 datë 06.10.2020
	16.09.2020		675,322	nr. 467 datë 24.12.2020
	16.09.2020		675,322	nr. 468 datë 24.12.2020
Nr. 2	24.12.2020	70,336,526	34,324,678	nr. 545 datë 28.12.2020
	24.12.2020		34,324,678	nr. 546 datë 28.12.2020
	24.12.2020		843,585	nr. 101 datë 14.04.2021
	24.12.2020		843,585	nr. 102 datë 14.04.2021
Nr. 3	12.04.2021	25,740,495	9,156,415	nr. 105 datë 16.04.2021
	12.04.2021		9,156,415	nr. 106 datë 16.04.2021

Pra në total rezultojnë se janë situacionuar nga ana e sipërmarrësit punime në vlerë **117,427,665 lekë me TVSH, ose 37 % e vlerës totale të kontratës**, nga të cilat janë likuiduar nga ana e Autoritetit Kontraktor shuma prej 110,000,000 lekë pa TVSH, ose 7,427,665 lekë me TVSH më pak nga vlera e situacionuar.

Në mënyrë të detajuar gjetjet në lidhje me këtë investim paraqiten si më poshtë:

5. Titulli i gjetjes: Volume punimesh të situacionuara por të pakryera në fakt.

Situata:

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion, konkretisht nga auditimi i dosjes teknike të kontratës, nga krahasimi i librezës së masave, situacionit progresiv, projektit të miratuar me ndryshime, etj. rezultoi se i janë likuiduar tepër sipërmarrësit të punimeve shuma prej **10,880,258 lekë pa TVSH**, kjo si rrjedhojë e punimeve të situacionuara por të pakryera në fakt për 4 zëra punimesh. (Shiko Aneksin 2.6.2.1)

Kriteri:

- Kontrata e shërbimit të mbikëqyrjes me objekt 'Përmirësimi i furnizimit me ujë për lagjen Krastë e Vogël, Harmes dhe qytetin e Elbasanit' lidhur sipas aktit nr. 3166 prot., datë 23.10.2019
 - Ligji nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit", i ndryshuar, Kreu III, ku përcaktohet se:
- neni 7: "Mbikëqyrësi i punimeve është i detyruar të kontrollojë periodikisht dhe në fazat më kryesore, librin e kantierit dhe është përgjegjës për saktësinë vërtetësinë e dokumenteve dhe cilësinë e punimeve të ndërtimit"
- Udhëzimi nr. 3 datë 15.02.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit", i ndryshuar me Udhëzimin nr. 1, datë 16.6.2011, Kreu I, pika 3, nënparagrafi 3.2 dhe 3.3 ku përcaktohet se:

3.2 Libreza e masave për punimet e ndërtimit është dokumentacioni bazë për verifikimin e saktësisë së vëllimeve të punimeve të ndërtimit, të vendosura në situacion. Kjo librezë hartohet nga drejtuesi teknik i objektit dhe firmoset nga ai, nga mbikëqyrësi i punimeve dhe nga përfaqësuesi ligjor i sipërmarrësit, për të cilin është miratuar leja e ndërtimit.

3.3 Situacionet mujore pjesore, progresive dhe përfundimtare hartohen mbi bazën e volumeve të llogaritura në librezën e masave dhe çmimeve faktike, mbështetur në analizat teknike të çmimeve, që përfshihen në manualin teknik të çmimeve të ndërtimit, të miratuara çdo vit me vendim të Këshillit të Ministrave. Ato firmosen nga drejtuesi teknik i objektit, mbikëqyrësi i punimeve dhe përfaqësuesi ligjor i sipërmarrësit për të cilin është miratuar leja e ndërtimit. Në rastet kur në manualin teknik të çmimeve të ndërtimit mungojnë analizat teknike të çmimeve të zërave të punimeve të kryera në objekt, veprohet në përputhje me procedurën e përcaktuar në pikën 8 të vendimit nr. 514, datë 15.8.2007 të Këshillit të Ministrave "Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit".

Ndikimi:

Dëm ekonomik prej **10,880,258 lekë pa TVSh.**

Shkaku

Mungesa e ushtrimit të detyrave ligjore dhe kontraktuale nga ana e mbikëqyrësit të punimeve.

Rëndësia:

E lartë.

5.1 Rekomandimi:

Nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të AKUM të kërkohej në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e vlerës **10,880,258 lekë pa TVSH** ndaj sipërmarrësit BOE L.&B.&A.K.&B. si punime të pakryera por të likuiduara në kontratën e sipërmarrjes të lidhur sipas aktit me nr. 2446 prot., datë 26.08.2019 me objekt 'Përmirësimi i furnizimit me ujë për lagjen Krastë e Vogël, Harmës dhe qytetin e Elbasanit'.

Lidhur me mangësitë e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi mbikëqyrësi i punimeve OE A. MK e përfaqësuar nga z. E.M..

6. Titulli i gjetjes:

Shkelje e kushteve të lejes së ndërtimit.

Situata:

Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me kontratën me objekt 'Përmirësimi i furnizimit me ujë për lagjen Krastë e Vogël, Harmës dhe qytetin e Elbasanit', në lidhje me zbatimin e punimeve Grupi i Auditimit kreu verifikim në terren në prezencë të mbikëqyrësit të punimeve. Sipas lejes së miratuar me Vendimin nr. 985/7, datë 17.03.2020,

është parashikuar në pikën 10 të saj se zhvilluesi do të duhej të depozitonte mbetjet ndërtimore në Jug të fshatit Vidhas, Nj.A. Papër nën juridiksionin e Bashkisë Elbasan. Leja e miratuar me Vendimin nr. 985/7, datë 17.03.2020, në pikën 10 të saj ka cituar se vendi depozitimit i materialeve do të jetë ai i caktuar sipas Vendimit nr. 66, datë 23.05.2019 të Këshillit të Bashkisë Elbasan. Ky Vendim administrohet në Bashkinë Elbasan me nr. 3862/1 prot., datë 29.05.2019 dhe në Prefekturën e Qarkut Elbasan me nr. 823 prot., datë 29.05.2019 dhe është marrë ndër të tjera në bazë të:

- Ligjit nr. 10431 datë 09.06.2011 'Për mbrojtjen e mjedisit';
- Ligjit nr. 10463 datë 22.09.2011 'Për menaxhimin e integruar të mbetjeve'
- VKM nr. 575 datë 24.06.2015 'Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte', pika 15, 17, gjerat a,b,c, ç;
- VKM nr. 389 datë 27.06.2018 'Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 452 datë 11.07.2012 të Këshillit të Ministrave 'Për landfille të mbetjeve''.

Në kuptimit të ligjit nr. 10463 datë 22.09.2011 'Për menaxhimin e integruar të mbetjeve', pika 52 dhe VKM nr. 575 datë 24.06.2015 'Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte', pika 4, paragrafi i dytë, sipërmarrësi i punimeve në rastin në fjalë është Zotëruesi i mbetjeve inerte. Sipas këtij kuadri ligjor "Zotëruesi i mbetjeve inerte", është personi fizik ose juridik, i cili, gjatë aktivitetit të tij të ndërtimit, riparimit, restaurimit apo prishjes së objekteve, prodhon, transporton ose trajton mbetje inerte të cilat janë të renditura në kapitullin 17, të Vendimit nr. 99, datë 18.2.2005, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e katalogut shqiptar të klasifikimit të mbetjeve", të ndryshuar dhe/ose krijuesi i mbetjeve ose çdo person që zotëron mbetje. Në vijim në pikën 15 të VKM nr. 575 datë 24.06.2015 'Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte' citohet se: Zotëruesit e mbetjeve inerte janë të detyruar të dorëzojnë mbetjet inerte në venddepozitimin e përkohshëm ose lëndfille të trajtimit të mbetjeve inerte, kundrejt tarifës për ton/mbetje, të propozuar nga operatori dhe të miratuar nga njësitë e qeverisjes vendore. Nga auditimi nuk rezulton asnjë provë dokumentare për të konfirmuar se nga ana e sipërmarrësit të punimeve janë kryer këto pagesa për ton/mbetje sipas tarifës së miratuar nga ana e Bashkisë Elbasan si dhe asnjë marrëveshje me operatorë të pajisur me leje mjedisore, sipas shtojcës 1, bashkëlidhur ligjit nr. 10448, datë 14.7.2011, "Për lejet e mjedisit", të ndryshuar, dhe me licencë të tipit III.2.B, sipas Vendimit nr. 538, datë 26.5.2009, të Këshillit të Ministrave, "Për licencat dhe lejet që trajtohen nga/apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta". Gjithashtu, nuk rezulton asnjë dokument i plotësuar dhe i nënshkruar mbi transferimin e këtyre mbetjeve me qëllim regjistrimin e tyre në Regjistrin e Transfertave Individuale, sipas vendimit nr. 229, datë 23.4.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe të dokumentit të transferimit të mbetjeve jo të rrezikshme". Në kushte të tilla nga ana e

sipërmarrësit të punimeve nuk janë respektuar drejt pikat 4, 5 dhe 6, të VKM nr. 575 datë 24.06.2015 në vend depozitimin e përkohshëm të përcaktuar nga NJQV-ja. Sipas dokumentacionit fotografik dhe argumenteve nga subjekti i audituar, rezulton se nga ana e sipërmarrësit të punimeve nuk janë kryer procese pune për depozitimin e materialit të dalë nga gërmimet por vetëm transporti i këtyre materialeve dhe shkarkimi i tyre (edhe nëse ka ndodhur nuk konfirmohet sasia). Edhe pse ky veprim rezulton të jetë kryer në kundërshtim me pikat e cituara në pikën 3 si më sipër përsëri nuk konfirmohet kryerja e proceseve të punës për depozitimin, e cila edhe nëse do të ishte rasti nuk është detyrë e firmës sipërmarrëse. Nëse do ti referohemi analizës së bërë nga ana e Projektuesit në lidhje me depozitimin, do të konstatohet se nën këtë zë janë parashikuar si më poshtë:

$$\begin{aligned} \text{Sp} + \text{p} - 3.19 \text{ o.p} \times 125 \text{ lekë/o.p} &= 398.8 \text{ lekë/m}^3 + \text{Sig. Shoqërore } 67 \text{ lekë/m}^3 = \\ &465 \text{ lekë/m}^3; \\ \text{Ekskavator me kove } 0.25 \text{ m}^3 - 0.1 \text{ o.p} \times 2,800 \text{ lekë} &= 280 \text{ lekë/m}^3; \\ \text{Shpenzime plotësuese } 8 \% \times 745 \text{ lekë/m}^3 &= 60 \text{ lekë/m}^3; \\ \text{Fitimi } 10 \% \times 745 \text{ lekë/m}^3 &= 74.5 \text{ lekë/m}^3; \\ \text{TOTALI} &= 880 \text{ lekë/m}^3 \end{aligned}$$

Në këto kushte, nisur nga dokumentacioni i vënë në dispozicion arrihet në konkluzionin se nuk konfirmohet kryerja e depozitimit dhe as kryerja e zërit sipas parashikimeve të projektuesit.

Kriteri:

- Kontrata e shërbimit të mbikëqyrjes me objekt *'Përmirësimi i furnizimit me ujë për lagjen Krastë e Vogël, Harmes dhe qytetin e Elbasanit'* lidhur sipas aktit nr. 3166 prot., datë 23.10.2019

- Ligji nr. 8402, datë 10.09.1998 *"Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit"*, i ndryshuar, Kreu III, ku përcaktohet se:

neni 7: *"Mbikëqyrësi i punimeve është i detyruar të kontrollojë periodikisht dhe në fazat më kryesore, librin e kantierit dhe është përgjegjës për saktësinë vërtetësinë e dokumenteve dhe cilësinë e punimeve të ndërtimit"*

- Udhëzimi nr. 3 datë 15.02.2001 *"Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit"*, i ndryshuar me Udhëzimin nr. 1, datë 16.6.2011, Kreu I, pika 3, nënpikat 3.2 dhe 3.3 ku përcaktohet se:

3.2 Libreza e masave për punimet e ndërtimit është dokumentacioni bazë për verifikimin e saktësisë së vëllimeve të punimeve të ndërtimit, të vendosura në situacion. Kjo librezë hartohet nga drejtuesi teknik i objektit dhe firmoset nga ai, nga mbikëqyrësi i punimeve dhe nga përfaqësuesi ligjor i sipërmarrësit, për të cilin është miratuar leja e ndërtimit.

3.3 Situacionet mujore pjesore, progresive dhe përfundimtare hartohen mbi bazën e volumeve të llogaritura në librezën e masave dhe çmimeve faktike, mbështetur në analizat teknike të çmimeve, që përfshihen në manualin teknik të çmimeve të ndërtimit, të miratuara çdo vit me vendim të Këshillit të Ministrave. Ato firmosen nga drejtuesi teknik i objektit, mbikëqyrësi i punimeve dhe përfaqësuesi ligjor i sipërmarrësit për të cilin është miratuar leja e ndërtimit. Në rastet kur në manualin teknik të çmimeve të ndërtimit mungojnë analizat teknike të çmimeve të zërave të punimeve të kryera në objekt, veprohet në përputhje me procedurën e përcaktuar në pikën 8 të vendimit nr. 514, datë 15.8.2007 të Këshillit të Ministrave *"Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit"*.

sipas kërkesave të Ligjit nr. 10431 datë 09.06.2011 *"Për mbrojtjen e mjedisit"* Ligjit nr. 10463 datë 22.09.2011 *"Për menaxhimin e integruar të mbetjeve"* VKM nr. 575 datë 24.06.2015 *"Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte"* VKM nr. 389 datë 27.06.2018 *"Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 452 datë 11.07.2012 të Këshillit të Ministrave"* *"Për"*

Ndikimi:	landfillet e mbetjeve Mungesw e aplikimit tw konfiskimit tw garancisw financiare prej 4 % e vlerws sw preventivit nw maswn 12,833,340 lekë për shkelje të kushteve të lejes së ndërtimit.
Shkaku	Mungesa e ushtrimit të detyrave ligjore dhe kontraktuale nga ana e mbikëqyrësit të punimeve.
Rëndësia:	E lartë.
6.1 Rekomandimi:	Nga ana e AKUM, në cilësinë e Zhvilluesit të Lejes së Ndërtimit nr. 985/10 prot., datë 04.06.2020, miratuar me Vendim të Kryetarit të Bashkisë Elbasan nr. 985/7, datë 17.03.2020, ti kërkohet Bashkisë Elbasan, ndjekja e të gjitha procedurave të nevojshme administrative në të gjitha shkallët e gjykimit, konfiskimi i garancisë financiare në masën 4 % të preventivit, ose shumës 12,833,340 lekë për shkelje të kushteve të Lejes së ndërtimit, nga ana e subjektit ndërtues shoqërisë BOE L.&B.&A.K.&B. me të cilin është lidhur kontrata përkatëse e sipërmarrjes së punimeve sipas aktit me nr. 2446 prot., datë 26.08.2019 me objekt <i>‘Përmirësimi i furnizimit me ujë për lagjen Krastë e Vogël, Harmës dhe qytetin e Elbasanit’</i> .

Lidhur me mangësitë e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi mbikëqyrësi i punimeve OE A. MK e përfaqësuar nga z. E.M..

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit në lidhje me kontratën me objekt *‘Përmirësimi i furnizimit me ujë për lagjen Krastë e Vogël, Harmës dhe qytetin e Elbasanit’*, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresën nr. 888/11 prot., datë 24.02.2022 nga ana e mbikëqyrësit të punimeve A. MK me përfaqësues ligjor z. E.M., administruar në subjekt me nr. - prot., datë 14.02.2022 ku janë shprehur objeksionet si më poshtë.

Pretendimi i subjektit:

Në lidhje me zërat:

Mbushje me çakëll e gur gurore në trupin e rrugës, përhapur e ngjeshur me makineri

Shtresë stabilizanti t=15 cm

Shtresë rëre

“Nga grupi i auditimi nuk është paraqitur një tabelë e përlllogaritjes ... ”

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Pretendimet tuaja mbi këtë pikë nuk merren në konsideratë nga Grupi i Auditimit pasi sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion ato janë përsëritje e argumenteve të dhëna me observacionet e dëguara për aktin e konstatimit. Për sa më sipër pretendimet tuaja nuk qëndrojnë dhe si të tilla ato nuk merren në konsideratë nga Grupi i Auditimit.

Pretendimi i subjektit:

Në lidhje me zërin:

Depozitim dheu në vend depozitim

“Gjatë zbatimit të punimeve janë zbatuar me përpikmëri parashikimet e kontratës së sipërmarrjes nr. 3889 prot., datë 31.12.2019 dhe projektit të zbatimit specifikimeve teknike dhe ofertës ekonomike të shpallur fituese. Nga Bashkia Elbasan në rolin e përfituesit të investimit dhe juridiksionit territorial të zonës ku do të realizohet ky investim, është miratuar leja infrastrukturore, me Vendim nr. 985/7, datë 17.03.2020, për realizimin e punimeve të këtij

objekti. Gjithashtu po nga bashkia Elbasan është miratuar edhe leja e ndërtimit me nr. 985/10 prot., datë 04.06.2020. Me vendimin Nr. 985/7, datë 17.03.2020 ka përcaktuar vend depozitimin e mbetjeve ndërtimore për këtë objekt, ku në pikën 10 të dispozitivit të saj, është vendosur se:

10. Në zbatim të V.K.B-së nr. 66, datë 23.5.2019, Zhvilluesi është i detyruar që mbetjet ndërtimore, të depozitohen në jug të fshatit Vidhas, Njësia Administrative Papër, në truall shtet me nr. pasurie 52/26 me kapacitet maksimal 1.000.000 ton/vit nën juridiksionin e Bashkisë Elbasan

Materiali i dalë rishtazi gatë realizimit të punimeve është grumbulluar në kantier dhe më pas është transportuar me kamionët e sipërmarrësve të punimeve në vend depozitimin e përcaktuar nga Bashkia Elbasan, në (shatin Vidhas, Njësia Administrative Papër).

Një gjë të tillë e vërteton edhe Bashkia Elbasan, e cila me shkresën nr. 749 prot., datë 10.02.2022 Lënda: “Informacion për largimin e mbetjeve ndërtimore dhe inerte nga investimi për përmirësim të furnizimit me ujë të pijshëm në Krastë e Vogël, Harmas, pjesën Jug – Perëndimore të qytetit Elbasan dhe unazën perëndimore të qytetit, ku citojë janë shprehur ndër të tjera se:

Pas përfundimit të punimeve shoqëria L. shpk ... kanë bërë pastrimin e territorit rreth objekteve të ndërtuara nga mbetjet e ndryshme ndërtimore dhe inertet, dhera si dhe transportimin, depozitimin e tyre në vend – depozitimin në jug të fshatit Vidhas, njësia Administrative Papër. (vijon me përsëritje të observacionit të dërguar për aktin e konstatimit) ...”

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Pretendimet tuaja mbi këtë pikë nuk merren në konsideratë nga Grupi i Auditimit pasi faktet e dorëzuara nga ana juaj, përfshirë këtu edhe dokumentacionin e dërguar nga ana e Bashkisë Elbasan me nr. 79 prot., datë 10.02.2022, konfirmojnë edhe një herë gjetjen e audituesve të KLSH se zëri *Depozitim dheu në vend depozitim*, nuk është kryer dhe aq më tepër sipas parashikimeve dhe termave të referencës së kontratës së sipërmarrjes. Ky dokument nuk citon asnjë prej atyre të konstatuara si të munguara në aktin e konstatimit dhe në Projektraportin e Auditimit, pra pagesa për ton/mbetje sipas tarifës së miratuar nga ana e Bashkisë Elbasan si dhe asnjë marrëveshje me operatorë të pajisur me leje mjedisore, sipas shtojcës 1, bashkëlidhur ligjit nr. 10448, datë 14.7.2011, “Për lejet e mjedisit”, të ndryshuar, nuk është vënë në dispozicion një dokument i plotësuar dhe i nënshkruar mbi transferimin e këtyre mbetjeve me qëllim regjistrimin e tyre në Regjistrin e Transfertave Individuale, sipas vendimit nr. 229, datë 23.4.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe të dokumentit të transferimit të mbetjeve jo të rrezikshme”.

Konkretisht sqarojmë si më poshtë:

1. Rikujtojmë se Grupi i Auditimit kreu verifikim në terren në prezencë të mbikëqyrësit të punimeve ku ndër të tjera u pyet edhe mbi vend depozitimin e materialeve të dala nga gërmimet. Në lidhje me këtë pyetje nuk u dha asnjë përgjigje nga ana juaj;

2. Për sa i përket lejes së ndërtimit sqarojmë se Grupi i Auditimit ka patur në dispozicion Lejen e miratuar me Vendimin nr. 985/7, datë 17.03.2020 dhe është në dijeni të faktit se kjo leje ka parashikuar në pikën 10 të saj se zhvilluesi do të duhej të depozitonte mbetjet ndërtimore në Jug të fshatit Vidhas, Njësia Administrative Papër nën juridiksionin e Bashkisë dhe pikërisht për këtë edhe Ju në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve u pyetët nga Grupi i Auditimit në lidhje me vendin ku janë depozituar materialet e ndërtimit;

3. Leja e miratuar me Vendimin nr. 985/7, datë 17.03.2020, në pikën 10 të saj ka cituar se vendi depozitimit i materialeve do të jetë ai i caktuar sipas Vendimit nr. 66, datë 23.05.2019 të Këshillit të Bashkisë Elbasan. Ju bëjmë me dije se ky Vendim administrohet në Bashkinë

Elbasan me nr. 3862/1 prot., datë 29.05.2019 dhe në Prefekturën e Qarkut Elbasan me nr. 823 prot., datë 29.05.2019. Ky vendim është marrë ndër të tjera në bazë të:

- Ligjit nr. 10431 datë 09.06.2011 'Për mbrojtjen e mjedisit';
- Ligjit nr. 10463 datë 22.09.2011 'Për menaxhimin e integruar të mbetjeve'
- VKM nr. 575 datë 24.06.2015 'Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte', pika 15, 17, gjerat a,b,c, ç;
- VKM nr. 389 datë 27.06.2018 'Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 452 datë 11.07.2012 të Këshillit të Ministrave 'Për landfilllet e mbetjeve''.

Në kuptimit të ligjit nr. 10463 datë 22.09.2011 'Për menaxhimin e integruar të mbetjeve', pika 52 dhe VKM nr. 575 datë 24.06.2015 'Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte', pika 4, paragrafi i dytë, sipërmarrësi i punimeve në rastin në fjalë është Zotërues i mbetjeve inerte. Sipas këtij kuadri ligjor "Zotëruesi i mbetjeve inerte", është personi fizik ose juridik, i cili, gjatë aktivitetit të tij të ndërtimit, riparimit, restaurimit apo prishjes së objekteve, prodhon, transporton ose trajton mbetje inerte të cilat janë të renditura në kapitullin 17, të Vendimit nr. 99, datë 18.2.2005, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e katalogut shqiptar të klasifikimit të mbetjeve", të ndryshuar dhe/ose krijuesi i mbetjeve ose çdo person që zotëron mbetje.

Në vijim në pikën 15 të VKM nr. 575 datë 24.06.2015 'Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte' citohet se:

Zotëruesit e mbetjeve inerte janë të detyruar të dorëzojnë mbetjet inerte në venddepozitimin e përkohshëm ose landfilllet e trajtimit të mbetjeve inerte, kundrejt tarifës për ton/mbetje, të propozuar nga operatori dhe të miratuar nga njësitë e qeverisjes vendore.

Nga ana Juaj nuk rezulton asnjë provë dokumentare për të konfirmuar se nga ana e sipërmarrësit të punimeve janë kryer këto pagesa për ton/mbetje sipas tarifës së miratuar nga ana e Bashkisë Elbasan si dhe asnjë marrëveshje me operatorë të pajisur me leje mjedisore, sipas shtojcës 1, bashkëlidhur ligjit nr. 10448, datë 14.7.2011, "Për lejet e mjedisit", të ndryshuar, dhe me licencë të tipit III.2.B, sipas Vendimit nr. 538, datë 26.5.2009, të Këshillit të Ministrave, "Për licencat dhe lejet që trajtohen nga/apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta". Gjithashtu, nga ana Juaj nuk është vënë në dispozicion një dokument i plotësuar dhe i nënshkruar mbi transferimin e këtyre mbetjeve me qëllim regjistrimin e tyre në Regjistrin e Transfertave Individuale, sipas vendimit nr. 229, datë 23.4.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe të dokumentit të transferimit të mbetjeve jo të rrezikshme". Në kushte të tilla nga ana Juaj nuk janë respektuar drejt pikat 4, 5 dhe 6, të VKM nr. 575 datë 24.06.2015 në vend depozitimin e përkohshëm të përcaktuar nga NJQV-ja.

4. Sipas dokumentacionit fotografik të sjellë me observacion si dhe argumenteve të sjella nga ana Juaj në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve, rezulton se nga ana e sipërmarrësit të punimeve nuk janë kryer procese pune për depozitimin e materialit të dalë nga gërmimet por vetëm transporti i këtyre materialeve dhe shkarkimi i tyre (edhe nëse ka ndodhur nuk konfirmohet sasia). Edhe pse ky veprim rezulton të jetë kryer në kundërshtim me pikat e cituara në pikën 3 si më sipër përsëri nuk konfirmohet kryerja e proceseve të punës për depozitimin, e cila edhe nëse do të ishte rasti nuk është detyrë e firmës sipërmarrëse.

5. Nëse do të referoheni analizës së bërë nga ana e Projektuesit në lidhje me depozitimin, do të konstatooni se nën këtë zë janë parashikuar si më poshtë:

$$\begin{aligned} Sp + p &= 3.19 \text{ o.p} \times 125 \text{ lekë/o.p} = 398.8 \text{ lekë/m}^3 + \text{Sig. Shoqërore } 67 \text{ lekë/m}^3 = 465 \text{ lekë/m}^3; \\ \text{Ekskavator me kove } 0.25 \text{ m}^3 &- 0.1 \text{ o.p} \times 2,800 \text{ lekë} = 280 \text{ lekë/m}^3; \end{aligned}$$

$$\begin{aligned} \text{Shpenzime plotësuese } 8 \% \times 745 \text{ lekë/m}^3 &= 60 \text{ lekë/m}^3; \\ \text{Fitimi } 10 \% \times 745 \text{ lekë/m}^3 &= 74.5 \text{ lekë/m}^3; \\ \text{TOTALI} &= 880 \text{ lekë/m}^3 \end{aligned}$$

Në këto kushte, nisur nga dokumentacioni i vënë në dispozicion gjatë fazës së auditimit në terren si dhe nga ai i nisur me observacion (dokumentacioni fotografik) arrihet në konkluzionin se nuk konfirmohet kryerja e depozitimit sipas kërkesave të Ligjit nr. 10431 datë 09.06.2011 *'Për mbrojtjen e mjedisit'*, Ligjit nr. 10463 datë 22.09.2011 *'Për menaxhimin e integruar të mbetjeve'* VKM nr. 575 datë 24.06.2015 *'Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte'*, VKM nr. 389 datë 27.06.2018 *'Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 452 datë 11.07.2012 të Këshillit të Ministrave 'Për landfilllet e mbetjeve''* dhe as kryerja e zërit sipas parashikimeve të projektuesit. Për sa më sipër pretendimet tuaja nuk qëndrojnë, nuk mbështeten në dokumente e fakte konkrete, nuk justifikojnë gjetjet e konstatuara gjatë fazës së auditimit në terren dhe si të tilla ato nuk merren në konsideratë nga Grupi i Auditimit.

7. Titulli i gjetjes: Preventivi i kontratës, përmban zëra, kryerja e të cilave, është detyrim ligjor i sipërmarrësit të punimeve e për rrjedhojë likuidimit i tyre do të përbënte dëm ekonomik.

Situata: Sipas projekt-preventivit të hartuar nga ana e projektuesit rezulton se janë përfshirë në preventiv e njëkohësisht edhe në ofertën e paraqitur nga sipërmarrësi i punimeve BOE L.&B.&A.K.&B. zëra për kryerjen e testimeve të linjave të shtruara. Në fakt referuar *Specifikimeve Teknike*, pika 4.9 *Analiza e Çmimit Njësipërcaktohet se: 6Çmimi njësi për Tubat, Valvolat, Hidrantet dhe pjesët speciale përfshin furnizimin, transportin ngarkimin, shkarkimin dhe transportin e materialeve dhe pajisjeve të nevojshme gjatë instalimit të tyre si dhe vendosjen e të gjitha elementëve të tyre në mënyrë të përsosur dhe testimin që do ti bëhet për presionin e punës me të cilën do të punojnë*". Gjithashtu, referuar kontratës së sipërmarrjes të lidhur mes palëve sipas aktit me nr. 2446 prot., datë 26.08.2019, neni 26 Inspektimet, pika 1 *përcaktohet se: "Kontraktori duhet të bëjë të gjitha testet dhe inspektimet e kërkuara nga dispozitat e kontratës. Kosto e këtyre testimeve dhe inspektimeve duhet të financohet tërësisht nga kontraktori brenda çmimit të kontratës"*. Për rrjedhojë likuidimi i këtyre zërave sipas këtij preventivi në vlerën **1,833,240 lekë pa TVSH** do të përbënte dëm ekonomik dhe si i tillë duhet të zbritet përmes ndryshimeve në projekt-preventiv sipas procedurave përkatëse, pasi aktualisht ky zë punimesh i preventivuar dhe në analizën e çmimeve për njësi nuk është likuiduar me situacione por është parashikuar në preventiv.

Kriteri:

- Kontrata e shërbimit të mbikëqyrjes me objekt *'Përmirësimi i furnizimit me ujë për lagjen Krastë e Vogël, Harmes dhe qytetin e Elbasanit'* lidhur sipas aktit nr. 3166 prot., datë 23.10.2019
- Ligji nr. 8402, datë 10.09.1998 *"Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi"*, i ndryshuar, Kreu III, *ku përcaktohet se:*
neni 7: *"Mbikëqyrësi i punimeve është i detyruar të kontrollojë periodikisht dhe në fazat më kryesore, librin e kantierit dhe është përgjegjës për saktësinë vërtetësinë e dokumenteve dhe cilësinë e punimeve të ndërtimit"*
- Udhëzimi nr. 3 datë 15.02.2001 *"Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit"*, i ndryshuar me Udhëzimin nr. 1, datë 16.6.2011, Kreu I, pika 3, nënpikat 3.2 dhe 3.3 *ku përcaktohet se:*
3.2 *Libreza e masave për punimet e ndërtimit është dokumentacioni bazë për verifikimin e saktësisë së vëllimeve të punimeve të ndërtimit, të vendosura në situacion. Kjo librezë hartohet nga drejtuesi teknik i objektit dhe firmoset nga ai, nga mbikëqyrësi i punimeve dhe nga përfaqësuesi*

ligjor i sipërmarrësit, për të cilin është miratuar leja e ndërtimit.

3.3 Situacionet mujore pjesore, progresive dhe përfundimtare hartohen mbi bazën e volumeve të llogaritura në librezën e masave dhe çmimeve faktike, mbështetur në analizat teknike të çmimeve, që përfshihen në manualin teknik të çmimeve të ndërtimit, të miratuara çdo vit me vendim të Këshillit të Ministrave. Ato firmosen nga drejtuesi teknik i objektit, mbikëqyrësi i punimeve dhe përfaqësuesi ligjor i sipërmarrësit për të cilin është miratuar leja e ndërtimit. Në rastet kur në manualin teknik të çmimeve të ndërtimit mungojnë analizat teknike të çmimeve të zërave të punimeve të kryera në objekt, veprohet në përputhje me procedurën e përcaktuar në pikën 8 të vendimit nr. 514, datë 15.8.2007 të Këshillit të Ministrave “Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit”.

- Specifikimet Teknike, pika 4.9 Analiza e Çmimit Njësi përcaktohet se: “Çmimi njësi për Tubat, Valvolat, Hidrantet dhe pjesët speciale përfshin furnizimin, transportin ngarkimin, shkarkimin dhe transportin e materialeve dhe pajisjeve të nevojshme gjatë instalimit të tyre si dhe vendosjen e të gjitha elementëve të tyre në mënyrë të përsosur dhe testimin që do të bëhet për presionin e punës me të cilën do të punojnë”;
- Kontrata e sipërmarrjes e lidhur mes palëve sipas aktit me nr. 2446 prot., datë 26.08.2019, neni 26 Inspektimet, pika 1 ku përcaktohet se: “Kontraktori duhet të bëjë të gjitha testet dhe inspektimet e kërkuara nga dispozitat e kontratës. Kosto e këtyre testimeve dhe inspektimeve duhet të financohet tërësisht nga kontraktori brenda çmimit të kontratës”.

Ndikimi: Likuidimi i zërave në vlerën **1,833,240 lekë pa TVSH** për kryerjen e testimeve të linjave të shtruara, do të përbënte dëm ekonomik në rast likuidimi nga ana e Autoritetit Kontraktor.

Shkaku Mungesa e ushtrimit të detyrave ligjore dhe kontraktuale nga ana e mbikëqyrësit të punimeve.

Rëndësia: E lartë.

7.1 Rekomandimi: Nga AKUM si dhe mbikëqyrësi i punimeve, të merren masat organizative për ndryshimin e zërave të preventivit të kontratës në vlerën **1,833,240 lekë pa TVSH** pasi kryerja e testimeve të linjave të shtruara është përfshirë në çmimin e vendosjes së tubave dhe përveç kësaj, kostot e testimeve dhe inspektimeve duhet të financohen tërësisht nga ana e kontraktorit.

Lidhur me mangësitë e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi mbikëqyrësi i punimeve OE A. MK e përfaqësuar nga z. E.M..

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit në lidhje me kontratën me objekt ‘Përmirësimi i furnizimit me ujë për lagjen Krastë e Vogël, Harmës dhe qytetin e Elbasanit’, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresën nr. 888/11 prot., datë 24.02.2022 nga ana e mbikëqyrësit të punimeve A. MK me përfaqësues ligjor z. E.M., administruar në subjekt me nr. - prot., datë 14.02.2022 ku janë shprehur objeksionet si më poshtë.

Pretendimi i subjektit:

“Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion nga Autoriteti Kontraktor Agjencia Kombëtare e Ujësjetës Kanalizime dhe Infrastrukturës së Mbetjeve, rezulton se autori i projektit është shoqëria “P. C.” ShPK. ...”.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Pretendimet tuaja mbi këtë pikë nuk merren në konsideratë nga Grupi i Auditimit pasi sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion ato janë përsëritje e argumenteve të dhëna me observacionet e dërguara për aktin e konstatimit. Për sa më sipër pretendimet tuaja nuk qëndrojnë dhe si të tilla ato nuk merren në konsideratë nga Grupi i Auditimit.

8. Titulli i gjetjes: Mangësi në drejtim të zbatimit të punimeve dhe si në dokumentacionin e dosjes teknike.

Situata: Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion, nga auditimi rezultuan mangësitë si më poshtë:

a. Referuar dokumentacionit fotografik të ndodhur në dosjen teknike rezulton se shtrati i kanaleve, kjo të paktën në rastet e dokumentuara, nuk është pastruar sipas kërkesave të parashikuara në pikën 2.14 të *Specifikimeve Teknike* ku përcaktohet se: Materiali nuk duhet të përmbajë gurë dhe mbetje të tjera të dëmshme si dhe atyre në pikën 2.15 ku përcaktohet se: Mbushja dhe mbulimi i kanaleve do të bëhet pasi të ketë përfunduar gërmimi dhe pastrimi i kanaleve. Konkretisht rezulton se kanalet nuk janë të pastruara nga gurët, në shumë raste tubacionet janë vendosur në prezencë uji, në disa raste janë mbuluar me materialin e rezultuar nga gërmimi dhe në disa të tjera konstatohet se ka prezencë mbeturinash urbane;

b. Nga sondazhet e kryera për punimet e situacionuara rezultoi se materiali i përdorur si zhavorr lumi nuk përmbush kushtet e parashikuara në *Specifikimet Teknike* pasi:

- Ka përmbajtje të lartë materiali të imët;
- Përmban fraksione me dimensione më të mëdha se 75 mm, konkretisht me dimensione të diametrit maksimal 15 cm, 17 cm e deri në 20 cm, kjo në kundërshtim me pikën 2.16 të *Specifikimeve Teknike*, ku përcaktohet se: Materialet që do të përdoren për punime mbushëse do të jenë të lira nga gurët dhe pjesë të forta më të mëdha se 75 mm në çdo përmasë dhe gjithashtu të pastër nga përbërës druri apo mbeturina të çdo lloji;
- Ka përmbajtje dherash;

c. Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se për mbushjet me të cilat janë realizuar kanalet (rëra dhe zhavorret) nuk disponohet asnjë provë për të vërtetuar nëse ato janë përgatitur sipas kushteve të diktuar nga projektuesi në lidhje me lagështinë, përzierjen, përhapjen dhe ngjeshjen në objekt me rul vibruës, me ngjeshës të posaçëm dore ose ngjeshës mekanik. Për punimet e ngjeshjes nuk është kryer asnjë testim, kjo në kundërshtim me pikën 2.17 të *Specifikimeve Teknike*, ku përcaktohet se:

Testet që kërkohen me këtë rast janë:

- Dy testet për klasifikimin e çdo tipi materiali për shtratimin, mbushjen, mbulimin dhe një test shtesë për klasifikimin e çdo 50 ton ngarkesë materiali;
- Dy teste për densitetin e lagështisë (Proctor) ose dy teste për densitetin relativ për çdo tip materiali të propozuar për shtratim, mbulim përveç materialit kokrrizor për shtratim;

d. Në dosjen teknike mungon aprovimi i mbikëqyrësit të punimeve për vendin e marrjes së zhavorrit.

Kriteri:

- Kontrata e shërbimit të mbikëqyrjes me objekt 'Përmirësimi i furnizimit me ujë për lagjen Krastë e Vogël, Harmes dhe qytetin e Elbasanit' lidhur sipas aktit nr. 3166 prot., datë 23.10.2019;

- Ligji nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi", i ndryshuar, Kreu III, ku përcaktohet se:

neni 7: "Mbikëqyrësi i punimeve është i detyruar të kontrollojë periodikisht dhe në fazat më kryesore, librin e kantierit dhe është përgjegjës për saktësinë vërtetësinë e dokumenteve dhe cilësinë e punimeve të ndërtimit"

- Kontrata e sipërmarrjes e lidhur mes palëve sipas aktit me nr. 2446 prot., datë 26.08.2019, neni 26 Inspektimet, pika 1 ku përcaktohet se: "Kontraktori duhet të bëjë të gjitha testet dhe inspektimet e kërkuara nga dispozitat e kontratës. Kosto e këtyre testeve dhe inspektimeve duhet të financohet tërësisht nga kontraktori brenda çmimit të kontratës".

Ndikimi:

Kryerja e punimeve jo sipas kushteve teknike dhe kërkesave të projektit

Shkaku	përbën risk të lartë për amortizim të shpejtë të investimit duke sjellë për pasojë domosdoshmërinë e kryerjes rishtazi të investimeve.
Rëndësia:	E lartë.
8.1	Nga ana e AKUM si dhe mbikëqyrësi i punimeve të kryhen inspektime me qëllim verifikimin e shtrateve të kanaleve për të verifikuar pastërtinë e tyre nga mbetjet urbane dhe mbetje të tjera të dëmshme. Dokumentacioni i sipërcituar të kërkohet nga ana e mbikëqyrësit ndaj sipërmarrësit të punimeve përpara fazës së kolaudit dhe të kontrollohet gjatë marrjes në dorëzim nga komisioni përkatës i ngritur me Urdhër të Titullarit.
8.2	Nga ana e AKUM si dhe mbikëqyrësi i punimeve të kryhen inspektime me qëllim verifikimin e shtrateve të kanaleve për të verifikuar nëse materiali i përdorur si zhavorr lumi përmbush kushtet e parashikuara në <i>Specifikimet Teknike</i> . Dokumentacioni i sipërcituar të kërkohet nga ana e mbikëqyrësit ndaj sipërmarrësit të punimeve përpara fazës së kolaudit dhe të kontrollohet gjatë marrjes në dorëzim nga komisioni përkatës i ngritur me Urdhër të Titullarit.

Lidhur me mangësitë e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi mbikëqyrësi i punimeve OE A. MK e përfaqësuar nga z. E.M.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit në lidhje me kontratën me objekt *‘Përmirësimi i furnizimit me ujë për lagjen Krastë e Vogël, Harmës dhe qytetin e Elbasanit’*, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresën nr. 888/11 prot., datë 24.02.2022 nga ana e mbikëqyrësit të punimeve A. MK me përfaqësues ligjor z. E.M., administruar në subjekt me nr. - prot., datë 14.02.2022 ku janë shprehur objeksionet si më poshtë.

Pretendimi i subjektit:

Në lidhje me pastrimin e kanaleve

“Gjatë realizimit të punimeve, në seksion kanali dhe jo vetëm, nga sipërmarrësit e punimeve janë zbatuar të gjitha kushtet teknike të zbatimit të punimeve në fuqi ...”

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Pretendimet tuaja mbi këtë pikë nuk merren në konsideratë nga Grupi i Auditimit pasi sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion ato janë përsëritje e argumenteve të dhëna me observacionet e dërguara për aktin e konstatimit. Për sa më sipër pretendimet tuaja nuk qëndrojnë dhe si të tilla ato nuk merren në konsideratë nga Grupi i Auditimit.

III.6.3. Mbi zbatimin e kontratës së punimeve civile “Ndërtim i kolektorit kryesor të ujërave të zeza dhe I.T.U.P në Gjirin e Lalzit”.

Kontrata óNdërtim i kolektorit kryesor të ujërave të zeza ITUP, në zonën turistike të Gjirit të L.zit, Durrësó, është nënshkruar me nr. 2774 prot., datë 10.10.2016, ndërmjet AKUM përfaqësuar nga z. A.A. dhe Kontraktorin óS.A-degë e shoqërisë së huajó përfaqësuar nga z. I.T., me vlerë 1,319,1216,061 lekë. Afati i përfundimit të punimeve është përcaktuar 30 muaj. Periudha e garancisë së punimeve është përcaktuar 2 vjet. Leja e ndërtimit është miratuar nga Këshilli Kombëtar i Territorit me nr. 2, datë 22.02.2017. Për mbikëqyrjen e punimeve është përzgjedhur Shoqëria óT.ó SHPK me përgjegjës ligjor znj. D.Q..

Kontrata përfshin punime që kanë të bëjnë me ndërtimin e katër stacioneve të pompimit, të cilat lidhen me impiantin e trajtimit të ujërave të ndotura, tubacioneve përkatëse lidhëse, punime elektromekanike si dhe punime për ndërtimin e impiantit të trajtimit. Objektivi i këtij investimi është trajtimi i ujërave të ndotura, duke mbajtur të pastër ambientin në të cilin shtrihet zona e cila ka rëndësi shumë të lartë jo vetëm për banorët e zonës por edhe për mbarrëvajtjen e turizmit, pasi shtrihet në afërsi të detit.

Sheshi i ndërtimit i është dorëzuar kontraktorit me datë 23.11.2016, akti i piketimit dhe procesverbali i fillimit të punimeve janë mbajtur po me këtë datë. Njoftimi për përfundimin e punimeve është bërë nga Kontraktori me shkresë nr. 113 prot., datë 23.05.2019 dhe mbikëqyrësi i punimeve me shkresë nr. 455 prot., datë 23.05.2019. Bazuar në ditarin përkatës, punimet kanë përfunduar në periudhëne parashikuar të realizimit të punimeve.

Krahas ndryshimeve dhe shtesave është kërkuar edhe përdorimi i fondit rezervë me shkresë të mbikëqyrësit të punimeve nr. Extra, datë 26.04.2019.

Janë certifikuar 21 situacione progresive, përfshirë situacionin përfundimtar, i cili është certifikuar me vlerë 1,096,265,771 lekë pa TVSH, ose 1,315,518,925 lekë me TVSH.

Në objekt janë verifikuar disa zëra punimesh, kryesisht për punime ndërtimore të stacioneve të pompimit dhe të impiantit, nga ku nuk u konstatuan diferenca.

1. Titulli i Gjetjes:	Hartim me mangësi i analizës së çmimeve, për zëra të rinj punimesh.
Situata:	Gjatë zbatimit të kontratës óNdërtim i kolektorit kryesor të ujërave të zeza dhe I.T.U.P në Gjirin e Lalzitô, kanë rezultuar diferenca të volumeve të parashikuara krahasuar me ato faktike, por edhe nevoja për ndryshime. Mbikëqyrësi óT.ô SHPK, me shkresë nr. 181 prot., datë 13.07.2018. Për zëra të rinj të punimeve të konstatuara si të nevojshme janë hartuar analiza të çmimeve. Titullari i AK z. A.B., me Urdhër nr. 39 prot., datë 19.04.2018, ka ngritur grupin e punës për negocimin e çmimeve për zëra të rinj punimesh të përbërë nga z. F.M., z. G.A., z. D.Z., z. Z.I. dhe z. Z.M.. Në këto analiza çmimesh ka edhe referenca nga studimi i tregut i realizuar, ndërsa për zëra të tjerë janë hartuar analiza të kostos, për të cilat u konstatuan mangësi si më poshtë: - Sipas zërit 1.5.1, An.E.1, është parashikuaróNdërtim linje elektrike kabllore nëntokësore me kabllo 24 kV, ALXLPE. 3 x 1 x 185 mm², sipas rregullores së OSHEE, sipas tipologjisë së zonës ku kalon linja, mufta dhe terminale për kabllot, tuba çeliku Ø 160 mm për intersektimet me rrugë të linjësô, parashikuar me çmim 4,935,020 lekë. Për këtë zë punimi është ndryshuar dimensionin e kabllit nga 624 kV, ALXLPE. 3 x 1 x 185 mm² në 24 kV, ALXLPE. 3 x 1 x 240/25 mm², si dhe është shtuar shtresë me tulla dhe shirit sinjalizues, duke e klasifikuar zë të ri punimi óNdërtim linje elektrike kabllore nëntokësore me kabllo 24 kV, ALXLPE. 3 x 1 x 240/25 mm², sipas rregullores së OSHEE, sipas tipologjisë së zonës ku kalon linja, mufta dhe terminale për kabllot, tuba çeliku Ø 160 mm për intersektimet me rrugë të linjës, shtresë mbrojtëse me tulla të plota dhe shirit sinjalizuesô, përcaktuar me çmim 7,228,812 lekë. Ndryshimi sa më sipër është argumentuar me faktin se nga informacioni i marrë nga OSHEE Durrës, si dhe nga kontrollat në vend, rezulton që seksioni i linjës kabllore i instaluar dhe pjesa e mbetur nga nënstacioni i Sukthit është me 3 x 1 x 240 mm², ndryshe nga projekti i cili parashikon linjë kabllore 3 x 1 x 185 mm². Për sa më sipër, duke qenë një kusht i detyrueshëm ndaj OSHEE është miratuar ndryshimi i seksionit të kabullit. - Sipas zërit 1.5.1, është parashikuar óLinjë nëntokësore fibër optike e armuar

	me 12 deje SM të futur në tub HDPE Ø 40 mm, përfshirë specififikimet dhe lidhjet e nevojshme. Futja në tub e fibrës të bëhet me pajisje pneumatike. Të futet në një trase me linjën TM duke respektuar kushtet teknike për të tilla instalime. Ky zë është zëvendësuar me: òLinjë nëntokësore fibër optike e armuar me 24 deje SM të futur në tub HDPE Ø 40 mm, përfshirë specififikimet dhe lidhjet e nevojshme. Futja në tub e fibrës të bëhet me pajisje pneumatike. Të futet në një trase me linjën TM duke respektuar kushtet teknike për të tilla instalime. Sa më sipër është ndryshuar vetëm lloji i kabullit nga 12 SM në 24 SM, me çmim të ndryshuar nga 1,052,708 lekë/km në 1,272,699 lekë/km. Rritja e kapacitetit të fibrës optike është bërë për mundësimin e instalimit të kamerave të vëzhgimit si dhe shtimit të stacioneve të pompimit në të ardhmen. Për përcaktimin e çmimeve sipas zërave të mësipërm, duhet të reflektohet vetëm ndryshimi i çmimit të bazës materiale dhe jo hartimi i analizave të plota.
Kriteri:	Udhëzimi nr. 2, datë 08.05.2003 òPër klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimitò, Kreu II, Pika a.
Ndikimi/Efekti:	Nuk përcaktohet efekt, për arsye të mungesës së referencave në çmime.
Shkaku:	Ndryshime të justifikuara, por që vetëm nga ndryshimi i dimensionit të kabllove, çmimi i punimeve është rritur në mënyrë të konsideruar.
Rëndësia:	E lartë.
Rekomandime:	AKUM, të marrë masa për analizimin në detaje të çmimeve që përcaktohen në zëra të rinj punimesh, të cilat nevojiten të përcaktohen nga ndryshimet e mundshme të projektit gjatë zbatimit të kontratës.

2. Titulli i Gjetjes:	Hartim me mangësi i analizës së çmimeve, për zëra të rinj punimesh.
Situata:	Gjatë zbatimit të kontratës òNdërtim i kolektorit kryesor të ujërave të zeza dhe I.T.U.P në Gjirin e Lalzitò, janë bërë ndryshime të cilat kanë rezultuar edhe me zëra të rinj punimesh. Nga verifikimi i analizës së kostos së tyre, konstatohen mangësi si më poshtë: - Sipas zërit 2.2.5 (2.116 + an.23) òRrethim me mur me blloqe betoni, kangjella dhe derë hyrëseò, por edhe për rrethimet e stacioneve të pompave, është përfshirë zë i ri i punimeve òTrarë themeli beton monolit C 20/25ò. Çmimi i aplikuar për këtë zë është 15,145 lekë/m³. Nga analiza e çmimit konstatohet se ka rritje të sasisë për zërin kallëpe konkretisht, kallëp muri nga përcaktimi në manual në sasinë 3.5 m², është aplikuar sasia 10 m² dhe kallëp trari nga 3.5 m² në 4 m². Çmimi i betonit C 20/25 në manual është 5,388 lekë/m³, ndërsa në analizën e re është paraqitur 6,629 lekë/m³. Çmimi i betonit është rritur me pretendimin se duhet përdorur betopompa, por në këtë rast nuk kemi hedhje të betonit në lartësi. Nga ribërja e llogaritjeve rezulton se çmimi që duhet të aplikohet të ishte 12,376 lekë/m³. Sipas këtij zëri është likuiduar sasia 148.8 m³. Vlera 412,027 lekë [148.8 m³ x (15,145 – 12,376)], është përfituar padrejtësisht nga Kontraktori “S.A” SHPK dhe përbën dëm ekonomik. - Sipas zërit 2.2.5 (2.116 + an.23) òRrethim me mur me blloqe betoni, kangjella dhe derë hyrëseò, për kolonat metalike profil katror me dimensione (5 x 5 cm x 1.5 mm), me lartësi 1.75 m, është aplikuar çmimi 4,660 lekë për copë. Nga verifikimi i këtij çmimi në sitin e subjektit òM.ò, rezulton se për profil me gjatësi 6 m, çmimi është 3,140 lekë, ose 1050 lekë për kolonë (890 lekë + 18 % struktura). Nga verifikimi i manualit të çmimeve të ndërtimit viti 2015, rezulton se çmimi i hekurit profil dhe shirit është 94 lekë për kg, ose 827.2 lekë për kolonë. Duke marrë në konsideratë çmimin e tregut (1050 lekë për kolonë) si

	dhe numrin 277 copë impianti dhe 53 copë stacionet e pompimit), <i>vlera 1,191,300 lekë [(4,660 lekë – 1,050 lekë) x 330 copë], është përfituar padrejtësisht nga kontraktori “S.A” dhe përbën dëm ekonomik.</i> - Nga shqyrtimi i zërit 1.1.B.3 óMbikëlim i linjës me presionó rezulton se janë përfshirë konstruksione metalike për mbështetjen e tubit në sasinë 16.43 ton, me çmim 216,364 lekë/ton. Nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se në konstruksione metalike është përfshirë tubacioni me diametër Ø 711 mm dhe spesor 11 mm, me gjatësi 82 m. Nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se në kontratën bazë, për ndërtimin e kalimit ishte parashikuar çmimi për tubacion çeliku është 187,111 lekë për ton dhe i konstruksionit metalik 216,364 lekë/ton. Sa më sipër, çmimi i tubit të çelikut duhet të ndahej nga çmimi i konstruksioneve metalike. Pesha e tubit e përcaktuar konstruksion është 15.3 ton. <i>Vlera 447,571 lekë (216,364 -187,111) x 15.3 ton, është përfituar padrejtësisht nga kontraktori “S.A” dhe përbën dëm ekonomik.</i> - Nga shqyrtimi i zërit óPropozime shtesa V.Oó, nënzëri óRezervuar betoni me volum 36.9 m³ó, janë përfshirë punime elektrike, kablllo, kablllo tokëzimi, ndriçues infrastrukture, për mbrojtjen nga zjarri dhe pompat, është parashikuar vlera 1,593,879 lekë. Nga verifikimi i analizës së çmimeve të detajuar rezulton se është përfshirë transport me vlerë 1,870 lekë, materiale ndërtimi me vlerë 1,364,169.5 lekë pa përfshirë 18 % të fitimit dhe shpenzime të përgjithshme (63,771 lekë transport, 76,525 lekë ngjeshje tabani dhe 1,223,873 lekë shtresë çakulli). Vendosija e vlerës së mësipërme pa asnjë argumentim, për zëra që nuk kanë të bëjnë me punime elektrike, si dhe duke marrë në konsideratë se sistemi zjarrfikës parashikohet më vete, <i>vlera e likuiduar në shumën 1,539,879 lekë, është përfituar padrejtësisht nga Kontraktori “S.A” SHPK dhe përbën dëm ekonomik.</i> -Sipas zërit óNdërtim linje elektrike kablllore nëntokësore me kablllo 24 kV, ALXLPE. 3 x 1 x 240/25 mm², sipas rregullores së OSHEE, sipas tipologjisë së zonës ku kalon linja, mufta dhe terminale për kabllot, tuba çeliku Ø 160 mm për intersektimet me rrugë të linjës, shtresë mbrojtëse me tulla të plota dhe shirit sinjalizuesó,rezulton se analiza e çmimit është rishikuar për të gjithë elementët dhe jo vetëm për elementët e shtuar. Në këtë analizë çmimi, sa i përket shtresës mbrojtëse me tulla të plota, krahas materialit dhe punëtorisë, është përfshirë edhe zëri makineri, zë i cili mund të përfshihet në rast të ndërtimit të murit dhe jo shtresë me tulla. <i>Vlera 130,060 lekë(20,150 x 18% x 5.47 km), është përfituar padrejtësisht nga Kontraktori “S.A” SHPK dhe përbën dëm ekonomik.</i>
Kriteri:	-VKM nr. 514, datë15.08.2007 óPër informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të ndërtimitó i ndryshuar, pika 2 dhe 11. - Udhëzimi Këshillit Të Ministrave nr. 2, datë 08.05.2003 óPër klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimitó. - VKM nr. 629, datë 15.7.2015 óPër miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyreó, pika 4.
Ndikimi/Efekti:	Është shkaktuar dëm ekonomik me vlerë3,720,837 lekë.
Shkaku:	Mos respektimi i akteve ligjore në përcaktimin e çmimeve për zëra të rinj punimesh.
Rëndësia:	E lartë.
Rekomandime:	AKUM të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjyqimit, arkëtimin e vlerës

	3,720,837 lekë , nga Kontraktori BOE “S.A” SHPK, përfituar padrejtësisht si pasojë e mangësive në hartimin e analizës së kostos së punimeve të ndërtimit.
--	--

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

Grupi i negocimit i përbërë nga z. F.M., z. G.A., z. D.Z., z. J.Gj., z. Z.I. dhe z. I.M., si dhe mbikëqyrësi i punimeve Shoqëria “T.” SHPK.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar Shoqëria óT.ô SHPK, është paraqitur observacioni me shkresë nr. 58/2 prot., datë 10.02.2022, protokolluar në KLSH me nr. 888/11, datë 24.02.2022, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

Argumentet e paraqitura janë të njëjta me ato të sjella për aktkonstatimin.

- Pretendohet se sipas zërit 2.2.5 (2.116+an.23) óRrethi me mur me blloqe betoni, kangjella te dera hyrëseô nuk ka dëm ekonomik, pasi kallëpëria është llogaritur duke iu referuar dimensioneve faktike të murit.
- Pretendohet se, po sipas zërit të mësipërm, kolonat metalike nuk janë thjesht një profil i pa përpunuar. Elementi i mësipërm përbëhet nga pllaka metalike me katër vrima për mbështetjen mbi mure, katër prezhinierë, 3 elementë fiksues me vidë për fiksimin e zgarës.
- Në lidhje me zërin 1.1.B.3 óMbikalim i linjës me presionô, pretendohet se tubi i çelikut është trajtuar në brendësi me profile hekuri të salduara për të pozicionuar tubin si dhe tubin tjetër janë profile për kalimin e linjës elektrike dhe linjës së fibrës.
- Në lidhje me zërin óPropozime e shtesa V.Oô, pranohet se ka një gabim, por bashkëngjitur paraqitet analiza e saktë.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

- Në lidhje me zërin 2.2.5 (2.116+an.23) óRrethi me mur me blloqe betoni, kangjella te dera hyrëseô, sqarojmë se nga ndryshimi i markës së betonit ndryshon vetëm sasia e çimentos e përfshirë në beton. Manuali përcakton qartë sasinë e kallëpit të duhur sipas sasisë së betonit. Pretendimi nuk qëndron.
- Në lidhje me trajtimin sa i përket kolonave metalike sqarojmë se, analiza e çmimit nuk është detajuar, si dhe ka të përfshirë zërin vendosje. Nga ana e grupit të auditimit është marrë në konsideratë vlera e tregut. Kolonat metalike janë një produkt i gatshëm i cili blihet në treg dhe jo material që përpunohet.
- Në lidhje me zërin 1.1.B.3 óMbikalim i linjës me presionô edhe nga observacioni trajtohet si tub dhe jo si konstruksion metalik. Elementët e fiksimit nuk mund të realizohen në pjesën e brendshme të tubit. Nga grupi i auditimit nuk është përllogaritur e diferenca e peshës e gjithë mbikalimit, por vetëm e tubacionit.
- Në lidhje me zërin óPropozime e shtesa V.Oô, pranohet se ka një gabim. Vlera korresponduese e paraqitur është e pa miratuar, e pa detajuar dhe e pa argumentuar.

Të njëjtat argumente janë paraqitur edhe nga z. F.M., z. Z.I., z. G.A. dhe z. J.Gj. në observacionin sipas shkresës nr. 71/1 prot., datë 18.02.2022, protokolluar në KLSH me nr. 888/11, datë 24.02.2022.

III.6.4. Mbi zbatimin e kontratës së punimeve civile “Impianti i trajtimit të ujërave të ndotura në zonën bregdetare Dhralë, Palasë, Lot i parë”.

Kontrata e punimeve civile óImpianti i trajtimit të ujërave të ndotura në zonën bregdetare Dhralë-Palasë, Lot 1ô, është nënshkruar ndërmjet AKUM, përfaqësuar nga z. A.A., me nr. 2476, datë 31.08.2017, me Kontraktorin óGj.ô SHPK, përfaqësuar nga z. M.Gj. me vlerë 138,305,992.3 lekë. Afati i përfundimit të punimeve është përcaktuar 36 muaj dhe periudha e garancisë 24 muaj. Për mbikëqyrjen e punimeve është përzgjedhur Shoqëria óT.ô SHP, me përfaqësues ligjor z. I. K., me të cilën është nënshkruar kontrata nr. 3298, datë 22.11.2017.

Leja e ndërtimit është miratuar nga Këshilli Kombëtar i Territorit me nr. 02, datë 12.04.2017.

Akti i dorëzimit të sheshit të punimeve mbajtur midis palëve është mbajtur më datë 22.11.2017.

Njoftimi i fillimit të punimeve dhe dorëzimi i kantierit janë realizuar me datë 22.11.2017.

Njoftimi për përfundimin për përfundimin e punimeve është bërë me shkresë nr. 166 prot., datë 23.12.2019, punimet kanë përfunduar për një afat 11 muaj më shpejt nga përcaktimi në kontratë.

Punimet i janë dorëzuar Shoqërisë ujësjellës-Kanalizime Himarë sipas procesverbalit të datës 24.02.2020, nënshkruar nga UK Himarë nga Drejtori z. A.G. dhe M.V. (inxhinier pranë shoqërisë).

Preventivit të punimeve i janë bërë ndryshime të cilat kanë dalë të nevojshme gjatë zbatimit të kontratës. Punimet shtesë të rezultuara, janë financuar nga fondi rezervë.

Nga auditimi i dosjes teknike rezulton se janë mbajtur rregullisht procesverbale të punimeve që bëhen të padukshme, janë kryer testimet e materialeve të përcaktuar në specifikimet teknike, janë realizuar kontrolle të ndryshme gjatë fazës së zbatimit, janë dokumentuar procese të ndryshme të punimeve me fotografi etj.

Situacioni përfundimtar është certifikuar me vlerë 133,861,535 lekë.

Akti i kolauditimit është mbajtur me 24.02.2020, nga komisioni i përbërë nga znj. A. M. (C.) inxhinere gjeolog, z. Z.I., inxhinier hidroteknik, znj. V.B., inxhinier ndërtimi dhe znj. M.V., përfaqësuese e UK SHA Himarë.

1. Titulli i Gjetjes:	Mangësi në përcaktimin e volumeve të disa zërave të punimeve.
Situata:	Nga verifikimi i punimeve të realizuara në objekt sipas kontratës óImpianti i trajtimit të ujërave të ndotura në zonën bregdetare Dhralë, Palasë, Lot i parë, u konstatuan mangësitë si më poshtë: - Tek impianti i trajtimit të ujërave të ndotura nuk është realizuar zëri mbushje me dhe humusor $t=15$ cm, mbi soletën e ITUN. - Trotuari nuk është ndërtuar sipas specifikimeve teknike si dhe nuk është realizuar me pllaka, në sasinë 80 m^2 për sheshin e impiantit dhe 16 m^2 për stacionin e pompave. Gjithsesi, për këtë trotuar janë realizuar shtresa betoni. Vlera e likuiduar për këtë zë punimi në shumën 153,000 lekë ($96\text{ m}^2 \times 1,600\text{ lekë/m}^2$), përbën efekt negativ financiar, pasi konsiderohet funksional. - Portathyrëse në impiant dhe stacion pompimi janë ndërtuar me peshë 0.21 ton, ndërsa është certifikuar me peshë 1.7 ton, sipas llogaritjeve si më poshtë: Elementët e portës 5×5 cm ($t=4\text{mm}$), gjatësi 16 ml, me peshë 98 kg. Kolonat e mbajtëse, profil 8×8 cm ($t=8\text{ mm}$), gjatësi 4 m, me peshë 72 kg. Rrjeta mbushëse me peshë 40 kg. Diferenca në peshë rezulton 1.49 ton ($1.7\text{ ton} - 0.21\text{ ton}$). Pavarësisht peshës së vendosur, dyert janë funksionale. Vlera 551,300 lekë ($1.49\text{ ton} \times 185,000\text{ lekë/ton} \times 2\text{ copë}$), përbën efekt negativ financiar. - Sipas zërit I.1.An 34 óKonstruksion metalik çelik i pa oksidueshëm (shkallët, zgarat, kapakët etj.), është certifikuar sasia 2 ton, me çmim 325,000 lekë. Nga

	verifikimi ilibrezës së masave rezulton se për kapakët e pusetave është certifikuar sasia 1.96 ton. Nga verifikimi në terren i punimeve rezulton se kapakët janë ndërtuar me llamarinë me trashësi 2.5 mm. Nga përlogaritjet, rezulton se për puseta me dimensione 140 cm x 140 cm (8 copë), pesha e llogaritur është 0.12 ton për copë, ndërkohë që nga llogaritjet për materialin e vendosur faktik rezulton se një kapak pusete peshon 0.06 ton. Për kapakët e pusetave me dimensione 100 cm x 100 cm (12 copë), pesha e llogaritur është 0.08 ton, ndërkohë që nga llogaritjet sipas realizimit faktik rezulton pesha 0.035 ton. Sa më sipër është certifikuar më shumë sasia 1 ton (0.48 ton + 0.54 ton). Pavarësisht se kapakët e kryejnë funksionin e përcaktuar, vlera 325,000 lekë (1 ton x 325,000 lekë), konsiderohet efekt negativ financiar. Nga verifikimi i punimeve në objekt u konstatuan muri anësor prej beton arme ka pësuar çedim, duke u spostuar në pjesën e fugave. Ky spostim nuk është në distancë të konsiderueshme, por mund të krijojë problem me kalimin e kohës në qëndrueshmërinë e impiantit.
Kriteri:	Udhëzimin e KM nr. 2, datë 13.05.2005 óPër zbatimin e punimeve të ndërtimitó, kreu III, pika 4.
Ndikimi/Efekti:	Vlera 1,029,300 lekë konsiderohet efekt negativ financiar.
Shkaku:	Mangësi në ndjekjen e preseve të ndërtimit të impiantit.
Rëndësia:	E mesme.
Rekomandime:	AKUM në bashkëpunim me mbikëqyrësin e punimeve të marrë masa duke i kërkuar kontraktorit përmirësimin dhe rregullimet përkatëse të identifikuara, si dhe realizimin e zërit mbushje me dhe humosor mbi soletë, brenda periudhës së garancisë së defekteve.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

Mbikëqyrësi i punimeve Shoqëria "T." SHPK.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar Shoqëria óT.ó SHPK, është paraqitur shkresa nr. 282/2 prot., datë 16.02.2022, protokolluar në KLSH me nr. 888/11, datë 24.02.2022, sipas të cilës i kërkohet Kontraktorit, marrja e masave sipas rekomandimit të KLSH për përmirësimet dhe rregullimet përkatëse.

III.7. Mbi zbatimin e procedurave të prokurimit për blerjet me vlera të vogël.

Në zbatim të pikës 7, óMbi zbatimin e procedurave të prokurimit për blerjet me vlerë të vogëló të Programit të Auditimit, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- Regjistri i realizimeve të prokurimeve për periudhën 31.07.2019 ñ 31.12.2019;
- Regjistri i realizimeve të prokurimeve për vitin 2020;
- Regjistri i realizimeve të prokurimeve për periudhën 01.01.2021 ñ 30.06.2021;
- Të gjitha procedurat e prokurimit me vlera të vogla për periudhën 31.07.2019 ñ 30.06.2021.

Gjatë periudhës 31.07.2019 ñ 31.12.2019 janë realizuar 4 procedura prokurimi blerje me vlerë të vogël me fond limit në shumën 1,816,666 lekë pa TVSH dhe me vlerë kontrate në shumën 1,289,800 lekë pa TVSh. Këto procedura u audituan të gjitha.

Titullari i autoritetit kontraktor AKUM ka ngritur një komision për prokurimet me vlerë të vogël për vitin 2019 me Urdhrin Nr. 1 datë 03.01.2019 me përbërjen: L.V., Kryetar, M.M., Anëtare dhe L.H., Anëtare. Me Urdhrin Nr. 104 datë 02.09.2019, znj. L.V.u zëvendësua nga E.S..

Nga dokumentacioni i lartpërmendur dhe të dhënat e vëna në dispozicion të grupit të auditimit, u zhvillua auditimi i procedurave si më poshtë vijon:

1. Pjesë këmbimi (filtra, bateri goma antifrizë alkol frenash);
2. Tonerë;
3. Riparim dhe shërbim automjete;
4. Letër A3, A4, kancelari etj.

Gjatë vitit 2020 janë realizuar 3 procedura prokurimi blerje me vlerë të vogël me fond limit në shumën 2,183,333 lekë pa TVSH dhe me vlerë kontrate në shumën 1,585,169 lekë pa TVSh. Këto procedura u audituan të gjitha.

Titullari i autoritetit kontraktor AKUM ka ngritur një komision për prokurimet me vlerë të vogël për vitin 2020 me Urdhërin Nr. 16 datë 16.01.2020 me përbërjen: E.S., Kryetar, M.M., Anëtare dhe L.H., Anëtare. Me Urdhërin Nr. 59 datë 25.06.2020, pas zëvendësimit të një anëtari përbërja e Komisionit rezulton: M.M., Kryetar, F.B., Anëtare dhe L.H., Anëtare.

Me miratimin e Urdhrit Nr. 65 datë 09.07.2020, pas zëvendësimit të një anëtari përbërja e Komisionit rezulton: M.M., Kryetar, F.B., Anëtare dhe A.A., Anëtare.

Nga dokumentacioni i lartpërmendur dhe të dhënat e vëna në dispozicion të grupit të auditimit, u zhvillua auditimi i procedurave si më poshtë vijon:

1. Letër A3, A4, kancelari etj;
2. Riparim dhe shërbim automjete;
3. Tonerë.

Gjatë periudhës 01.01.2021 në 30.06.2021 janë realizuar procedura prokurimi blerje me vlerë të vogël me fond limit në shumën 1,513,452 lekë pa TVSH dhe me vlerë kontrate në shumën 1,183,469 lekë pa TVSh. Këto procedura u audituan të gjitha.

Titullari i autoritetit kontraktor AKUM ka ngritur një komision për prokurimet me vlerë të vogël për vitin 2021 me Urdhërin Nr. 5, datë 07.01.2021 me përbërjen: L.V., Kryetar, M.M., Anëtare dhe A.A., Anëtare.

Me Urdhërin Nr. 51 datë 17.06.2021, pas zëvendësimit të një anëtari përbërja e Komisionit rezulton: L.V., Kryetar, M.M., Anëtare dhe F.S., Anëtare.

Nga dokumentacioni i lartpërmendur dhe të dhënat e vëna në dispozicion të grupit të auditimit, u zhvillua auditimi i procedurave si më poshtë vijon:

1. Kolaudim punimesh për objektin "Furnizim me ujë i qytetit të Kukësit dhe 14 fshatrave rreth saj " faza II" (shitesë kontrate);
2. Kolaudim punimesh për objektin "Furnizim me ujë i qytetit të Kukësit dhe 14 fshatrave rreth saj " faza II";
3. Riparim dhe shërbim automjete.

Pas auditimit të dhjetë procedurave të prokurimit me vlerë të vogël:

1. Pjesë këmbimi (filtra, bateri goma antifrizë alkol frenash) sipas Urdhërit të Prokurimit nr. 2277 prot., datë 01.08.2019;
2. Tonerë, sipas Urdhrit të Prokurimit nr. 3248, datë 31.10.2019;
3. Riparim dhe shërbim automjete, sipas Urdhërit të Prokurimit nr. 3373 prot., datë 11.11.2019;
4. Letër A3, A4, kancelari etj., sipas Urdhrit të Prokurimit nr. 3267 prot., datë 01.11.2019;
5. Letër A3, A4, kancelari etj., sipas Urdhrit të Prokurimit nr. 2577 prot., datë 13.10.2020;
6. Riparim dhe shërbim automjete, sipas Urdhrit të Prokurimit nr. 1645 prot., datë 06.07.2020;
7. Tonerë, sipas Urdhrit të Prokurimit nr. 2578, datë 13.10.2020;
8. Kolaudim punimesh për objektin "Furnizim me ujë i qytetit të Kukësit dhe 14 fshatrave rreth saj " faza II" (shitesë kontrate), sipas Urdhrit të Prokurimit nr. 1345, datë 17.06.2021;

9. Kolaudim punimesh për objektin "Furnizim me ujë i qytetit të Kukësit dhe 14 fshatrave rreth saj " faza II", sipas Urdhrit të Prokurimit nr. 1355, datë 17.06.2021;

10. Riparim dhe shërbim automjeteve, sipas Urdhrit të Prokurimit nr. 1079 prot., datë 24.06.2021,

u konstatuan shkeljet procedurale sa më poshtë:

1. Titulli i gjetjes:	Përgatitja e specifikimeve nuk është bërë nga Komisioni i prokurimit me vlera të vogla, apo një tjetër komision i ngritur me urdhër të posaçëm të Titullarit, por nga persona të paautorizuar me Urdhër nga Titullari i AKUM, <i>në 8 raste.</i>
Situata:	Nga auditimi i procedurave të prokurimeve me vlerë të vogël u konstatua se për procedurat 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 10, përkatësisht: • Pjesë këmbimi (filtra, bateri goma antifrizë alkol frenash); • Tonerë; • Riparim dhe shërbim automjeteve; • Letër A3, A4, kancelari etj; • Letër A3, A4, kancelari etj; • Riparim dhe shërbim automjeteve; • Tonerë; • Riparim dhe shërbim automjeteve përgatitja e specifikimeve nuk është bërë nga Komisioni i prokurimit me vlera të vogla, apo një tjetër komision i ngritur me urdhër të posaçëm të Titullarit, por nga persona të paautorizuar me Urdhër nga Titullari i AKUM.
Kriteri:	Udhëzimi nr. 3 i APP, datë 08.01.2018 óMbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike, i ndryshuar, pika 5: óPërpara nxjerrjes së urdhrit të prokurimit nga titullari i autoritetit kontraktor ose personi i autorizuar prej tij, komisioni i prokurimit me vlerë të vogël, pasi të ketë siguruar apo hartuar specifikimet teknike/termat e referencës, përlogarit fondin për sasinë e mallrave, shërbimeve, punëve që do të prokurojë, në përputhje me nenin 59 të VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 óPër miratimin e rregullave të prokurimit publikó i ndryshuar, nëse kjo detyrë nuk i është ngarkuar paraprakisht një strukture të posaçme.
Ndikimi:	Mospërgatitja e specifikimeve nga Komisioni i prokurimit me vlera të vogla, apo një tjetër komision i ngritur me urdhër të posaçëm të Titullarit, rrit mundësinë për efektivitet dhe efikasitet të munguar.
Shkaku	Praktikë e ndjekur në vijimësi për shkak të një shpërnadarje kompetencash óin bonisó (në mirëkuptim mes palëve).
Rëndësia:	E ulët.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Projekt Raportit të Auditimit, nga subjekti i audituar AKUM është paraqitur observacioni me shkresë nr. 2540/2 prot., të datës 17.12.2021, si më poshtë, cituar në ligjëratë të drejtë:

Pretendimi i subjektit:

A. Një pjesë e personave të ngarkuar me përgjegjësi, sikurse nga shkresa nr. 2540/2 prot., e datës 17.12.2021 bien dakord me gjetjen dhe shprehen në observacione për secilën procedurë veçmas se: ó.... Përsa më sipër, ky konstatim do të respektohet në procedurat në vijimô.

B. Në observacionin e ardhur me shkresën nr. 2540/1 prot., të datës 17.12.2021 nga z. A.A. lidhur me procedurat e prokurimit me vlerë të vogël:óTонераô,sipas Urdhrit të Prokurimit nr. 3248, datë 31.10.2019 dhe óTонераô,sipas Urdhrit të Prokurimit nr. 2578, datë 13.10.2020, vihet në dukje se: óSa i përket konstatimit tuaj se nuk ka patur një urdhër për hartimin e specifikimeve teknike dhe përllogaritjen e fondit limit, po ju bëjmë me dije se praktika e konceptimit të kërkesës për prokurim (e cila përmban përllogaritjen e fondit limit referuar sasisë së nevojshme dhe specifikimet teknike) është kryer si praktikë nga Sektori i Burimeve Njerëzore, si sektor përgjegjës për mbledhjen e kërkesave, në rolin e personit përgjegjës për administrimin e magazinës. Hartimi i kërkesës për prokurim bazohet mbi specifikimet e pajisjeve printera/fotokoje etj, që disponon fizikisht dhe përdor për nevojat e veta stafi i AKUM. Janë pikërisht këto pajisje të cilat përcaktojnë dhe diktojnë automatikisht dhe ngushtësisht hartimin e specifikimeve teknike për mallin Toner, si dhe përllogaritjen e fondit limit në bazë të sasisë të nevojshme dhe praktikata e mëparshme, nga sektori i Burimeve Njerëzore.

Në çdo rast përsa më sipër, ju bëj me dije se në cilësinë e Drejtorit të Drejtorisë, kam miratuar kërkesën nga Përgjegjësi i Burimeve Njerëzore, në bazë të nevojave të institucionit, me qëllim vazhdimin e procedurës së prokurimit nga Komisioni i Blerjeve të Vogla. Në këtë rast asesi në rolin dhe në funksionin që kam mbajtur si Drejtori i Drejtorisë nuk kam hartuar Specifikimet Teknike për këto nevoja të institucionit, por kam miratuar Kërkesën për kryerjen e kësaj procedure, sipas rolit dhe detyrave funksionale që ky vend pune kaô.

Po ashtu, lidhur me dy procedurat e prokurimit me vlerë të vogël: óLetër A3, A4, kancelari etj.ô, sipas Urdhrit të Prokurimit nr. 3267 prot., datë 01.11.2019 dhe óLetër A3, A4, kancelari etj.ô, sipas Urdhrit të Prokurimit nr. 2577 prot., datë 13.10.2020, vihet në dukje se: óë përsa i përket gjetjes se nuk ka patur një urdhër për hartimin e specifikimeve teknike dhe përllogaritjen e fondit limit referuar Ofertave të marra nëpërmjet email-it dhe specifikimet teknike) është kryer si praktikë nga Sektori i Burimeve Njerëzore, si sektor përgjegjës për mbledhjen e kërkesave dhe nevojave të stafit të AKUM për këto mallra, në rolin e personit përgjegjës për administrimin e magazinës.

Ky sektor ka hartuar bashkëlidhur kërkesës për prokurim specifikimet bazuar në pajisjet që stafi përdor për pune dhe disponon fizikisht në AKUM bazuar në nevojat e secilit sektor apo drejtori që lidhen me hartimin e specifikimeve teknike, si dhe përllogaritjen e fondit limit në bazë të sasisë të nevojshme dhe ofertave që ka marrë nga operatorë ekonomikë, të cilët e kanë fushën e veprimtarisë të njëjtë me procedurën që do prokurohet. Duke konsideruar llojin e mallit që kërkuar të procedohet për prokurim nisur nga nevojat e institucionit, këto mjete kancelarie nuk kërkojnë një ekspertizë specifike për të përgatitur dokumentacion mbështetës si specifikime teknike apo fond limit, nisur nga praktikata e mëparshme.

Në çdo rast përsa më sipër, ju bëj me dije se në cilësinë e Drejtorit të Drejtorisë, kam miratuar kërkesën nga Përgjegjësi i Burimeve Njerëzore, në bazë të nevojave të institucionit, me qëllim vazhdimin e procedurës së prokurimit nga Komisioni i Blerjeve të Vogla. Në këtë rast asesi në rolin dhe në funksionin që kam mbajtur si Drejtori i Drejtorisë nuk kam hartuar Specifikimet Teknike për këto nevoja të institucionit, por kam miratuar kërkesën për kryerjen e kësaj procedure, sipas rolit dhe detyrave funksionale që ky vend pune kaô.

C. Në observacionin e ardhur nga z. A.B., në pikën i), lidhur me procedurat e prokurimit me vlerë të vogël: óRiparim dhe shërbim automjeteshôsipas Urdhrit të Prokurimit nr. 3373 prot., datë 11.11.2019 dhe óRiparim dhe shërbim Automjeteshô, sipas Urdhrit të Prokurimit nr. 1645 prot., datë 06.07.2020 vihet në dukje: óPraktika për Kryerjen e procedurave të prokurimit , ndiqet dhe zbatohet nga Komisioni i prokurimit për blerje të vogla, duke shoqëruar procedurat respektive me dokumentacionin e llogaritjeve të fondit limit, specifikimeve teknike apo të tjera në zbatim të ligjit për të përmbyllur praktikën e nevojshme. Për më shumë, çdo dokumentacion që njësitë mund të përgatisin duke konsideruar nevojat e institucionit apo në raste të tjera urdhra të miratuara nga titullari, që lidhen ngushtësisht me procedurat që ky komision ndjek, janë të njohura dhe të dokumentuar për komisionin përpara se ai të vijojë me kryerjen e procedurës së prokurimit. Në rastet kur komisioni nuk disponon të dokumentuar praktikën e plotë apo vëren mangësi apo argumentim, për të iniciuar procedurën e prokurimit, kërkon dhe angazhohet për plotësimin e tyre, duke u drejtuar dhe kërkuar angazhimin njësive përgjegjëse që e kanë iniciuar kërkesën.

Në çdo rast dhe pavarësisht sa më lart detajuar, përpilimi dhe kontrolli i procedurave apo praktikave shoqëruar me dokumentacionin mbështetës, është detyrë funksionale dhe përgjegjësi e njësive dhe e drejtuesve në nivele të ndryshme brenda njësive, që bazuar në kuadrin ligjor i cili rregullon funksionimin dhe organizimin e AKUM, sipërcituar, ngarkohen për zbatim....ô.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit:

A. Dakortësia me konstatimet dhe gjetjet e GA nga ana e të ngarkuarve me përgjegjësi e bën të panevojshëm ritrajtimin e rasteve ku janë anashkaluar rregullat që duhen respektuar për procedurat e prokurimeve me vlerë të vogël.

B. Për sa observuar nga z. A.A., vëmë në dukje se:

Referuar praktikës së prokurimit me vlerë të vogël (si njëra prej procedurave të konstatuara me shkelje), óTonaô,sipas Urdhrit të Prokurimit nr. 3248, datë 31.10.2019, me kërkesën (pa datë dhe numër protokolli) drejtuar Komisionit të Prokurimit me vlerë të vogël dhe jo Titullarit, e Drejtorit të Drejtorisë Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse, z. A.A., është justifikuar kërkesa e kryerjes së prokurimit nga shënimi: óBazuar në regjistrin e prokurimeve të vitit 2019ô, specifikimet teknike, lidhur me mallrat e nevojshëm për tûi prokuruar, janë përgatitur nga z. A.A., si të përfshirë në kërkesën e mësipërme dhe jo nga një komisioni. Po ashtu nuk dokumentohet se ky dokument është përpiluar si aktmiratimi i kërkesës të ardhur nga Përgjegjësi i Sektorit të burimeve Njerëzore. Si i tillë akti rezulton i përpiluar me nismën e z. A.. Bashkëlidhur keni dërguar një Memo me lëndë tjetër: Kërkesë për lidhje kontrate vjetore për óShërbimin e riparimit të autovetuarave të AKUMô.

Pavarësisht se nevojat e autoritetit kontraktor mund të jenë lehtësisht të identifikueshme, ôë pa kërkuar një ekspertizë specifike për të përgatitur dokumentacion mbështetës si specifikime teknike apo fond limit, nisur nga praktikat e mëparshme ë ,ô, sikurse ju vini në dukje, legjislacioni në fuqi parashikon administrimin e procedurave të prokurimit nga komisione dhe jo nga persona që veprojnë mbi bazën e një nisme personale.

Ndaj observacioni nuk merret në konsideratë.

C. Për sa observuar nga z. A.B., lidhur me procedurën óRiparim dhe shërbim automjeteshôsipas Urdhrit të Prokurimit nr. 3373 prot., datë 11.11.2019 vëmë në dukje se: Specifikimet e përfshira në Memon nga z. H.H., janë huazuar nga AK për të përpiluar specifikimet teknike e Ftesës për

Ofertë nr. 3373/1, të datës 11.11.2019, hedhur në portalin e AAA, më 12.11.2019, ndërkohë që specifikimet nuk janë përpiluar nga një komision i posaçëm (mungon Urdhri për ngritjen e komisionit të përgatitjes së specifikimeve teknike për procedurën e prokurimit). Z. H.H. nuk e ka dokumentuar se ka vepruar në zbatim të një Urdhri të Titullarit të AKUM për përgatitjen e specifikimeve, ndërkohë që Komisioni i prokurimit me vlera të vogla do duhej t'ia kishte hartuar vetë këto specifikime në mungesë të një urdhër tjetër. Mirëpo lidhur me ekzistencën e një Urdhri tjetër paralel të Drejtorit të Përgjithshëm, Komisioni i prokurimit me vlera të vogla nuk ka si të ketë dijeni, bile ka arsye t'ia marrë për të mirëqenë ekzistencën, përderisa Drejtori i Përgjithshëm ka miratuar Memon në të gjithë përmbajtjen e saj.

Drejtori i Përgjithshëm, z. A.B. ka vepruar po ashtu në shkelje, kur ka miratuar përmbajtjen e Memos.

Specifikimet janë përgatitur nga një punonjës i paautorizuar dhe jo nga Komisioni i prokurimit me vlera të vogla.

Lidhur me procedurën e riparimit dhe shërbim Automjetesh, sipas Urdhrit të Prokurimit nr. 1645 prot., datë 06.07.2020, vëmë në dukje se: Specifikimet e përfshira në Memon nga z. H. H., janë huazuar nga AK për të përpiluar specifikimet teknike e Ftesës për Ofertë nr. 1645/1, të datës 06.07.2020, hedhur në portalin e AAA, më 08.07.2020, dhe ndërkohë që ato nuk janë përpiluar nga një komision i posaçëm. Mungon Urdhri për ngritjen e komisionit të përgatitjes së specifikimeve teknike për procedurën e prokurimit, si dhe nuk dokumentohet ekzistenca e një Urdhri që ngarkon z. H. H. me këtë detyrë.

Mungon pra Urdhri për ngritjen e komisionit për përgatitjen e specifikimeve teknike për procedurën e prokurimit, ndërkohë që Komisioni i prokurimit me vlera të vogla do duhej t'ia kishte përgatitur vetë specifikimeve teknike në mungesë të një Urdhri tjetër. Mirëpo lidhur me ekzistencën e një Urdhri të tillë të Drejtorit të Përgjithshëm, që mund të autorizonte të tjerë, Komisioni i prokurimit me vlera të vogla nuk ka si të ketë dijeni, bile ka arsye t'ia marrë për të mirëqenë ekzistencën, përderisa Drejtori i Përgjithshëm ka miratuar Memon në të gjithë përmbajtjen e saj. Drejtori i Përgjithshëm, z. A.B. ka vepruar po ashtu në shkelje, kur ka miratuar përmbajtjen e Memos.

Konsideruar se sikurse konstatuar nga GA në aktokonstatimin nr. 3, datë 10.12.2021, sikurse më lart cituar, nuk është prekur nga observacioni, bën që observacioni të mos merret në konsideratë.

Për mangësitë e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi: H.H., Përgjegjës i Sektorit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse; L.V., në cilësinë e Kryetares së Komisionit të Prokurimeve me vlerë të vogël; M.M., në cilësinë e Anëtares së Komisionit të Prokurimeve me vlerë të vogël; L.H., në cilësinë e Anëtares së Komisionit të Prokurimeve me vlerë të vogël; A.A., Drejtor i Drejtorisë Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse; E.S., në cilësinë e Kryetarit të Komisionit të Prokurimeve me vlerë të vogël; A.B., në cilësinë e Titullarit të AK, AKUM; A. A., në cilësinë e Anëtares së Komisionit të Prokurimeve me vlerë të vogël; F.B., në cilësinë e Anëtares së Komisionit të Prokurimeve me vlerë të vogël; F.Sh., në cilësinë e Titullarit të deleguar me autorizimin nr. 251, datë 29.01.2021.

Për sa më sipër është mbajtur Aktkonstatimi nr. 3, datë 10.12.2021.

2. Titulli i gjetjes:	Përlllogaritja e fondit limit nuk është bërë Komisioni i prokurimit me vlera të vogla, apo një tjetër komision i ngritur me urdhër të posaçëm të Titullarit, por nga persona të paautorizuar me Urdhër nga Titullari i AKUM, në 10 rastet e audituara.
------------------------------	---

Situata:	Nga auditimi i procedurave tëprokurimeve me vlerë të vogël u konstatua se për procedurat 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, përkatësisht: • Pjesë këmbimi (filtra, bateri goma antifrizë alkol frenash); • Tonerë; • Riparim dhe shërbim automjesh; • Letër A3, A4, kancelari etj; • Letër A3, A4, kancelari etj; • Riparim dhe shërbim automjesh; • Tonerë; • Kolaudim punimesh për objektin "Furnizim me ujë i qytetit të Kukësit dhe 14 fshatrave rreth saj " faza II" (shtesë kontrate); • Kolaudim punimesh për objektin "Furnizim me ujë i qytetit të Kukësit dhe 14 fshatrave rreth saj " faza II"; • Riparim dhe shërbim automjesh, përlllogaritja e fondit limit nuk është bërë Komisioni i prokurimit me vlera të vogla, apo një tjetër komision i ngritur me urdhër të posaçëm të Titullarit, por nga persona të paautorizuar me Urdhër nga Titullari i AKUM.
Kriteri:	Udhëzimi nr. 3 i APP, datë 08.01.2018 óMbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike, i ndryshuar, pika 5: óPërpara nxjerrjes së urdhrit të prokurimit nga titullari i autoritetit kontraktor ose personi i autorizuar prej tij, komisioni i prokurimit me vlerë të vogël, pasi të ketë siguruar apo hartuar specifikimet teknike/termat e referencës, përlllogarit fondin për sasinë e mallrave, shërbimeve, punëve që do të prokurojë, në përputhje me nenin 59 të VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 óPër miratimin e rregullave të prokurimit publikó i ndryshuar, nëse kjo detyrë nuk i është ngarkuar paraprakisht një strukture të posaçme. Vendimi Nr. 914, datë 29.12.2014 óPër miratimin e rregullave të prokurimit publikó, i ndryshuar, neni 59, pika 1: óPërlllogaritja e vlerës limit të kontratës bëhet nga njësia e prokurimit, nëse kjo detyrë nuk i është ngarkuar një strukture të posaçme dhe pika 2: óAutoriteti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrit të prokurimit, duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përlllogaritjen e vlerës së kontratës, bazuar në specifikimet teknike të objektit që prokurohet.
Ndikimi:	Mos përlllogaritja e fondit limit nga Komisioni i prokurimit me vlera të vogla, apo një tjetër komision i ngritur me urdhër të posaçëm të Titullarit, rrit mundësinë për ekonomikitet të munguar.
Shkaku	Praktikë e ndjekur në vijimësi për shkak të një shpërndarje kompetencash óin bonisó (në mirëkuptim mes palëve).
Rëndësia:	E ultë.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Projekt Raportit të Auditimit, nga subjekti i audituar AKUM është paraqitur observacioni me shkresë nr. 2540/2 prot., të datës 17.12.2021, nr. 2540/1 prot., të datës 17.12.2021, si më poshtë, cituar në ligjëratë të drejtë:

Pretendimi i subjektit:

A. Një pjesë e personave të ngarkuar me përgjegjësi, sikurse nga shkresa nr. 2540/2 prot., e datës 17.12.2021 bien dakord me gjetjen dhe shprehen në observacione për secilën procedurë veçmas se: ó.... Përsa më sipër, ky konstatim do të respektohet në procedurat në vijimô.

B. Observacionin e ardhur me shkresën nr. 2540/1 prot., të datës 17.12.2021 nga z. A.A. lidhur me procedurat e prokurimit me vlerë të vogël i cituam në bllok në paragrafin e mëparshëm.

C. Observacioni i ardhur me shkresën nr. 2540/2 prot., të datës 17.12.2021 nga z. F.Sh., znj. V.B., znj. L.H. dhe z. Th.M.lidhur me procedurat e prokurimit me vlerë të vogël: óKolaudim punimesh për objektin "Furnizim me ujë i qytetit të Kukësit dhe 14 fshatrave rreth saj" faza II" (shitesë kontrate)ô,sipas Urdhrit të Prokurimit nr. 1345, datë 17.06.2021 dhe óKolaudim punimesh për objektin "Furnizim me ujë i qytetit të Kukësit dhe 14 fshatrave rreth saj" faza II"ô,sipas Urdhrit të Prokurimit nr. 1355, datë 17.06.2021, vë në dukje se: óReferuar óRregullores për Organizimin dhe funksionimin dhe Funksionimin të AKUMô miratuar me Urdhrin Nr.,Nr 2104 prot.,datë 24.02.2020 ju sqarojmë si më poshtë:

Spektori i planifikimit të Investimeve ndër detyrat funksionale ka dhe detyrën sipas pikës j të rregullores te Spektori i planifikimit të Investimeve, si më poshtë citoj:

óPlanifikon ndarjen e fondeve të objekteve për Ndërtim Montim, Mbikëqyrje dhe Kolaudim përpara fillimit të procedurave të prokurimit ó

Spektori i planifikimit në përgatitjen e buxhetit ku parashikohen Investimet llogarit paraprakisht vlerat për objektet mbikëqyrje dhe kolaudim objekteve në zbatim të VKM 354,datë 11.05.2016 óPër miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikimin territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudimô të cilat kanë kod të veçantë në buxhet për arsye Tenderimi.

Për sa më sipër meqë AKUM në rastet e shpërmendura është AK llogaritja është paraprakisht nga Spektori I Planifikimit të Investimeve e cila shërben për vazhdimin e procedurave të prokurimit të AKUM.

Pra rezulton se Spektori planifikimit të investimeve e ka detyrë funksionale óPlanifikimin e ndarjes së fondeve të objekteve për Ndërtim Montim, Mbikëqyrje dhe Kolaudim përpara fillimit të procedurave të prokurimit dhe nuk ka nevojë për autorizim apo urdhër për të vepruar sipas detyrave funksionale të miratuar nga Rregullorjaô.

D. Observacioni i ardhur nga z. A.B., në pikën i), lidhur me procedurat e prokurimit me vlerë të vogël: óRiparim dhe shërbim automjeteshôsipas Urdhrit të Prokurimit nr. 3373 prot., datë 11.11.2019 dhe óRiparim dhe shërbim Automjeteshô, sipas Urdhrit të Prokurimit nr. 1645 prot., datë 06.07.2020 u citua në paragrafin e mëparshëm.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit:

A. Dakortësia me konstatimet dhe gjetjet e GA nga ana e të ngarkuarve me përgjegjësi e bën të panevojshëm ri trajtimin e rasteve ku janë anashkaluar rregullat që duhen respektuar për procedurat e prokurimeve me vlerë të vogël.

B.Observacionet e ardhura me shkresën nr. 2540/1 prot., të datës 17.12.2021 nga z. A.A. lidhur me procedurat e prokurimit me vlerë të vogël, nuk merren në konsideratë.

C.Observacioni i ardhur me shkresën nr. 2540/2 prot., të datës 17.12.2021 nga z. F.Sh., znj. V.B., znj. L.H. dhe z. Th.M.lidhur me procedurat e prokurimit me vlerë të vogël: óKolaudim punimesh për objektin "Furnizim me ujë i qytetit të Kukësit dhe 14 fshatrave rreth saj" faza II" (shtesë kontrate)ó,sipas Urdhrit të Prokurimit nr. 1345, datë 17.06.2021 dhe óKolaudim punimesh për objektin "Furnizim me ujë i qytetit të Kukësit dhe 14 fshatrave rreth saj" faza II"ó,sipas Urdhrit të Prokurimit nr. 1355, datë 17.06.2021, merret në konsideratë.

D. Sa i përket procedure së prokurimit me vlerë të vogël: óRiparim dhe shërbim automjeteshósipas Urdhrit të Prokurimit nr. 3373 prot., datë 11.11.2019, lidhur me përllogaritjen e vlerës limit, rezulton se z. H.H. nuk e ka dokumentuar se ka vepruar në zbatim të një Urdhri të Titullarit të AKUM për përcaktimin e fondit limit, si dhe në dosje nuk dokumentohen ofertat, si dhe çmimet e blerjeve të mëparshme, ndërkohë që Komisioni i prokurimit me vlera të vogla do duhej t'ia kishte përcaktuar vetë fondin limit, në mungesë të një Urdhri tjetër. Mirëpo lidhur me ekzistencën e një Urdhri tjetër paralel të Drejtorit të Përgjithshëm, Komisioni i prokurimit me vlera të vogla nuk ka si të ketë dijeni, biles ka arsye t'ia marrë për të mirëqenë ekzistencën, përderisa Drejtori i Përgjithshëm ka miratuar Memon në të gjithë përmbajtjen e saj.

Drejtori i Përgjithshëm, z. A.B.ka vepruar po ashtu në shkelje, kur ka miratuar përmbajtjen e Memos.

Sa i përket procedure së prokurimit me vlerë të vogël: óRiparim dhe shërbim Automjeteshó, sipas Urdhrit të Prokurimit nr. 1645 prot., datë 06.07.2020, fondi limit u përcaktua në vlerën 960,000 lekë me TVSH (ndr. apo 800,000 lekë pa TVSH), jo nga Komisioni i llogaritjes së fondit limit (nuk dokumentohet miratimi i një Urdhri për ngritjen e komisionit që përcakton fondin limit), por nga vetë kërkuesi (nuk dokumentohet ekzistenca e një Urdhëri që i ngarkon këtë detyrë z. H.) i zhvillimit të procedurës së prokurimit në fjalë, z. H.H., i cili në Memon e mësipërme, në të cilën thuhet se óNë Regjistrin e Parashikimeve të Prokurimeve Publike për vitin 2020, të AKUM për zërin óRiparim dhe shërbim Automjeteshó është miratuar fondi limit 960 mijë lekë (me TVSH).

Fondi limit u përcaktua mbi një bazë të dhëna çmimesh të papërcaktuar dhe dokumentuar, si burim dhe mbi bazën e specifikimeve të bëra në Memon e z. H.H., dhe jo mbi bazën e specifikimeve të ndonjë komisioni që përgatit specifikimet teknike meqë mungon Urdhri për ngritjen e komisionit që përgatit specifikimet teknike, ndërkohë që Komisioni i prokurimit me vlera të vogla do duhej t'ia kishte përcaktuar vetë fondin limit në mungesë të një Urdhri tjetër. Mirëpo lidhur me ekzistencën e një Urdhri të tillë të Drejtorit të Përgjithshëm, që mund të autorizonte të tjerë, Komisioni i prokurimit me vlera të vogla nuk ka si të ketë dijeni, biles ka arsye t'ia marrë për të mirëqenë ekzistencën, përderisa Drejtori i Përgjithshëm ka miratuar Memon në të gjithë përmbajtjen e saj. Drejtori i Përgjithshëm, z. A.B.ka vepruar po ashtu në shkelje, kur ka miratuar përmbajtjen e Memos.

Për sa më sipër observacionet e z. A.B.nuk merren në konsideratë.

Për mangësitë e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi: H.H., Përgjegjës i Sektorit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse; L.V., në cilësinë e Kryetares së Komisionit të Prokurimeve me vlerë të vogël; M.M., në cilësinë e Anëtares së Komisionit të Prokurimeve me vlerë të vogël; L.H., në cilësinë e Anëtares së Komisionit të Prokurimeve me vlerë të vogël; A.A., Drejtor i Drejtorisë Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse; E.S., në cilësinë e Kryetarit të Komisionit të Prokurimeve me vlerë të vogël; A.B., në cilësinë e Titullarit të AK, AKUM; Aulona Avdualaj, në cilësinë e Anëtares së Komisionit të Prokurimeve me vlerë të vogël; F.B., në

cilësinë e Anëtares së Komisionit të Prokurimeve me vlerë të vogël; F.Sh., në cilësinë e Titullarit të deleguar me autorizimin nr. 251, datë 29.01.2021.

Për sa më sipër është mbajtur Aktkonstatimi nr. 3, datë 10.12.2021.

3. Titulli i gjetjes:	Marrja e mallrave dhe shërbimeve nuk është bërë nga Komisioni i marrjes në dorëzim të aktiveve, apo nga ndonjë komision i ngritur me urdhër të posaçëm nga Titullari i AKUM, në 4 raste; 1, 3, 6, 10.
Situata:	Nga auditimi i procedurave të prokurimeve me vlerë të vogël u konstatua se për procedurat 1, 3, 6, 10, përkatësisht: • Pjesë këmbimi (filtra, bateri goma antifrizë alkol frenash); • Riparim dhe shërbim automjesh; • Riparim dhe shërbim automjesh; • Riparim dhe shërbim automjesh, marrja e mallrave dhe shërbimeve nuk është bërë nga Komisioni i marrjes në dorëzim të aktiveve, apo nga ndonjë komision i ngritur me urdhër të posaçëm nga Titullari i AKUM.
Kriteri:	Udhëzimi Nr. 30, datë 27.12.2011, óPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikó ndryshuar, pika 42: óTitullari i njësisë miraton urdhrin për ngritjen e komisionit për marrjen në dorëzim të aktiveve të furnizuara për sasinë, cilësinë, llojin, plotësinë e tyre dhe të dokumentacionit shoqëruesó, dhe pika 43: óKomisioni përbëhet nga specialistë të fushës sipas llojit të aktiveve dhe, në rast nevojë, edhe nga ekspertë të jashtëm. Në komision bëjnë pjesë jo më pak se tre veta, duke përfshirë edhe punonjësin me përgjegjësi materialó.
Ndikimi:	Mosmarrja e mallrave dhe shërbimeve nga Komisioni i marrjes në dorëzim të aktiveve, apo nga ndonjë komision i ngritur me urdhër të posaçëm nga Titullari i AKUM rrit mundësinë që zbatimi i detyrimeve nga ana e OE të mos jetë i përpiktë.
Shkaku	Praktikë e ndjekur në vijimësi për shkak të një shpërndarje kompetencash óin bonisó (në mirëkuptim mes palëve).
Rëndësia:	E ultë.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Projekt Raportit të Auditimit, nga subjekti i audituar AKUM është paraqitur observacioni me shkresë nr. 2540/2 prot., të datës 17.12.2021, si më poshtë, cituar në ligjëratë të drejtë:

Pretendimi i subjektit:

A. Personave të ngarkuar me përgjegjësi, sikurse nga shkresa nr. 2540/2 prot., e datës 17.12.2021 bien dakord me gjetjen dhe shprehen në observacione për secilën procedurë veçmas se: ó... Përsa më sipër, ky konstatim do të respektohet në procedurat në vijimó.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit:

A. Dakortësia me konstatimet dhe gjetjet e GA nga ana e të ngarkuarve me përgjegjësi e bën të panevojshëm rritja të rasteve ku janë anashkaluar rregullat që duhen respektuar për procedurat e prokurimeve me vlerë të vogël.

Për mangësitë e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi: V.B., në cilësinë e Kryetares së Komisionit për marrjen në dorëzim të aktiveve të furnizuara, A.ç., në cilësinë e Anëtares së Komisionit për marrjen në dorëzim të aktiveve të furnizuara, H.H., në cilësinë e Anëtarit të Komisionit për marrjen në dorëzim të aktiveve të furnizuara.

Për sa më sipër është mbajtur Aktkonstatimi nr. 3, datë 10.12.2021

4. Titulli i gjetjes:	Urdhri i Prokurimit nuk përmban emrat e anëtarëve të Komisionit të Prokurimit, në 5 raste; 1, 2, 3, 4, 6.
Situata:	Nga auditimi i procedurave tëprokurimeve me vlerë të vogël u konstatua se për procedurat 1, 2, 3, 4, 6, përkatësisht: • Pjesë këmbimi (filtra, bateri goma antifrizë alkol frenash); • Tonerë; • Riparim dhe shërbim automjete; • Letër A3, A4, kancelari etj; • Riparim dhe shërbim automjete, Urdhri i Prokurimit nuk përmban, emrat e anëtarëve të Komisionit të Prokurimit për Blerjet e Vogla
Kriteri:	Vendimi Nr. 914, datë 29.12.2014 óPër miratimin e rregullave të prokurimit publikó, i ndryshuar, neni 60: óKur ka nevojë për punë/mallra/shërbime, pas përllogaritjes së fondit limit sipas nenit 59 të këtyre rregullave, titullari i autoritetit kontraktor apo zyrtari i autorizuar nxjerr menjëherë urdhrin e prokurimit, i cili duhet të përmbajë: - objektin e prokurimit; - fondin e përllogaritur të vitit buxhetor, si dhe fondin total të përllogaritur, në rastin e kontratave shumëvjeçare dhe marrëveshjes kuadër; - llojin e procedurës së prokurimit, arsyet e përdorimit të saj ose mënyrën e prokurimit (nëse është rasti); - emrat e anëtarëve të njësisë së prokurimit.
Ndikimi:	Mospërfshirja e emrave të anëtarëve të Komisionit të Prokurimit për Blerjet e Vogla, në urdhrin e prokurimit, bën që komisioni të ndeshë vështirësi në komunikimin me hallkat e tjera të njësisë prokuruese.
Shkaku	Mosvlerësim.
Rëndësia:	E ultë.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Projekt Raportit të Auditimit, nga subjekti i audituar AKUM është paraqitur observacioni me shkresë nr. 2540/1 prot., të datës 17.12.2021, si më poshtë, cituar në ligjëratë të drejtë:

Pretendimi i subjektit:

A. Observacioni i ardhur nga z. A.B., në pikën, lidhur me 5 procedurat e prokurimit me vlerë të vogël të sipërlistuarat në dukje: óProcedurat e blerjeve me vlerë të vogël rregullohen nga kuadri ligjor i APP-së dhe specifikisht në këtë rast Udhëzimi i APP Nr. 3, datë 08.01.2018, ë ë , ku në specifikimet dhe formularët që APP udhëzon për njësitë e institucioneve publike që mbulojnë dhe kanë për detyrë funksionale prokurimet, përfshirja e emrave të anëtarëve të Njësisë së Prokurimit, nuk udhëzohet si e detyrueshme në urdhra prokurimi. Mbështetur kjo në faktin se

Komisioni i Prokurimeve ngrihet në institucion nga titullari dhe çdo njësi që përfshihet direkt apo indirekt në proces dhe procedura njihet me anëtarët nga Urdhri i titullarit në momentin e ngritjes së Komisionit apo edhe përgjatë në rast ndryshim anëtarë ë ô.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit:

A. AKUM si Autoritet Kontraktor në rastet e tjera të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël, ka optuar që në Urdhër Prokurim të përfshihen emrat e anëtarëve të Komisionit të Prokurimit, duke krijuar kështu një qasje të dyzuar lidhur me standardin.

Por gjithsesi, sa vënë në dukje në observacion është e vërtetë dhe si i tillë observacioni merret në konsideratë.

Për sa më sipër është mbajtur Aktkonstatimi nr. 3, datë 10.12.2021

5. Titulli i gjetjes:	Faturat nuk rezultojnë të firmosura nga Komisioni i prokurimeve me vlerë të vogël, në 5 raste.
Situata:	Nga auditimi i procedurave të prokurimeve me vlerë të vogël u konstatua se për procedurat 2, 3, 4, 6, 10, përkatësisht: • Tонера; • Riparim dhe shërbim automjesh; • Letër A3, A4, kancelari etj; • Riparim dhe shërbim automjesh; • Riparim dhe shërbim automjesh, faturat nuk rezultojnë të firmosura nga Komisioni i prokurimeve me vlerë të vogël, në 5 raste.
Kriteri:	Udhëzimi nr. 3 i APP, datë 08.01.2018 óMbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronikeó, i ndryshuar, pika 19: óPagesa për prokurimet me vlerë të vogël bëhet sipas legjislacionit tatimor në fuqi. Në çdo rast, faturat e mallrave apo të shërbimeve duhet të jenë të rregullta sipas legjislacionit në fuqi, si dhe të nënshkruhen nga anëtarët e komisionit. Faturat e lëshuara kanë vlerën e kontratës së lidhur, kur palët nuk kanë nënshkruar një të tillë.ó;
Ndikimi:	Mosfirmosja e faturave të shitjes për mallrat dhe shërbimet e prokuruar, nga Komisioni i prokurimit me vlera të vogla, krijon mundësi që të shmanget verifikimi i përkimit në mes të vlerës së faturës dhe vlerës për të cilin është prokuruar malli apo shërbimi.
Shkaku	Neglizhencë.
Rëndësia:	E ultë.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Projekt Raportit të Auditimit, nga subjekti i audituar AKUM është paraqitur observacioni me shkresë nr. 2540/2 prot., të datës 17.12.2021, dhe observacioni me shkresë nr. 2540/2 prot., të datës 17.12.2021, si më poshtë, cituar në ligjëratë të drejtë:

Pretendimi i subjektit:

A. Një pjesë e personave të ngarkuar me përgjegjësi, sikurse nga shkresa nr. 2540/2 prot., e datës 17.12.2021 bien dakort me gjetjen dhe shprehen në observacione për secilën procedurë veçmas se: ó.... Përsa më sipër, ky konstatim do të respektohet në procedurat në vijimó.

B. Nga sa observuar nga z. A.B., lidhur me procedurat e prokurimit me vlerë të vogël: óTонераô, sipas Urdhrit të Prokurimit nr. 3248, datë 31.10.2019, óPjesë këmbimiô, sipas Urdhrit të Prokurimit nr. 3373 prot., datë 11.11.2019, óLetër A3, A4, kancelari etj.ô, sipas Urdhrit të Prokurimit nr. 3267 prot., datë 01.11.2019, óRiparim dhe shërbim Automjeteshô, sipas Urdhrit të Prokurimit nr. 1645 prot., datë 06.07.2020, citohet: óPraktikat dhe dokumentacioni që lidhet ngushtësisht me pagesa, mbi kontrata të lidhura duhet me rigorozitet të kontrollohen nga njësitë përgjegjëse, jo vetëm që iniciojnë dhe zbatojnë procedurat, por edhe njësia përgjegjëse që procedon me finalizimin për likuidimin respektiv të pagesës.

Në çdo rast dhe pavarësisht sa më lart detajuar, përpilimi dhe kontrolli i procedurave apo praktikave shoqëruar me dokumentacionin mbështetës, është detyrë funksionale dhe përgjegjësi e njësive dhe e drejtuesve në nivele të ndryshme brenda njësive, që bazuar në kuadrin ligjor i cili rregullon funksionimin dhe organizimin e AKUM, sipërcituar, ngarkohen për zbatimë .ô.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit:

A. Dakortësia me konstatimet dhe gjetjet e GA nga ana e të ngarkuarve me përgjegjësi e bën të panevojshëm rritimin e rasteve ku janë anashkaluar rregullat që duhen respektuar për procedurat e prokurimeve me vlerë të vogël.

B. Përsa mosfirmosja e faturave të shitjes për mallrat dhe shërbimet e prokuruar, nga Komisioni i prokurimit me vlera të vogla është në shkelje të kuadrin ligjor që rregullon likuidimin e faturave dhe ekzekutimin e pagesave, po aq shkelje mbetet edhe autorizimi i pagesave nga titullari në këto kushte.

Për këtë arsye, observacioni nuk merret në konsideratë.

Për mangësitë e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi: E.S., në cilësinë e Kryetarit të Komisionit të Prokurimeve me vlerë të vogël; M.M., në cilësinë e Anëtares së Komisionit të Prokurimeve me vlerë të vogël; L.H., në cilësinë e Anëtares së Komisionit të Prokurimeve me vlerë të vogël; A.B., në cilësinë e Titullarit të AK, AKUM; A. A., në cilësinë e Anëtares së Komisionit të Prokurimeve me vlerë të vogël; F.B., në cilësinë e Anëtares së Komisionit të Prokurimeve me vlerë të vogël; H.H., Përgjegjës i Sektorit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse.

Për sa më sipër është mbajtur Aktkonstatimi nr. 3, datë 10.12.2021

6. Titulli i gjetjes tërësore:	Në auditimin e 10 procedurave të prokurimit me vlera të vogla u konstatuan shkelje të lehta, të cilat në mënyrë të përmbledhur rezultojnë si më poshtë; • Përgatitja e specifikimeve nuk është bërë nga Komisioni i prokurimit me vlera të vogla, apo një tjetër komision i ngritur me urdhër të posaçëm të Titullarit, por nga persona të paautorizuar me Urdhër nga Titullari i AKUM, në 8 raste; • Përllogaritja e fondit limit nuk është bërë Komisioni i prokurimit me vlera të vogla, apo një tjetër komision i ngritur me urdhër të posaçëm të Titullarit, por nga persona të paautorizuar me Urdhër nga Titullari i AKUM, në 8 raste; • Marrja e mallrave dhe shërbimeve nuk është bërë nga Komisioni i marrjes në dorëzim të aktiveve, apo nga ndonjë komision i ngritur me urdhër të posaçëm nga Titullari i AKUM, në 4 raste;
--	--

	Fatura e shitjes, nuk rezultojnë të firmosura nga Komisioni i prokurimeve me vlerë të vogël, në 5 raste.
Kriteri:	Veprime në mospërputhje me: Udhëzimin nr. 3 i APP, datë 08.01.2018 óMbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronikeó, i ndryshuar, pika 5; Vendimin Nr. 914, datë 29.12.2014 óPër miratimin e rregullave të prokurimit publikó, i ndryshuar, neni 59, pika 1: óPërlllogaritja e vlerës limit të kontratës bëhet nga njësia e prokurimit, nëse kjo detyrë nuk i është ngarkuar një strukturë të posaçmeó dhe pika 2; Udhëzimin Nr. 30, datë 27.12.2011, óPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikó i ndryshuar, pika 42 dhe pika 43; Udhëzimin nr. 3 i APP, datë 08.01.2018 óMbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronikeó, i ndryshuar, pika 19.
6.1 Rekomandimi	Njësitë dhe drejtuesit e niveleve të ndryshme të AKUM, si dhe komisionet e blerjeve me vlera të vogla të marrin masat, që për procedurat e prokurimit me vlerë të vogël, të mos përsëriten shkeljet e konstatuara sa më sipër, duke siguruar zbatimin me përpikmëri të kuadrin rregullativ ligjor.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit të Auditimit, nga subjekti i audituar AKUM është paraqitur observacioni me shkresë nr. 888/11 prot., të datës 24.02.2022, në të cilin AKUM bën me dije se nga Komisioni i Blerjeve të Vogla janë përgatitur observacione dhe në vijim përcillet bashkëngjitur dokumentacioni i zbatimit të konstatimit të Grupit të Auditimit. Më tej duke u konsideruar si i zbatuar rekomandimi i lënë nga KLSH, AKUM kërkon mospërfshirjen e rekomandimit në Raportin Përfundimtar. Lidhur me zbatimin e këtij rekomandimi, KLSH do bëjë në të auditime përputhshmërie ku do verifikojë ndjekjen dhe zbatimin e rekomandimeve.

III.8. Zbatimi i rekomandimeve të lëna nga auditimet e mëparshme.

Në zbatim të pikës 8 të Programit të Auditimit, óZbatimi i rekomandimeve të lëna nga auditimet e mëparshmeó, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- Raporti Përfundimtar i Auditimit nr. 362/I prot., datë 29.05.2019, i ndryshuar, përcjellë me shkresën nr. 362/9, datë 28.10.2019.
- Vendimi nr. 136, datë 28.10.2019 të Kryetarit të KLSH – së.
- Vendimi i Kryetarit të KLSH – së nr. 98, nr. 675/24 prot., datë 01.10.2020, pas zbatimit të Programit të Auditimit nr. 675 prot., datë 13.07.2020 “Mbi verifikimin e zbatimit të rekomandimeve”.
- Akt Verifikimi nr. 1, nr. 1968 prot., më datë 28.07.2020.
- Dokumentacion i vënë në dispozicion nga AKUM mbi veprimet e kryera në zbatim të rekomandimeve.
- Dokumentacion i vënë në dispozicion nga Avokatura e Shtetit.
- Etj.

Mbështetur në Ligjin 154/2014 Datë 27.11.2014 óPër Organizimin dhe Funksionimin e KLSHó, **në zbatim të Programit të Auditimit** të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit **nr.**

362/1 prot., datë 29.05.2019, i ndryshuar, në Agjencinë Kombëtare të Ujësjetllës Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve (AKUM), nga data 03.06.2019 - 09.08.2019, për periudhën nga 01.05.2016 deri në 31.07.2019, u krye një auditim përputhshmërie.

Në përfundim të këtij auditimi u konstatuan disa mangësi dhe shkelje të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, të cilat më hollësisht janë trajtuar në Vendimin nr. 136, datë 28.10.2019 të Kryetarit të KLSH ñ së dhe në Raportin Përfundimtar të Auditimit, përcjellë me shkresën nr. 362/9, datë 28.10.2019.

- Në zbatim të nenit 15, shkronja ójô, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 óPër organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetitô, subjekti **ka kthyer përgjigje në KLSH, brenda 20 ditëve** nga marrja e shkresës, në bazë të cilës KLSH është vënë në dijeni mbi marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve si dhe planin e veprimeve. (nr 3270/1, datë 12.11.2019).

- Po ashtu nga ana e subjektit **është kthyer përgjigja brenda afatit 6 mujor**, në zbatim të nenit 15, shkronja ójô, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 óPër organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetitô ku është përcjellë plani i veprimeve për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së (shkresë e AKUM-së me nr. 582, datë 20.02.2020 dhe protokolluar në KLSH me nr 362/11, datë 24.02.2020) në të cilën është pasqyruar rekomandimet e lëna, strukturat përgjegjëse për zbatimin e rekomandimeve dhe afatet e përcaktuara për zbatimin e rekomandimeve.

a. Për përmirësimin e gjendjes janë lënë **7 masa organizative**;

b. Rekomandime për Masa për Zhdëmtim janë lënë **15 rekomandime** për shumën 494.674 mijë lekë;

c. Masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin dhe menaxhimin me ekonomikitet, eficence dhe efektivitet të fondeve publike janë lënë **10 rekomandime**;

d. Për parandalimin e dëmit ekonomik janë lënë **2 rekomandime**;

e. Drejtorit të Përgjithshëm të óAgjencinë Kombëtare të Ujësjetllës Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeveô, i është rekomanduar të vlerësojë, në varësi të analizës së përgjegjësisë, shkallën e përgjegjësisë për secilin nëpunës për mangësitë dhe shkeljet e konstatuara dhe të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe të fillojë procedurat për dhënien e masave disiplinore e administrative.

Më pas, **në bazë Programit të Auditimit Tematik nr. 675 prot., datë 13.07.2020** të miratuar nga Kryetari i KLSH ñ së óPër zbatimin e rekomandimeve të lëna në vitin 2019ô, si dhe Autorizimit nr. 675/8, datë 14.07.2020, në përputhje me Udhëzimin e Kryetarit, nr. 1, datë 04.11.2016 óMbi procedurat për ndjekjen dhe dokumentimin e punës në auditimin e verifikimit të zbatimit të rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetitô, janë konstatuar raste të moszbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH, të cilat më hollësisht janë trajtuar në **raportin përfundimtar të auditimit**, si dhe në **Vendimin e Kryetarit të KLSH – së nr. 98, datë 01.10.2020**.

Sikurse konstatuar nga Akt Verifikimi nr. 1, nr. 1968 prot., më datë 28.07.2020, i mbajtur nga Grupi i Auditimit, në prani të përfaqësuesit të subjektit të auditimit, z. A.B., Drejtor i Përgjithshëm i AKUM, mbi ndjekjen dhe zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së, si dhe nga Vendimi i Kryetarit të KLSH ñ së nr. 98, nr. 675/24 prot., datë 01.10.2020, gjatë auditimit të kryer në bazë të Autorizimit nr. 675/8, datë 14/07/2020 me objekt: **óMbi verifikimin e zbatimit të rekomandimeveô**, si dhe Udhëzimit të Kryetarit të KLSH-së nr. 1, datë 04.11.2016 óMbi procedurat për ndjekjen dhe dokumentimin e punës në auditimin e verifikimit të zbatimit të rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit”, vihet në dukje se:

Nga ana e KLSH-së, me shkresat përcjellëse janë lënë **34** rekomandime gjithsej, nga këto, **7** masa organizative, **15** masa zhdëmtimi, **10** masa për eliminimin e efekteve negative në administrimin e fondeve publike dhe **2** masa për parandalimin e dëmit ekonomik.

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

a. Për përmirësimin e gjendjes janë lënë **7 masa organizative**, të cilat janë **pranuar dhe zbatuar plotësisht 7**;

b. Rekomandime për Masa për Zhdëmtim janë lënë **15 rekomandime** për shumën 494.674 mijë lekë nga të cilat, janë **pranuar 15**, janë në **proces zbatimi 12**, dhe është **zbatuar 3** masë në shumën 5,491 mijë lekë;

c. Masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin dhe menaxhimin me ekonomikitet, efience dhe efektivitet të fondeve publike janë lënë **10 rekomandime**, nga të cilat janë **pranuar 8 dhe zbatuar, si dhe 2 rekomandime nuk janë pranuar**.

d. Rekomandime për parandalimin e dëmit ekonomik janë lënë **2 rekomandime** të cilat janë **pranuar dhe janë në proces zbatimi**.

e. Drejtorit të Përgjithshëm të ÓAgjencinë Kombëtare të Ujësjetllës Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve, i është rekomanduar të vlerësojë, në varësi të analizës së përgjegjësisë, shkallën e përgjegjësisë për secilin nëpunës për mangësitë dhe shkeljet e konstatuara dhe të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe të fillojë procedurat për dhënien e masave disiplinore e administrative.

Pas përfundimit të Auditimit Tematik nr. 675 prot., datë 13.07.2020,

-Në zbatim të nenit 15, shkronja ójô, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 óPër organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, “*Kontrolli i Lartë i Shtetit, sipas rastit, në fillim, përgjatë dhe/ose në përfundim të veprimtarisë, duhet: të vendosë një afat kohor për zbatimin e rekomandimeve dhe të informohet nga subjektet e audituara ose institucionet më të larta rreth programeve të tyre, për të zbatuar rekomandimet e bëra sipas paragrafëve të mësipërm, brenda 20 ditëve nga data e marrjes së kërkesës*” subjekti ka kthyer përgjigje në KLSH, brenda 20 ditëve (me shkresën nr. 2786 prot., datë 02.11.2020 në KLSH, në përgjigje të shkresës nr. 675/37 prot., datë 06.10.2020, protokolluar në AKUM me nr. 2564 prot., datë 12.10.2020), nga marrja e shkresës nr. **675/37 prot. të datës 06.10.2020, “Mbi auditimin e zbatimit të rekomandimeve të mëparshme”, në zbatim të Pikës III të saj.**

1. Titulli i gjetjes:	Moszbatim i të gjitha rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm dhe mosraportim sipas afateve të përcaktuara
Situata:	Nga auditimi i respektimit të afatit ligjor prej 6 muajsh, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna rezulton se nga ana e AKUM nuk është raportuar në Kontrollin e Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna, brenda 6 muajve nga përcjellja e rekomandimeve pas këtij auditimi. Sipas Vendimit të Kryetarit të KLSH ñ së nr. 98, nr. 675/24 prot., datë 01.10.2020, gjatë auditimit të kryer në bazë të Autorizimit nr. 675/8, datë 14/07/2020 me objekt: <i>óMbi verifikimin e zbatimit të rekomandimeve</i> , lidhur me 34 rekomandimet e lëna gjithsej, nga këto, 7 masa organizative, 15 masa zhdëmtimi, 10 masa për eliminimin e efekteve negative në administrimin e fondeve publike dhe 2 masa për

	parandalimin e dëmit ekonomik, pasi u konstatua se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve ishte si më poshtë: a) Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 7 masa organizative, të cilat janë pranuar dhe zbatuar plotësisht 7; b) Rekomandime për Masa për Zhdëmtim janë lënë 15 rekomandime për shumën 494.674 mijë lekë nga të cilat, janë pranuar 15, janë në proces zbatimi 12, dhe është zbatuar 3 masë në shumën 5,491 mijë lekë; c) Masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin dhe menaxhimin me ekonomicitet, eficence dhe efektivitet të fondeve publike janë lënë 10 rekomandime, nga të cilat janë pranuar 8 dhe zbatuar, si dhe 2 rekomandime nuk janë pranuar. d) Rekomandime për parandalimin e dëmit ekonomik janë lënë 2 rekomandime të cilat janë pranuar dhe janë në proces zbatimi, në shkresën nr. 675/37 prot. të datës 06.10.2020, “Mbi auditimin e zbatimit të rekomandimeve të mëparshme”, pasi referuar Pikës I, vihet në dukje se: “Bazuar në nenet 15 dhe 16 të Ligjit Nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, për përmirësimin e gjendjes, Ju rikërkojmë që, për të gjitha rekomandimet që konsiderohen në proces zbatimi, ose të zbatuara pjesërisht të inkurajohet përsheptimi i realizimit të plotë të tyre, si vijon...në Pikë II kërkohet: òPër të gjitha rekomandimet e tjera që konsiderohen ònë proces zbatimi, inkurajohet përsheptimi i realizimit të plotë të tyre brenda 3 mujorit të tretë, të vitit 2020 dhe në mbështetje të nenit 30, pika 2 të Ligjit Nr.154/2014, datë 27.11.2014 òPër organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, brenda 6 muajve nga përcjellja e rekomandimeve tona, të raportohet me shkrim pranë KLSH mbi ecurinë e zbatimit të tyre”.
Kriteri:	Ligji nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 30, <u>Rekomandimet e KLSH në shtëpi dhe ecuria e zbatimit të tyre</u>, paragrafi 2, ku përcaktohet se: “Subjekti i audituar, brenda 6 muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit, i raporton Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna”
Ndikimi/Efekti:	Mosraportim në KLSH dhe rekomandime të lëna në proces zbatimi.
Shkaku:	Mosmarrja e masave në kohën e duhur.
Rëndësia:	E mesme.
1.1 Rekomandime:	Drejtori i Përgjithshëm i AKUM të marrë masa që të raportojë pranë KLSH mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve duke zbatuar afatin 6 - mujor si dhe të përsheptoj procesin e realizimit të rekomandimeve që janë në proces zbatimi.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Projekt Raportit të Auditimit, nga subjekti i audituar AKUM është paraqitur observacioni me shkresë nr. 2540/1 prot., të datës 17.12.2021, si më poshtë, cituar në ligjëratë të drejtë:

Pretendimi i subjektit:

A.Nga observacioni i ardhur nga z. A.B.i cili sikurse nga aktkonstatimi i cituar ngarkohet me përgjegjësi, vihet në dukje: óSa i përket zbatimit të rekomandimeve të lëna, titullari i institucionit pasi çdo njësi përgjegjëse është njohur me to, ka kërkuar njësitë përgjegjëse të përfshira në rekomandime për nisjen e punës për angazhimin dhe marrjen e masave për respektimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH, sipas detyrave funksionale që çdo njësi është përgjegjëse bazuar në gjetjet dhe rekomandimet respektive.

Grupet e punës dhe njësitë e përfshira kanë marrë angazhimet sipas përgjegjësisë respektive në rolet dhe funksionet që kanë dhe ushtrojnë, për të konsideruar zbatimin e tyre sipas kuadrit ligjor dhe rekomandimeve të auditit të KLSH nëse dhe dhënë argumentimet e tyre.

Mbështetur në shkresën e AKUM, nr. 2786, prot., datë 02.11.2020 óInformacion mbi auditimin e zbatimit të rekomandimeve të tjera që ishin konsideruar ónë proces zbatimiô po ndiqeshin nga njësitë përgjegjëse në të gjitha fazat e gjyqimit, ku në momentin që këto njësi do të kishin zhvillimedo tçua bëhej me dijeni, brenda afateve të përcaktuara në muajin Prill 2021. Në periudhën 5 Mars 2021 e deri në vijim 14 Qershor 2021 në mbështetje të shkresave, shkresë AKUM nr. 584 prot., datë 05.03.2021 për Ministrin e Infrastrukturës dhe Energjisë, si dhe shkresës së Ministrit të MIE nr. 2421/1 prot., datë 08.03.2021 për AKUM, nuk kam ushtruar funksionin e titullarit të përgjithshëm bazuar në miratimin e kërkesës sime për pezullim nga Ministri përgjegjës për Infrastrukturën për periudhën e sipërcituar. Pas datës 14 Qershor 2021, kam njohur zyrtarisht Ministrin përgjegjës për Infrastrukturën me dorëheqjen time, duke hequr dorë prfundimisht nga pozicioni i titullarit të këtij institucioni.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit:

A. Lidhur me sa vënë në dukje më lart nga z. A.B., ish në titullari i AKUM lirohet nga përgjegjësia, e cila në rrethanën që na bëhet e ditur nga observuesi, bie mbi Drejtorin e Përgjithshëm të Komanduar.

Ndaj observacioni merret në konsideratë.

Për mangësitë e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi: F.Sh., në cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm të Komanduar të AKUM.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit të Auditimit, nga subjekti i audituar AKUM është paraqitur observacioni me shkresë nr. 888/11 prot., të datës 24.02.2022, në të cilin AKUM bën me dije se në vijim do të zbatojë detyrat e lëna nga KLSH, lidhur me këtë pikë.

Në zbatim të Programit të Auditimit të Përputhshmërisë nr. 888/2 prot., datë 07.09.2021 të miratuar nga Kryetari i KLSH nëse, në Agjencinë Kombëtare të Ujësjellës Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve (AKUM),për periudhën 31.07.2019 në 30.06.2021, ndjekja dhe zbatimi i rekomandimeve, sikurse nga Akt Verifikimi nr. 1, nr. 1968 prot., më datë 28.07.2020 (për periudhën që i paraprinte auditimit përkatës), ashtu dhe nga konstatimet e ecursisë së proceseve të ndjekjes dhe zbatimit të rekomandimeve gjatë periudhës së mëvonshme, deri më datën 30.06.2021, në rend kronologjik paraqitet si vijon:

a. Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 7 masa organizative, të cilat janë pranuar dhe zbatuar plotësisht 7;

b. Rekomandime për Masa për Zhdëmtim janë lënë **15 rekomandime** për shumën 494.674 mijë lekë nga të cilat, janë **pranuar 15**, janë në **proces zbatimi 10**, dhe është **zbatuar 5**;

c. Masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin dhe menaxhimin me ekonomicitet, efience dhe efektivitet të fondeve publike janë lënë **10 rekomandime**, nga të cilat janë **pranuar 8 dhe zbatuar**, si dhe **2 rekomandime nuk janë pranuar** Lidhur me rekomandimet e papranuara 1.1 dhe 2.1, AKUM me shkresën nr. 2786 prot., datë 02.11.2020, shpjegon dhe insiston në arsyet e mospranimin dhe moszbatimit të këtyre 2 rekomandimeve:

d. Për parandalimin e dëmit ekonomik janë lënë **2 rekomandime**, të cilat janë **pranuar**. **Rekomandimi (1.1) është në proces zbatimi (1.1), ndërsa rekomandim (1.2) është zbatuar.**

Lidhur me **Rekomandimin 1.1**: óMe qëllim, shmangien e dëmit ekonomik që mund ti shkaktohet buxhetit të shtetit i llogaritur afërsisht rreth **90 milion Euro**, në rast të humbjes së gjyqit në gjykatën e Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë (ICC) Londër, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë të bëjë të pa mundurën që të gjejë gjuhën e bashkëpunimit me Kontraktorin BO óD., I.& K., J.ó, **për ti kërkuar tërheqjen e tij nga çështje që ka hapur në këtë gjykatë, dhe njëkohësisht në këmbim, ti kërkojë Kontraktorit të rilidhë kontratën për vazhdimin e zbatimit të punimeve**”, rekomandim i lënë për zbatim óMenjëherëó, pasi Grupi i Auditimit konstatoi se çështja është në proces, ky Grup i ka kërkuar Kordinatores së Njesisë së Zbatimit të Projektit më datë 26.10.2021 observacionet e AKUM, lidhur me konstatimet dhe gjetjet e KLSH ñ së, si pas lënies së Akt - Verifikimit Nr. 1, nr. 2494 prot., datë 30.08.2019 (protokolli i brendshem i AKUKM), ashtu dhe në fazën e Projekt Raportit, si dhe kundërshtimet e Raportit të Auditimit.

2. Titulli i gjetjes:	Mosvënie në dispozicion të grupit të auditimit të dokumentacionit të kërkuar.
Situata:	Grupi i Auditimit i ka kërkuar Kordinatores së Njesisë së Zbatimit të Projektit më datë 26.10.2021 observacionet e AKUM, lidhur me konstatimet dhe gjetjet e KLSH ñ së, si pas lënies së Akt - Verifikimit Nr. 1, nr. 2494 prot., datë 30.08.2019 (protokolli i brendshem i AKUKM), ashtu dhe në fazën e Projekt Raportit, si dhe kundërshtimet e Raportit të Auditimit. Me e-mailin e datës 26.10.2021, përgjigja e dhënë nga Kordinatorja e Njesisë së Zbatimit të Projektit óPërmirësimi i Sistemit të Kanalizimeve të Tiranës së Madheó, znj. R. K. ishte: óNe vijimë . gjej bashkëngjitur Akt Verifikimin nga Auditimi i KLSH si dhe Raportin Përfundimtar nga Auditimi i vitit 2019. Observacione nga ky auditim nuk gjeta as tek zyra jone as ne protokollë . Aktualisht kjo çështje ndodhet në Arbitrazh, Dhoma Ndërkombëtare e Tregtisë (ICC) dhe po ndiqet nga Avokatura e Shtetit, e cila na përfaqëson si institucionë . AKUM është në kontakt të vazhdueshëm me Avokaturen e Shtetit duke i asistuar me çdo dokumentacion të kërkuar prej tyre.ó. Grupit të Auditimit të tilla dokumente nuk i janë vënë në dispozicion nga subjekti. Avokatura e Shtetit, pas auditimit në terren dhe para hartimit të Projektraportit të auditimit, me shkresën nr. 882/33, datë 28.12.2021, me lëndë: óKërkesë për vënie në dispozicion informacioni/dokumentacionió, drejtuar KLSH ñ së, pasi komunikon nevojën për sigurim informacioni dhe/ose çdo dokumenti të prodhuar nga KLSH në kuadër të Programit të Auditimit nr. 362/1, me objekt: óAuditim Përfundimtar të kryer pranë Agjencisë Kombëtare të Ujësjellës ñ Kanalizime dhe Infrastrukturës së Mbetjeve, mbi Projektin për Përmirësimin e Sistemit të Kanalizimeve të Tiranës së Madhe, i ka përcjellur KLSH ñ së përkatësisht: raportin përfundimtar nr.362/9 prot., datë 28.10.2019 të Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe komentet e Konsulentit

	T., J.& E., mbi akt-konstatimet e bëra Kontrollit të Lartë të Shtetit. Lidhur me sa përcjellë nga ana e Avokaturës së Shtetit, rezulton se konsulenti/inxhinier T.& E., (këtu e në vijim óT.& P.ô) i angazhuar për mbikëqyrjen e punimeve, ka paraqitur observacione (<i>“Komentet e Konsulentit për Projekt-Raportin për Auditimin e Kryer në Agjencinë Kombëtare të Ujësjetës-Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve”</i>) lidhur me projektraportin e përgatitur nga grupi i auditimit i ngarkuar asokohe me auditimin e përputhshmërisë në subjektin AKUM, sipas programit të auditimit të sipërcituar. Në kuadër të funksionit kryesor që kryen një proces auditimi në tërësi, si një sistem rregullator që vlerëson dhe evidenton shkeljet e parimeve të ligjshmërisë të një subjekti në raport me menaxhimin financiar dhe shfrytëzimin me efience, efektivitet dhe ekonomikitet të pasurisë shtetërore dhe fondeve publike, grupi i auditimit, i ndodhur përballë një fakti të ri sikundër janë observacionet e paraqitura nga konsulenti, i merr në shqyrtim këto të fundit në respektim të parimit të sipërcituar. Punimet për zbatimin e projektit për sistemin e kanalizimeve të Tiranës së Madhe, objekt i kontratës FIDIC, e lidhur ndërmjet AKUK (sot AKUM) dhe kontraktorit JV D.& K., janë mbikëqyrur nga konsulenti/inxhinieri óT.& E.ô. Përgjatë ekzekutimit të kontratës në fjalë, konsulenti ka evidentuar një progres punimesh të ulëta nga kontraktori, shkak ky edhe i përfundimit/zgjidhjes së kontratës nga ana e punëdhënësit. Në observacionet e paraqitura, konsulenti shprehet se shkak kryesor i përfundimit/zgjidhjes së kontratës me kontraktorin kanë qenë vonesat e kontraktorit në realizimin e punimeve, rast ky i parashikuar në nenin 15.2.c (I) të kontratës. Në fakt, nëse i referohemi shkresës nr.2004 prot., dt.04.07.2018, të AKUM drejtuar JV C. D.& K. C., óNjoftim për zgjidhje kontrateô, si shkak i zgjidhjes së kontratës evidentohen vonesat e kontraktorit në realizimin e punimeve, pavarësisht një sërë njoftimeve për korrigjim/notice to correct, në adresë të tij. Në raportin përfundimtar të auditimit, (faqja 95 e tij) citohet se óNdërprerja (zgjidhja) e kësaj kontrate në mënyrë të njëanshme nga AKUM, pa marrë parasysh sugjerimet dhe Vërejtjet e Këshillit të Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve nuk është bërë në përputhshme me nenin 15.2 të kontratës së lidhur me kontraktorin JV óD.& K.ô. Në interpretim literal të nenit 15 óTerminimi nga Punëdhënësiô të kontratës dhe specifikisht nenit 15.2 të saj, (cituar më lart) rezulton se zgjidhja e kontratës është një veprim i njëanshëm që mund të ndërmerret nga punëdhënësi për një nga shkaqet alternative të parashikuara në paragrafet (a) ñ (f) të nenit 15.2., dhe në asnjë nga rastet e evidentuara në këtë të fundit nuk kushtëzohet zgjidhja e kontratës nga ana e punëdhënësit, me marrjen në konsideratë të sugjerimeve dhe Vërejtjeve të Këshillit të Mosmarrëveshjeve të cilat për më tepër nuk janë të natyrës së vendimeve që ky Këshill jep sipas nenit 20.4 të kushteve të përgjithshme të kontratës. Raportet e Këshillit të Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve, në mënyrën si janë referuar në raportin përfundimtar të auditimit, janë selektive dhe nuk pasqyrojnë saktë natyrën e këtyre lloj raporteve të konkluduara nga Këshilli. Raportet e Këshillit të Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve ofrojnë një kontekst të dobishëm, por nuk janë një përmbledhje shteruese e të gjitha çështjeve të ngritura.
--	---

	Në raportin e tij të dymbëdhjetë, (pika 5 e tij) po ky Këshill i Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve shprehet se secila palë e interpreton kontratën sipas mënyrës dhe interesit të vet. Më tej, Këshilli vëren se nuk është në pozitat për të përcaktuar se cila palë ka të drejtë dhe konkretisht citojmë Këshillin i cili shprehet se <i>“Nëse palët duhet t’ia referojnë ndonjë mosmarrëveshje Këshillit të Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve, kjo duhet të bëhet në përputhje me nën-klauzolën 20.4 të kushteve të përgjithshme të kontratës. Asnjë vendim nuk mund të merret gjatë takimeve të vizitave në terren. Mbi dymbëdhjetë raportet e tij, Këshilli i Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve, nuk u shpreh nëse qëndrimi i kontraktorit apo i punëdhënësit lidhur me përgjegjësinë e aksesit në terrenin e punimeve/site ishte i saktë vetëm se të dy palët nuk mund të arrinin marrëveshje</i>”. Në raportin përfundimtar të auditimit citohet gabimisht pika 3.11 e raportit të parë dhe pika 3.7 e raportit të katërt për të argumentuar se aksesit në terren sollli për pasojë vonesë për kontraktorin që në fillim. Ndërkohë që nga raportet e hershme rezulton e qartë se aksesit në terren nuk ishte një çështje e ngritur si mosmarrëveshje mes palëve. Këta të fundit po punonin për të zgjidhur çështjet e aksesit në terren, aty ku ekzistonin, dhe këto çështje të aksesit në terren nuk e kishin vonuar ende realizimin e punimeve. Duke cituar pikën 3.11 të raportit të parë, në raportin përfundimtar të auditimit deklarohet se <i>“palët konfirmuan se hapësirat e punës nuk ishin të disponueshme për seksionin e dytë</i>”. Në fakt, raporti i parë shprehet se aksesit nuk ishte i disponueshëm për një numër aksesh/shaftesh të paspecifikuara dhe nuk thotë se kjo ka efektin e vonesës së punimeve, përkundrazi, ai specifikisht shprehet se "deri më tani nuk ka asnjë problem me aksesin në terren ose me shpronësimet" por se "probleme mund të lindin kur të fillojë puna e ndërtimit në Seksionin 2: Kanalizimet". Duke cituar pikën 3.7 të raportit të katërt, në raportin përfundimtar të auditimit deklarohet se <i>“Kontraktori u Ankua se nuk kishte hapësirë për të punuar dhe se si rrjedhojë, punëdhënësi sugjeroi ripozicionimin e disa akseve për të shmangur shpronësimet dhe problemet burokratike</i>”. Në fakt, ky raport shpreh pikërisht të kundërtën dhe e citojmë këtë të fundit: <i>“Kontraktori deklaroi se deri më tani nuk janë vërejtur probleme</i>”. Këshilli i Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve shprehet më tej se "ne kemi gjetur një mirëkuptim dhe mbështetje të mirë nga punëdhënësi në lidhje me pozicionimin e akseve/shafteve". Kështu, Këshilli i Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve në fakt po evidentonte (përmes këtij raporti) se sugjerimi i punëdhënësit për të shmangur shpronësimet ishte mirëpritur nga kontraktori si mënyrë për të shmangur vonesat, jo se kontraktori ishte i acaruar dhe se punëdhënësi kërkonte të shmangte më shumë shpronësime. Në raportin përfundimtar të auditimit pranohet qëndrimi i kontraktorit se punëdhënësi ishte përgjegjës për dhënien e aksesit në terren në tokë private, dhe konkretisht citojmë raportin <i>“Kontraktori ka punuar shumë për të bërë një marrëveshje me pronarët e pronave private dhe se opa ndihmën e supervisorit dhe punëdhënësit, ai nuk mund t’i përmbahet programit të punës dhe është duke u përballur me humbje financiare”</i>. Në fakt, referuar mbi dymbëdhjetë raporteve të tij, Këshilli i Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve, nuk u shpreh nëse qëndrimi i kontraktorit apo i punëdhënësit
--	--

	lidhur me përgjegjësinë e aksesit në terrenin e punimeve/site ishte i saktë, por u shpreh vetëm se të dy palët nuk mund të arrijnë marrëveshje.
	Nga shkresa nr. 882/33, datë 28.12.2021 e Avokaturës së Shtetit, me të dhënat e mësipërme të vëna në dukje nga konsulenti/inxhinier T.& E., krijohet një bazë të dhënash dhe informacioni që e detyron Grupin e Auditimit të ketë një vlerësim ndryshe mbi çështjen dhe Rekomandimin 1.1 të sipërcituar.
Kriteri:	Ligjin Nr.154/2014 datë 27.11.2014, óPër organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, Neni 26 óAksesi në dokumentet zyrtareó, paragrafet 1) dhe 2). 1. Kontrolli i Lartë i Shtetit ka të drejtë për të pasur akses në të gjitha dokumentet zyrtare, shkresore apo elektronike, në bazat elektronike të të dhënave si dhe në çdo informacion apo dokumentacion tjetër të subjekteve të audituara të parashikuar në këtë ligj, që mund të përbëjë sekret shtetëror apo konfidencial, dhe që konsiderohen të nevojshme në funksion të ushtrimit të kompetencave dhe detyrave të tij ligjore. 2. Të gjitha subjektet e audituara janë të detyruara të sigurojnë Kontrollit të Lartë të Shtetit akses në dokumentet zyrtare sipas paragrafit të mësipërm. Në rast të hasjes së pengesave, veprimeve apo mosveprimeve në kundërshtim me të drejtat e mësipërme, Kontrolli i Lartë i Shtetit i drejtohet, sipas rastit, organit më të lartë administrativ ose organeve të pushtetit gjyqësor.
Ndikimi/Efekti:	Pengim i procesit të auditimit.
Shkaku:	Mungesë vullneti bashkëpunimi.
Rëndësia:	E lartë
2.1 Rekomandime:	AKUM pa asnjë rezervë të sigurojnë audituesve të Kontrollit të Lartë të Shtetit akses të plotë në dokumentet zyrtare, objekt auditimi.

Për mangësitë e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi: R. K., Kordinatore e Njësisë së Zbatimit të Projektit “Përmirësimi i Sistemit të Kanalizimeve të Tiranës së Madhe” në AKUM.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit të Auditimit, nga subjekti i audituar AKUM është paraqitur observacioni me shkresë nr. 888/11 prot., të datës 24.02.2022, në të cilin AKUM bën me dije se në vijim do të zbatojë detyrat e lëna nga KLSH, lidhur me këtë pikë.

IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga Auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me kontratën me objekt ‘Përmirësimi i Infrastrukturës së Ujërave të Zeza në zonën Bregdetare, Vlorë’, rezulton se në përfundim të procedurës së prokurimit, është shpallur fitues BOE V.H.&B.I&E., të përfaqësuar këta sipas prokurës së posaçme me nr. 8315 rep. 4040 kol. Datë 13.07.2019 nga OE V.H.me nr. licence për zbatim punimesh NZ.3930/18 datë 06.12.2018 me të cilin është lidhur kontrata me Autoritetin Kontraktor e përfaqësuar nga z. A.B.me nr. 2446 prot., datë 26.08.2019 me vlerë 462,629,496 lekë me TVSh dhe me afat të zbatimit të punimeve 12 muaj. Sipas shkresës së administruar në subjekt me nr. 703 prot., datë 26.03.2021, është bërë një kërkesë nga ana e zv. Drejtorit të Përgjithshëm drejtuar Ujësjetës Kanalizime SHA Vlorë, për caktimin e një inxhinieri me licencën përkatëse për të qenë pjesë e grupit të kolaudit të

punimeve të përfunduara. Kësaj kërkesë, Ujësjellës Kanalizime SHA Vlorë, i ka kthyer përgjigje me shkresën nr. 830/1 prot., datë 11.05.2021, administruar në AKUM me nr. 703/1 prot., datë 14.05.2021 sipas të cilës ka caktuar inxhinierin përkatës. Grupi i kolaudimit është caktuar sipas Urdhrit nr. 1136 prot., datë 31.05.2021 të Zv. Drejtorit të Përgjithshëm. Në fakt ky urdhër është nxjerrë pas 3.5 muajsh dhe jo pas 30 ditësh nga përfundimi i punimeve dhe përveç kësaj, ky urdhër as nuk ka përcaktuar afatin e zgjatjes së procesit të kolaudimit. Sa më sipër është në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, neni 12, Udhëzimin nr. 3, datë 15.2.2001 të Këshillit të Ministrave “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, Kreu II, pika 2 si dhe me Udhëzimin nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu II, pika 10.1, paragrafi i dytë.

Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqet nr. 74-102, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

1.1 Rekomandimi: Nga AKUM në të ardhmen të merren masat për caktimin e kolaudatorit ose grupit të kolaudimit në afatet e duhura ligjore me qëllim realizimin e objektit të investimit, në përputhje me projektin, lejen e ndërtimit, standartet dhe rregullat teknike.

Në vijimësi

2. Gjetje nga Auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me kontratën me objekt ‘Përmirësimi i Infrastrukturës së Ujërave të Zeza në zonën Bregdetare, Vlorë’, rezulton se në zbatim të Urdhrit nr. 69, datë 07.10.2021, “Për monitorimin e situacionit përfundimtar nr. 6 dhe fondit rezervë”, grupi i punës ka hartuar një shkresë drejtuar Drejtorisë Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse ku vë në dijeni edhe Titullarin z. C.K. mbi faktin se në stacionin 102/1 ku mblidhen prurjet e të gjitha stacioneve të tjera, pompat e R.a të vendosura me investimin e realizuar nga sipërmarrësi BOE V.H.&B.I&E., ishin nxjerrë jashtë stacionit të pompimit dhe ishin çmontuar nga UK Vlorë me argumentin se në reshjet e fundit në qytetin e Vlorës këto pompa nuk arrinin të përçonin prurjen maksimale duke shkaktuar përmbytje.

Kjo ndërhyrje ka konsistuar në zëvendësimin e pompave të R.a me kapacitet Q=225 l/s, H=9.83 m, 26.8 KW me pompat e vjetra, pra me pompat ekzistuese përpara kryerjes së investimit. Sipas pretendimeve të sipërmarrësit, rezulton se gjatë heqjes së pompave, ato nuk janë ngritur me zinxhirët e Ankorigjës që janë lënë në çdo pompë në rast avarie dhe nuk janë hequr tubat udhëzues dhe për pasojë janë dëmtuar dhe shkëputur nga pjesa e murit të stacionit tubat udhëzuar për secilën pompë.

Nga Agjencia Kombëtare e Ujësjellës Kanalizime dhe Infrastrukturës së Mbetjeve, e përfaqësuar nga ish Drejtori i Përgjithshëm z. C.K., sipërmarrësi i punimeve BOE V.H.&B.I&E. si dhe mbikëqyrësi i punimeve BOE D. & H. nuk janë marrë masat e duhura për evidentimin e saktë dhe në kohë të mangësive dhe shkaqeve prej të cilave ka ardhur mungesa e funksionimit të pompave e duke lejuar marrjen në dorëzim nga ana e Ujësjellës Kanalizime Vlorë SHA, kur në fakt ky institucion (UKV SHA) nuk është në rolin e Investitorit dhe kjo aq më tepër për një punë e cila nuk i është nënshtruar procesit të kolaudimit. Aktualisht objekti ende nuk është kolauduar nga ana e Grupit të Punës.

Mungesa e vendimmarrjes nga ana e Titullarit në lidhje me ndryshimin e gjendjes, ka ndikuar në procesin e marrjes në dorëzim të punimeve, duke u bërë shkak për mos evidentimin në kohë të mangësive të zbatimit dhe më pas në ndarjen e përgjegjësisë në rast të identifikimit të tyre. Sa më sipër është në kundërshtim me Udhëzimin nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu II, pika 10.2, Urdhrit nr. 1136 prot., datë 31.05.2021, ligjin nr.

8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, neni 12, Udhëzimin nr. 3, datë 15.2.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu II.

Më hollësisht trajtuar në pikën 6, faqe 74-102, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

2.1 Rekomandimi: Nga ana e AKUM të merren masa që nga personat kryesorë përgjegjës për ndërtimin e objektit, konkretisht investitori Agjencia Kombëtare e Ujësjetllës Kanalizime dhe Infrastrukturës së Mbetjeve, sipërmarrësit si dhe mbikëqyrësit e punimeve të evidentohen saktë dhe në kohë mangësitë dhe shkaqet prej nga rezultojnë këto mangësi.

Menjëherë

2.2 Rekomandimi: Nga ana e AKUM të merren masa që nga personat kryesorë përgjegjës për ndërtimin e objektit, konkretisht investitori Agjencia Kombëtare e Ujësjetllës Kanalizime dhe Infrastrukturës së Mbetjeve, sipërmarrësit si dhe mbikëqyrësit e punimeve të ndiqen procedurat e marrjes pjesore në dorëzim të punimeve vetëm pas nënshkrimit të procesverbalit të kolaudimit.

Menjëherë

3. Gjetje nga Auditimi: Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me kontratën me objekt ‘Përmirësimi i furnizimit me ujë për lagjen Krastë e Vogël, Harmës dhe qytetin e Elbasanit’, rezulton se në përfundim të procedurës së prokurimit, është shpallur fitues BOE L.&B.&A.K.&B., të përfaqësuar këta sipas prokurës së posaçme me nr. 454 rep. 1344 kol. datë 13.08.2019 nga OE L.me nr. licence për zbatim punimesh NZ. 3386/7 me të cilin është lidhur kontrata me Autoritetin Kontraktor e përfaqësuar nga z. A.B.me nr. 2446 prot., datë 26.08.2019 me vlerë 320,833,499.7 lekë me TVSh dhe me afat të zbatimit të punimeve 12 muaj. Në lidhje me zbatimin e punimeve Grupi i Auditimit kreu verifikim në terren në prezencë të mbikëqyrësit të punimeve. Sipas lejes së miratuar me Vendimin nr. 985/7, datë 17.03.2020, është parashikuar në pikën 10 të saj se zhvilluesi do të duhej të depozitonte mbetjet ndërtimore në Jug të fshatit Vidhas, Nj.A. Papër nën juridiksionin e Bashkisë Elbasan. Leja e miratuar me Vendimin nr. 985/7, datë 17.03.2020, në pikën 10 të saj ka cituar se vendi depozitimit i materialeve do të jetë ai i caktuar sipas Vendimit nr. 66, datë 23.05.2019 të Këshillit të Bashkisë Elbasan. Ky Vendim administrohet në Bashkinë Elbasan me nr. 3862/1 prot., datë 29.05.2019 dhe në Prefekturën e Qarkut Elbasan me nr. 823 prot., datë 29.05.2019 dhe është marrë ndër të tjera në bazë të:

- Ligjit nr. 10431 datë 09.06.2011 ‘Për mbrojtjen e mjedisit’;
- Ligjit nr. 10463 datë 22.09.2011 ‘Për menaxhimin e integruar të mbetjeve’
- VKM nr. 575 datë 24.06.2015 ‘Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte’, pika 15, 17, gjerat a,b,c, ç;
- VKM nr. 389 datë 27.06.2018 ‘Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 452 datë 11.07.2012 të Këshillit të Ministrave ‘Për landfillet e mbetjeve’.

Në kuptimit të ligjit nr. 10463 datë 22.09.2011 ‘Për menaxhimin e integruar të mbetjeve’, pika 52 dhe VKM nr. 575 datë 24.06.2015 ‘Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte’, pika 4, paragrafi i dytë, sipërmarrësi i punimeve në rastin në fjalë është Zotërues i mbetjeve inerte. Sipas këtij kuadri ligjor “Zotëruesi i mbetjeve inerte”, është personi fizik ose juridik, i cili, gjatë aktivitetit të tij të ndërtimit, riparimit, restaurimit apo prishjes së objekteve, prodhon, transporton ose trajton mbetje inerte të cilat janë të renditura në kapitullin 17, të Vendimit nr. 99, datë 18.2.2005, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e katalogut shqiptar

të klasifikimit të mbetjeve”, të ndryshuar dhe/ose krijuesi i mbetjeve ose çdo person që zotëron mbetje. Në vijim në pikën 15 të VKM nr. 575 datë 24.06.2015 ‘Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte’ citohet se: *Zotëruesit e mbetjeve inerte janë të detyruar të dorëzojnë mbetjet inerte në venddepozitimin e përkohshëm ose lëndfillet e trajtimit të mbetjeve inerte, kundrejt tarifës për ton/mbetje, të propozuar nga operatori dhe të miratuar nga njësitë e qeverisjes vendore.* Nga auditimi nuk rezulton asnjë provë dokumentare për të konfirmuar se nga ana e sipërmarrësit të punimeve janë kryer këto pagesa për ton/mbetje sipas tarifës së miratuar nga ana e Bashkisë Elbasan si dhe asnjë marrëveshje me operatorë të pajisur me leje mjedisore, sipas shtojcës 1, bashkëlidhur ligjit nr. 10448, datë 14.7.2011, “Për lejet e mjedisit”, të ndryshuar, dhe me licencë të tipit III.2.B, sipas Vendimit nr. 538, datë 26.5.2009, të Këshillit të Ministrave, “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga/apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”. Gjithashtu, nuk rezulton asnjë dokument i plotësuar dhe i nënshkruar mbi transferimin e këtyre mbetjeve me qëllim regjistrimin e tyre në Regjistrin e Transfertave Individuale, sipas vendimit nr. 229, datë 23.4.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe të dokumentit të transferimit të mbetjeve jo të rrezikshme”. Në kushte të tilla nga ana e sipërmarrësit të punimeve nuk janë respektuar drejt pikat 4, 5 dhe 6, të VKM nr. 575 datë 24.06.2015 në vend depozitimin e përkohshëm të përcaktuar nga NJQV-ja. Sipas dokumentacionit fotografik dhe argumenteve nga subjekti i audituar, rezulton se nga ana e sipërmarrësit të punimeve nuk janë kryer procese pune për depozitimin e materialit të dalë nga gërmimet por vetëm transporti i këtyre materialeve dhe shkarkimi i tyre (edhe nëse ka ndodhur nuk konfirmohet sasia). Edhe pse ky veprim rezulton të jetë kryer në kundërshtim me pikat e cituara në pikën 3 si më sipër përsëri nuk konfirmohet kryerja e proceseve të punës për depozitimin, e cila edhe nëse do të ishte rasti nuk është detyrë e firmës sipërmarrëse. Nëse do të referohemi analizës së bërë nga ana e Projektuesit në lidhje me depozitimin, do të konstatohet se nën këtë zë janë parashikuar si më poshtë:

$$\begin{aligned}
 Sp + p &= 3.19 \text{ o.p} \times 125 \text{ lekë/o.p} = 398.8 \text{ lekë/m}^3 + \text{Sig. Shoqërore } 67 \text{ lekë/m}^3 = 465 \text{ lekë/m}^3; \\
 \text{Ekskavator me kove } 0.25 \text{ m}^3 &- 0.1 \text{ o.p} \times 2,800 \text{ lekë} = 280 \text{ lekë/m}^3; \\
 \text{Shpenzime plotësuese } 8 \% &\times 745 \text{ lekë/m}^3 = 60 \text{ lekë/m}^3; \\
 \text{Fitimi } 10 \% &\times 745 \text{ lekë/m}^3 = 74.5 \text{ lekë/m}^3; \\
 \text{TOTALI} &= 880 \text{ lekë/m}^3
 \end{aligned}$$

Në këto kushte, nisur nga dokumentacioni i vënë në dispozicion arrihet në konkluzionin se nuk konfirmohet kryerja e depozitimit sipas kërkesave të Ligjit nr. 10431 datë 09.06.2011 ËPër mbrojtjen e mjedisit, Ligjit nr. 10463 datë 22.09.2011 ËPër menaxhimin e integruar të mbetjeve VKM nr. 575 datë 24.06.2015 ËPër miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte VKM nr. 389 datë 27.06.2018 ËPër disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 452 datë 11.07.2012 të Këshillit të Ministrave ËPër lëndfillet e mbetjeve dhe as kryerja e zërit sipas parashikimeve të projektuesit.

Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqe 74-102, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

3.1 Rekomandimi: Nga ana e AKUM, në cilësinë e Zhvilluesit të Lejes së Ndërtimit nr. 985/10 prot., datë 04.06.2020, miratuar me Vendim të Kryetarit të Bashkisë Elbasan nr. 985/7, datë 17.03.2020, ti kërkohet Bashkisë Elbasan, ndjekja e të gjitha procedurave të nevojshme administrative në të gjitha shkallët e gjyqimit, konfiskimi i garancisë financiare në masën 4 % të preventivit, ose shumës **12,833,340 lekë** për shkelje të kushteve të lejes së ndërtimit, nga ana e subjektit ndërtues shoqërisë BOE L.&B.&A.K.&B. me të cilin është lidhur kontrata përkatëse e

sipërmarrjes së punimeve sipas aktit me nr. 2446 prot., datë 26.08.2019 me objekt ‘Përmirësimi i furnizimit me ujë për lagjen Krastë e Vogël, Harmës dhe qytetin e Elbasanit’

Menjëherë

4. Gjetje nga Auditimi: Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me kontratën me objekt ‘Përmirësimi i furnizimit me ujë për lagjen Krastë e Vogël, Harmës dhe qytetin e Elbasanit’, rezulton se në përfundim të procedurës së prokurimit, është shpallur fitues BOE L.&B.&A.K.&B., të përfaqësuar këta sipas prokurës së posaçme me nr. 454 rep. 1344 kol. datë 13.08.2019 nga OE L.me nr. licence për zbatim punimesh NZ. 3386/7 me të cilin është lidhur kontrata me Autoritetin Kontraktor e përfaqësuar nga z. A.B.me nr. 2446 prot., datë 26.08.2019 me vlerë 320,833,499.7 lekë me TVSh dhe me afat të zbatimit të punimeve 12 muaj. Nga auditimi rezulton se projekt-preventiv i hartuar nga ana e projektuesit janë përfshirë në preventiv e njëkohësisht edhe në ofertën e paraqitur nga sipërmarrësi i punimeve BOE L.&B.&A.K.&B. zëra për kryerjen e testimeve të linjave të shtruara. Në fakt referuar *Specifikimeve Teknike*, pika 4.9 *Analiza e Çmimit Njësi përcaktohet se: óÇmimi njësi për Tubat, Valvolat, Hidrantet dhe pjesët speciale përfshin furnizimin, transportin ngarkimin, shkarkimin dhe transportin e materialeve dhe pajisjeve të nevojshme gjatë instalimit të tyre si dhe vendosjen e të gjitha elementëve të tyre në mënyrë të përsosur dhe testimin që do ti bëhet për presionin e punës me të cilën do të punojnë*”. Gjithashtu, referuar kontratës së sipërmarrjes të lidhur mes palëve sipas aktit me nr. 2446 prot., datë 26.08.2019, neni 26 Inspektimet, pika 1 *përcaktohet se: “Kontraktori duhet të bëjë të gjitha testet dhe inspektimet e kërkuara nga dispozitat e kontratës. Kosto e këtyre testimeve dhe inspektimeve duhet të financohet tërësisht nga kontraktori brenda çmimit të kontratës*”. Për rrjedhojë likuidimi i këtyre zërave sipas këtij preventivi në vlerën **1,833,240 lekë pa TVSH** do të përbënte dëm ekonomik dhe si i tillë duhet të zbritet përmes ndryshimeve në projekt-preventiv sipas procedurave përkatëse, pasi aktualisht ky zë punimesh i preventivuar dhe në analizën e çmimeve për njësi nuk është likuiduar me situacione por është parashikuar në preventiv. Sa më sipër është në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 *óPër Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit*”, i ndryshuar, Kreu III, Udhëzimi nr. 3 datë 15.02.2001 *“Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit*”, i ndryshuar me Udhëzimin nr. 1, datë 16.6.2011, Kreu I, pika 3, nënpikat 3.2 dhe 3.3 *Specifikimet Teknike*, pika 4.9 *Analiza e Çmimit Njësi*, kontratën e sipërmarrjes të lidhur mes palëve sipas aktit me nr. 2446 prot., datë 26.08.2019, neni 26 Inspektimet, pika 1si dhe me kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes me objekt ‘Përmirësimi i furnizimit me ujë për lagjen Krastë e Vogël, Harmës dhe qytetin e Elbasanit’ lidhur sipas aktit nr. 3166 prot., datë 23.10.2019.

Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqe74-102, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

4.1 Rekomandimi: Nga AKUM si dhe mbikëqyrësi i punimeve, të merren masat organizative për ndryshimin e zërave të preventivit të kontratës në vlerën **1,833,240 lekë pa TVSH**pasi kryerja e testimeve të linjave të shtruara është përfshirë në çmimin e vendosjes së tubave dhe përveç kësaj, kostot e testimeve dhe inspektimeve duhet të financohen tërësisht nga ana e kontraktorit.

Menjëherë

5. Gjetje nga Auditimi: Nga auditimi i dokumentacionin në dosjen teknike të zbatimit të punimeve të kontratës me objekt ‘Përmirësimi i furnizimit me ujë për lagjen Krastë e Vogël, Harmës dhe qytetin e Elbasanit’ rezultuan mangësitë si më poshtë:

- a. Referuar dokumentacionit fotografik të ndodhur në dosjen teknike rezulton se shtrati i kanaleve, kjo të paktën në rastet e dokumentuara, nuk është pastruar sipas kërkesave të parashikuara në pikën 2.14 të *Specifikimeve Teknike* dhe pikën 2.15.
- b. Nga sondazhet e kryera për punimet e situacionuara rezultoi se materiali i përdorur si zhavorr lumi nuk përmbush kushtet e parashikuara në *Specifikimet Teknike* pasi ka përmbajtje të lartë materiali të imët dhe përmban fraksione me dimensione më të mëdha se 75 mm, konkretisht me dimensione të diametrit maksimal 15 cm, 17 cm e deri në 20 cm, kjo në kundërshtim me pikën 2.16 të *Specifikimeve Teknike*.
- c. Mbushjet me të cilat janë realizuar kanalet nuk janë përgatitur sipas kushteve të diktuar nga projektuesi në lidhje me lagështinë, përzierjen, përhapjen dhe ngjeshjen në objekt me rul vibruës, me ngjeshës të posaçëm dore ose ngjeshës mekanik. Për punimet e ngjeshjes nuk është kryer asnjë testim, kjo në kundërshtim me pikën 2.17 të *Specifikimeve Teknike*.
- d. Në dosjen teknike mungon aprovimi i mbikëqyrësit të punimeve për vendin e marrjes së zhavorrit.

Sa më sipër është në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi”, i ndryshuar, Kreu III, kontratën e sipërmarrjes të lidhur mes palëve sipas aktit me nr. 2446 prot., datë 26.08.2019, neni 26 Inspektimet, pika 1 si dhe me kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes me objekt ‘Përmirësimi i furnizimit me ujë për lagjen Krastë e Vogël, Harmes dhe qytetin e Elbasanit’ lidhur sipas aktit nr. 3166 prot., datë 23.10.2019. Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqe 74-102, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

5.1 Rekomandimi: Nga ana e AKUM si dhe mbikëqyrësi i punimeve të kryhen inspektime me qëllim verifikimin e shtrateve të kanaleve për të verifikuar pastërtinë e tyre nga mbetjet urbane dhe mbetje të tjera të dëmshme. Dokumentacioni i sipërcituar të kërkohej nga ana e mbikëqyrësit ndaj sipërmarrësit të punimeve përpara fazës së kolaudit dhe të kontrollohet gjatë marrjes në dorëzim nga komisioni përkatës i ngritur me Urdhër të Titullarit.

Menjëherë

5.2 Rekomandimi: Nga ana e AKUM si dhe mbikëqyrësi i punimeve të kryhen inspektime me qëllim verifikimin e shtrateve të kanaleve për të verifikuar nëse materiali i përdorur si zhavorr lumi përmbush kushtet e parashikuara në *Specifikimet Teknike*. Dokumentacioni i sipërcituar të kërkohej nga ana e mbikëqyrësit ndaj sipërmarrësit të punimeve përpara fazës së kolaudit dhe të kontrollohet gjatë marrjes në dorëzim nga komisioni përkatës i ngritur me Urdhër të Titullarit.

Menjëherë

6. Gjetje nga auditimi: Gjatë zbatimit të kontratës 0Ndërtim i kolektorit kryesor të ujërave të zeza dhe I.T.U.P në Gjirin e Lalzitô, kanë rezultuar diferenca të volumeve të parashikuara krahasuar me ato faktike, por edhe nevoja për ndryshime.

Me Urdhër nr. 39 prot., datë 19.04.2018, është ngritur grupin e punës për negocimin e çmimeve për zëra të rinj punimesh.

Në këto analiza çmimesh për zëra të rinj punimesh ka referenca nga studimi i tregut i realizuar, ndërsa për zëra të tjerë janë hartuar analiza të kostos, për të cilat u konstatuan mangësi pasi në përcaktimin e çmimeve sipas zërave të miratuara duhet të refleктоhej vetëm ndryshimi i çmimit të bazës materiale dhe jo hartimi i analizave të plota. Veprimet të cilat bien në kundërshtim me Udhëzimi nr. 2, datë 08.05.2003 óPër klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimitô, Kreu II, Pika a.

Më hollësisht trajtuar në Pikën 6 faqe 74-102, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

6.1. Rekomandimi: AKUM, të marrë masa për analizimin në detaje të çmimeve që përcaktohen në zëra të rinj punimesh, të cilat nevojiten të përcaktohen nga ndryshimet e mundshme të projektit gjatë zbatimit të kontratës.

Vazhdimisht

7. Gjetje nga auditimi:- U konstatuan vonesa në likuidimin e dëmshpërblimit të ish-pronarëve të shpronësuar, për interes publik, në zbatimin e projektit óPërmirësimi i Sistemit të Kanalizimeve të Tiranës së Madheô. Pavarësisht se Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë (shkresa nr. 3534 prot., datë 17.12.2018) me Vendimin Nr. 657 Regj., datë 11.12.2018 ka vendosur: mospranimin e kërkesës së AKUM, për pezullimin e ekzekutimit të Vendimit Nr. 3401 datë 28.09.2018 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, e cila linte në fuqi të Vendimin Nr. 6577, datë 28.12.2015, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, e cila vendosi: 1. Pranimin e pjesshëm të padisë (të shtetasit Arben Arif Bodlli); 2. Shfuqizimin e pikës 4 të listës së pronarëve të VKM Nr.772, datë 16.09.2015; 3. Detyrimin e palëve të paditura (AKUM...) për të shpërblyer paditësit diferencën e krijuar në shumën 6.619.144 lekë; pavarësisht lajmërimit nga ana e përmbaruesit A. K. drejtuar AKUM për të ekzekutuar vullnetarisht detyrimet; pavarësisht vënies nën sekuestro të llogarive të AKUK (AKUM) që në një kohë para periudhës në fokus auditim, sikurse dhe vendosjes të sekuestros mbi llogaritë e AKUM me 07.08.2020, shlyerja e detyrimit është bërë me vonesë në katër këste.

Për këtë situatë, sikurse informuar formalisht nëpërmjet postës elektronike (datë 27 tetor 2021) nga znj. N. A. Përgjegjëse e Sektorit të Financës, Drejtoria Ekonomike, z. A. B. është likujduar me këste, për shkak të mungesës së fondeve, duke filluar pagesat pas një viti dhe duke përfunduar pas afro dy vitesh, pavarësisht se duhej progrA.ar dhe parashikuar në fondet buxhetore për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore, të akorduara në ligjin vjetor të buxhetit pasardhës. Këto vonesa janë në shkelje të Udhëzimit të Këshillit të Ministrave Nr. 1, datë 04.06.2014 óPër mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të njërive të qeverisjes së përgjithshme në llogari të thesaritô, pika 3, germës a) dhe germës b), si dhe pikës 4.

Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqe 28-47 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

7.1. Rekomandimi: - AKUM të sigurojë shlyerjen pa vonesë të pagesave të dëmshpërblimeve për efekt shpronësimi, objekt vendimesh gjyqësore.

Menjëherë dhe në vazhdim

8. Gjetje nga auditimi:- U konstatua se nga Kordinatori i Njesisë të Zbatimit të Projektit, lidhur me procesin e shpronësimit, nuk ka raportime të dokumentuara. Lidhur me detyrimin e Koordinatorit të Njesisë së Zbatimit të projektit óPërmirësimi i Sistemit të Kanalizimeve të Tiranës së Madheô për të raportuar pranë Drejtorit të Përgjithshëm të AKUM, lidhur me shpronësimet sikurse konfirmuar nga e - maili i datës 21 tetor 2021, marrë nga znj. R. K., shkruhet: óNjësia e zbatimit ka raportuar ne vazhdimësi me Drejtorin e Përgjithshëm ne mbledhje periodike ne lidhje me shpronësimet por jo te dokumentuaraô. Nga sa pohohet, konstatohet se raportimi lidhur me shpronësimet mbetet një detyrim i cili nuk dokumentohet, nëpërmjet asnjë akti shkresor, ndaj përmbushja e këtij detyrimi konsiderohet e parealizuar nga Koordinatorja e Njesisë së Zbatimit të Projektit. Mosraportimi është në shkelje të Urdhrit të Ministrit të MIE, Nr. 88, datë 24.02.2020, me të cilin është miratuar óRregullorja e brendshme për organizimin dhe funksionimin e AKUMô, nenit 17, pikë 4.

Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqe 6 faqe 28-47 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

8.1. Rekomandimi: - Të sigurohet në AKUM një raportim i vazhdueshëm dhe i dokumentuar mbi proceset e shpronësimit dhe detyrimeve që rrjedhin prej tij, tek Drejtori i Përgjithshëm.

Menjëherë dhe në vazhdim

9. Gjetje nga auditimi:- Nënfaqja e Njoftimeve óShpronësimeó e faqes zyrtare të AKUM, është e pazhvilluar dhe pa asnjë përmbajtje apo informacionë Mungojnë aktet ligjore dhe nënligjore që udhëheqin procesin e shpronësimit, si dhe kriteret e dhënies së shpërblimeve për efekt të shpronësimeve.

Moszhvillimi i nënfaqes së Njoftimeve, óShpronësimeó e faqes zyrtare të AKUM, është në shkelje tëLigjit Nr. 119/2014 óPër të drejtën e informimitó, nenit 7, pikës 1, germave k), l), iii. *Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqe 28-47 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

9.1. Rekomandimi: - Të sigurohet nga AKUM zhvillimi i nënfaqes së Njoftimeve, óShpronësimeó tek faqja zyrtare e agjencisë.

Menjëherë dhe në vazhdim

10. Gjetje nga auditimi:- AKUM nuk ka përgatitur kërkesën për shpronësim dhe dosjen përkatëse të dokumentacionit shoqërues konform parashikimeve ligjore mbi shpronësimin, lidhur me zhvillim e Projektit óRehabilitimi i Rrjetit Hidrik të Tiranësó. Sikurse vënë në dukje në shkresën nr. 8086/1 prot., datë 21.10.2019 (apo nr. 2667/1 prot., datë 2b2.11.2019, prototokoll i AKUM) Sektori i Shpronësimeve të MIE, konstatohet se AKUM nuk ka përgatitur kërkesën për shpronësim dhe dosjen përkatëse të dokumentacionit shoqërues konform parashikimeve ligjore mbi shpronësimin, duke bërë që të mungojë: Projekti i miratuar dhe argumentet përkatëse ligjore për interesin publik lidhur me realizimin e tij; Lejet dhe miratimet përkatëse nga organet kompetente sipas ligjit, në përputhje me natyrën dhe llojin e projektit që kërkohet të realizohet; Aktet që vërtetojnë mënyrën e realizimit të projektit, nga vetë kërkuuesi i shpronësimit ose me të tretët, si dhe afatet përkatëse; si dhe shumë dokumente të tjerë të nevojshëm për ecurinë e kërkesës për shpronësim.

Mospërgatitja e kërkesës për shpronësim dhe dosjes përkatëse të dokumentacionit shoqërues konform parashikimeve nga AKUM, është në shkelje tëLigjit nr. 8561, datë 22.12.1999 óPër shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publikó, i ndryshuar, nenit10, pikës 1, germave b), d), dh).

Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqe 28-47 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

10.1. Rekomandimi: -AKUM të angazhohet seriozisht në përgatiten e kërkesave për shpronësim dhe dosjeve të cilat shoqërojnë procesin e shpronësimit, duke shmangur shkeljet e konstatuara.

Në vazhdim

11. Gjetje nga auditimi:- ASHK ka vënë me vonesë në dispozicion të AKUM zyrtarisht informacionin e kërkuar mbi pasuritë pronë private, që preken nga zbatimi i Projektit óRehabilitimi i Rrjetit Hidrikó. Nga AKUM më datë 14.09.2020 është kryer procedura e aplikimit online për verifikimin e statusit juridik të pronave që preken në zbatim të projektit óRehabilitimi i Rrjetit Hidrikó. Me shkresën nr. 2327/1 datë 28.09.2020 ASHK ka dërguar faturën për shërbimin kadastral për të cilin AKUM do aplikonte në portal, në përgjigje të kërkesës së AKUM për këtë informacion, përcjellë me shkresën nr. 2327 prot., datë 14.09.2020.

Me shkresën nr. 3326 prot., datë 24.12.2020 (protokoll i AKUM) ASHK ka vënë në dispozicion zyrtarisht informacionin e kërkuar mbi pasuritë pronë private që preken nga zbatimi i Projektit óRehabilitimi i Rrjetit Hidrikó, në kuadër të aplikimit të kryer online nga AKUM.

Referuar vonesës në dhënien e shërbimit për të cilin ka aplikuar AKUM, konstatohet shkelja e afateve procedurale nga ASHK në dhënien e shërbimit kadastral. Ndërkohë AKUM duhej të kishte insistuar pranë ASHK për respektimin e afateve.

Vonesat e vënies në dispozicion të AKUM nga ASHK, të informacionit të kërkuar mbi pasuritë pronë private, që preken nga zbatimi i Projektit óRehabilitimi i Rrjetit Hidrikó, janë në shkelje të Ligjit Nr. 111/2018 óPër kadastrënó, nenit 29, pikës 3.

Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqe 28-47 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

11.1. Rekomandimi: -AKUM të insistojë me vëmendje të shtuar në marrjen e informacionit nga ASHK, lidhur me statutet juridike të pasurive të cilat preken nga proceset e shpronësimit, duke synuar një ndërveprim më efikas me ASHK.

Në vazhdim

12. Gjetje nga auditimi:- AKUM nuk ka përgatitur kërkesën e shpronësimit dhe dosjen përkatëse të dokumentacionit shoqërues, brenda afateve kohore përcaktuara nga parashikimet ligjore mbi shpronësimin, referuar Projektit óRehabilitimi i Rrjetit Hidrikó të Tiranësó. Me shkresën nr.469 Prot., datë 24.02.2021 AKUM ka dërguar dosjen e plotë për kërkesën për shpronësim në MIE. Në këtë pikë procesi i shpronësimit nuk është e sigurtë se mund të përmbillet pozitivisht, meqë referuar shkresës me lëndë: óKujtesë mbi plotësimin e dokumentacionit të kërkesës për shpronësimó nr. 1994 prot., datë 21.02.2020 (nr. 605 prot., datë 24.02.2020, protokoll i AKUM), ku MIE tërhiqte vëmendjen dhe sqaronte se, óMeqenëse kanë kaluar mbi 4 muaj dhe nga ana juaj nuk është dërguar dokumentacioni i kërkuar, Ju bëjmë me dije se vonesat e tejzgjatura në plotësimin e dokumentacionit, përbëjnë shkak për kthimin e dosjes së shpronësimit dhe refuzimin e kërkesës për shpronësim, referuar përcaktimeve të nenit 12, të Ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 óPër shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publikó, i ndryshuar, duke shtuar në fund se: óSa më sipër, lutemi plotësimin e dokumentacionit të kërkuar brenda 30 ditëve, në të kundërt do të procedohet me kthimin e kërkesës për shpronësimó.

Nga data 21.02.2020 kanë kaluar rreth 13 muaj, pra 12 muaj përtej afatit 30 ditor, të lënë si afat nga Komisioni i Posaçëm i Shpronësimeve të MIE. Kësaj vonese i ka paraprirë edhe vonesa tjetër prej katër muajsh, e cila u bë shkas për dërgimin e shkresës nr. 1994 prot., datë 21.02.2020 (nr. 605 prot., datë 24.02.2020, protokoll i AKUM), nga MIE. Duke përjashtuar AKUM nën nga përgjegjësia për vonesën ASHK, sigurisht, konstatohet se vonesa në dërgimin e kërkesës për shpronësim lidhet me administrimin jo në përputhje me ligjin, nga ana e AKUM. Vërtetë nga MIE nuk është refuzuar kërkesa për shpronësim e AKUM, por konsideruar edhe koha që MIE ka tashmë dosjen në dispozicion, dhe nuk ka dhënë përgjigje lidhur me praktikën, shtyn të mendohet se kërkesa, për shkak të kalimit të afateve, mund të jetë e destinuar për refuzim për kapërcim të afateve.

Mosrespektimi i afateve për përgatitjen e kërkesës për shpronësim dhe dosjes përkatëse, është në shkelje të Ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 óPër shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publikó, i ndryshuar, nenit 12, pikave 2) dhe 3).

Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqe 28-47, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

12.1. Rekomandimi: -AKUM të angazhohet seriozisht në përgatitjen e kërkesave për shpronësim brenda afateve kohore.

Menjëherë dhe në vazhdim

13. Gjetje nga auditimi: - Nga auditimi i procedurave të prokurimit me vlera të vogla në 10 prej tyre në mënyrë të përmbledhur u konstatuan si më poshtë:

- Përgatitja e specifikimeve në 8 procedura nuk është bërë nga Komisioni i prokurimit me vlera të vogla, apo një tjetër komision i ngritur me urdhër të posaçëm të Titullarit, por nga persona të paaautorizuar nga Titullari i AKUM;

- Përllogaritja e fondit limit në 8 procedura nuk është bërë nga Komisioni i prokurimit me vlera të vogla, apo një tjetër komision i ngritur me urdhër të posaçëm të Titullarit, por nga persona të paaautorizuar nga Titullari i AKUM;

- Marrja e mallrave dhe shërbimeve në 4 procedura nuk është bërë nga Komisioni i marrjes në dorëzim të aktiveve, apo nga ndonjë komision i ngritur me urdhër të posaçëm nga Titullari i AKUM;

- Fatura e shitjes në 5 procedura, nuk rezultojnë të firmosura nga Komisioni i prokurimeve me vlerë të vogël;

Këto praktika janë në shkelje të Udhëzimit nr. 3, i APP, datë 08.01.2018 *óMbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike*, i ndryshuar, pikave 5 dhe 19, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 *óPër miratimin e rregullave të prokurimit publik*, i ndryshuar, nenit 59, pikave 1 dhe 2, Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011, *óPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik* i ndryshuar, pikave 42 dhe 43.

Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqe 28-47, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

13.1. Rekomandimi: -Njësitë dhe drejtuesit e niveleve të ndryshme të AKUM, si dhe komisionet e blerjeve me vlera të vogla të marrin masat, që për procedurat e prokurimit me vlerë të vogël, të mos përsëriten shkeljet e konstatuara sa më sipër, duke siguruar zbatimin me përpikmëri të kuadrin rregullativ ligjor.

Menjëherë dhe në vazhdim

14. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të prokurimit publik për periudhën objekt auditimi u konstatua se dosjet e procedurave të prokurimit nuk janë arkivuar, inventarizuar dhe numerizuar me numër fletësh, veprim në kundërshtim me ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 *óPër Arkivat*, nenin 4/26 dhe *óNormat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë*, Neni 19 si edhe udhëzimet e APP-së.

Më hollësisht trajtuar në pikën 5 faqe 48-74, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

14.1.Rekomandimi: AKUM të marrë masa për sistemimin e dosjeve të procedurave të prokurimit, inventarizimit dhe arkivimit të tyre, sipas lidhjeve dhe në mënyrë kronologjike.

Vazhdimisht

15. Gjetje nga auditimi: Në procedurën e prokurimit me objekt *óPërmirësimi i infrastrukturës së ujërave të zeza në zonën bregdetare Vlorë*, me fond limit 407,368,357 lekë pa tvsh, zhvilluar në vitin 2019, janë kualifikuar dy operatorë ekonomik:

a. BOE óB.Ió shpk. & óV.H.ó shpk & óE.ó shpk, me vlerë 389,375,085 lekë pa tvsh, i shpallur fitues.

b. Operatori ekonomik óA.K.ó shpk me vlerë 399,953,374 lekë pa tvsh.

Nga auditimi i DST, dokumenteve të paraqitura nga BOE óV.H.ó shpk & óE.ó shpk & óB.ó shpk, u konstatua se BOE i mësipërm nuk ka plotësuar kriteret e kërkuara sipas DST, konkretisht si më poshtë:

- Shoqëria óE.ô shpk nuk ka përmbushur kriterin për mjetet dhe pajisjet që ka në dispozicion, konkretisht për mjetin Autobot Uji, kjo pasi referuar kontratës së bashkëpunimit me nr. 8314 Rep, nr. 4039 Kol, datë 13.07.2019 kjo shoqëri ka marrë përsipër të kryejë punime me autobot por nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion për posedimin e autobotit.

- Shoqëria óE.ô shpk nuk ka paraqitur dokumentacion të plotë dhe të saktë për të dëshmuar plotësimin e kriterëve të veçanta për kualifikim ku kërkohet që OE te disponojë Licence QKL III.2.B. (Grumbullim, Transportim mbetjeje Urbane).

KVO ka kualifikuar dhe shpallur fitues BOE óV.H.ô shpk & óE.ô shpk & óB.ô shpk, me ofertën, 389,375,085 lekë pa tvsh, duke mos plorësuar kriteret e kërkuara në DST, veprime në kundërshtim me nenin 46 óKualifikimi i ofertuesveô e nenit 53 óShqyrtimi i ofertaveô, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, óPër prokurimin publikô i ndryshuar.

Më hollësisht trajtuar në pikën 5 faqe 48-74, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

15.1.Rekomandimi: AKUM të marrë masa në të ardhmen që për çdo operator ekonomik të kualifikuar, të sigurojë plotësimin e të gjitha kriterëve të kërkuar në dokumentet standarde të tenderit në mënyrë që të shmangë praktikën në kundërshtim me ligjin e prokurimit publik.

Vazhdimisht

16. Gjetje nga auditimi:Nga auditimi mbi hartimin dhe zbatimin e buxhetit për periudhën objekt auditimi rezultoi se për të gjitha procedurat e prokurimit të audituara Autoriteti Kontraktor ka lidhur kontrata me operatorë ekonomikë të shpallur fitues pa pasur fondet e plota (në llogarinë përkatëse) të nevojshme për të marrë angazhimet buxhetore për realizimin e punimeve, ndërkohë që kontratat kanë qenë me kohëzgjatje brenda 12 muajve referuar DST dhe kontratës së lidhur. Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008 óPër menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisëô të ndryshuar neni 40 óE drejta për të kryer shpenzimeô, neni 50 óAngazhimet buxhetoreô dhe neni 51 óMenaxhimi i angazhimeveô dhe VKM nr. 914 datë 29.12.2014 óPër miratimin e Rregullave të Prokurimit Publikô i ndryshuar, nenin 70 óLidhja e Kontratësô, neni 76 óKohëzgjatja e kontratësô pika 1.

Më hollësisht trajtuar në pikën 5 faqe 48-74, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

16.1. Rekomandimi: AKUM në cilësinë e AK të marrin masat e nevojshme që në përfundim të procedurave të prokurimit të nënshkruaj kontratën vetëm pasi fondi i nevojshëm për realizimin e kontratës të jetë në dispozicion (në llogarinë përkatëse) të autoritetit kontraktor.

Vazhdimisht

17. Gjetje nga auditimi:-Nga auditimi i respektimit të afatit ligjor prej 6 muajsh, për raportimin në KLSH, të ecursisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna rezultoi se nga ana e AKUM nuk është raportuar në Kontrollin e Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna, brenda 6 muajve nga përcjellja e rekomandimeve pas këtij auditimi.

Sipas Vendimit të Kryetarit të KLSH ñ së nr. 98, nr. 675/24 prot., datë 01.10.2020, gjatë auditimit të kryer në bazë të Autorizimit nr. 675/8, datë 14/07/2020 me objekt: óMbi verifikimin e zbatimit të rekomandimeveô, lidhur me 34 rekomandimet e lëna gjithsej, nga këto, 7 masa organizative, 15 masa zhdëmtimi, 10 masa për eliminimin e efekteve negative në administrimin e fondeve publike dhe 2 masa për parandalimin e dëmit ekonomik, pasi u konstatua se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve ishte si më poshtë: Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 7 masa organizative, të cilat janë pranuar dhe zbatuar plotësisht 7; Rekomandime për Masa për Zhdëmtim janë lënë 15 rekomandime për shumën 494.674 mijë lekë nga të cilat, janë pranuar

15, janë në proces zbatimi 12, dhe është zbatuar 3 masë në shumën 5,491 mijë lekë; Masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin dhe menaxhimin me ekonomicitet, efience dhe efektivitet të fondeve publike janë lënë 10 rekomandime, nga të cilat janë pranuar 8 dhe zbatuar, si dhe 2 rekomandime nuk janë pranuar; Rekomandime për parandalimin e dëmit ekonomik janë lënë 2 rekomandime të cilat janë pranuar dhe janë në proces zbatimi, në shkresën nr. 675/37 prot. të datës 06.10.2020, óMbi auditimin e zbatimit të rekomandimeve të mëparshmeó, pasi referuar Pikës I, vihet në dukje se: óBazuar në nenet 15 dhe 16 të Ligjit Nr.154/2014, datë 27.11.2014 óPër organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetitó, për përmirësimin e gjendjes, Ju rikërkjómë që, për të gjitha rekomandimet që konsiderohen në proces zbatimi, ose të zbatuara pjesërisht të inkurajohet përsheptimi i realizimit të plotë të tyre, si vijon...në Pikë II kërkohet: óPër të gjitha rekomandimet e tjera që konsiderohen ónë proces zbatimió, inkurajohet përsheptimi i realizimit të plotë të tyre brenda 3 mujorit të tretë, të vitit 2020 dhe në mbështetje të nenit 30, pika 2 të Ligjit Nr.154/2014, datë 27.11.2014 óPër organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetitó, brenda 6 muajve nga përcjellja e rekomandimeve tona, të raportohet me shkrim pranë KLSH mbi ecurinë e zbatimit të tyreó.

Sa më lart, është në shkelje të LigjitNr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 30, Rekomandimet e KLSH ñ së dhe ecuria e zbatimit të tyre, paragrafi 2.

Më hollësisht trajtuar në pikën 8 faqe 115-123, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

17.1. Rekomandimi: - Drejtori i Përgjithshëm i AKUM të marrë masa që të raportojë pranë KLSH mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve duke zbatuar afatin 6 -mujor si dhe të përsheptojë procesin e realizimit të rekomandimeve që janë në proces zbatimi.

Në vazhdim

18. Gjetje nga auditimi:-Grupi i Auditimit i ka kërkuar Kordinatores së Njësisë së Zbatimit të Projektit më datë 26.10.2021 observacionet e AKUM, lidhur me konstatimet dhe gjetjet e KLSH ñ së, si pas lënies së Akt - Verifikimit Nr. 1, nr. 2494 prot., datë 30.08.2019 (protokolli i brendshëm i AKUKM), ashtu dhe në fazën e Projekt Raportit, si dhe kundërshtimet e Raportit të Auditimit. Me e-mailin e datës 26.10.2021, përgjigja e dhënë nga Kordinatorja e Njësisë së Zbatimit të Projektit óPërmirësimi i Sistemit të Kanalizimeve të Tiranës së Madheó, znj. R. K. ishte: óNe vijimë . gjej bashkengjitur Akt Verifikimin nga Auditi i KLSH si dhe Raportin Përfundimtar nga Auditimi i vitit 2019. Observacione nga ky auditim nuk u gjet as në zyrë as ne protokollë . Aktualisht kjo çështje ndodhet në Arbitrazh, Dhoma Ndërkombëtare e Tregtisë (ICC) dhe po ndiqet nga Avokatura e Shtetit, e cila na përfaqëson si institucionë . AKUM eshte ne kontakt te vazhdueshem me Avokaturen e Shtetit duke i asistuar me çdo dokumentacion te kerkuar prej tyre.ó.

Grupit të Auditimit të tilla dokumente nuk i janë vënë në dispozicion nga subjekti.

Ndërkohë që Avokatura e Shtetit, me shkresën nr. 882/33, datë 28.12.2021, me lëndë: óKërkesë për vënie në dispozicion informacioni/dokumentacionió, drejtuar KLSHñsë, pasi komunikon nevojën për sigurim informacioni dhe/ose çdo dokumenti të prodhuar nga KLSH në kuadër të Programit të Auditimit nr. 362/1, me objekt: óAuditim Përputhshmërieó të kryer pranë Agjencisë Kombëtare të Ujësjellës ñ Kanalizime dhe Infrastrukturës së Mbetjeve, mbi Projektin për Përmirësimin e Sistemit të Kanalizimeve të Tiranës së Madhe, i ka përcjellur KLSH ñ së përkatësisht: raportin përfundimtar nr.362/9 prot., datë 28.10.2019 të Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe komentet e Konsulentit T., J.& E., mbi akt-konstatimet e bëra Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Mosvënia në dispozicion të grupit të auditimit të dokumentacionit të kërkuar, është në shkelje të Ligjit Nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Neni 26 óAksesi në dokumentet zyrtareó, paragrafet 1) dhe 2).

Më hollësisht trajtuar në pikën 8 faqe 115-123, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

18.1. Rekomandimi: -AKUM pa asnjë rezervë të sigurojnë audituesve të Kontrollit të Lartë të Shtetit akses të plotë në dokumentet zyrtare, objekt auditimi.

Në vazhdim

B. MASA SHPËRBLIM DËMI

1. Gjetje nga Auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me zbatimin e kontratës nr. 3889 prot., datë 31.12.2019 me objekt *óPërmirësimi i furnizimit me ujë për lagjen Krastë e Vogël, Harmës dhe qytetin e Elbasanitó*, me vlerë 320,833,499.7 lekë me TVSh, me afat të zbatimit të punimeve 12 muaj, lidhur midis BOE óL.&B.&A.K.&B.ó, SHPK të përfaqësuar nga OE óL.ó SHPK dhe Autoritetin Kontraktor i përfaqësuar nga z. A.B.rezultoi se: Nga auditimi i dosjes teknike të kontratës, krahasimi i librezës së masave, situacionit progresiv, projektit të miratuar me ndryshime, etj. rezultoi se i janë likuiduar 4 zëra punimesh të situacionuara por të pakryera në fakt në vlerën **10,880,258** lekë pa TVSh, (*Aneksi 2.6.2.1*). Sa më sipër është në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi”, i ndryshuar, Kreu III, Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar me Udhëzimin nr. 1, datë 16.6.2011, Kreu I, pika 3, nënpikat 3.2 dhe 3.3 si dhe me kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes me objekt “Përmirësimi i furnizimit me ujë për lagjen Krastë e Vogël, Harmës dhe qytetin e Elbasanit” lidhur sipas aktit nr. 3166 prot., datë 23.10.2019.

Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqe 75-99, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

1.1 Rekomandimi: Nga ana e AKUM të kërkohej në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit arkëtimi i vlerës **10,880,258** lekë pa TVSH nga sipërmarrësit BOE óL.&B.&A.K.&B.ó SHPK sa përfituar padrejtësisht punime të pakryera por të likuiduara.

Menjëherë

2. Gjetje nga Auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me zbatimin e kontratës nr. 2446 prot., datë 26.08.2019 me objekt *óPërmirësimi i Infrastrukturës së Ujërave të Zeza në zonën Bregdetare, Vlorëó*, me vlerë 462,629,496 lekë me TVSh, me afat të zbatimit të punimeve 12 muaj, lidhur midis BOE óV.H.&B.I&E.ó, SHPK të përfaqësuar nga OE óV. H.ó SHPK dhe Autoritetin Kontraktor i përfaqësuar nga z. A.B.rezultoi se: Nga auditimi i dosjes teknike të kontratës, krahasimi i librezës së masave, situacionit progresiv, projektit të miratuar me ndryshime, etj. rezultoi se i janë likuiduar 17 zëra punimesh të situacionuara por të pakryera në fakt në vlerën **8,364,636** lekë pa TVSh, (*Aneksi 2.6.1.1*). Sa më sipër është në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi”, i ndryshuar, Kreu III, Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar me Udhëzimin nr. 1, datë 16.6.2011, Kreu I, pika 3, nënpikat 3.2 dhe 3.3 si dhe me kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes me objekt “Përmirësimi i furnizimit me ujë për lagjen Krastë e Vogël, Harmës dhe qytetin e Elbasanit” lidhur sipas aktit nr. 1226 prot., datë 26.04.2019.

Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqe 74-102, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

2.1 Rekomandimi: Nga ana e AKUM të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit arkëtimi i vlerës **8,364,636** lekë pa TVSH nga sipërmarrësit BOE óV.H.&B.I&E.ô SHPK sa përfituar padrejtësisht punime të pakryera por të likuiduara.

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi: Gjatë zbatimit të kontratës óNdërtim i kolektorit kryesor të ujërave të zeza dhe I.T.U.P në Gjirin e Lalzitô, janë bërë ndryshime të cilat kanë rezultuar edhe me zëra të rinj punimesh. Nga verifikimi i analizës së kostos së tyre, konstatohen mangësi si më poshtë:

- Sipas zërit 2.2.5 (2.116 + an.23) óRrethim me mur me blloqe betoni, kanxhella dhe derë hyrëseô, por edhe për rrethimet e stacioneve të pompave, është përfshirë zë i ri i punimeve óTrarë themeli beton monolit C 20/25ô. Çmimi i aplikuar për këtë zë është 15,145 lekë/m³. Nga analiza e çmimit konstatohet se ka rritje të sasisë për zërin kallëpe konkretisht, kallëp muri nga përcaktimi në manual në sasinë 3.5 m², është aplikuar sasia 10 m² dhe kallëp trari nga 3.5 m² në 4 m². Çmimi i betonit C 20/25 në manual është 5,388 lekë/m³, ndërsa në analizën e re është paraqitur 6,629 lekë/m³. Çmimi i betonit është rritur me pretendimin se duhet përdorur betopompa, por në këtë rast nuk kemi hedhje të betonit në lartësi. Nga ribërja e llogaritjeve rezulton se çmimi që duhet të aplikohet të ishte 12,376 lekë/m³. Sipas këtij zëri është likuiduar sasia 148.8 m³. Vlera **412,027 lekë** [148.8 m³ x (15,145 ñ 12,376)], është përfituar padrejtësisht nga Kontraktori óS.Aô SHPK dhe përbën dëm ekonomik.

- Sipas zërit 2.2.5 (2.116 + an.23) óRrethim me mur me blloqe betoni, kanxhella dhe derë hyrëseô, për kolonat metalike profil katror me dimensione (5 x 5 cm x 1.5 mm), me lartësi 1.75 m, është aplikuar çmimi 4,660 lekë për copë. Nga verifikimi i këtij çmimi në sitin e Subjektit óM.ô, rezulton se për profil me gjatësi 6 m, çmimi është 3,140 lekë, ose 1050 lekë për kolonë (890 lekë + 18 % struktura). Nga verifikimi i manualit të çmimeve të ndërtimit viti 2015, rezulton se çmimi i hekurit profil dhe shirit është 94 lekë për kg, ose 827.2 lekë për kolonë. Duke marrë në konsideratë çmimin e tregut (1050 lekë për kolonë) si dhe numrin 277 copë impianti dhe 53 copë stacionet e pompimit), vlera **1,191,300 lekë** [(4,660 lekë ñ 1,050 lekë) x 330 copë], është përfituar padrejtësisht nga kontraktori óS.Aô dhe përbën dëm ekonomik.

- Nga shqyrtimi i zërit 1.1.B.3 óMbikalim i linjës me presionô rezulton se janë përfshirë konstruksione metalike për mbështjen e tubit në sasinë 16.43 ton, me çmim 216,364 lekë/ton. Nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se në konstruksione metalike është përfshirë tubacioni me diametër Ø 711 mm dhe spesor 11 mm, me gjatësi 82 m. Nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se në kontratën bazë, për ndërtimin e kalimit ishte parashikuar çmimi për tubacion çeliku është 187,111 lekë për ton dhe i konstruksionit metalik 216,364 lekë/ton. Sa më sipër, çmimi i tubit të çelikut duhet të ndahej nga çmimi i konstruksioneve metalike. Pesha e tubit e përcaktuar konstruksion është 15.3 ton. Vlera **447,571 lekë** (216,364 -187,111) x 15.3 ton, është përfituar padrejtësisht nga kontraktori óS.Aô dhe përbën dëm ekonomik.

- Nga shqyrtimi i zërit óPropozime shtesa V.Oô, nënzëri óRezervuar betoni me volum 36.9 m³ô, janë përfshirë punime elektrike, kabllo, kabllo tokëzimi, ndriçues infrastrukture, për mbrojtjen nga zjarri dhe pompat, është parashikuar vlera 1,593,879 lekë. Nga verifikimi i analizës së çmimeve të detajuar rezulton se është përfshirë transport me vlerë 1,870 lekë, materiale ndërtimi me vlerë 1,364,169.5 lekë pa përfshirë 18 % të fitimit dhe shpenzime të përgjithshme (63,771 lekë transport, 76,525 lekë ngjeshje tabani dhe 1,223,873 lekë shtresë çakulli). Vendosja e vlerës së mësipërme pa asnjë argumentim, për zëra që nuk kanë të bëjnë me punime elektrike, si dhe duke marrë në konsideratë se sistemi zjarrfikës parashikohet më vete, vlera e likuiduar në

shumën **1,539,879 lekë**, është përfutur padrejtësisht nga Kontraktori óS.Aô SHPK dhe përbën dëm ekonomik.

-Sipas zërit óNdërtim linje elektrike kabllorë nëntokësore me kablllo 24 kV, ALXLPE. 3 x 1 x 240/25 mm², sipas rregullores së OSHEE, sipas tipologjisë së zonës ku kalon linja, mufta dhe terminale për kabllot, tuba çeliku Ø 160 mm për intersektimet me rrugë të linjës, shtresë mbrojtëse me tulla të plota dhe shirit sinjalizues,rezulton se analiza e çmimit është rishikuar për të gjithë elementët dhe jo vetëm për elementët e shtuar. Në këtë analizë çmimi, sa i përket shtresës mbrojtëse me tulla të plota, krahas materialit dhe punëtorisë, është përfshirë edhe zëri makineri, zë i cili mund të përfshihet në rast të ndërtimit të murit dhe jo shtresë me tulla. Vlera **130,060 lekë** (20,150 x 18% x 5.47 km), është përfutur padrejtësisht nga Kontraktori óS.Aô SHPK dhe përbën dëm ekonomik. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me VKM nr. 514, datë 15.08.2007 óPër informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të ndërtimitô ndryshuar, pika 2 dhe 11, Udhëzimi i Këshillit Të Ministrave nr. 2, datë 08.05.2003 óPër klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimitô si dhe VKM nr. 629, datë 15.7.2015 óPër miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyreô, pika 4.

Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqe 74-102, të Raportit Pwrfundimtar të Auditimit.

3.1. Rekomandimi:AKUM të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjyimit, arkëtimin e vlerës **3,720,837 lekë**, nga Kontraktori BOE “S.A” SHPK,përfutur padrejtësisht si pasojë e mangësive në hartimin e analizës së kostos së punimeve të ndërtimit.

Menjëherë

C.MASA PËR ELEMENIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.

1. Gjetje nga Auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit në lidhje me zbatimin e kontratës me objekt ‘Përmirësimi i *Infrastrukturës së Ujërave të Zeza në zonën Bregdetare, Vlorë*’, rezultoi se punimet e konsideruara si të përfunduara nga palët (sipërmarrës, mbikëqyrës) nuk janë kolauduar nga ana e Grupit të Punës të ngritur me Urdhrin nr. 1136 prot., datë 31.05.2021 gjithashtu nga ana e Autoritetit Kontraktor nuk është miratuar situacioni përfundimtar i punimeve dhe as ai i përdorimit të fondit rezervë. Grupi i punës më datën 22.04.2021 ka miratuar situacionin nr. 5 i cili nga ana e sipërmarrësit është dorëzuar me datë 02.03.2021 dhe nga ana e mbikëqyrësit të punimeve më datën 02.03.2021, kur si datë e përfundimit të punimeve ishte parashikuar data 15.02.2021. Autoriteti Kontraktor gjatë periudhës në auditim nuk ka paraqitur dokumentacion për marrjen në dorëzim dhe miratim të situacionin përfundimtar nr. 6, por për ta konfirmuar atë nëse është apo jo i vërtetë dhe nëse punimet janë kryer konform kontratës së sipërmarrjes. Nga ish Titullarit z. C.K., me Urdhrin nr. 69, datë 07.10.2021, administruar në AKUK me nr. 1926, prot., datë 07.10.2021, óPër monitorimin e situacionit përfundimtar nr. 6 dhe fondit rezervëô është ngritur Grupi i Punës. Ky Grup Pune ka hartuar një shkresë drejtuar Drejtorisë Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse duke vënë në dijeni edhe Titullarin mbi faktin se në stacionin 102/1 ku mblidhen prurjet e të gjitha stacioneve të tjera, pompat e R.a të vendosura me investimin e realizuar nga sipërmarrësi BOE V.H.&B.I&E., ishin nxjerrë jashtë stacionit të pompimit dhe ishin çmontuar nga vetë UK Vlorë me argumentin se në reshjet e fundit në qytetin e Vlorës këto

pompa nuk arrinin të përçonin prurjen maksimale duke shkaktuar përmbytje. Për këtë arsye nga ana e Grupit të Punës u la si detyrë që kontraktori të bënte dhe një herë kontrollin mbi konfigurimin e pompave nëse defekti fillon aty apo nga projektuesi në kriteret e projektimit për pompat që ka vendosur në projekt, pasi kontraktori thekson se çdo pompë është marrë sipër specifikimeve teknike përkatëse të projektit.

Në fakt sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se nuk disponohen testimet e kryera në zbatim të pikës 4.16 TESTIMI DHE INSPEKTIMI I PAJISJEVE të dokumentit me titull Rehabilitimi i Sistemit të Stacioneve të Pompimit të K.U.Z Vlorë, Specifikimet Teknike.

Në përfundim, rezulton se edhe pas datës në të cilën punimet duhet të kishin përfunduar, ky grup pune ka lenë rekomandime sikur kontrata të ishte ende në proces apo si të ishte grup kolaudimi dhe nga asnjë prej palëve përgjegjës nuk janë marrë masa për aplikimin e penalteteve duke favorizuar padrejtësisht sipërmarrësin e punimeve. Situacionet dhe likuidimet përkatëse paraqiten sipas tabelës së paraqitur në Aneksin nr. 2.6.1.2. Duke patur parasysh se vlera e kontratës pas ndryshimeve dhe miratimeve të marra nga ana e Projektuesit dhe Autoritetit Kontraktor është në masën 441,699,656 lekë me TVSH rezulton se punimet e pa miratuara dhe të pa marra aktualisht në dorëzim nga ana e Autoritetit Kontraktor janë në vlerën 163,931,250 lekë me TVSH, ose 37 % e vlerës së kontratës.

Nga ana e ish në Titullarit të Autoritetit Kontraktor z. C.K., ish në zv. Drejtorit të Përgjithshëm z. F.Sh. si dhe mbikëqyrësi i punimeve BOE D.&H.S. nuk janë marrë masa për aplikimin e penalteteve për vonesa në përfundimin në afat të zbatimit të kontratës dhe realizimin e punimeve, kjo në zbatim të nenit 38 të lidhur sipas aktit nr. 2446 prot., datë 26.08.2019, e ndryshuar. Konkretisht rezulton se ndaj sipërmarrësit të punimeve nuk janë aplikuar penaltetet për dorëzimin me vonesë të situacionit nr. 5 dhe mos dorëzimit deri aktualisht të situacionit nr. 6 i përlllogaritur sipas tabelës së paraqitur në aneksin nr. 2.6.1.3.

Vlera e pa aplikuar e penalteteve prej **25,715,880 lekë përbën përdorim pa efektivitet, eficiencë dhe ekonomikitet të fondeve të AKUM** për shkak të mos arritjes së funksionit kryesor të këtij investimi dhe si e tillë ka rënduar situatën financiare të AKUM dhe atë funksionale të investimit në Ujësjellës Kanalizime Vlorë.

Sa më sipër është në kundërshtim me Ligjin nr. 10 296 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, neni 8, pika 1, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 77 Mbikëqyrja e kontratës, Kontrata e sipërmarrjes së punimeve të lidhur sipas aktit nr. 2446 prot., datë 26.08.2019, e ndryshuar, neni 38 si dhe me kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes me objekt ‘Përmirësimi i Infrastrukturës së Ujërave të Zeza në zonën Bregdetare, Vlorë’.

Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqe 74-102, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

1.1 Rekomandimi: Nga AKUM të merren masat e nevojshmet për nxjerrjen e përgjegjësisë dhe shmangien e praktikave të cilat ndikojnë në përdorimin pa efektivitet, eficiencë dhe ekonomikitet të fondeve si pasojë e mos përmbushjes së qëllimeve kryesore të investimeve në vlerën prej **25,715,880 lekë pa TVSH** e shkaktuar në kontratën e lidhur me sipërmarrësit BOE ÓV.H.&B.I&E.” si penaltet i aplikuar për vonesa në realizimin e kontratës së sipërmarrjes të lidhur sipas aktit me nr. 2446 prot., datë 26.08.2019 me objekt ‘Përmirësimi i Infrastrukturës së Ujërave të Zeza në zonën Bregdetare, Vlorë’.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi: Në lidhje me proceset gjyqësore në të cilat shoqëria është palë, nga dokumentacioni i vënë në dispozicion konstatohet se për periudhën objekt auditimi janë humbur

10 çështje gjyqësore, duke e detyruar institucionin të paguajë vlerën **126,031,384 lekë e cila përbën efekt financiar negative për buxhetin e shtetit**; si dëshmipërblim për ndërprerje të paligjshme të marrëdhënieve të punës në vlerën 8,740,707 lekë, si dëshmipërblime për shpronësime në masë të pa drejtë në vlerën 19,850,459 lekë dhe si dëshmipërblim për kontratat e investimit në vlerën 97,440,218 lekë, shpenzime përmbartimore për këto venime kapin vlerën e 6,443,953 lekë dhe shpenzimet gjyqësore në vlerën 851,287 lekë.

Më hollësisht trajtuar në Pikën 2, faqe 22 deri 28 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

2.1. Rekomandimi: Nga Drejtori i Përgjithshëm, Departamenti Ligjor dhe Departamenti i Ekonomik i AKUM të merren masa për ndjekjen me përgjegjësi të gjitha proceseve gjyqësore të iniciuara ndaj Institucionit, për menaxhimin sa më të mirë të fondeve publike. Drejtuesit e institucionit duhet të shmangin në maksimum detyrimin e tarifave përmbartimore dhe likuidimin e detyrimeve të rrjedhura nga vendimmarrjet e gabuara në mnyrë vullnetare për të shmangur tarifat përmbartimore që kanë kapin vlerën e 6,443,953 lekë. Në do rast të nxirren përgjegjësit dhe të merren masat e duhura.

Vazhdimisht

3. Gjetje nga auditimi: Në procedurën e prokurimit me objekt *óF.V Matësa prodhimi/konsumi dhe pajisje për ndërmarrjet Durrës, Elbasan, Lushnjë, Vlore, Fier, Kavajë*, me fond limit 365,599,130 lekë pa tvsh, zhvilluar në vitin 2019, është kualifikuar:

a. BOE óG.E.S.T.ó & óA. shpk, me ofertën në vlerën 300,631,377 lekë pa tvsh, i shpallur fitues.

Nga auditimi i DST, dokumenteve të paraqitura nga BOE óG.E.S.T.ó & óA. shpk u konstatua se BOE i mësipërm nuk ka plotësuar kriteret e kërkuara sipas DST, konkretisht si më poshtë:

- Shoqëria óA. shpk nuk përmbush kriterin 2.3 Për kapacitetin teknik, pika 1.a për përvojën e suksesshme në realizimin e të paktën: *óKontrate e ngjashme për furnizim me vlerë jo më të vogël se 40% e vlerës së përllëgaritur të kontratës që prokurohet të realizuar gjatë tri viteve të fundit, datë e përllëgaritur nga data e hapjes së ofertave*.

Referuar kontratës së bashkëpunimit kjo shoqëri ka marrë përsipër të kryejë 30% të të punimeve, konkretisht fondi limit 365,599,130 lekë * 30%=**109,679,739 lekë** pa tvsh.

Nga auditimi dokumenteve të paraqitura nga ky OE në SPE rezulton se shuma e punëve të ngjashme të kryera në asnjë rast nuk e kalojnë shumën 50,000,000 lekë ose **13.6%** e fondit limit.

- Shoqëria A. nuk plotëson kërkesat për stafin teknik pasi nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion për inxhinierët e kërkuar në DST si: 1(një) Inxhinier Mekatronik dhe 6 (gjashtë) Inxhinier Elektronik.

KVO ka kualifikuar dhe shpallur fitues BOE óG.E.S.T.ó & óA. shpk, me ofertën, 300,631,377 lekë pa tvsh, duke mos plotësuar kriteret e kërkuara në DST, veprime në kundërshtim me nenin 46 *óKualifikimi i ofertuesve* e nenit 53 *óShqyrtimi i ofertave*, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, *óPër prokurimin publik* i ndryshuar.

Më hollësisht trajtuar në Pikën 5, faqe 48 deri 74, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

3.1.Rekomandimi: AKUM nëpërmjet strukturave përkatëse, të marrë masa të menjëhershme për eliminimin e praktikave të kualifikimit dhe shpalljes fitues të operatorëve ekonomik në kushtet e mos plotësimit të kriteve të miratuara në DST, procedura të cilat deri më tani kanë sjellë pasoja me efekte negative.

Menjëhere dhe në vazhdimësi

4. Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi i punimeve të realizuara në objekt sipas kontratës óImpianti i trajtimit të ujërave të ndotura në zonën bregdetare Dhralë, Palasë, Lot i parë, u konstatuan mangësitë si më poshtë:

- Tek impianti i trajtimit të ujërave të ndotura nuk është realizuar zëri mbushje me dhe humusor $t=15$ cm, mbi soletën e ITUN.

- Trotuari nuk është ndërtuar sipas specifikimeve teknike pasi nuk është realizuar me pllaka, por me shtresë betoni, në sasinë 80 m^2 për sheshin e impiantit dhe 16 m^2 për stacionin e pompave. Gjithsesi, për këtë trotuar janë realizuar shtresa betoni. Vlera e likuiduar për këtë zë punimi në shumën 153,000 lekë ($96 \text{ m}^2 \times 1,600 \text{ lekë/m}^2$), përbën efekt negativ financiar, pasi konsiderohet funksional.

- Portat hyrëse në impiant dhe stacion pompimi janë ndërtuar me peshë 0.21 ton, ndërsa është certifikuar me peshë 1.7 ton, sipas llogaritjeve si më poshtë:

Elementët e portës 5×5 cm ($t=4$ mm), gjatësi 16 ml, me peshë 98 kg.

Kolonat e mbajtëse, profil 8×8 cm ($t=8$ mm), gjatësi 4 m, me peshë 72 kg.

Rrjeta mbushëse me peshë 40 kg.

Diferenca në peshë rezulton 1.49 ton ($1.7 \text{ ton} - 0.21 \text{ ton}$). Pavarësisht peshës së vendosur, dyert janë funksionale. Vlera 551,300 lekë ($1.49 \text{ ton} \times 185,000 \text{ lekë/ton} \times 2 \text{ copë}$), përbën efekt negativ financiar.

- Sipas zërit I.1.An 34 óKonstruksion metalik çelik i pa oksidueshëm (shkallët, zgarat, kapakët etj.), është certifikuar sasia 2 ton, me çmim 325,000 lekë. Nga verifikimi ilibrezës së masave rezulton se për kapakët e pusetave është certifikuar sasia 1.96 ton. Nga verifikimi në terren i punimeve rezulton se kapakët janë ndërtuar me llamarinë me trashësi 2.5 mm. Nga përlllogaritjet, rezulton se për puseta me dimensione $140 \text{ cm} \times 140 \text{ cm}$ (8 copë), pesha e llogaritur është 0.12 ton për copë, ndërkohë që nga llogaritjet për materialin e vendosur faktik rezulton se një kapak pusete peshon 0.06 ton. Për kapakët e pusetave me dimensione $100 \text{ cm} \times 100 \text{ cm}$ (12 copë), pesha e llogaritur është 0.08 ton, ndërkohë që nga llogaritjet sipas realizimit faktik rezulton pesha 0.035 ton. Sa më sipër është certifikuar më shumë sasia 1 ton ($0.48 \text{ ton} + 0.54 \text{ ton}$). Pavarësisht se kapakët e kryejnë funksionin e përcaktuar, vlera 325,000 lekë ($1 \text{ ton} \times 325,000 \text{ lekë}$), konsiderohet efekt negativ financiar dhe vlera e plotë e efektit negativ është me vlerë 1,029,300 lekë.

Nga verifikimi i punimeve në objekt u konstatuan muri anësor prej beton arme ka pësuar çedim, duke u spostuar në pjesën e fugave. Ky spostim nuk është në distancë të konsiderueshme, por mund të krijojë problem me kalimin e kohës në qëndrueshmërinë e impiantit. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Udhëzimin e KM nr. 2, datë 13.05.2005 óPër zbatimin e punimeve të ndërtimit, kreu III, pika 4.

Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqe 74-102, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

3.1. Rekomandimi: AKUM në bashkëpunim me mbikëqyrësin e punimeve të marrë masa duke i kërkuar kontraktorit përmirësimin dhe rregullimet përkatëse të identifikuara si dhe të realizojë zërin mbushje me dhe humusor mbi soletë, brenda periudhës së garancisë së defekteve.

Brenda periudhës së garancisë së punimeve.

D. MASA ADMINISTRATIVE

D. I - Referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e ndërtimit, përcaktuar në nenin 7/1 dhe 12 Kreu III, të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar dhe Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e

punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kreu II, Pika 3 (si dhe përgjegjësitë individuale të evidentuar dhe pasqyruar në pjesët takuese të Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe komentet e subjektit të audituar), mbështetur në nenin 5 shkronja (b) dhe nenin 9/1, shkronja (a) të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007, ndryshuar, me nenin 12 të ligjit nr. 183/2014 datë 01.04.2013 “*Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme*”, bazuar në nenin 15 dhe nenin 30, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*”, **i rekomandojmë**, Kryeinspektorit të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor Elbasan, **të vlerësojë shkeljet e konstatuara:**

1. Subjektit “**A. M.**” ShPK me përfaqësues ligjor E.M., me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK.2892/2, në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve në objektin ‘*Përmirësimi i furnizimit me ujë për lagjen Krastë e Vogël, Harmes dhe qytetin e Elbasanit*’, për certifikimin e punimeve të pakryera të kryera jo në përputhje me specifikimet teknike me pasojë dëm ekonomik vlerën **10,880,258 lekë pa TVSh.**

Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqe 74-102, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

D. II - Referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e ndërtimit, përcaktuar në nenin 7/1 dhe 12, Kreu III, nenet 15 e 16 të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 “*Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit*” i ndryshuar dhe Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “*Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit*” i ndryshuar, Kreu II, Pika 3 (si dhe përgjegjësitë individuale të evidentuar dhe pasqyruar në pjesët takuese të Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe komentet e subjektit të audituar, mbështetur në nenin 5 shkronja (b) dhe nenin 9/1, shkronja (a) të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007, ndryshuar, me nenin 12 të ligjit nr. 183/2014 datë 01.04.2013 “*Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme*”, bazuar në nenin 15 dhe nenin 30, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*”, **i rekomandojmë**, Kryeinspektorit të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor Vlorë, **të vlerësojë shkeljet e konstatuara:**

2. Nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “**D.**” ShPK me përfaqësues ligjor S.G.& “**H. & S.**” ShPK me përfaqësues ligjor F. B., në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve në objektin ‘*Përmirësimi i Infrastrukturës së Ujërave të Zeza në zonën Bregdetare, Vlorë*’, për certifikimin e punimeve të pakryera të kryera jo në përputhje me specifikimet teknike me pasojë dëm ekonomik vlerën **8,364,636 lekë pa TVSH** si dhe mungesën e aplikimit të penalteteve për vonesa në përfundimin në afat të punimeve, me pasojë përdorim pa efektivitet, eficiencë dhe ekonomicitet në vlerën **25,715,880 lekë pa TVSH.**

Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqe 74-102, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

D. III - Referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e ndërtimit, përcaktuar në nenin 7/1 dhe 12 Kreu III, të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 “*Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit*” i ndryshuar dhe Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “*Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit*” i ndryshuar, Kreu II, Pika 3 (si dhe përgjegjësitë individuale të evidentuar dhe pasqyruar në pjesët takuese të Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe komentet e subjektit të audituar), mbështetur në nenin 5 shkronja (b) dhe nenin 9/1, shkronja (a) të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007, ndryshuar, me nenin 12 të ligjit nr. 183/2014 datë 01.04.2013 “*Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme*”, bazuar në nenin 15 dhe nenin 30, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*”, **i rekomandojmë**, Kryeinspektorit të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor Durrës, **të vlerësojë shkeljet e konstatuara:**

Shoqëria “T.” SHPK, në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve në objektin óNdërtim i kolektorit kryesor të ujërave të zeza ITUP, në zonën turistike të Gjirit të Lalzit, Durrësó,nuk ka verifikuar me korrektësi analizat teknike të çmimeve për zëra të rinj të punimeve, me pasojë dëm ekonomik me vlerë 3,720,837 lekë.

Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqe 74-102, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

E. MASA DISIPLINORE

Bazuar e në referim të nenit nr. 37 të Kodit të Punës të Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995, i ndryshuar, si dhe kontratës individuale të punës, neni 11, i kërkojmë Drejtorit të Përgjithshëm të AKUM fillimin e procedurave për dhënie masë disiplinore, si më poshtë:

“Vërejtje”, për:

1. Znj. L.V.

2. Z. A.C.

Në procedurën e prokurimit me objekt óPërmirësimi i furnizimit me ujë për lagjen Krastë e Vogël, Harmes dhe qytetin Elbasanó, kanë hartuar kritere të cilat nuk janë në përputhje me volumin e kontratës.

Znj. L.V.nuk ka inventarizuar dosjet e prokurimit.

Në procedurën e prokurimit me objekt óPërmirësimi i infrastrukturës së ujërave të zeza në zonën bregdetare Vlorëó, ka hartuar kritere të cilat nuk janë në përputhje me volumin e kontratës.

Znj. A.C.,në procedurën e prokurimit me objekt óImpiant i Trajtimi te Ujerave te Ndotura dhe sistemi KUZ Drimadhe, Dhermió, si anëtare e NjP, ka hartuar kritere të cilat nuk janë në përputhje me volumin e kontratës.

Znj. A.C., në procedurën e prokurimit me objekt óFurnizimi me ujë i zonave turistike Drimadhes, Dhërmi dhe përmirësimi i rrjetit te ujësjellësit te fshatit Dhërmió, ka hartuar kritere të cilat nuk janë në përputhje me volumin e kontratës, si dhe në zbatimin e procedurës së prokurimit óF.V Matësa prodhimi/konsumi dhe pajisje për ndërmarrjet Durrës, Elbasan, Lushnjë, Vlore, Fier, Kavajëó, kanë kualifikuar dhe shpallur fitues një BOE, pasi nuk ka plotësuar kriteret e kërkuara në DST, në lidhje me punë të ngjashme dhe stafin teknik.

3. Z. A.B.

4. Z. E.S., në cilësinë e anëtarëve të njësisë së prokurimit për arsye se:

Në procedurën e prokurimit me objekt óPërmirësimi i furnizimit me ujë për lagjen Krastë e Vogël, Harmes dhe qytetin Elbasanó, kanë hartuar kritere të cilat nuk janë në përputhje me volumin e kontratës.

z. E. S., nuk ka inventarizuar dosje prokurimi.

z. A.B., në procedurën e prokurimit me objekt óF.V Matësa prodhimi/konsumi dhe pajisje për ndërmarrjet Durrës, Elbasan, Lushnjë, Vlore, Fier, Kavajëó, ka hartuar kritere të cilat nuk janë në përputhje me volumin e kontratës.

5. Znj. M.M., në cilësinë e anëtarit të njësisë së prokurimit për arsye se:

Në procedurën e prokurimit me objekt óMpiant i Trajtimi te Ujerave te Ndotura dhe sistemi KUZ Drimadhe, Dhermió, kanë hartuar kriteret të cilat nuk janë në përputhje me volumin e kontratës.

Në procedurën e prokurimit me objekt óFurnizimi me ujë i zonave turistike Drimadhes, Dhërmi dhe përmirësimi i rrjetit te ujësjellësit te fshatit Dhërmió, kanë hartuar kriteret të cilat nuk janë në përputhje me volumin e kontratës.

Nuk ka kryer inventarizime të dosjeve të prokurimit, si dhe në procedurën e prokurimit me objekt óF.V Matësa prodhimi/konsumi dhe pajisje për ndërmarrjet Durrës, Elbasan, Lushnjë, Vlore, Fier, Kavajëó, kanë hartuar kriteret të cilat nuk janë në përputhje me volumin e kontratës.

6. Z. J.O., në cilësinë e anëtarit të njësisë së prokurimit për arsye se:

Në procedurën e prokurimit me objekt óPërmirësimi i infrastrukturës së ujërave të zeza në zonën bregdetare Vlorëó, kanë hartuar kriteret të cilat nuk janë në përputhje me volumin e kontratës.

7. Z. J.Gj.

8. Z. A.M.

9. Z. Z.I., në cilësinë e anëtarëve të njësisë së prokurimit për arsye se:

Në procedurën e prokurimit me objekt óF.V Matësa prodhimi/konsumi dhe pajisje për ndërmarrjet Durrës, Elbasan, Lushnjë, Vlore, Fier, Kavajëó, kanë hartuar kriteret të cilat nuk janë në përputhje me volumin e kontratës.

z. J.Gj.dhe A.M., në zbatimin e procedurës së prokurimit óPërmirësimi i infrastrukturës së ujërave të zeza në zonën bregdetare Vlorëó, kanë kualifikuar dhe shpallur fitues BOE, *i renditur i katërti*, me vlerë 389,375,085 lekë, pasi nuk ka plotësuar kriteret e kërkuara në DST.

z. J.Gj.dhe z. Z.I., gjatë zbatimit të kontratës óNdërtim i kolektorit kryesor të ujërave të zeza ITUP, në zonën turistike të Gjirit të Lalzit, Durrësó, sa i përket çmimeve për zëra të rinj punmesh, janë konstatuar mangësi në hartimin e analizave teknike, me pasojë dëm ekonomik me vlerë 3,720,837 lekë.

10. Z. S.Z.

11. Z. G.LI., në cilësinë e anëtarëve të KVO, për arsye se:

Në zbatimin e procedurës së prokurimit óF.V Matësa prodhimi/konsumi dhe pajisje për ndërmarrjet Durrës, Elbasan, Lushnjë, Vlore, Fier, Kavajëó, kanë kualifikuar dhe shpallur fitues një BOE, pasi nuk ka plotësuar kriteret e kërkuara në DST, në lidhje me punë të ngjashme dhe stafin teknik.

Z. F.M., në zbatimin e procedurës së prokurimit óPërmirësimi i infrastrukturës së ujërave të zeza në zonën bregdetare Vlorëó, kanë kualifikuar dhe shpallur fitues BOE, *i renditur i katërti*, me vlerë 389,375,085 lekë, pasi nuk ka plotësuar kriteret e kërkuara në DST.

z. F.M.,Gjatë zbatimit të kontratës óNdërtim i kolektorit kryesor të ujërave të zeza ITUP, në zonën turistike të Gjirit të Lalzit, Durrësó, sa i përket çmimeve për zëra të rinj punmesh, janë konstatuar mangësi në hartimin e analizave teknike, me pasojë dëm ekonomik me vlerë 3,720,837 lekë.

12. Z. G.A., në cilësinë e anëtarit të grupit të negocimit, për arsye se:

Gjatë zbatimit të kontratës óNdërtim i kolektorit kryesor të ujërave të zeza ITUP, në zonën turistike të Gjirit të Lalzit, Durrësó, sa i përket çmimeve për zëra të rinj punmesh, janë konstatuar mangësi në hartimin e analizave teknike, me pasojë dëm ekonomik me vlerë 3,720,837 lekë.

F.1. PËR PUNONJËSIT E LARGUAR.

Për ish punonjësit e mëposhtëm nuk rekomandojmë masa disiplinore edhe sepse shkeljet e natyrës administrative të konstatuara, pavarësisht se ekzistojnë nuk mund të ezaurohen si të tilla, pasi këto persona nuk janë në marrëdhënie pune me këtë institucion dhe nuk ka adresim institucional për dhënien e zbatimit të tyre.

Nga ana jonë në bazë të shkeljeve të konstatuara masa disiplinore do të ishte:

1. Z. C.K., me detyrë Drejtor i Përgjithshëm, do të rekomandohej *Largim nga puna*, por ky rekomandim konsiderohet i ezauruar pasi ka ndërprerë marrëdhëniet e punës me institucionin.

Nga ana jonë në bazë të shkeljeve të konstatuara masa disiplinore do të ishte *“Vërejtje”*, përkatësisht për:

- 1. Z. I.M.**
- 2. Z. F.M.**
- 3. Z D.Z.**
- 4. Z. I.Sh.**
- 5. Z. Th. M.**

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Shoqërive Publike dhe Investimeve të Huaja.

V. ANEKSE

Aneksi nr. 2.6 *“Mbi zbatimin e kontratave për punime, mallra dhe shërbime:*

- a. Lidhja e kontratave, ndryshimet dhe shtesat përkatëse si dhe realizimi në sasi e cilësi;*
- b. Zbatimi i afateve të përfundimit të kontratave”*

2.6.1 Kontrata: *Përmirësimi i Infrastrukturës së Ujërave të Zeza në zonën Bregdetare, Vlorë’;*

Aneksi nr. 2.6.1.1 *“Tabela shpjeguese e diferencave në volume pune të pakryera ndaj BOE V.H.&B.I&E. për kontratën e sipërmarrjes të lidhur sipas aktit me nr. 2446 prot., datë 26.08.2019 me objekt ‘Përmirësimi i Infrastrukturës së Ujërave të Zeza në zonën Bregdetare, Vlorë’.*

ZONA E LUNGOMARES

- *Zëri Shtresë rëre/Rëra që mbulon tubin*

Sipas situacionit përfundimtar është likuiduar për këtë zë volumni prej 6,720 m³, ose vlera totale prej 8,316,480 lekë pa TVSH, nga të cilat sasia prej 1648 m³,ose vlera prej 1,367,840 lekë pa TVSH për zonën e Lungomares dhe volumni prej 5072 m³, ose vlera prej 6,948,640 lekë pa TVSH për zonën e Fabrikës së Çimentos. Në fakt sipas Specifikimeve Teknike, Relacionit

Teknik dhe preventivit të hartuar nga ana e Projektuesit rezulton se një sasi e volumit të rërës për mbulimin e tubit është parashikuar nën zërat si më poshtë:

- Analizë “*F V tuba të brinjëzuar HDPE SN8 d=160 mm Pn4*”, sasia e parashikuar sipas analizës së projektuesit 0.11 m³/ml;
- 3.An/1t “*F V tuba të brinjëzuar HDPE SN8 d=315 mm*”, sasia e parashikuar sipas manualit 0.15 m³/ml;
- 3.An/2t “*F V tuba të brinjëzuar HDPE SN8 d=400 mm*”, sasia e parashikuar sipas manualit 0.19 m³/ml;
- 3.An/3t “*F V tuba të brinjëzuar HDPE SN8 d=500 mm*”, sasia e parashikuar sipas manualit 0.24 m³/ml;
- 3.An/4t “*F V tuba të brinjëzuar HDPE SN8 d=600 mm*”, sasia e parashikuar sipas manualit 0.24 m³/ml;
- 3.An/5t “*F V tuba të brinjëzuar HDPE SN8 d=600 mm*”, sasia e parashikuar sipas manualit 0.37 m³/ml;

Duke bërë korrigjimet përkatëse për çdo rast rezulton se janë përfitur tepër nga ana e sipërmarrësit volumi si më poshtë:

Nr.	Dimensioni i Tubit	Sasia e Situacionuar	Sasia sipas manualit	Diferenca në Vlerë
1	160 mm ³	153.65	57.6	78,912
2	315 mm	193.27	65.9	90,265
3	400 mm	242.32	88.54	121,300
TOTAL				290,477

Gjithashtu, në lidhje me këtë zë konstatohet se gjatë paraqitjes së volumeve në situacion të marra nga librezat e masave, këto të fundit janë paraqitur me gabime duke bërë që nga ana e sipërmarrësit të përfitohen tepër volumi prej 144.7 m³, ose vlera prej **198,249 lekë pa TVSH**, e argumentuar kjo si më poshtë.

Sipas detajeve të projektit të zbatimit, pusetat janë me gjerësi 1 ml dhe janë të pajisura me një detaj që bën lidhjen e tubit të linjës me pusetën. Nga ana e Projektuesit, në dokumentin *Specifikime Teknike*, faqe 14 citohet se:

“Matja: Linja e qendrës së tubave të brinjëzuara e pusetës në faqen e brendshme të pusetës pasuese përgjatë aksit të tubit”.

Në fakt sipas librezës së masave rezulton se gjatësia e çdo linje të realizuar me shtresë rëre është përlogaritur duke marrë si gjatësi atë nga aksi në aks të pusetave pa zbritur nga kjo distancë gjatësinë prej 1 ml, e cila i korrespondon ½ së diametrit të të dy pusetave si dhe distancën prej 0.5 ml për çdo pusetë që i korrespondon rrethimit me mbushje çaklli të pusetës, ose gjatësinë prej 1 ml. Duke bërë korrigjimet përkatëse rezulton se për çdo dimension tubi janë përfitur tepër volumet e rërës si më poshtë:

$$\begin{aligned}
 &160 \text{ mm } 52 \text{ ml} * 0.29 \text{ m}^2/\text{ml} * 1,370 \text{ lekë}/\text{m}^3 = 20,660 \text{ lekë} \\
 &200 \text{ mm } 292 \text{ ml} * 0.33 \text{ m}^2/\text{ml} * 1,370 \text{ lekë}/\text{m}^3 = 132,013 \text{ lekë} \\
 &250 \text{ mm: } 44 \text{ ml} * 0.38 \text{ m}^2/\text{ml} * 1,370 \text{ lekë}/\text{m}^3 = 22,906 \text{ lekë} \\
 &315 \text{ mm } 37.92 \text{ ml} * 0.15 \text{ m}^2/\text{ml} * 1,370 \text{ lekë}/\text{m}^3 = 7,792 \text{ lekë} \\
 &400 \text{ mm } 57.16 \text{ ml} * 0.19 \text{ m}^2/\text{ml} * 1,370 \text{ lekë}/\text{m}^3 = 14,878 \text{ lekë}
 \end{aligned}$$

- Zëri Tub HDPE SN8 d= 160 mm

³ Në lidhje me këtë zë është hartuar analizë çmimi nga ana e Projektuesit e cila ka parashikuar rërë në sasinë 0.11 m³/ml

- Zëri Tub HDPE SN8 d= 200 mm
- Zëri Tub HDPE SN8 d= 250 mm
- Zëri Tub HDPE SN8 d= 315 mm
- Zëri Tub HDPE SN8 d= 400 mm

Si rrjedhojë e argumentit të dhënë më sipër në lidhje me volumet e rërës, edhe në lidhje me tubacionet konstatohet se gjatë paraqitjes së volumeve në situacion të marra nga librezat e masave, këto të fundit janë paraqitur me gabime duke bërë që nga ana e sipërmarrësit të përfitohen tepër vlera prej **1,094,036 lekë pa TVSH**, e argumentuar kjo si më poshtë.

Nr.	Dimensioni i Tubit	Sasia e Situacionuar	Diferenca në volum	Çmimi	Diferenca në Vlerë
1	160 mm	2745	255	1,340	341,700
2	200 mm	2588	292.14	1,560	455,738
3	250 mm	380	44	1,740	76,560
4	315 mm	445	37.92	1,840	69,773
5	400 mm	466	57.16	2,660	152,045
				TOTAL	1,094,036

Në mënyrë analitike diferencat rezultojnë si më poshtë:

Nr.	Linja	Gjatësia sipas Librezës së Masave	Gjatësia e korrigjuar	Diferenca në sasi
1	456 - 455	51.4	48.00	3.40
2	455 - 439	34	32.00	2.00
3	439 - 191	60.8	58.00	2.80
4	191 ñ 192	15.4	12.00	3.40
5	8-7	24.4	21.00	3.40
6	7-6	30.3	27.00	3.30
7	6-5	26.8	24.00	2.80
8	5-4	21.1	18.00	3.10
9	04 - 267	15.6	13.60	2.00
10	312 - 246	26.9	19.00	7.90
11	245 - 246	21.8	20.00	1.80
12	118 ñ 119	23.3	20.15	3.15
13	119 - 162	21.8	19.06	2.74
14	162 - 209	23.3	20.05	3.25
15	209 - 70	14.4	9.00	5.40
16	70 - 71	17.4	12.00	5.40
17	71 - 03	26.3	23.00	3.30
18	3-51	21.8	19.00	2.80
19	39 - 40	8.7	4.05	4.65
20	40 ñ 51	29.2	27.00	2.20
21	51 ñ 35	12.3	11.00	1.30
22	184 ñ O7	16.4	8.00	8.40
23	290 ñ O9	34.6	31.14	3.46
24	9 ñ 10	8	5.05	2.95
25	10 ñ 11	12.8	10.22	2.58
26	11 ñ 128	21.4	18.40	3.00
27	128 -O10	26.3	26.30	0.00
28	119 ñ 120	14	10.00	4.00
29	120 ñ 98	26.6	24.00	2.60
30	98- 99	12.9	11.00	1.90

31	194 ñ 1	17.4	14.00	3.40
32	1 ñ 22	13.9	11.00	2.90
33	22- 59	12.9	10.00	2.90
34	59 ñ 99	10.2	7.00	3.20
35	99 -O10	35.9	32.00	3.90
36	26 ñ 338	30.3	27.00	3.30
37	338 ñ 31	33	29.00	4.00
38	31 - O1	38.5	36.00	2.50
39	350 ñ 308	48	43.00	5.00
40	308-309	47	44.00	3.00
41	294-176	29.3	28.00	1.30
42	245-246	47.9	41.00	6.90
43	246-281	38.6	35.00	3.60
44	281-171	30.2	26.00	4.20
45	18-17	31.7	30.05	1.65
46	17-49	17.5	14.01	3.49
47	49-70	20.2	17.02	3.18
48	70-69	18.6	17.01	1.59
49	69-77	13	8.01	4.99
50	77-210	17.4	14.06	3.34
51	210-214	13.2	11.08	2.12
52	214-315	25	17.07	7.93
53	315-197	33.4	33.40	0.00
54	197-196	12.7	10.13	2.57
55	11-10	63.2	60.70	2.50
56	10-9	57.2	54.70	2.50
57	9-462	19.8	17.30	2.50
58	462-196	80	77.50	2.50
59	196-318	25.8	23.30	2.50
60	318-362	31.6	29.10	2.50
61	362-414	30.8	28.30	2.50
62	414-233	38.1	35.60	2.50
63	233-147	24.5	22.00	2.50
64	146-141	21	18.50	2.50
65	141-23	19	16.50	2.50
66	23-24	21	18.50	2.50
67	24- Ekzistuese	4	1.50	2.50
68	380-O22	22.4	19.00	3.40
69	247-248	31.1	28.50	2.60
70	248-21	23	20.01	2.99
71	21-O29	54.3	51.02	3.28
72	140-279	22.5	20.50	2.00
73	279-94	23.7	21.60	2.10
74	94-95	11.6	11.60	0.00
75	95-19	28.1	18.40	9.70
76	19-20	8.5	6.10	2.40
77	20-154	24.9	22.30	2.60
78	154-387	43	40.05	2.95
79	387-364	27.5	25.00	2.50
80	364-487	24.3	21.00	3.30
81	464-O34	22.5	19.50	3.00
82	366-364	28.5	28.50	0.00
83	364-22	38.6	34.05	4.55

84	22-372	116.8	114.80	2.00
85	372-373	21.5	18.00	3.50
86	373-376	43.5	40.05	3.45
87	86-O23	31.3	23.70	7.60
88	29-O26	16.7	13.02	3.68
89	82-O25	62.5	59.40	3.10
90	308	4.5	3.50	1.00
91	308	57.2	56.20	1.00
92	PB20	64.2	63.20	1.00
93	29	17	16.00	1.00
94	70	3	2.00	1.00
95	70	4.6	3.60	1.00
96	82	122	121.00	1.00
97	40	4	3.00	1.00
98	71	4	3.00	1.00
Sasia Totale			292.14	

250 mm

Nr.	Linja	Gjatësia sipas Librezës së Masave	Gjatësia e korrigjuar	Diferenca në sasi
1	192-267	24	21.00	3.00
2	276-380	31.4	29.00	2.40
3	380-62	27.9	25.00	2.90
4	62-134	23	20.00	3.00
5	246-311	35.7	32.00	3.70
6	311-150	28.9	26.00	2.90
7	150- O11	16.2	12.00	4.20
8	35-O29	32.5	27.00	5.50
9	309-176	26.6	24.00	2.60
10	176-56	20	18.00	2.00
11	56-57	10.3	8.00	2.30
12	57-265	43.1	39.00	4.10
13	265-170	36.4	34.00	2.40
14	170-171	18	15.00	3.00
Sasia Totale			44	

315 mm

Nr.	Linja	Gjatësia sipas Librezës së Masave	Gjatësia e korrigjuar	Diferenca në sasi
1	134-135	50.8	48.00	2.80
2	135-1	40	37.00	3.00
3	1-2	26	22.00	4.00
4	2-O4	26.1	26.10	0.00
5	171-122	38	36.00	2.00
6	122-O2	12.1	9.02	3.08
7	147-328	45	39.06	5.94
8	328-201	41.8	38.00	3.80
9	201-202	20.7	16.00	4.70
10	202-291	27.6	23.00	4.60
11	291-418	32.6	32.60	0.00
12	418-397	41.6	38.00	3.60
13	397-144	20.4	20.00	0.40

14	144-145	16.6	12.00	4.60
Sasia Totale				37.92

400 mm

Nr.	Linja	Gjatësia sipas Librezës së Masave	Gjatësia e korigjuar	Diferenca në sasi
1	145-206	12.8	8.00	4.80
2	206-169	20.8	18.00	2.80
3	169-170	26.3	23.00	3.30
4	170-174	17.2	14.00	3.20
5	174-175	32.7	30.11	2.59
6	175-75	22	19.40	2.60
7	75-76	16.4	13.27	3.13
8	76-55	17.8	15.31	2.49
9	55-56	12.2	9.17	3.03
10	56-45	14.2	11.20	3.00
11	45-46	7	4.15	2.85
12	46-252	20.6	18.24	2.36
13	252-271	34.2	31.54	2.66
14	271-272	22	19.29	2.71
15	272-335	28.8	26.50	2.30
16	335-285	50	47.65	2.35
17	285-286	14.9	12.14	2.76
18	286-295	27.6	27.25	0.35
19	295-296	17.8	13.12	4.68
20	296-O22	50.7	47.50	3.20
Sasia Totale				57.16

- Zëri Gërmim dheu me ekskavator me goma 0.25 m³, në kanale gjerësi deri në 2 m, tokë e zakonshme, kategoria III, me shkarkim në tokë

Edhe në lidhje me këtë zë, konstatohet se gjatë paraqitjes së volumeve në situacion të marra nga librezat e masave, këto të fundit janë paraqitur me gabime duke bërë që nga ana e sipërmarrësit të përfitohen tepër vlera prej **58,000 lekë pa TVSH**. Kjo vlerë është përfituar tepër pasi, ashtu si edhe në zërat e tjerë, edhe për punimet e gërmimit nuk është zbritur diferenca prej 1 ml për çdo krahë të linjës së tubacionit, punimet e gërmimit për të cilat janë përfshirë në punimet e gërmimit për pusetat.

- Zëri Gërmim dheu kanal me krahë tokë e zakonshme

Edhe në lidhje me këtë zë, konstatohet se gjatë paraqitjes së volumeve në situacion të marra nga librezat e masave, këto të fundit janë paraqitur me gabime duke bërë që nga ana e sipërmarrësit të përfitohen tepër vlera prej **12,789 lekë pa TVSH**. Kjo vlerë është përfituar tepër pasi, ashtu si edhe në zërat e tjerë, edhe për punimet e gërmimit me krahë nuk është zbritur diferenca prej 1 ml për çdo krahë të linjës së tubacionit, punimet e gërmimit për të cilat janë përfshirë në punimet e gërmimit për pusetat.

- Zëri Gërmim dheu me krahë prezencë uji

Edhe në lidhje me këtë zë, konstatohet se gjatë paraqitjes së volumeve në situacion të marra nga librezat e masave, këto të fundit janë paraqitur me gabime duke bërë që nga ana e sipërmarrësit të përfitohen tepër vlera prej **10,869 lekë pa TVSH**. Kjo vlerë është përfituar tepër pasi, ashtu si edhe në zërat e tjerë, edhe për punimet e gërmimit në prezencë uji nuk është zbritur diferenca prej 1 ml për çdo krahë të linjës së tubacionit, punimet e gërmimit për të cilat janë përfshirë në punimet e gërmimit për pusetat.

- Zëri Gërmim shkëmb i fortë me çekiç me ekskavator me zinxhir

Edhe në lidhje me këtë zë, konstatohet se gjatë paraqitjes së volumeve në situacion të marra nga librezat e masave, këto të fundit janë paraqitur me gabime duke bërë që nga ana e sipërmarrësit të përfitohen tepër vlera prej **127,594 lekë pa TVSH**. Kjo vlerë është përfituar tepër pasi, ashtu si edhe në zërat e tjerë, edhe për punimet e gërmimit në masiv shkëmbor nuk është zbritur diferenca prej 1 ml për çdo krahë të linjës së tubacionit, punimet e gërmimit për të cilat janë përfshirë në punimet e gërmimit për pusetat. Gjithashtu, për këtë zë konstatohet se janë përfituar tepër volumi prej 12.02 m³ pasi për 4 pusetat MH 247, MH 248, MH 021 dhe MH 29 që janë paraqitur si të përfshira si në masiv shkëmbor, kur në fakt ky volum është kryer edhe si volum pune për zërin gërmim dheu në po të njëjtën sasi duke bërë që nga ana e sipërmarrësit të përfitohen tepër vlera prej **47,178 lekë pa TVSH**.

- Zëri Mbushje me material të dalë nga gërmimi

Edhe në lidhje me këtë zë, konstatohet se gjatë paraqitjes së volumeve në situacion të marra nga librezat e masave, këto të fundit janë paraqitur me gabime duke bërë që nga ana e sipërmarrësit të përfitohen tepër i njëjti volum me atë të gërmuar, pra sasia prej 200 m³, ose vlera prej **114,000 lekë pa TVSH**. Kjo vlerë është përfituar tepër pasi, ashtu si edhe në zërat e tjerë, edhe për punimet e mbushjes nuk është zbritur diferenca prej 1 ml për çdo krahë të linjës së tubacionit.

- Zëri Largim dheu me auto 3 km

- Zëri Transport materiale ndërtimi, dheu me auto deri 7.0 km (në vlerë diferenca e transportit 10 km-transportin 3 km të kryer)

Edhe në lidhje me këta zëra, konstatohet se gjatë paraqitjes së volumeve në situacion të marra nga librezat e masave, këto të fundit janë paraqitur me gabime duke bërë që nga ana e sipërmarrësit të përfitohen tepër i njëjti volum me atë të gërmuar, pra sasia prej 200 m³, ose vlera prej **92,200 lekë pa TVSH** (200 m³ x 210 lekë/m³ + 200 m³ x 251 m³). Kjo vlerë është përfituar tepër pasi, ashtu si edhe në zërat e tjerë, edhe për punimet e transportit nuk janë zbritur diferenca prej 1 ml për çdo krahë të linjës së tubacionit.

- Zëri Shtresë me çakëll në rrugë me trashësi 0.15 ml

Edhe në lidhje me këtë zë, konstatohet se gjatë paraqitjes së volumeve në situacion të marra nga librezat e masave, këto të fundit janë paraqitur me gabime duke bërë që nga ana e sipërmarrësit të përfitohen tepër sasia prej 21.42 m³, ose vlera prej **28,917 lekë pa TVSH**. Kjo vlerë është përfituar tepër pasi, ashtu si edhe në zërat e tjerë, edhe për punimet e shtresës me çakëll nuk është zbritur diferenca prej 1 ml.

Nr.	Dimensioni i Tubit	Sasia e Situacionuar (ml)	Diferenca në volum (ml)	Gjerësia e kanalit	Lartësia	Volumi
1	160 mm	2745	255	0.56	0.15	21.42

- Zëri Shtresë asfaltobetoni me granil guri kave , 10 cm, me makineri

Edhe në lidhje me këtë zë, konstatohet se gjatë paraqitjes së volumeve në situacion të marra nga librezat e masave, këto të fundit janë paraqitur me gabime duke bërë që nga ana e sipërmarrësit të përfitohen tepër sasia prej 44.1 m³, ose vlera prej **133,182 lekë pa TVSH**. Kjo vlerë është përfituar tepër pasi, ashtu si edhe në zërat e tjerë, edhe për punimet e shtresës me asfaltobeton nuk është zbritur diferenca prej 1 ml e madje nuk janë zbritur as diferenca për efekt të unazës betonarme.

- Zëri Shtresë çakëll me trashësi 20 cm

Edhe në lidhje me këtë zë, konstatohet se gjatë paraqitjes së volumeve në situacion të marra nga librezat e masave, këto të fundit janë paraqitur me gabime duke bërë që nga ana e sipërmarrësit të

përfitohen tepër sasia prej 372 m³, ose vlera prej **316,200 lekë pa TVSH**. Kjo vlerë është përfutur tepër pasi, ashtu si edhe në zërat e tjerë, edhe për punimet e shtresës me çakëll nuk është zbritur diferenca prej 1 ml.

- Zëri Shtresë betoni me trashësi 15 cm

Edhe në lidhje me këtë zë, konstatohet se gjatë paraqitjes së volumeve në situacion të marra nga libreza e masave, këto të fundit janë paraqitur me gabime duke bërë që nga ana e sipërmarrësit të përfitohen tepër sasia prej 16.4 m³, ose vlera prej **126,116 lekë pa TVSH**. Kjo vlerë është përfutur tepër pasi, ashtu si edhe në zërat e tjerë, edhe për punimet e shtresës me beton nuk është zbritur diferenca prej 1 ml.

ZONA E FABRIKËS SË ÇIMENTOS

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se në mënyrë të ngjashme me zonën e Lungomares është vepruar edhe për zonën e Fabrikës së Çimentos duke bërë që nga ana e sipërmarrësit të punimeve të përfitohen tepër volume për zërat me vlerat respektive sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Zëri	Njësia	Sasia	Çmimi	Vlera
1	Gërmim dheu me ekskavator me goma 0.25 m ³ , në kanale gjerësi deri në 2 m, tokë e zakonshme, kategoria III, me shkarkim në tokë	m ³	670	290	194,300
2	Gërmim dheu kanal me krahë tokë e zakonshme	m ³	151.6	580	87,928
3	Gërmim dheu me krahë prezencë uji	m ³	31.3	670	20,971
4	Shtresë rëre/Rëra që mbulon tubin	m ³	749.5	1,370	1,026,815
5	Mbushje me material të dalë nga gërmimi	m ³	359.4	570	204,858
6	Tub HDPE SN8 d=200 mm	ml	610	1,560	951,600
7	Tub HDPE SN8 d=250 mm	ml	142	1,740	247,080
8	Tub HDPE SN8 d=315 mm	ml	88	1,840	161,920
9	Tub HDPE SN8 d=400 mm	ml	106	2,660	281,960
10	Tub HDPE SN8 d=160 mm	ml	333	1,340	446,220
11	Shtresë rëre	m ³	393.8	830	326,854
12	Largim dheu me auto 3 km	m ³	852.9	210	179,109
13	Transport materiale dertimi, dheu me auto deri 7.0 km (në vlerë diferenca e transportit 10 km-transportin 3 km te kryer)	m ³	852.9	251	214,078
14	Shtrese asfaltobetonit me granit guri kave, 10cm, me makineri	m ²	204.4	3,020	617,288
15	Shtrese çaklli me trashësi 20 cm	m ²	563.9	850	479,315
16	Shtrese çakall rruge me trashësi 0.15 ml	m ³	35.7	7,690	274,533
SHUMA					5,714,829

Në total, rezulton se për të dyja zona janë përfutur tepër nga ana e sipërmarrësit të punimeve vlera prej **8,364,636 lekë pa TVSH** e cila përbën dëm ekonomik dhe si e tillë duhet të arkëtohet ndaj sipërmarrësit të punimeve.

Aneksi nr. 2.6.1.2 “Tabela shpjeguese e pagesave të kryera ndaj BOE V.H.&B.I&E. për kontratën e sipërmarrjes të lidhur sipas aktit me nr. 2446 prot., datë 26.08.2019 me objekt “Përmirësimi i Infrastrukturës së Ujërave të Zeza në zonën Bregdetare, Vlorë”.

Situacioni	Data e Faturës tatimore	Vlera	Data e Memos	USH nr. Datë	Shuma e paguar		Total
					Aktualisht	5%	
Nr. 1	05.02.2019	97,768,406	06.12.2019	nr. 565 datë 10.12.2019	92,879,986	4,888,420	97,768,406

Nr. 2	29.02.2020	15,600,000	14.09.2020	nr. 326 datë 15.09.2020	14,820,000	780,000	15,600,000
	10.03.2020	18,000,000	14.09.2020	nr. 327 datë 15.09.2020	17,100,000	900,000	18,000,000
	24.08.2020	16,400,000	14.09.2020	nr. 328 datë 15.09.2020	15,580,000	820,000	16,400,000
Nr. 3	30.09.2020	16,054,800	15.12.2020	nr. 456 datë 18.12.2020	15,252,060	802,740	16,054,800
	31.10.2020	43,945,200	15.12.2020	nr. 457 datë 18.12.2020	41,747,940	2,197,260	43,945,200
	31.10.2020	10,000,000	15.12.2020	nr. 540 datë 28.12.2020	9,500,000	500,000	10,000,000
Nr. 4	24.12.2020	40,000,000	28.12.2020	nr. 544 datë 28.12.2020	38,000,000	2,000,000	40,000,000
Nr. 5	12.04.2021	20,000,000	22.04.2021	nr. 114 datë 30.04.2020	19,000,000	1,000,000	20,000,000
SHUMA		277,768,406				SHUMA	277,768,406

Aneksi nr. 2.6.1.3 “Tabela shpjeguese e penaliteteve të pa aplikuar për dorëzimin me vonesë të situacionit nr. 5 dhe mos dorëzimit deri në fund të afatit të auditimit të situacionit nr. 6 për kontratën e sipërmarrjes të lidhur sipas aktit me nr. 2446 prot., datë 26.08.2019 me objekt ‘Përmirësimi i Infrastrukturës së Ujërave të Zeza në zonën Bregdetare, Vlorë’.

Vlera e punimeve të kryera jashtë afatit të kontratës	1/1000 e vlerës (për kontrata me afat mbi 12 muaj)	Data e situacionit	Ditë e vonese vonesë ⁴	Vlera e pa aplikuar e penalitetit
99,840,000 ¹	0.001	02.03.2021	15	1,497,600
84,091,249	0.001	-	288	24,218,280
SHUMA				25,715,880

Aneksi nr. 2.6.2.1 “Shpjegimi i diferencave në volume pune të pakryera ndaj BOE L.&B.&A.K.&B. për kontratën e sipërmarrjes të lidhur sipas aktit me nr. 2446 prot., datë 26.08.2019 me objekt ‘Përmirësimi i furnizimit me ujë për lagjen Krastë e Vogël, Harmës dhe qytetin e Elbasanit’.

Nga krahasimi i volumeve të punës të situacionuara, me volumet e pasqyruara në librezën e masave si dhe referuar detajeve të projektit të zbatimit, verifikimit në terren të punimeve të ndërtimit si dhe dokumentacionit të dorëzuar në Autoritetin Kontraktor rezultojnë se janë përfituar tepër nga ana e sipërmarrësit të punimeve BOE L.&B.&A.K.&B. shuma prej **10,880,258 lekë pa TVSH**. Konkretisht kjo vlerë argumentohet si më poshtë:

- e. Nga sondazhet e kryera për kategorinë *Furnizimi me ujë i zonës Krastë e Vogël* rezultojnë se nuk është realizuar zëri *Mbushje me çakëll e gur guroR.e në trupin e rrugës, përhapur e ngjeshur me makineri*, ose vlera prej 140,340 lekë pa TVSH dhe as zëri *Shtresë stabilizanti t=15 cm*, ose vlera 374,396 lekë pa TVSH. Pra në total janë përfituar tepër nga ana e sipërmarrësit të punimeve vlera prej **514,736 lekë pa TVSH**;
- f. Sipas dokumentacioni fotografik të ndodhur në dosjen teknike rezultojnë se nuk është realizuar

⁴ Penalitet janë përlogaritur duke marrë për bazë datën e dorëzimit të akteve të konstatimit nga Audituesit Shtetëror të KLSH, afat ky i cili duhet të përlogaritet saktësisht deri në datën e lëshimit të Urdhër pagesës nga ana e Autoritetit Kontraktor.

shtresa e rërës në nivelin kuotës së poshtme të tubit, ose thellësia prej 10 cm nën çdo dimension tubi, duke bërë që të përfitohen tepër nga ana e sipërmarrësit të punimeve vlera prej 801 m³ (ky volum është përlllogaritur në bazë të gjatësive të situacionuara të tubave me Dj 160 mm, 140 mm, 110 mm, 90 mm, 75 mm, 63 mm, 50 mm, 40 mm, 32 mm, 25 mm dhe 20 mm, gjerësive të gërmimit për çdo seksion tërthor si dhe një thellësie prej 10 cm, e cila është parashikuar në nivelin e kuotës së poshtme të tubit). Për rrjedhojë duke bërë përlllogaritjet rezulton se i janë paguar tepër sipërmarrësit të punimeve vlera prej **760,950 lekë pa TVSH**;

- g. Sipas situacionit progresiv nr. 3 rezulton se e gjithë sasia e gërmuar e materialit është transportuar dhe po kjo sasi materiali është situacionuar edhe nën zërin *An. Depozitim dheu në vend depozitim*. Në fakt në dosjen teknike nuk disponohet asnjë autorizim nga ana e Bashkisë Elbasan mbi miratimin e vendit të depozitimit të materialeve të gërmuara, nuk disponohet një plan i organizimit të punimeve dhe as miratim nga ana e mbikëqyrësit të punimeve. Sipas relacionit nr. 1 të mbikëqyrësit të punimeve, në pikën 5 është bërë përshkrimi për realizimin e zërave të punimeve të kryera për punimet e Depo 1000 m³ të ndërtuar në Harmes. Sipas këtij relacioni është shprehur fakti se materiali është shkëmbor dhe nuk mund të përdoret për mbushje (!!!) dhe ka mungesë hapësire për depozitim në vend e për pasojë sasia e materialit të gërmuar prej 2,380.2 m³ sipas relacionit është transportuar dhe depozituar përmes hapjes, rrafshimit dhe spostimit në një vend më pak se 10 km nga vendi në të cilin është gërmuar. Në fakt, gjatë verifikimit në terren u konstatua se sasia e materialit shkëmbor të gërmuar rezultoi e pa transportuar pasi është përdorur si taban në sheshin përballë depos. Referuar *Specifikimeve Teknike*, pika 2.20 *Analiza e çmimit njësi të punimeve të gërmimit*, përcaktohet se: “Aty ku materiali i gërmuar është përdorur për mbushje, depozitimi duke përfshirë edhe transportin nga depozitimi, ngarkimin, shkarkimin, transportin me dorë, etj. janë të përfshirë në çmimin njësi nga gërmimet”. Për rrjedhojë rezulton se nga ana e sipërmarrësit të punimeve është përfituar tepër vlera e punimeve për transportin dhe depozitimin e materialit shkëmbor të gërmuar pasi edhe puna e kryer faktikisht për ngjeshjen dhe krijimin e tabanit të përmendur më sipër është parashikuar në çmimit për punimet e gërmimit. Duke bërë korrigjimet rezulton se vetëm për punimet e kryera në kategorinë *Ndërtim Depo 1000 m³, Harmes, Elbasan* janë përfituar tepër vlera 570,000 lekë pa TVSH për transportin e materialit si dhe vlera 1,140,000 lekë pa TVSH për depozitimin e materialit, ose **1,710,000 lekë pa TVSH** në total. Gjithashtu, gjatë verifikimit në terren për punimet e kryera në kategorinë *Furnizim me ujë i zonës Krastë e Vogël* rezultoi se materiale të dala nga punimet e gërmimit ndodheshin brenda kantierit në të cilin mbaheshin materialet e ndërtimit, një pjesë e tyre rezultoi e përdorur për mbushjen e kanaleve dhe në shumë raste këto materiale gjendeshin të shkarkuara në pronat private. Në kushtet si më sipër kur nuk dokumentohet të paktën depozitimi si vend i miratuar nga Njësia Vendore Bashkia Elbasan, kur nga verifikimi në terren nuk u konstatua asnjë pikë e depozitimit të materialeve e cila të argumentojë kryerjen e zërit *An. Depozitim dheu në vend depozitim*, ky volum pune rezulton të jetë përfituar padrejtësisht nga ana e sipërmarrësit të punimeve, volum për të cilin është likuiduar vlera prej **7,894,572 lekë pa TVSH** (199,290 lekë pa TVSH për kategorinë *Punime për linjën DN-200, PE-100-PN-10 të kthimit nga depo e re*, 1,959,000 lekë pa TVSH për kategorinë *Punime për linjën DN-400 PE-100,PN-10, depo Kraste e Vogël deri në unazë*, 173,082 lekë pa TVSH për kategorinë *Punime për linjën DN-200,PE-100-PN-10 të zonës së varrezave*, 887,400 lekë pa TVSH për kategorinë *Punime për linjën DN-200, PE-100, të furnizimit të depos së re, Hermas*, 4,675,800 lekë pa TVSH

për kategorinë *Furnizimi me ujë i zonës Krastë e Vogël*).

Aneksi nr. 2.6.2.2 “Materiali fotografike i kryer gjatë inspektimit në terren të punimeve”.



Fig. 1 Mungesa e rërë poshtë kuotës së poshtme të tubit



Fig. 2 Hedhja e rërës pas vendosjes së tubit



Fig. 3 Verifikimi i fraksioneve të zhavorrit



Fig. 4 Verifikimi i fraksioneve të zhavorrit



Fig. 5 Verifikimi i shtresës së stabilizantit dhe çakllit në Objektivin Furnizimi me ujë në zonës Krastë e Vogël

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT